

Bashkia Shkodër
Biblioteka “Marin Barleti”

Gegnia

e përkohshme kulturore-artistike

*12 - 2020
Vjeti V i botimit,
Shkodër*

Gegnia

E përkohshme kulturore-artistike

12-2020

Vjeti V i botimit,

Shkodër

Redaksia:

Maxhid Cungu, Gjovalin Çuni, Arben Prendi, Ermira Alija

Redaktor gjuhësor: Erzen Koperaj

**Botohet nën kujdesin e Bashkisë Shkodër
dhe Bibliotekës “Marin Barleti”**

ISSN: 2519-73-91

Adresa e redaksisë: Biblioteka “Marin Barleti”, Shkodër

E-mail: info@bashkiashkoder.gov.al

info@bibliotekashkoder.com

Shënim: *Pikëpamjet e artikullshkruesave nuk shprehin detyrimisht qëndrimin e redaksisë.*

Përmbajtja

▪ Viti i Fishtës ▪

Tonin ÇOBANI

Kanuni i Lekë Dukagjinit, Gjeçovi dhe Fishta 5

▪ Albanologji ▪

Aurel PLASARI

Një bibliotekë kombëtare: ideja lindi në Shkodër..... 8

▪ Intervistë ▪

Ermira ALIJA

“Adrianit, Da Vinçit tonë të ardhshëm” -

Intervistë me artistin A. Paci 19

▪ Histori ▪

Ardian MUHAJ

Shkodranët në galerat tregtare të Venedikut drejt Europës

Veriore në shek.XV 28

Italo SARRO

Padre Salvatore da Offida e padre Paolo da Mantova 37

Hamza KAZAZI

Kryengritja e Postribës dhe roli i Jup Kazazit në përgatitjen e saj 60

Ndue BACAJ

Një rikujtesë për 100 - vjetorin e “Luftës së Koplikut” (1920-2020) 74

▪ Trashëgimi kulturore ▪

Vasil TOLE

Muzika popullore qytetare post-aheng (gjysma e dytë e

shekullit XIX deri më sot) 82

Eno KOÇO

Gjon K.Kujxhia dhe rëndësia e veprës “Valle Kombëtare”

në muzikologjinë shqiptare 90

Arben PRENDI <i>Shkodra përmes vështrimeve etnografike e kulturore të studiuesit Gj.Sheldia</i>	108
▪ Kritikë letrare ▪	
Arjeta FERLUSHKAJ <i>Mesjeta ime: roman-à-clef</i>	113
▪ Kritikë letrare ▪	
Gëzim PUKA <i>Drama e jetës së Lekë Tasit dhe “Arka e Noes”</i>	132
▪ Letërsi ▪	
Ag APOLLONI <i>Sandalet e Senekës</i>	136
Stefan ÇAPALIKU <i>Xhaketë teke (fragment romani)</i>	147
Durim TAÇI <i>“Një prani në ikje” (fragment romani)</i>	156
Rudof Marku <i>Poezi dhe përkthime</i>	171
▪ Aforizma ▪	
Dhimitër DHORA 15 aforizma nga koha e pandemisë nga COVID-19	177
▪ Bibliofili ▪	
Valbona BERDICA <i>Refleksion për revistën e parë në Shkodër</i>	179
Gjovalin ÇUNI <i>Pak rreshta për ish-kolegun dhe përkthyesin Ferit Hafizi</i>	197
▪ Filateli ▪	
Lorenc KAÇULINI <i>Arkeologjia në pullat shqiptare</i>	201
▪ Kronikë kulturore ▪	
<i>Mysafirët e Festivalit letrar të Shkodrës</i>	206

▪ Viti i Fishtës ▪

Tonin Çobani*

KANUNI I LEKË DUKAGJINIT, GJEÇOVI DHE FISHTA

Qëllimi kryesor në librin tim “Gjergj Fishta dhe Kanuni i Lekë Dukagjinit”- pat qenë paraqitja e meritueshme e profileve të tre personaliteteve të kulturës sonë kombëtare, disi të zhvleftësuar ndër mote; kush më shumë e kush më pak.

I pari, Lekë Dukagjini, autor i Kanunit të shqiptarëve, jo vetëm sepse ai Kanun mban emrin e tij: Lekë Dukagjini në kulturën shqiptare është si Sokrati për filozofinë greke apo Konfuci për kinezët. Ata, edhe pse nuk lanë vepra të skalitura, njihen si autorë të rëndësishëm, së paku, në kulturat nacionale respektive.

I dyti, Shtjefën Gjeçovi, që mblodhi, e sistemoi dhe e la të shkruar Kanunin e Lekë Dukagjinit në një gjuhë, sa të bukur në kumbim, aq të saktë dhe ekonomike në komunikim: për pasojë, një gjuhë edhe potente e vepruese (*perlokutive*¹)² Gjeçovi me Kanunin e Lekë Dukagjinit në *Mbajtur në “Festivalin Letrar të Shkodrës”.

¹ Në kontrast me aktet *locutionary* dhe *illocutionary* (të cilat janë nivele të tjera të përshkrimit, në vend së llojeve të ndryshme të akteve të të folurit, Austin John1.. (1962) *si të bëni gjëra me fjalë*, Oxford OUP, p.101: Duke thënë diçka, më shpesh, apo edhe normalisht, prodhojnë *certain* pasuese mbi ndenjat, mendimet ose veprimet e audiencës, ose e folësit, ose të personave të tjerë, dhe kjo mund të bëhet me projektimin, qëllimin, ose qëllimin i prodhimit të tyre.

² Ndryshe nocionit të *aktit locutionary*, i cili përshkruan funksionin gjuhësor të një mënyrë të të folurit, një efekt *perlocutionary* është në një kuptim të jashtëm të performancës. Kjo mund të mendohet, në një kuptim, si efekt i aktit *illocutionary* nëpërmjet aktit *locutionary*. Prandaj, kur shqyrton aktit *perlocutionary*, efekti mbi

gjuhën shqipe ka meritat e Vëllezërve Grim për gjuhën gjermane dhe në kulturën evropiane.

I treti, është Gjergj Fishta³. Ai u përfshi edhe emocionalisht në frymën e Kanunit, duke nxitur Gjeçovin në punën e tij disavjeçare dhe duke përgatitur një studim të thelluar si parathënie që shoqëron botimin përfundimtar të Kanunit. Si del edhe nga ai studim, poeti ynë besonte se shqiptarët në Ballkan kanë këngët e tyre epiko-legjendare (Cikli i kreshnikëve). Ligjet e organizimit të jetës shoqërore (Kanuni i Lekë Dukagjinit) edhe një epike të lavdishme që po krijohet ndërsa kombi shqiptar po rilindte. Ajo rilindje këndohet në veprën *Lahuta e Malcis*, që po shkruante ndërkohë Gjergj Fishta, prandaj është quajtur me të drejtë Poet Kombëtar. Dhe, si dihet, në fillimet e tij poetike Fishta ka shkruar poezinë lirike, “Gjakësorëve”, që fillon me vargjet “Ndalnju ku veni, burra” për të penguar fisin e vet në rrugën e gjakmarrjes, pasi poetit ia vranë vëllain më të madh, Çupin, më 1899.

Nga ana tjetër, për të krijuar këta profile në mënyrë sa më autentike, më është dashur t’i pastroj skicë –portretet e tyre nga njollat apo shtrembërimet që u janë shtruar rrugës deri në ditët e sotme.

Shtrembërimi i parë ka nisur trojeve ballkanike diku nëpër darkat shqiptare, me pyetje të mbetura pezull: a ka ekzistuar apo jo një princ me emrin Lekë Dukagjini? Dhe, a ka qenë ky pinjoll i Dukagjinëve, vërtetë, një ligjëbërës? Apo, e ka përvetësuar ligjin nga Leka (Aleksandri) i Madh, duke ia imponuar me dhunë shqiptarëve të principatës së vet e më gjerë? Meqë pyetje të tilla kanë mbetur pa përgjigje ideologjike të kënaqshme, Lekë Dukagjini edhe sot e kësaj dite nuk është përfshirë si zë më vete në të dy botimet e Fjalorit Enciklopedi Shqiptar.

Shtrembërimi i dytë vjen përtej oqeanit për t’u shpërfaqur në Ballkan dhe më gjerë. Ai iniciohet prej Stavri Skëndos, një intelektual me autoritetet e diasporës shqiptare. Prandaj shtrembërimet të tilla të formuluar nga penda e tij, si: “*gjëja e vetme që bën një shqiptar*, të themi, i kanunizuar apo i indoktrinuar nga Kanuni i Lekë Dukagjinit, është të vrasë tjetrin për dy gisht nder”, qarkullojnë si postulate pa autor edhe në ditët e sotme.

Kam synuar të argumentoj se pa u pastruar çdo përmendje e Kanunit nga keqinterpretimet të kësaj natyre, nuk mund të zhvillohet asnjë

dëgjuesit apo lexuesit është e theksuar

³ Gjergj Fishta është emri i Zefit, të birit të Ndokë Simonit. Ai lindi më 31 tetor 1871 dhe vdiq më 30 dhjetor 1940.

diskurs serioz, jo më të gjykohet për përqendrimet konkrete lidhur me të, me Kanunin e Lekë Dukagjinit, pra, si trashëgimi kulturore.

Edhe një shtrembërim tjetër vjen prej përtej ujërave, por në këtë rast jo përtej oqeanit, por përtej detit Adriatik. Atje jetonte shkrimtari Ernest Koliqi, i cili mendonte të kundërtën e Stavri Skëndos, d.m.th.se ruajtja e atij “dy gisht nderi” ndër shqiptarë është shenjë origjinaliteti, gjë e cila nuk duhet trazuar nga kultura perëndimore... e gjëra të tilla.

Edhe ky interpretim në ekstremin e tjetër e shtrembëron çdo diskurs mbi Kanunin. Fishta vetë e ka mallkuar gjakësorin edhe nëse ai mbron dy gisht a dy pëllëmbë nder të shpallur nga çdo kanun a ligj, lindor qoftë a perëndimor. Sepse Fishta i ka vënë vetes detyrë të mbrojë shqiptarin dhe Kanunin që ka mbrojtur ndër shekuj shqiptarin dhe shqiptarinë: vetëm një Kanun i tillë është traditë kulturore, është qytetari.

Më është dashur, së fundmi, që, në këtë sprovë letrare të titulluar “Gjergj Fishta dhe Kanuni i Lekë Dukagjinit” t’i kundërvihem opinionëve të papërgjegjshme mediatike të sotme, që vijnë jo vetëm për shkak të shtrembërimeve të natyrës që shtrova më sipër, por edhe për hir të keqmenaxhimeve të situatave të tranzicionit e deri te mungesa e profesionalizmit të atyre që bëjnë gazetari, opinionizëm a politika zhvillimi...

▪ Albanologji ▪

Aurel PLASARI *

NJË BIBLIOTEKË KOMBËTARE: IDEJA LINDI NË SHKODËR

Edhe pse i botuar mes një morie dokumentesh të tjera, njoftimi duket të mos ketë tërhequr vëmendjen për përmbajtjen e tij. Në 100-vjetorin e Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë ai meriton të lexohet siç lypset, duke u nxjerrë në dukje. Njoftimi gjendet ndër dokumentet diplomatike të shërbimit konsullor austro-hungarez që mbulonte “Shqipërinë turke”, më vonë edhe Shqipërinë e pavarësuar deri kur vetë monarkia e Danubit ra.

Në një telegram të datës 8 shkurt 1912, që konsulli i Austro-Hungarisë në Shkodër i ka dërguar eprorit të tij në Vjenë, kontit Von Aerenthal, e ka vënë në dijeni për një Qarkore të Klubit “Gjuha Shqype” të Shkodrës. Do t’i kthehem këtij Klubi në vendin përkatës. Në botimin shqip të korpusit të dokumenteve *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze*, vëll. I (Tiranë 2014) është shënuar për nënshkrimin e konsullit “firma **Biblioteka Publike “Marin Barleti” i shpreh mirënjohjen më të thellë Prof. Aurel Plasarit për kontributin e vyer të dhënë në fushën e bibliotek-ekonomisë shqiptare. Prof. Plasari në postin e drejtorit të Bibliotekës Kombëtare na u gjend gjithnjë pranë, jo vetëm me këshilla, por edhe në nxitjen e promovimit të vlerave arkivore të bibliotekës sonë.*

e palexueshme”, por nënshkrimi i përket padyshim konsullit Zambaur. Simbas njoftimit të konsullit Klubi “Gjuha Shqype” ua ka shpërndarë Qarkoren e përmendur konsullatave të huaja, veprimtarëve që punojnë në vend, si edhe personaliteteve të huaja që interesohen për zhvillimin e kulturës së vendit: Miss. Durham, Baron Nopcsa, Dr. Steinmetz etj., pra tre albanologëve veprues të asaj kohe për çështjen shqiptare. Në lidhje me të konsulli ka njoftuar ministrin: “Sikurse Shkëlqesia juaj do të denjojë ta kuptojë nga ajo vetë [Qarkorja] Klubi në fjalë ka ndër mend të ngrejë një Bibliotekë kombëtare në Shkodër”: *“Wie Eure Exzellenz demselben hochgeneigtest zu entnehmen geruhen beabsichtigt der erzählte Klub die Errichtung einer nationalen Bibliothek in Scutari”*.

Konsulli Zambaur ka shtuar që ka biseduar vetë, për këtë qëllim, me disa nga personalitetet drejtuese të Klubit në fjalë dhe ata i kanë thënë se klubi do të jetë mirënjohës për çdo dhurim librash “të cilët merren me çështjet shqiptare dhe me gjuhën shqipe”. Pra fjala qenkësh për një bazë albanologjike të “bibliotekës kombëtare” kështu të ideuar. “Duke mbajtur parasysh ndikimin që ushtron Klubi mbi çështjet e këtushme kombëtare, - u ka sugjeruar konsulli eprorëve, - jam i mendimit se është në interesin tonë që, me anë të një dhurimi të madh librash, të zëmë një vend kryesor në listën e mirëbërësve”. Për të mundur përzgjedhjen e veprave që t’i shërbenin qëllimit, konsulli ka rekomanduar edhe përdorimin e bibliografisë së Pekmezit. E ka pasur fjalën për veprën unike në atë kohë – ende sa pa qarkulluar *Bibliografia shqiptare* e z. Legrand – *Albanesische Bibliographie*, Zusammengestellt von Ing. F. Manek, Dr. G. Pekmezi, Ob-Leut. A. Stotz, Eien 1909. Konsulli ka propozuar edhe një shumë që do të duhej shpenzuar për blerjen e librave: 6 deri 7 mijë korona.

Qarkorja, që duket të ketë qarkulluar gjerë, do të duhet kërkuar ende në fondet e AQSh, ku me siguri kopje do të gjendet. Të mbahet parasysh që Klubi “Gjuha Shqype” ka shpërndarë më shumë se një qarkore. Në vargun e dokumenteve të përmendura të diplomacisë austro-hungareze të vitit 1912 nuk del e regjistruar Qarkorja, por një “kërkesë” pak më e hershme e Klubit drejtuar konsullit Zambaur në Shkodër, e formuluar si vijon:

“Shkodër, më 15 janar 1912.

Shkodër e Shqipërisë.

Zotëri, kemi nderin t’ju bëjmë në dije se Klubi “Gjuha Shqipe” është duke mbledhur gjithfarë veprash që kanë lidhje me gjuhën tonë dhe

me kombësinë tonë [sic] me qëllim që të ngrejë një bibliotekë për të ndihmuar arsimin popullor. Duke pasur bindjen, zotëri, se ju do të keni mirësinë t'j jepni ndonjë libër kësaj biblioteke për të kontribuar në këtë mënyrë në çështjen e ngritjes së ndjenjave patriotike të popullit, kemi nderin t'ju drejtojmë shprehjen e mirënjohjes sonë më të thellë dhe të përshëndetjeve tona më të mira.

Kryesia e Klubit “Gjuha shqipe”, Shkodër.

Adresa; “Klubi shqiptar”, Shkodër e Shqipërisë”.

Vihet re që teksti i 15 janarit (*Shqipëria në dokumentet austro-hungareze*, I, nr. 43) nuk e përmend konceptin “kombëtare” për bibliotekën që është ideuar të ngrihet. Përveç kontrollit të Qarkores që Zambauri ka përmendur, konceptin e “bibliotekës kombëtare” konsulli mund ta ketë përsaktësuar edhe prej vetë drejtuesve të Klubit posa që në telegramin drejtuar eprorit në Vjenë kishte shënuar: “Në lidhje me këtë [idenë për ngritjen e bibliotekës] unë jam kujdesur të zhvilloj bisedime me drejtuesit kryesorë të këtij bashkimi...”.

Për ç'u takon “drejtuesve” të Klubit mendja nuk mund të mos të shkojë, më së pari, te një mësues dhe atdhetar aktiv si Matí Logoreci (1867-1941), ndër themeluesit dhe drejtuesit e Klubit “Gjuha Shqype”. Edhe pak vite më vonë emri i tij do të rezultojë mes emrave që hedhin bazat e Bibliotekës mirëfilli kombëtare. Marrëdhëniet e Logorecit me autoritetet austro-hungareze do të kenë qenë të favorizuara edhe nga faktet që jo vetëm Kolegja Saverjane e Etërve jezuitë, ku ai qe shkolluar qysh në të parin vit të themelimit të saj (1877), mbahej me subvencionet e Austrisë, por edhe shkolla e Prizrenit ku ai kishte shërbyer si mësues ishte mbajtur për do kohë me të tilla subvencione si juridiksion i Arkipeshkvisë së Shkupit (*Mémoire über Albanien*, tabelat e subvencioneve gjatë viteve 1894, 1895, 1896 për kryedioqezat dhe dioqezat në Shqipëri, f. 6: *Lehrer Logoresi und Gehilfe Ljumezzi in Prisren*). Për qarkoret e lëshuara nga vetë Logoreci duhet thënë se ai rezulton autor i një numri të tillash të Klubit “Gjuha Shqype” deri te njëra nga të fundit, e vitit 1938, që e ka filluar pikërisht me fjalët: “Kemi thanë e rithanë, shkruet e rishkruet deri sa me mërzitë lexuesit e ktyne qarkorevet...” (“Java”, Tiranë 1938, nr. 46/4, 8 prill).

* * *

Të shkoqisim tani diçka lidhur me Klubin “Gjuha Shqype” të

Shkodrës. Ai ishte njëri ndër klubet e shumta që u çelën në viset shqiptare të Perandorisë osmane – edhe përtej tyre – duke përfituar nga i ashtuquajti revolucion xhonturk, në të cilin shqiptarët luajtën rol të dorës së fortë, dhe përkatësisht nga lëshimet që kishte premtuar për kombësitë e ndryshme të Perandorisë partia e paraqitur si “Komiteti Bashkim e Përparim”: *İttihat ve Terakki Cemiyeti*. Të tilla klube, me profil patriotik-kulturor të nënkuptuar politik, u organizuan nga shqiptarët në Stamboll, Kostancë të Rumanisë, Manastir, Gjirokastrë, Janinë, Filat, Shkup, Dibër, Korçë, Pogradec, Elbasan, Tiranë, Shkodër, deri në Mitrovicë (AQSh, fondi 102: Koleksioni i shoqërive dhe klubeve shqiptare 1893-1912). Një dëshmi nga koleksionet e Bibliotekës Kombëtare: njëri prej ekzemplarëve të këngës së dytë të veprës *Lahuta e Malcis* të Fishtës (Zadra 1907), që ruhet aty, mban vulën “Klubi Shqyptar n’ Shkup”. I ka përkitur bibliotekës së publicistit atdhetar Jashar Erebara, që ka shënuar në të me dorë të vet: “Klubi shqyptarë në Shkup: sa u ba - shpallë Hyrieti u hap edhe Klubi”.

E shumta e këtyre klubeve u mbyllën përdhuni prej xhonturqve mbas lëvizjeve politike të shqiptarëve që patën marrë guxim nga të shpallurit e “Kushtetutës” (1908). Klubet në fjalë e kishin kundërshtinë brenda vetes posa që në statutet e tyre qenë detyruar të shënonin se nuk do të merreshin me politikë, ishin pra organizime “me një deriçkë anadollake”, siç e vuri re Noli (“Dielli”, Boston 1909, nr. 1, 15 shkurt). Shqiptarët, me t’u zhdehur, ia dolën t’i organizonin përsëri disa syresh.

Klubi “Gjuha Shqipe” në Shkodër, që këtu intereson, u themelua për herë të parë më 29 shtator 1908. Revista *Leka*, ndoshta për shkak të një konflikti të hershëm me nismëtarin e vërtetë të themelimit të Klubit dhe me idetë e tij për një arsim laik, e ka përshkruar themelimin në fjalë me “nismën” e fotografit shkodran Kel Kodheli, vijues i firmës “Marubbi” (“Leka”, Shkodër 1937, nr. 6, 272-275). Kontributi i spikatur i Kelit të Marubbit në këtë histori nuk mund të mohohet: ateljeja e tij, për vetë veçantinë si studio fotografike e hapur për publikun, kishte funksionuar qysh prej vitit 1903 si njëfarë “klubi i mbëshehët”, ku mbledheshin në takime atdhetarë të Shkodrës dhe jo vetëm. Ndër shumë emra që fotografi atdhetar ka kujtuar më vonë bien në sy: Ndoc Çoba, Át Gjergj Fishta, Át Pashko Bardhi, Mit’hat Frashëri, Luigj Gurakuqi, Matí Logoreci, Fuad Toptani, Lazër Gurakuqi etj. (“Leka”, po aty. Edhe AQSh, fondi 102, dosja 192). Pos avantazhit që i krijonte atelieja, Kel Kodheli kishte qenë anëtarësuar në partinë *İttihat ve Terakki*, çfarë i

jepte edhe mundësinë të shpërndante në Shkodër organe që hynin ilegalisht nga jashtë, si *La Nazione Albanese* të Anselmo Lorecchios dhe *Albania* të Faik Konicës, duke i mbuluar me shpërndarjen e së përkohshmes *Osmanli* të xhonturqve të Brukselit, pra të partisë së tij. Si anëtar i partisë xhonturke ai kishte nxjerrë edhe lejen, që është ruajtur, për botimin e një gazete gjysmë turqisht dhe gjysmë shqip (“Leka”, Shkodër 1938, nr. 1-3, 89/691-90/692). Duke përfituar nga ky status “partiak” i fotografit u mundësua edhe krijimi më 1908 në Shkodër i Klubit “Gjuha Shqype” dhe në historikun e Klubit është shënuar: “Per leje s’kish nevojë, pse mjeftote cilltija e Kelit si jeun-turc”.

Për saktësi historike nisma për themelimin e Klubit “Gjuha Shqype” duhet t’i njihet Matí Logoreci, sikundër është dëshmuar edhe në shtypin e kohës: “N’ marim t’ mujt Shtatorit u ngrehnë n’ gjytet t’ Teutës dy klube, njeni i emnuem “Gjuha Shqype”, tjetri “Gegnia”. Klubi i parë i themeluar prej t’ nershmit zotnij Matí Logoreci, atdhetar i përmendun n’ çastje t’ kombit t’ onë e n’ përmirsi t’ gjuhës [...] Ka për qëllim t’përhapunit e ndjenjave kombtare e mësimin e gjuhës nër ata Shqyptarë qi s’e dinë të këndojnë e të shkruajnë” etj. (“Kombi”, Boston 1908, nr. 106, 26 tetor 1908). Për Karl Gurakuqin, njohës nga pranë i personazheve të kohës, lejen për Klubin e kishte nxjerrë Matí Logoreci së bashku me Lazër Gurakuqin (“Mësuesi”, Tiranë 1929, nr. 8-9-10, 276). Në listat e anëtarësisë së Klubit të 1908-s emri i Matí Logoreci del i shënuar me nr. 1.

Qysh në themelimin e Klubit “Gjuha Shqype” qenë regjistruar 146 anëtarë, të cilët sa venin e shtoheshin, të interesuar për të ndjekur fjalimet atdhetare që mbanin Matí Logoreci, Lazër Gurakuqi, Karlo Suma e të tjerë (“Leka”, Shkodër 1937, nr. 6, 273). Selia ku mbledheshin ishte një lokal që e kishte marrë me qera Imz. Jak Serreqi, arkipeshkv i Shkodrës (po aty). Me synimin për të përfshirë edhe pjesën myslimane të popullsisë së qytetit në veprimtaritë për gjuhën shqipe, Klubi formoi edhe një degë më vete të emërtuar “Bashkimi”. Të mos ngatërrohet me “Bashkimin” e 1899-s. Atdhetari Riza Dani u dallua në drejtimin e këtij “Bashkimi” të 1908-s. Atëherë shpërtheu një konflikt mes dy bashkësive të qytetit, myslimane e katolike. Puna kishte shkuar deri në armiqësi të shpallur mes mbështetësve të alfabetit latin dhe mbështetësve të alfabetit arab për shkrimin e gjuhës shqipe. Ishte, siç do të zbulohet, konflikt i provokuar nga vetë xhonturqit nëpërmjet agjentëve të tyre gjysmëzyrtarë dhe autoritetet turke përfituan për ta mbyllur Klubin përdhuni, me polici. Për

atë bandë aventurierësh në të cilën kishte përfunduar partia “Bashkim e Përparim” në çdo hap emancipimi kulturor që hidhte bashkësia katolike e Shqipërisë kishte gisht diplomacia austro-hungareze.

Në një raport të konsullit austro-hungarez Pallavicini nga Stambolli për ministrin Aehrenthal, të 16 marsit 1910, citohen në ligjëratë të drejtë fjalët e vezirit të madh Ibrahim Haki Pasha një deputeti të njohur të Shqipërisë: “Dëshirën e shqiptarëve për të pranuar alfabetin latin Qeveria [xhonturke] e quan si hap të parë për shkëputjen e tyre nga Turqia. Qeverisë i duhet të bëjë çmos dhe do të bëjë çmos për ta ndaluar përdorimin e alfabetit latin” (HHStPA, PA XIV/24 Albanien). Në një broshurë pak të njohur, të botuar më 1911 nën inicialet E. b. V., Eqrem bej Vlora citonte një qarkore që autoriteti më i lartë i myslimanëve, Sheh-Ul-Islami, u kishte dërguar më 5 prill 1910 të gjithë myftinjve të Shqipërisë për ta refuzuar alfabetin latin për gjuhën shqipe dhe për ta ndaluar “rreptësisht” përdorimin e tij në shkollat shqipe (*Die Eährheit über das Vorgehen der Jungtürken in Albanien*, Eien / Leipzig 1911, 21).

Prishja e Klubit “Gjuha Shqype” të Shkodrës u bë lajm ndërkombëtar, e trajtoi jo vetëm shtypi shqiptar jashtë Shqipërisë, por edhe shtypi anglez (“Times”), ai grek (“Pyrros”) etj. Nga gazeta “Kombi” e Bostonit reagoi vrazhdë Fan Noli duke ia vënë fajin fanatizmit të myslimanëve të Shkodrës që, simbas tij, kurrë nuk ushqyen shpresën e guximshme që mund të bëheshin “njerëz të rinj” me të shpallurit e Kushtetutës. Mundet edhe e teproi duke i ballafaquar ata me myslimanët e Toskërisë, “të cilët që prej kohe kanë kuptuar ç’do të thotë qytetërim” (“Kombi”, Boston 1908, nr. 108, 26 nëntor). Gjithsesi edhe ai ishte i vetëdijshëm që konflikti i Shkodrës që provokuar nga intrigat e xhonturqve: “Xhonturqit zunë të tremben kur panë që shqiptarët e paskan me gjithë zemër atdhetarizmën dhe çelë brenda në aq pak kohë 15 klube dhe 4 gazeta, edhe menjëherë zunë të vënë spica. Sa për intrigantë s’mënuan të gjenin sa të donin. Shqiptarë grekomanë e turkomanë ka sa të duash” (“Kombi”, Boston 1909, nr. 2, 27 shkurt).

Klubi “Gjuha Shqype” u organizua përsëri. Më 24 dhe 31 dhjetor 1910 një grup të rinjsh shkodranë, pa iu trembur andrallave, i paraqitën Bedri Pashës lutjen për lejen e çeljes së Klubit “Gjuha Shqype” në bazë të të drejtave që u jepte “Kushtetuta” e shpallur. Leja, e ruajtur me tekstin në turqishte osmane, u erdhi më 3 janar 1911 dhe Klubi i riorganizuar u lidh me “Bashkimin” e Stambollit, që konsiderohej klub

“central” (“Leka”, Shkodër 1937, nr. 6, 322-326). Gazeta “Bashkimi” e Dom Ndoc Nikajt, organ i shoqatës “Bashkimi” të 1899-s, e ka njoftuar këtë “të çelun” të Klubi të ri në numrin e saj të datës 29 janar 1911. Ka çekur aty edhe faktin se ceremoni përrurimi nuk ishte kryer ende ngaqë pritej ardhja e Imz. Jak Serreqit, kryetar nderi i Klubit. Në AQSh ruhen certifikata e lejes lëshuar nga valiu i Shkodrës, shpallja e kryesisë së Klubit, “Kanunet” e tij, letrat e aderimit në Klub të Luigj Gurakuqit dhe Dom Ndoc Nikajt, ftesa dhe lajmërimet për mbledhjet e anëtarësisë së Klubit, procesverbale të mbledhjeve, dëftesa të financave të Klubit etj. (AQSh, fondi 102, dosje 188, 189, 190). Duke mbajtur parasysh që bëhej fjalë për një shoqatë të miratuar e të kontrolluar nga administrata xhonturke, në variantet e statuteve të Klubit (*Kanune të Klubit “Gjuha Shqype”*) të ruajtura në AQSh dhe të riprodhuara nga *Leka*, çështja e “bibliotekës” duket të jetë trajtuar në mënyrë të kamufluar, duke u shënuar vetëm “T’ çilunit e t’ mbajtnit e një salon leximit”.

Nga listat e ndryshme të anëtarësisë së Klubit të 1911-s rezultojnë 161 anëtarë, një përzierje kërshërore personalitetesh intelektuale të saj kohe dhe përfaqësuesish të familjeve të njohura tregtare të Shkodrës. Nuk mund të mos bien në sy ndër ta arkiveshkvijtë në zë për përfshirjen e tyre në lëvizjen kombëtare, të cilët kanë qenë edhe baza e shoqërisë së mëhershme “Bashkimi” të themeluar më 1899 në Shkodër nga Abati Prend Doçi: Imz. Jak Serreqi, Imz. Nikollë Kaçorri dhe Imz. Gjergj Koleci ipeshkv. Ashtu bien në sy edhe emra veprimtarësh të tjerë të spikatur po të “Bashkimit” të dikurshëm, si Dom Ndoc Nikaj, Át Gjergj Fishta, Át Pashko Bardhi, mësuesit Gaspër Beltoja, Gaspër Mikeli, Matí Logoreci etj. Po, sepse edhe Matí Logoreci pati qenë ndër anëtarët e “Bashkimit” të mëparshëm dhe qe larguar prej tij tok me vëllezërit Mjeda – i kishte kushërinj – kur Dom Ndreu qe prishur me “Bashkimin” për shkak të mendimit të ngulmët në alfabetin e vet. Prandaj, meqë ra fjala, Logoreci vajti në Kongresin e Manastirit si përfaqësues i shoqërisë “Agimi” të vëllezërve Mjeda dhe i alfabetit të saj, jo i “Bashkimit”, që aty u përfaqësua nga Fishta dhe Gurakuqi.

Ky ka qenë pra Klubi që në janar të vitit 1912, ende në “Shqipërinë turke” dhe pikërisht në ndërkohën e Xhemijetit xhonturk, pati ndër mend të ngrinte një “bibliotekë kombëtare” në Shkodër, siç njoftonte konsulli Zambaur dhe siç kuptohet nga fushata e Klubit për grumbullimin e librave dhe botimeve periodike. Për kërshëri të organizimit le të saktësohet që në qershor të po atij viti kryetar i Klubit rezulton Ndoc

Çoba, i cili në mbledhjen e përgjithshme të Klubit më 9 qershor 1912 ka mbajtur ligjëratën *Giuhë e komsí* ("Leka", Shkodër 1937, nr. 8-12, 508-513). Tani, duke pasur para syve qoftë edhe vetëm emrat autoritarë të përmendur sipër, emra që në kulturën shqiptare kanë bërë histori, ideja e një projekti për "bibliotekë kombëtare" vjen plotësisht e kuptueshme.

Do të ishte me interes që zhvillimi i atij projekti të ndiqej edhe më imtë nëpër burimet dokumentare në dy drejtime: 1) Nga njëra anë, në ato të diplomacisë austro-hungareze, prej të cilave kuptohet që puna për mbledhjen e librave për bibliotekën në fjalë ka vijuar qysh atë vit (1912), duke filluar më 23 shkurt me telegramin e udhëzimeve që ministria e Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë i jepte konsullit Zambaur në Shkodër për blerjen e librave "pa përmbajtje politike" për bibliotekën në fjalë (*Shqipëria në dokumentet austro-hungareze*, I, nr. 191); 2) Nga ana tjetër, në letërkëmbimin e Klubit me personalitete të ndryshme jashtë Shqipërisë, të cilëve u qe drejtuar me Qarkoren e përmendur për projektin në fjalë. Në AQSh ndodhet një pjesë me vlerë e letërkëmbimit të kryesisë së Klubit "Gjuha Shqype" me klubet e tjera shqiptare, si Klubi "Bashkimi" i Stambollit, Klubi "Bashkimi" i Elbasanit etj., por edhe me personalitete të ndryshme të kohës, si Mihal Grameno, Mihal Xoxa etj., pikërisht për të mbledhur libra për bibliotekën e ideuar (AQSh, fondi 102, dosje 192).

Një numër librash që mbajnë vulën "Klubi "Gjuha Shqype" Shkodër" janë trashëguar në Bibliotekën Kombëtare. Ata fillojnë nga një botim i rrallë i vitit 1908 me titull *Rrnésa e bulkut n' t' maajtun t' baktis*. Është, me sa kuptohet, fillimi i një kolane botimesh, të këputur në mes, të Klubit të 1908-s nën syzën "Libra për popull". Me riorganizimin e Klubit më 1911 edhe botimet e tij rezultojnë të riorganizuara tanimë nën emërtesën editoriale si "Klubi "Gjuha Shqype" n' Shkodër". Nr. 1 ndër këto botime është *Kndime t'para për t'rritshëm*, Shkodër 1911 (Shtypshkronja "Nikaj"). Edhe pse pa autorësi, i ka gjasat të jetë vepër e Matí Logorecit, posa që edhe numrat 2 dhe 3 të së njëjtës kolane janë vepra po të tij: *Ndollina historiket t'motshme t'përmbledhuna prejë M. Logorecit*, Blëe i I / Blëe i II (Klubi "Gjuha shqype" n' Shkodër, Nr. 2 dhe Nr. 3, Shtypshkroja "Nikaj" 1911). Klubi i 1911-s i ka shtypur botimet në një shtypshkronjë private, atë të klerikut atdhetar Dom Ndoc Nikaj, deri më 1914 kur duken të jenë ndalur për shkak të shpërthimit të Luftës së Madhe. Një listë e botimeve të Klubit mund të shihet po në AQSh (fondi 102, dosje 193).

* * *

Në vitet '50 të shekullit të kaluar, kur u përvijuan skicimet e para të historikut të Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë, fillet e saj u lidhën tek institucioni i njohur si *Komisija Letrare Shqipe*. Afërmendsh që në atë kohë burimet dokumentare të shërbimit diplomatik austro-hungarez nuk njiheshin. *Komisija Letrare Shqipe* (1916-1918) ishte një komision gjuhëtarësh dhe shkrimtarësh që, në kontingjencat e Luftës I Botërore dhe nën regjimin e pushtimit austro-hungarez, u organizua në Shkodër pranë Drejtorisë së Arsimit me qëllim që të zgjidhte një varg problemesh të gjuhës shqipe dhe të përdorimit të saj në administratë dhe shkolla mbas dy kongreseve të Manastirit (1908, 1910). E pakta nga konferenca shkencore organizuar në Shkodër në 100-vjetorin e themelimit të saj (“Komisia Letrare Shqipe në Shkodër: ngjarje me rëndësi historike dhe gjuhësore”), *Komisija* ka filluar tanimë të rivlerësohet si një institucion ku janë hedhur bazat e institucioneve të mëvonshme kërkimore-studimore për gjuhën dhe letërsinë shqipe. Pjesa autoritare e anëtarëve të *Komisís* vinin sa nga “Bashkimi” i 1899-s, edhe nga Klubi “Gjuha Shqype” i 1911-s: Át Gjergj Fishta, Luigj Gurakuqi, Dom Ndre Mjeda, Matí Logoreci (këta edhe nga “Agimi”) etj. Dhe një saktësim, për t’u vënë re, nga Karl Gurakuqi: në ndërkohën e fundit të *Komisís* (1919) kryetar i saj ka qenë Matí Logoreci (*Shkrimtarët shqiptarë*, II, f. 132).

Lidhja e Bibliotekës Kombëtare te *Komisija Letrare Shqipe* nxirret nga një informacion që ka dhënë *Fletorja zyrtare* e datës 10 dhjetor 1922, vit i përrurimit të Bibliotekës Kombëtare. Duhet saktësuar “vit i përrurimit”, duke qenë se Biblioteka Kombëtare rezulton e themeluar, me një akt të Ministrisë së atëhershme të Arsimit, më 10 korrik 1920 dhe me drejtor pikërisht të njohurin Matí Logoreci (“Koha”, 28 gusht 1920). Vetë drejtori Logoreci qysh atë vit ka drejtuar disa thirrje për pasurimin e Bibliotekës Kombëtare (“Zani i ri”, 9 gusht 1920; “Gazeta e Korçës”, 18 gusht 1920; “Populli”, 27 gusht 1920 etj.). Ministria e Punëve të Brendshme, në fillim të vitit 1921, lëshoi njërin ndër aktet themelore detyruese të ekzistimit të një biblioteke kombëtare: qarkoren “Mbi dërgimin e kopjeve të detyruara të çdo botimi Bibliotekës së Shtetit” (“Qarkoret e M.P.B të vjetit 1921”, nr. 2, 58). Pra të merremi vesh mirë: nëse i qëndrojmë themelimit të Bibliotekës Kombëtare më 1920, duke ia festuar këtë vit 100-vjetorin, atëherë i pari drejtor i saj rezulton Matí Logoreci, jo siç mëton ndryshe Ministria e sotme e “Kulturës”.

Në njoftimin e çekur te *Fletorja zyrtare* e 1922-shit, në një bisedë me

rastin e përrurimit të Bibliotekës Kombëtare pranë Ministrisë së Arsimit, drejtori i ri Karl Gurakuqi ka kujtuar sesi në rrethanat e “pushtimit të ushtrivët Austro-Magjare” *Komisija Letrare* në Shkodër më 1917 ka pas parë të nevojshme themelimin e një biblioteke. Kjo e dhënë lexohet në vetë botimin zyrtar periodik *Lajmet e Komisë Letrare Shqipe në Shkodër*, nr. 1, kallënduer 1918, si vijon:

“Më 16 të Prillit [1917] u themelue bibliotheka e Komisë Letrare, d.m.th. Biblioteka e Shqipnis. Muerën pjesë në këtë mbledhje z.z. Gurakuqi, Mjedja, Peci, Logoreci, Mosi, Naraçi. Kryekomanda i kishte çuem Komisë një letrë me nr. 1106 me 28.III.1917, qi foli mbi trajtimin e bibliothekës së Komisë. U vendue: I ngarkohet z. Mosit me marrë listën e libravet, qi kanë shtypshkrojat “Nikaj” [dhe] e “Zojës papërlyeme”.”

“Biblioteka e Shtetit u themelua në Shkodër”: kështu e ka njoftuar shtypi atë ngjarje (“Dielli”, Boston 1919, 13 gusht). Puna për pasurimin e bibliotekës së *Komisës* ka vijuar edhe gjatë vitit 1918, kur nga “e Nalta Komandë në Shqipni” u lëshua edhe urdhri për dorëzimin e detyruar në bibliotekën e *Komisës* të dy kopjeve nga çdo botim në territorin shqiptar (*Lajmet e Komisë Letrare Shqipe në Shkodër*, nr. 1, kallënduer 1918, 27). Karl Gurakuqi ka treguar sesi në vitin 1920, kur qeveria e re qe vendosur në Tiranë, ministri i atëhershëm i Arsimit Sotir Peci ka dhënë urdhrin që biblioteka e *Komisës* të shpërngulej nga Shkodra në Tiranë. Duke qenë ai vetë njëri ndër pjesëtarët e mbledhjes së prillit 1917, kur ajo bibliotekë qe themeluar, Peci e ka ditur se për çfarë bëhej fjalë. I ngarkuar me shpërnguljen e saj, Karl Gurakuqi e ka kryer atë duke e bartur bibliotekën e *Komisës* pranë Ministrisë së Arsimit në Tiranë më 10 korrik 1920, çfarë pajton me datën zyrtare të vendimit të ministrit të atëhershëm të Arsimit për themelimin e Bibliotekës Kombëtare. Në korrik të vitit 1922 në gazetën pararendëse të *Fletores zyrtare* njoftohej: “Karl Gurakuqi emërohet drejtor i Bibliotekës së Shtetit” (“Dit’ e re”, Tiranë 1922, nr. 20, 16 korrik).

Ndër materialet e pasura të veprimtarisë së *Komisës Letrare Shqipe* në Shkodër, që ruhen, mund të ndiqen të dhënat prej të cilave kuptohet sesi kanë kaluar në trashëgiminë e *Komisës* edhe fonde në libra e botime periodike sa të vetë Klubit “Gjuha Shqype”, aq edhe të mbledhura prej tij për projektin e vet të bibliotekës (AQSh, fond 447 etj.).

Ideimi i një projekti të tillë qysh prej fillimit të vitit 1912, pra kur Shqipëria nuk kishte dalë ende shtet i pavarur, e meriton të regjistrohet

në histori si njëri nga aktet më të rëndësishme të Klubit “Gjuha Shqype” në Shkodër. Pa dyshim që ishte projekt i cili nuk mund të kryhej sa hap e mbyll sytë; nuk bëhej fjalë thjesht për “grumbullim librash”, por për vendosjen e një guri themeli në institucionalizimin e kulturës kombëtare. Projekti i ideuar u zhvillua dhe bëri përpara shkallë nga një shkallë: nga biblioteka e Klubit “Gjuha Shqipe” në Shkodër te biblioteka e *Komisís Letrare Shqipe* po në Shkodër, mandej te shpërngulja si bibliotekë pranë Ministrisë së Arsimit në Tiranë deri te themelimi i Bibliotekës Kombëtare më 1920 dhe përrurimi i saj më 1922.

▪ Intervistë ▪

Ermira ALIA

“ADRIANIT, DA VINÇIT TONË TË ARDHSHËM”**- Intervistë me artistin Adrian Paci -**

Piktori shkodran Adrian Paci, një ndër artistët bashkëkohorë shqiptarë ma të njohun brenda dhe jashtë vendit, ndan me ne përmes intervistës me studiuesen Ermira Alia, emocionet dhe arritjet e punës së tij të admirueshme shumëvjeçare. Ndër emocionet e veçanta të kësaj interviste asht të kujtuemit e poetit Zef Zorba i cili me intuitën dhe gjeninë e poetit kishte pa te fëmija artistin e ardhshëm tue i dhurue një libër me dedikimin “Adrianit, da Vinçit tonë të ardhshëm”. Me këtë rast artisti Paci shprehë pikëpamjet e veta për artin, shoqinë por edhe për situatën politike në vend, veçanërisht reagimin e tij kundër shembjes së Teatrit Kombëtar. Siç shprehet Paci:Ku ka transformim ka patjetër edhe krizë, edhe dhimbje, por një identitet i hapun e përjeton këtë krizë si një moment vital ku bashkëjetojnë humbja dhe fitorja, kujtesa dhe dëshirat, mungesa dhe pasunimi me eksperiencë të reja. Identitetet e ngurtësue janë të destinueme ta jetojnë në mënyrë tragjike transformimin e pashmangshëm. Ka edhe kjo bukurinë e vet.

Shpia ku ju jeni rritë Adrian në Shkodër, ashtë në një rreth, ku ka një denduri të çuditshme artistësh, një pjesë të të cilëve mbase

i keni njohë e një pjesë jo. Njëkohësisht jeni rritë ndoshta duke dialogue me piktura e vizatime të përfundueme e të papërfundueme të babës tuej, që kanë zëvendësue në një fare mënyre komunikimin e gjallë, qysh kur ishit 7 vjeç. Besoj se, edhe kur vinit tek shtëpia e hallës tuej, vetëm pesë minuta në këmbë larg, kishit një komunikim të afërt jo vetëm me të, por përsëri edhe me pikturën, pasi ajo ishte bashkëshortja e piktorit Ndoc Gurashi. Ç’gjurmë kanë lanë e ç’ndikim kanë pasë këto qasje tek ju dhe arti juej?

Sigurisht që unë jam rritë në një ambjent ku arti ka qenë një prezencë e randësishme. Ju përmendet punimet e tim eti që më kanë shoqnie vazhdimisht, por edhe librat e tij të cilët unë nuk mbërrijsha me i lexue mbasi ishin shumica në rusisht e unë isha shumë i vogël, por i mbaja në dorë duke soditë imazhet e riprodhimeve ku rrëmoja ndër fotot e pikturave të Rembrand, Frantz Haltz, Tiziano, Leonardo, Velasques, por edhe Gauguin, Van Gogh etj. Mbandej vizitat tek miqt e babës në studiot e tyne. Në veçanti Ismail Lulani të cilin e kisha edhe mësues vizatimi në Shtëpine e Pionierit. Im atë kishte themelue në Shkollën e Muzikës Degën e Arteve Figurative, por vdiq vetëm pak ditë mbasi u hap viti shkollor. Danish Jukniu, erdhi në vend të tij e unë shkoja qysh i vogël e vizatoja krah liceistëve nën vëzhgimin e afërt të Danishit. Nuk ishin vetëm artistët por edhe artdashësit apo njerëzit e kulturës pjesë e atij ambjenti që më rrethonte. Shpesh shkoja e i baja vizitë Zef Zorbes, i cili banonte përballë shtëpisë sonë të cilin e thërrisja “daja Bep”. Ai më jepte letër e lapsë e unë ulesha afër tij e vizatoja. Një ditë më dhuroi një libër të Leonardo da Vinci-t me një dedikim që e ruej edhe sot: “Adrianit, Da Vincit tonë të ardhshëm”. Për një fëmijë të vogël ky ishte një stimul i jashtëzakonshëm. Më kujtohet se jam ulë e kam kopjue shumë vizatime nga ai libër megjithëse isha vetëm 8 vjeç. Një herë mbaj mend se po lueja futboll me kushërinin tem Zefin te rrugica përballë derës së Lukajve. Padashje na ra topi në oborrin e tyne e na më shumë frikë trokitëm në derë, mbasi e dinim se zonjusha Ana Luka ishte mjaft e rreptë me femijët që tesh e parë e bezdisnin duke i kërkue topin. Ajo hapi derën me një shikim të ngrysun, por sapo na pa ne të dy, u qesh në fytyrë e nxori gati një klithmë hareje: “Oh, artistat!”

Ju keni mbarue Akademinë e Arteve në Tiranë, por edhe kursin “Arte e Liturgia” pranë institutit Beato Angelico në Milano. Keni

dhanë mësim në disa Akademi të Arteve në Shqipëri dhe jashtë saj (Milano, Bergamo, Venecia). Jeni një artist që keni hapur ekspozita jo vetëm në vendet ma të randësishme të Evropës, si: Itali, Gjermani, Londër, Spanjë, Suedi, Francë, Zvicër... por edhe në Amerikë, Lindjen e Mesme etj. Në këto pjesëmarrje ju jo vetëm që keni afirmuar personalitetin tuaj si artist, por edhe jeni bënë njohës i mirë i shkollave, tendencave dhe i personaliteteve të artit bashkëkohor (kujtoj këtu që jeni zgjedhë edhe pjesë e Jurisë së Festivalit të Filmit të Marsejës). Si mendoni, në një botë të madhe, ku flitet për shumë shkolla dhe kur kemi parasysh Shqipërinë si një vend të vogël, me histori të ndërlikueme mbylljeje politike e ekonomike, a mund të flitet për një shkollë shqiptare artiapo mund të flitet për individualitete - shqiptarë?

Mendoj se arti shqiptar doli nga mbyllja dhe izolimi me një dëshirë të fortë dhe entuziazëm gati naiv për të kapë hapësinat e mungueme e të mohueme të artit ndërkombëtar. Ndërkohë bota, që nga izolimi ynë na dukej kollaj e lexueshme, e ndame në imperialiste e revizioniste, në materialiste e në idealiste, në kapitaliste e proletare, në realiste e abstrakte, në fakt ishte shumë më e koklavitun, më shumë sfumatura e më shumë dritëhije. Padyshim edhe kapërcimi i sundimit modernist me vertikalitetin e tij heroik dhe përvijimi i një menyre të ashtuquejtun post moderniste, ku shprehjet kulturore shartoheshin e shtresëzimet mbivendoseshin pa e përjashtue njena-tjetrën, e kishte bënë botën ma konfuze por edhe ma vibruese se ndamjet e ngurta me të cilat ishim mësueme me e lexue nga izolimi ynë. Artistët shqiptarë në këto kushte nuk e kishin luksin të paraqiteshin me “shkollën e tyre”, por mundem me thanë se askujt nuk ia kishte marrë mendja se një numer jo edhe aq i vogël artistesh shqiptare të dalë nga izolimi i thellë do t’i imponoheshin individualisht skenës nderkombëtare të artit jo vetëm me forcën e historive që rrëfenin, por edhe me rafinimin dhe ndjeshmëninë e gjuhës artistike që përdornin. Nëse ka pika të përbashkëta në punët e artistëve shqiptare që të bënë të mundun një kohezion stilistik, kjo asht herët për me u thanë, por një shikim kritik e një analizë edhe mund të fillohet me u bënë. Nga ana tjetër mendoj se brezi ma i ri i artistëve që ka fillue me dalë në skenë mbas viteve 2000 ka një tjetër ndjeshmëni e për rrjedhojë, një tjetër estetike. Mandej patjetër seicili artist ka gjurmën e vet e ndoshta sot mundet me tingellue edhe disi anakronike cilësimi

“shkollë shqiptare e artit”.

Në janar të 2019-ës, në auditorin e Museut të Arteve Moderne në Romë, keni mbajtur një *lectio magistralis* me temë: Zhvendosje dhe hapje (Spostamenti e aperture) që kishte objekt zhvendosjen e vendit ose të këndvështrimit, që hap perspektiva dhe perceptime të reja të kontekstit, të së tashmes dhe të vetvetes. Në kuadrin e një debati të hershëm e të vazhdueshëm mbi identitetin dhe në kuadrin e punës tuej që ashtë vlerësue si kërkim i identitetit kulturordhe personal në ndryshimin e vazhdueshëm, si mendoni, a sjell kjo zhvendosje dhe ky ndryshim i vazhdueshëm krizë identiteti?

Identiteti nuk mundet me qenë veçse në krizë. Thjesht varet a do ta përjetojë në mënyrë të ndërjegjshme apo do ta vuaj si viktimë e pandërgjegjshme faktin se çdo gjâ rreth tij ndryshon, se koha kalon, se hapësira transformohet, se pikat e referimit spostohen vazhdimisht dhe sistemet e vlerave nuk janë të përleshëm. E vetmja mundësi për identitetin ashtë të transformohet duke ruajtur vazhdimësinë nëpërmjet ndryshimit. Ku ka transformim ka patjetër edhe krizë, edhe dhimbje, por një identitet i hapun e përjeton këtë krizë si një moment vital ku bashkëjetojnë humbja dhe fitorja, kujtesa dhe dëshirat, mungesa dhe pasunimi me eksperiencën të reja. Identitetet e ngurtësue janë të destinueme ta jetojnë në mënyrë tragjike transformimin e pashmangshëm. Ka edhe kjo bukurinë e vet.

Si medium përndjesitë tuaja artistike, keni zgjedhë në fillim pikturën, skulpturën dhe pastaj keni vazhduer me fotografinë dhe filmin. Çfarë mund të na thoni për këtë? Asht rritja emocionale dhe e mendimit që e ban njeriun të kërkojë forma të reja shprehjeje, nuk e di nëse mund të themi të gjuhës kinematike të shprehjes? Apo janë tendencat e artit që propozojnë?

Unë pikturën nuk e kam zgjedhë, kam kaluar natyrshëm nga zhgarravinat feminare tek penelat e format ma të artikulueme, gjithmonë duke e konsiderue vizatimin e pikturën si ambjentin e natyrshëm të shprehjes artistike. Në vitet e shkollës, ku nxanësi e ma vonë studenti kërkon me eksperimentue e me dalë përtej asaj që asht e njoftun dhe e pranue, akademizmi i imponuem e mbante të ndrydhun tendencën për eksplorime. Gjithsesi, sot mendoj se ai rrotullim i vazhdueshëm

mbrenda të njëjtit territor stilistik, ka prodhues gjithsesi një formë interesante përsiatjeje ku familjariteti me gjuhën e pikturës përpëlitej me e gjetë risinë ndër detaje të vogla ma shumë implicite sesa explicite. Dalja nga Shqipëria në 1992 e ma vonë ikja në 1997, padyshim i dhanë një dimension lirie këtij kërkimi duke e bërë kurioz ndaj formave të tjera shprehëse. Gjithsesi mundem me thanë se video arti apo instalacioni e fotografia nuk ishin mjete të reja në vetvete. E re, apo ma mirë me thanë e freskët, mund të ishte qasja ndaj tyre. Por për ta ndërtue këtë qasje nuk mjafton vetëm dëshira për eksperimentim formal. Duhet shtyja ma të thella, motive ma të forta, që bëjnë të mundun që forma me marrë jetë e pa sforcueme dhe puna me pasë një sens të mbrendëshëm urgjence dhe nevojë e mos me mbetë thjesht si një kapriço formale. Patjetër që hapjet e mundësive që zhvillimet bashkëkohore kanë krijuar e kanë çlirue mjaft mundësinë krijuese duke i dhanë në dorë mjete të ndryshme. Puna asht se si me e bërë të mundun që ky disponibilitet gjuhësor mos me u kthye në një "kërcim nga dega në degë", por mbas një zgjedhje formale me qëndrue gjithmonë një nevojë e fortë që motivon nga mbrenda kërkimin formal.

Ka disa cilësime të kritikëve që flasin për atë që shprehin punët tueja, sipër shembull: tensionin mes konfliktit dhe mrekullisë, vetëdijen për shtyllat mes krijimit modern artistik dhe formave të mundshme të rezistencës, paradokset e inteligjencës njerëzore që don të bahet e vetëdijshme për realitetin nëpërmjet irealitetit. Nga ana tjetër çmoheni edhe për emotivitetin e thellë. Si mendoni, puna e artistave është një punë intuitive për të ndriçuar e kërkuar vetëdijen, apo për të kërkuar të paemërta që kërkojnë të dalin, të materializohen përsëri pa vetëdije? A ka vetëdija rol në art?

Vetëdija dhe pavetëdija, intuita dhe projekti marrin pjesë së bashku në krijimin artistik. Patjetër që ka në art një dialog me thelbin enigmatik të gjanave, me tjetërsinë e tyre e cila nuk posedohet prej nesh, as fizikisht e as mendërisht, por ndjehet. Në këtë kuptim arti dialogon me sekretet e botës, me të pathanshmen, të paemnen. Por gjithsesi, edhe në forma të turbullta, këto sekrete lëshojnë sinjalet e tyre e artisti kërkon me u vu në dialog me këto sinjale, me ia perceptue formën e me ia ndje energjinë. Mandej nga ky takim lind edhe nevoja e praktikës artistike, ku në lojë nuk janë vetem mendja e ndjesitë por edhe trupi, gjestet, format,

materia. Kësisoj gjânat marrin format e tyre specifike. Edhe tjetërsia nuk asht një koncept i përgjithshëm por ka trajta specifike e qasja e artistit përballë saj nuk mund të jetë përveçse specifike. Përndryshe do të kishim jo artistë, por njerëz që vehen në pozë e luejnë artistin, duke aplikue modele shabllon edhe pse shpesh të shoqnuem me fraza bombastike nuk ka asgja të vërtetë e të freskët.

Një pjesë e temave tuaja lidhen me rrënjët e të kaluemes, emigrimin, lëvizjen, humbjen, zhvendosjen, globalizmin, identitetin kulturor, nostalgjinë, kujtesën...

A ka një tendencë tek ju për t'iu qasur çështjeve sociale nëpërmjet artit, apo nëpërmjet tij i ftoni njerëzit të dalin jashtë perceptimeve rutinë të realitetit?

Në rradhë të parë të ftoj ty e lexuesin e këtyne rrjeshtave të mos i besoni deri në fund këtyne që ju tham, jo se ka tek unë ndonjë dëshirë për të mos thanë të vërtetën, por sepse mendoj se artisti nuk asht gjithmonë ai që posedon të “Vertetën” me V te madhe mbi punën e vet. Unë nuk due me i ftue njerëzit me bâ kurgja. Ajo që bâj asht një kërkim personal të cilin mandej e ndaj me të tjerët. Nuk ka në qasjen time si artist një dëshirë me i tregue dikujt se si duhet me mendue apo si duhet me përballue çështje sociale, por ka një interes dhe kuriozitet timin për të eksplorue një botë ku individi dhe kolektiviteti, kodet dhe thyemja e tyre, nevoja për mbijetesë dhe dëshira për kapërcime fantastike, mbivendosen vazhdimisht duke krijuë tensione e ndërlihdje që i gjej interesante e shpesh herë surprizuese. Këtyne surprizave mandej mundohem me i dhanë formë e me i nda me të tjerët. Sigurisht që proceset krijuëse mandej kanë sfumaturat e tyre që asht zor me i përkthye në fjalë në një intervistë, por ajo që më intereson asht e thjeshta dhe e natyrshmja që shfaqet me gjithë intensitetin e vet surprizues e ku shtresëzimet nuk janë të vendosuna artificialisht e në mënyrë mekanike por gjenerohen nga mbrenda e mbajnë punën në vibrimet e një tensioni sa kuptimor aq edhe formal.

Ju bashkë me bashkëshorten tuaj Melisën, keni ideuar dhe realizuar projektin *Art House*, me të cilin e keni kthyer shtëpinë tuaj të lindjes në galeri ekspozitash të ndryshme dhe në vend takimesh. Si e tillë ajo është quejtë një *vendbanim që valorizon energjinë*

kulturore, projekcion afatgjatë përballë dinamikës pushtuese ekonomike, që rrezikon të shkatërrojë strukturën tradicionale urbane të Shkodrës, filter për të deshifruar botën, vend takimi dhe dialogu midis botës së artit shqiptar dhe figurave ma të randësishme nga skena ndërkombëtare etj.

Kurse ju keni pohuar se asht një formë për të ndihmë hapjen e Shqipërisë, që edhe pse nuk asht ma e izolueme siç ishte dikur, komunikimin me pjesën tjetër të botës e ka akoma të vështirë...

A i keni realizue pritshmëritë tueja?

A asht ba vërtetë Shkodra, pjesë e qarkut ndërkombëtar të artit?

Brenda këtij kuadri, a keni dike që mund ta falenderoni ose dikë që mund t'i kërkoni me ba ma shumë?

Art House asht një projekt shumë i dashtun për mu e per familjen teme, por due ta theksoj qysh në fillim se ai asht një projekt që ka mbledhë rreth vetes një grup ma të gjënë vajzash e djemsh, grash e burrash të cilët me punën dhe pasionin e tyne i kanë dhanë e vazhdojnë me i dhanë jetë këtij projekti. E jo vetëm pjestarët e grupit të ngushtë të punës kanë kontributin e tyne të padiskutueshem në këtë projekt, por edhe njerëz të tjerë që na ndihmojnë, që marrin pjesë në aktivitetet tona, studentë, miq, që në forma të ndryshme kanë qenë pjesë e asaj që kena bâ në këto pesë vite. *Art House* asht një projekt i vogël që nuk ka ambicje të mëdha e nuk ka pasë ndër mend ndonjëherë ta kthejë Shkodrën në qendrën e botës, por kërkon me dhanë një kontribut modest në mënyrën ma cilësore të mundshme, duke mos e konsiderue ambjentin ku operon si një pikë periferike të një bote ku gjanat e vlefshme ndodhin vetëm në qendra të randësishme, por duke e pa territorin si një mundësi për të prodhue diçka që ka intesitetin e vet e cilësinë e vet specifike.

Njerëz që mund të falenderoj janë shumë duke fillue nga Tea Çuni me të cilën e kena nisë ketë punë pesë vite ma parë, Zef Paci, Lek Gjeloşi, Arta Nikolli, Besara Podgorica, Viola Gjoni, Lucjan Bedeni, Artan Draçini e shumë të tjerë që në forma të ndryshme kanë kontribue. Në këto vite mbi tridhjetë personalitete nga bota ndërkombëtare e artit kanë vizitue *Art House* e janë takue me artistë të rinj e kanë nda eksperiencen e tyne me publikun. Asnjë nga to nuk ka marrë shpërblim përveç mikpritjes dhe mirënjohjes.

Meqenëse jena tek çështjet sociale, të cilat shpesh herë

motivohen nga ato politike, në Shqipëri ka pasur një reagim të gjerë nga mbishkrimi juej për kryeministrin Edi Rama, që erdhi për shkaktë shembjes së Teatrit Kombëtar, që ju e quani pikën që e bëri vazon të derdhet. Megjithatë shkrimi juej ka një fytyrë ndryshe; ai karakterizohet nga një ndjeshmëri komplekse, që nuk i pengon disa prej konstatimeve tueja të thella të bahen akuza të randa dhe të hapuna, sidomos kur thoni se Edi Rama asht sot fytyra e dhunshme e pushtetit. Asht i pushtetshmi që nëpërkëmbtë ndryshmin e manipulon të dobëtin. Asht pazarxhiu që tregton me të mirën publike. Asht gaztori që tallet mbi viktimën që sapo ka dhunue. Nga ana tjetër, kur thoni se pikërisht atëherë kur Edi Rama ishte Ministër Kulture dhe ma vonë u zgjodh kryetar bashkie nëTiranë, zuni fill tek ai edhe fara e një arti, që bahet spektakël ipushtetit dhe i një pushteti që manipulon artin, mos doni të tregoni fuqinë e politikës që prish njeriun, artin dhe artistin?

Atë shkrim e kam formulue natën vonë mbas një dite të mbushun me tension që filloi sapo hapa sytë e mora vesh lajmin e rrëzimit të teatrit kombëtar. Në një farë mënyre ai shkrim asht një britmë dhimbjeje dhe akuze, sepse i drejtohet jo vetëm kryeministrit të Shqipnisë, por pikësëpari një njeriu të cilin e kam pasë të afërt për shumë vite e nga i cili kisha marrë frymëzimet e antikonformizmit dhe antagonizmit ndaj pushtetit. Ju më pyesni se mos asht fuqia e politikës që e prish njeriun, artin e artistin. Besoj kur thoni politikë keni parasysh pushtetin politik, ushtrimin e tij apo luftën për pushtet. Sigurisht që pushteti nuk asht i lehtë me u trajtue. Ne jemi të prirun ta shohim pushtetin e lidhun me postet politike. Unë mendoj se në ambjentin shqiptar pushteti nuk asht thjesht çështje e një kryeministri apo një kryetari bashkie. Jeta shqiptare dominohet nga pushteti i vulgaritetit, brutalitetit, injorancës, vorfnisë materiale e shpirtnore, prandaj kushdo që i hyn rrugës së politikës e synon pushtetin politik, në një farë menyre asht i detyruem me përballue këte pushtet të përhapun gjithandej e pikërisht shpresa që njerëzit mund të kenë tek politika asht se ajo, nëpërmjet forcës së shtetit, mund t'i dalin para e mund ta zmbropsin këtë pushtet të së keqes. Por pushteti politik nuk mundet mos me i pasë të gjitha veset e shoqnisë nga ka dalë e duhet një forcë e madhe për të mbajtë ushtrimin e tij jashtë së keqes së përhapun që dominon shoqninë. Nga ana tjetër ne duhet me fillue me u ndërgjegjsue se pushtet politik nuk ushtrohet vetëm nën frymëzimin

e forcës së besimit, por duhet të përpunojë edhe dyshimin, nuk duhet të mendojë vetëm për me lanë gjurmën e vet, por edhe me u kujdesë për atë çka ka gjetë. Ajo çka shpesh mungon në jetën tonë shoqnore asht kutura e përkujdesjes. Mendoj se ambjenti publik nuk ka nevojë për gjeste që, në rastin ma të keq, e dhunojnë e në rastin ma të mire e mahnisin, por për gjeste që e emancipojnë. Dhe emancipimi nuk kalon as nëpërmjet dhunës e as nëpërmjet mahnitjes të cilat në të dyja rastet prodhojnë një subjekt të nënshtruem.

Në Shqipëri ku gjanat shihen kryesisht me optikë partiake, çfarë reagimesh keni marrë nga ky shkrim? A keni marrë edhe reagime që ju kanë mërzitë apo zhgënjye?

Kam marrë shumë mbështetje, ma shumë se e kisha mendue. Sigurisht dikush edhe asht mërzitë e këtë mërzi ma ka shprehë.

Pandemia e korona-virusit, që vazhdon të ekzistojë, përveç problemeve serioze, solli edhe reagime dhe reflektime të ndryshme. Po jusi e përjetuat?

Në fillim si diçka të largët, të lidhun me një kontinent tjetër, e mandej afër e shumë afër kur Lombardia u kthye në një ndër qendrat botnore të infektimit. Mbyllja në shpi, pamundësia për kontakte me njerëzit e me qytetin sigurisht që ishin një moment pengimi, por edhe reflektimi. Fakti se rreth nesh kishte humbje jetësh e shumë dhimbje, nuk mund ta kthente këtë moment thjesht në një moment tërheqjeje medituese. Gjithsesi nevoja e rizbulimit të brishtësisë sonë, e faktit të të qenit pjesë e një bote organike e jo thjesht dominuesit e kësaj bote, nevoja për një ndalje e për një rishikim të frenezisë në të cilën shpesh herë jemi të përfshimë, mendoj se përtej mërzisë, kjo situatë na ka dhanë edhe leksione të cilat e mira do ishte t'i merrnim seriozisht e pa iu shmangë.

Çfarë mund t'u thoni lexuesve të revistës “Gegnia” në këtë situatë, kur ka shumë gjana që zhgënjëjnë, demotivojnë, por edhe sfidojnë?

Lexuesve të revistës po i tham faleminderit që moret mundimin me lexue duke ushtruar detyrën e bukur e të çmueshme të lexuesit.

▪ Histori ▪

Ardian MUHAJ

**SHKODRANËT NË GALERAT TREGTARE TË VENEDIKUT
DREJT EUROPËS VERIORE NË SHEK. XV**

Dëshmitë për praninë dhe rolin e shqiptarëve në vendet e Europës Veriore, veçanërisht në Vendet e Ulëta dhe Angli në shek. XIV e XV, edhe pse të pakta janë të rëndësishme sepse hedhin dritë mbi aspekte pak të njohura ose të panjohura të historisë sonë dhe një tregues me rëndësi për shkallën e zhvillimit ekonomik e social të shqiptarëve në këtë periudhë.

Rruga e mbërritjes së këtyre shqiptarëve në Europën Veriore, ka qenë ajo detare, në bordin e anijeve tregtare italiane, kryesisht venedikase. Deri në fundin e shek. XIV, itinerari i lundrimit që niste në Venecia, kishte si destinacion Flandrën, ose më saktë qendrën më të rëndësishme tregtare të saj, Bryzhin (Brugge-Bruges), dhe pastaj duke filluar prej kësaj kohe e deri në mbylljen e kësaj linje lundrimi në fillimin e shek. XVI, kishte destinacion të dyfishtë: Anglinë (Londër, Southampton)¹ dhe Flandrën (Sluis dhe Bryzhe). Ndërmjet këtyre dy pikave itinerari përfshinte edhe pushime të kohëzgjatjes së ndryshme në portet e

¹ *Port Books of Southampton for the Reign of Edward IV*, edited by D. B. Quinn and A. A. Ruddock, vëll. II, 1477-1481. Southampton: Cox & Sharland, 1938, (më tej *PBS*, II, 1477-1481), f. xviii.

Siçilisë, Jugut të Spanjës, dhe Portugalisë. Itinerari i miratuar nga Senati, ndryshonte në varësi të kushteve të lundrimit, kur anijeve u duhej të gjenin strehim të përkohshëm nga stuhitë. Kur niseshin drejt Flandrës, bënin ndalesa në Siçili, Napoli, Majorka, Malaga, Kadis, Lisbonë dhe Ferrol, ndërsa në kthim ndalonin në Kadis, Almeria, Malaga, Majorka dhe Siçili.² Linja e lundrimit të Flandrës, ishte linja më e vështirë e lundrimit në historinë dhe në gjeografinë e lundrimeve mesjetare. Për këtë arsye edhe anijet që përdorshin për këtë linjë ishin më të mirat dhe më të sigurtat e arsenalit venedikas. Udhëtimi vajtje-ardhje shkonte nga 10 deri në 18 muaj, prej të cilëve 3-4 muaj ishin lundrim, ndërsa koha tjetër ishte qëndrim nëpër portet ku tregtoheshin mallrat.³ Periudha kur kjo rrugë detare njohu edhe kulmin lulëzimit të saj ishte nga fundi i shek. XIV e deri në mesin e shek. XV.⁴

Në përgjithësi shqiptarët, ashtu si edhe dalmatët, boshnjakët e grekët, ishin të punësuar si rremëtarë apo si marinarë, dhe jo si tregtarë. Kjo nuk i pengonte që shpesh ta shfrytëzonin pozicionin e tyre si rremëtarë për të marrë me vete një numër të kufizuar mallrash të cilat mund t'i tregtonin, duke marrë në njëfarë mënyre rolin e tregtarëve të vegjël.

Të dhënat e para rreth pranisë së detarëve shqiptarë në Angli i gjejmë që në fundin e shek. XIV. Në këtë kohë venedikasit nisin të frekuentojnë edhe Anglinë, ngaqë deri atëherë zakonisht shkonin drejt Flandrës, pa u ndalur në portet angleze. Rekrutimi i shqiptarëve në galerat e linjave tregtare merr hov edhe më përpara se Venediku të merrte në zotërim qytetet e pellgut të Shkodrës e Lezhës. Kjo ka të bëjë me faktin se në fundin e shek. XIV, Sinjoria mbas fitores së luftës me Gjenovën (1378-1381) del si forca më e fuqishme detare në Mesdhe.⁵

Nga ana tjetër në këtë kohë, Venecia u godit nga një numër epidemish të murtajës, që riktheheshin periodikisht që prej vitit 1348. Vetëm

² PBS, II, 1477-1481, f. xx. Mbi galerat e Flandrës në përgjithësi shih edhe: Randon Brown, *Calendar of State Papers and Manuscripts relating to English Affairs existing in the Archives and Collections of Venice, and in Other Libraries of Northern Italy*, (më tej CSP, Venice), vëll. I, (1202-1509). London, 1864, f. 35 e në vazhdim; Roberto Cessi, "Le relazioni commerciali tra Venezia e le Fiandre nel sec. XIV", *Nuovo archivio veneto*, 27 (1914), f. 5-116; Alwyn A. Ruddock, *Italian Merchants and Shipping in Southampton, 1270-1600*, Southampton: University College, 1951.

³ PBS, II, 1477-1481, f. xxix.

⁴ William Cunningham, *The Growth of English Industry and Commerce during the Early and Middle Ages*, 5th edition, Cambridge University Press, 1915, f. 426.

⁵ Pompeo Molmenti, *Venice its Individual Growth from the Earliest Beginnings...*, vol. I, f. 129.

epidemia e vitit 1348 vlerësohet të ketë vrarë rreth një të tretën apo ndoshta edhe gjysmën e popullsisë së Venedikut. Një tjetër shpërthim i murtajës në vitin 1382 mendohet të ketë shkaktuar 19 mijë viktima. Si pasojë Venediku kishte një mungesë të madhe krahësh pune për flotën detare.

Dy janë portet kryesore angleze në të cilat qëndronin dhe bënë tregti anijet shtetërore venedikase: Londra dhe Southamptoni. Një nga dëshmitë më të hershme dhe më domethënëse të pranisë së shqiptarëve në Londër i përket vitit 1396. Kjo ka të bëjë me të dhënat që dalin nga një proces gjyqësor kundër Pal Aleksit apo Pal Lezhjanit dhe gjashtë bashkëpunëtorëve të tij.⁶ Katër galerat venedikase që kryenin linjën e Flandrës për atë vit kishin si pronarë Pasqual Zane, Francesco Leone, Giovanni Morosini dhe Bernardo Giustinian. Në kanalën e La Manshit, siç ishte zakon flota u nda në dy pjesë: Zana e Leona u drejtuan drejt Londrës, ndërsa Morosina e Giustinana me në krye kapitenin e përgjithshëm vazhduan drejt Flandrës. Udhëtimi vajtje-ardhje i flotës së galerave për atë vit zgjati 9 muaj, duke u nisur më 20 Mars nga Venecia dhe duke mbërritur në Londër nga fundi i qershorit.⁷

Lidhur me praninë e shqiptarëve në portin tjetër të rëndësishëm anglez, Southampton, një nga burimet më të çmuara për njohjen e pranisë së të huajve, mes tyre edhe shqiptarëve në këtë qytet, ishin regjistrat doganorë të portit, të quajtur *Port books*, ruajtur pjesërisht. Të dhënat e këtyre regjistrave janë veçanërisht me interes, për numrin relativisht të madh të shqiptarëve që dalin në këto regjistra, për gjeografinë e trevave nga vinin, por edhe për faktin se kjo prani e shtuar e detarëve shqiptarë në Southampton përkon me fazën e fundit të tregtisë së lulëzuar të italianëve në Detin e Veriut.

Pozita gjeografike në jug të Anglisë e ka favorizuar gjithnjë këtë port, por shtysën më të madhe zhvillimit të tij ia dha ardhja e flotave tregtare të qyteteve italiane, Venedikut, Firences e Gjenovës. Shkak për rritjen e rëndësisë së Southamptonit në tregtinë e venedikasve ishin

⁶ ASV, Avogadori de Comun, Raspe, 5, c. 60 (57) t-61 (58), 20 dhjetor 1396; Giuseppe Valentini, *Acta Albaniae Veneta saeculorum XIV et XV*, (më tej *AAV*), I/3, Munchen: Rudolf Trofenik, nr. 673; Stefano Piasentini, "La setta di Londra: Un ammutinamento di ciurme veneziane del 1396" *Studi Storici*, Fondazione Istituto Gramsci, 37/ 2 (1996), f. 513.

⁷ Piasentini, "La setta di Londra", f. 514; *CSP Venice I*, nr. 119. Dekret i Senatit për të bërë gati katër galera, më të mirat e arsenalit, për udhëtimin e Flandrës.

revoltat kundër tregtarëve të huaj që ndodhën në Londër në vitin 1456.⁸ Southamptoni shërbente si bazë për tregtarët e mëdhenj italianë si qendër grumbullimi e leshit dhe tekstileve të jugperëndimit të Anglisë dhe si port transit për tregtinë e artikulujve të luksit të Mesdheut dhe të Lindjes që e kishte qendrën në Londër.⁹

Duhet bërë dallimi mes kolonisë italiane të ngulitur aty dhe një numri shumë më të madh vizitorësh kalimtarë nga portet e Mesdheut që përbëhej nga një popullsi ambulante pronarë anijesh dhe marinarësh nga galerat dhe anijet e ankoruara në port. Qëndrimi i tyre në qytet shkonte nga disa ditë deri në tre apo katër muaj në rastin kur këto anije dimëronin në port. Megjithëse numri i tyre ishte relativisht i madh, ata luanin një rol shumë më të vogël në jetën e qytetit sesa kolonia e vogël e përhershme e tregtarëve italianë. Në Southampton venedikasit kishin si qendër të praktikave fetare dhe si vendvarrimi kishën e Shën Nikollës. Këtu po ashtu ndodhej edhe varreza e bashkësisë së rremëtarëve sklavonë e dalmatas.¹⁰

Të dhënat fiskale të portit të Southamptanit, për vitet 1427-1430 dhe 1435-1436 nuk japin asnjë të dhënë mbi praninë e shqiptarëve.¹¹ Kjo ka të bëjë edhe me faktin që regjistrat e hershëm, sidomos të viteve 1427-1430, japin shumë pak detaje. Në regjistrat e mëvonshëm, duke filluar nga viti fiskal 1439-1440, shqiptarët janë gjithnjë të pranishëm. Kështu, në regjistrat e vitit 1439-1440 në galerën ku Francesco Dandolo ishte pronar dhe që regjistron hyrjen në port më 4 prill 1440,¹² dalin të kenë kryer veprime tregtare, pëveç Gjonit dhe Dimitrit nga Lezha, edhe Perdolsimo nga Lodrini, Gjergji nga Danja, Gjon Bushati, Luka Trushi, Gjoni nga Danja, Dimitri nga Barbullushi, Gjoni nga Drishti, Martini

⁸ Colin Platt, *Medieval Southampton. The Port and trading Community. A. D. 1000-1600*. London and Boston: Routledge & Kegan Paul, 1973, f. 171; Ruddock, *Italian Merchants and Shipping in Southampton*, f. 66, 188.

⁹ Ruddock, *Italian Merchants and Shipping in Southampton*, f. 97.

¹⁰ Varreza e tyre ishte shënuar me një gur varri me një shqiponjë dykrenare të vendosur në një mburojë me një engjëll, një dem me krahë, një shqiponjë dhe një luan me krahë, me mbishkrimin: "Sepultura de la Scuola de Sclavonia. Ano Dm MCCCCLXXXI. Ruddock, *Italian Merchants and Shipping in Southampton*, f. 133.

¹¹ *The Port Books of Southampton, or (Anglo-French) Accounts of Robert Florys, water-bailiff and Receiver of Petty-customs, A.D. 1427-1430*. Edited by Paul Studer, Southampton: Cox & Sharland, 1913; *The local Port Book of Southampton, 1435-36*. Edited by Brian Foster. Southampton: The University Press, 1963.

¹² Kjo galerë regjistron daljen nga porti me 26 prill.(fis. 77r-80r). *The National Archives*, (më tej TNA), Customs Accounts, Sandwich, 127-18.

nga Lodrini,¹³ Përveç burimeve angleze, edhe burimet venedikase e konfirmojnë këtë pasqyrim të shqiptarëve në flotën e Flandrës. Një nga këto burime është ditari i mbajtur në bordin e galerave i priftit-noter Giovanni Manzini, ndërmjet viteve 1471-1486, ku dalin disa shqiptarë. Kështu në udhëtimin e vitit 1471-1472 del Gjoni nga Lezha,¹⁴ Novello nga Liqeni (i Shkodrës),¹⁵ Stefan Kërruqi,¹⁶ Marini nga Shkodra,¹⁷ dhe Nikollë Muriqi.¹⁸

Rruga e gjatë që galerat e Flandrës përshkonin ishte e mbushur me peripeci e rreziqe të shumta. Përkundër faktit që galerat venedikase të Flandrës ishin ndër anijet më të sigurta dhe më të armatosura të kohës, kishte raste kur edhe ato binin pre e piratëve. Në një sulm të tillë piratesk, Paskalini nga Shkodra që kishte nisur të lundronte që në moshë të renë flotën venedikase, ndërsa ndodhej në një nga galerat e Flandrës rreth vitit 1445, u plagos rëndë nga piratët, duke mbetur invalid përjetë.¹⁹

Po ashtu regjistri doganor për vitet 1469-1471, nxjerr në dritë praninë e një numri të konsiderueshëm shqiptarësh, kryesisht rremëtarë e marinarë, që në të njëjtën kohë edhe bënë tregti në Southampton. Një detar nga Shkodra, Marin de Skutere del në galerën e Jeronyme Deodos, mbërritur më 12 prill, ku shet krehra fildishi, coha të ngjyrosura, thika, tjerrëse të pikturuara dhe blen në këtë port pëlhura të pangjyrosura dhe lëkura të regjura.²⁰

E dimë se bëhet fjalë për një shkodran ngaqë nuk del i vetëm, por në mesin e shqiptarëve të tjerë si Stefani nga Drishti, Toma nga Shëngjoni apo Shengjini, Gjergji nga Shkodra, Pali nga Shkodra.²¹ Edhe në

¹³ *The Local Port Book of Southampton for 1439-40*, (më tej LPBS, 1439-40), Edited by Henry S. Cobb, Southampton: At the University, 1961, *Liber Alien*, fl 76r-80r.

¹⁴ Lucia Greco, "Sulle rotte delle galere veneziane: Il cartulario di bordo del prete notaio Giovanni Manzini (1471-1486)", *Archivio Veneto* (1991), f. 5-37; *Quaderno di bordo di Giovanni Manzini prete-notaio e cancelliere (1471-1484)*, bot. Lucia Greco, Venezia: Il comitato editore, 1997. ASV, Canc. inferiore, busta 124.

¹⁵ *Quaderno di bordo di Giovanni Manzini prete-notaio*, f. 13.

¹⁶ Agostino Pertusi, "Per la storia di Dulcigno nei secoli XIV-XV e dei suoi statuti cittadini", *Studi veneziani*, 15 (1973), f. 241, "villa de Charuzzi" në rrethinat e Ulqinit e identifikon me Kërroqi.

¹⁷ 12 shtator 1472 Messina: "sier Marin da Schutari". *Quaderno di bordo di Giovanni Manzini prete-notaio*, f. 21.

¹⁸ 19 shtator 1472. Del si dëshmitar në testamentin e "Ser Nicholaus Stela". *Quaderno di bordo di Giovanni Manzini prete-notaio*, f. 21.

¹⁹ *AAV*, III/21, 19 qershor 1446, nr. 5214.

²⁰ *PBS*, I, 1469-1470. Book B. (L. Alienigenus), fl. 13-14, p.57- 58, 15-23 qershor.

²¹ Stephano Dryvest që shet kinkalerina, stafidhe apo rrush të thatë Korinti, melasë;

galerën e Marco Trevisanit të regjistruar më 9 maj të të njëjtit vit, dalin të tjerë shqiptarë si Stephano Brusete (Brusato), Antone Meda, Nycolo Sumba,²² Jorge de Skutere,²³ Mykaell Albonesse, John de Skutere.²⁴ Në galerën e Nycholao de Peysero, hyrë më 30 nëntor 1469, dalin Gjoni nga Shati apo Shasi,²⁵ Juliani nga Danja²⁶ dhe Bartolome Vlonjati.²⁷ Po ashtu një Marin nga Shkodra, del sërish në regjistrat e Southamptonit vite më vonë në nëntor të vitit 1477, në galenë e Petrus Marcel, bashkë me shqiptarë të tjerë nga Drishti e Shkodra.²⁸

Një rast tjetër me rëndësi është ai i Gjon Drishtjanit (Giovanni da Drivasto). Identifikimi sa më i qartë i këtij detari është i një rëndësie të veçantë për historinë detare të shek. XV. Ky detar nga Drishti, ka pasur në zotërim dhe na ka lënë trashëgim dorëshkrimin më të vjetër që ekziston rreth teknologjisë së ndërtimit të anijeve. Bëhet fjalë për dorëshkrimin e hartuar nga detari Mikel nga Rodi në vitet 1434-1443.²⁹ Historia e këtij dorëshkrimi pas vdekjes së autorit nis me Gjon Drishtjanin, i cili në vitin 1473 e mbante në çantën e tij të udhëtimit. Në këtë dorëshkrim Gjoni ka lënë të shkruar edhe testamentin e tij, në dy faqet e fundit, kur ndodhej në bordin e një galere venedikase, në Halki,

Thomas de Senjone, gjilpëra e kapëse; Jorge de Skutere, kinkalerina. Povlo de Skutere, kinkalerina, stafidhe Korinti; Andrea de Lesso, fije liri, mëndafsh të papërpunuar, shtiza për thurje, karfica. *PBS*, I, 1469-1470. Book B. (L. Alienigenus), fl. 3-8.

²² *PBS*, I, 1469-1470. Book B. (L. Alienigenus), fl. 10v. Po ashtu më 19 dhe 22 qershor, pëlhura (fl. 11- 11v)

²³ *PBS*, I, 1469-1470. Book B. (L. Alienigenus), fl. 11. 18 qershor, kurse më 23 qershor, pëlhura kersey (fl. 12)

²⁴ *PBS*, I, 1469-1470. Book B. (L. Alienigenus), fl. 10-12v.

²⁵ John de Sato, shet shporta dhe fiq të thatë. *PBS*, I, 1469- 1470. Book B. (Liber Alienigenus), f. 1v.

²⁶ Juliano Daina, shet ngjyrosës pëlhurash, rrëshirë dhe kokrra parajse. (Lloj erëze, farë e bimës *Aframomum melegueta*). *PBS*, I, 1469- 1470. Book B, (Liber Alienigenus), f. 2.

²⁷ Bartolomew Valorens, pëlhura. *PBS*, I, 1469-1470. Book B. (L. Alienigenus), fl. 12v, 9 maj.

²⁸ Marino de Scutere, verë, vaj. Johanne de Scuter, pëlhura e sapun. Petro Dryvers, verë, xhenxhefil të gjelbër dhe 30 pashë të linjta. *PBS*, II, 1477-1481. Book E. (liber alienigenus), 1477-1478, appendix IV, f. 216-219.

²⁹ Mikeli nga Rodi del të ketë shërbyer në galerat venedikase për plot 42 vjet, nga viti 1401 deri në vitin 1443. Pamela O. Long, "Introduction: The World of Michael of Rhodes, Venetian Mariner", në *The Book of Michael of Rhodes. A Fifteenth-Century Maritime Manuscript*. Edited by Pamela O. Long, David McGee, and Alan M. Stahl, 3 vols. Massachusetts-London: The MIT Press, 2009, f. 1-2.

një ishull i vogël në afërsi të Rodit, më 29 Gusht 1473.³⁰

Ai del bashkë me shqiptarë të tjerë figuron në regjistrin e bujtinës së John Welles, si mikpritës i ekuipazhit të galerës së Giacomo Corner-it, mbërritur në Londër më 18 tetor 1441, dhe që qëndroi në qytet deri më 26 mars të vitit 1442.³¹ Mikpritësi duhej të regjistronte të gjitha aktet e shitblerjes që detarët e anijes kryenin në qytet. Sa i përket shqiptarëve, dalin të kenë kryer shitje të mallrave të ndryshme, kryesisht venedikase, Nikolla nga Ludrini,³² Domeniku nga Buna,³³ Vlashi nga Shkodra,³⁴ Kozmai nga Durrësi,³⁵ Antoni nga Drishti,³⁶ Pali nga Barbullushi,³⁷ Andrea nga Lezha,³⁸ Pali nga Lezha,³⁹ Gjoni nga Lezha,⁴⁰ Gjergji nga Malësia⁴¹ dhe Gjoni nga Drishti.⁴²

³⁰ Long, "The World of Michael of Rhodes", f. 28-29.

³¹*The views of hosts of alien merchants. 1440-1444.* Edited by Helen Bradley. Woodbridge: The Boydell Press, 2012.

³²Nicholo de Loderyn. TNA. E101/128/30 return 1; *Views of hosts*, f. 109, 112.

³³Dimë se në galerën e Petrus Surans që hyn në Southampton nga Flandra, më 26 shtator 1481, del Georgeo de Boyano, bashkë me shkodranë të tjerë si Lazaro de Squytery, Marco Stroce, Laurencio Barduche, Paulo de Seynt George, Georgeo Squytero, Beasio de Squytery dhe Primo Suma. *PBS, Book G, Liber Alienigenus, 1480- 1481, fl 22-23v.* Një Jeronim da Boyano del në Londër, më 12 maj 1444, në listën e bujtinës së William Chervyle në mesin e ekuipazhit të galerës së Alessandro Duodos, bashkë me Todoro da Mosake, Andrea da Jane, Marino d'Antivori, Marino da Zagabria, Polo da Madrose, Andrea da Montebello, Domenico d'Antivori. TNA, E101/128/30 return 4.

³⁴*Views of hosts*, f. 109.

³⁵*Views of hosts*, f. 110. Cosma de Doras ad vendu...a Thomas Hawkyns peper

³⁶*Views of hosts*, f. 110. Antony de Dryvesto ad vendu a Esmond Keruyle sugre

³⁷*Vews of hosts*, f. 110. Poule de Barbalovsy ad vendu le mesme iour au dit Robert querens.

³⁸*Views of hosts*, f. 111. Andreë de Lesch ad vendu le mesme iour a William Rose sugre ...Andria de Lesso ad vendu le mesme iour a Nicholas Ęifold ginger vert; (po aty, f. 112). *membrane 1B*:Andria Leschle mesme iour a John Trille peper (po aty, f. 113-114). Po ky Andrea nga Lezha, kishte mallra edhe në gale të e vitit 1438-1439. TNA E 122/73/10.

³⁹*Views of hosts*, f. 112....Poule de Lesch ad vendu... querens; (po aty, f. 114.) *membrane 1B, ...* ginger vert. Del edhe në një nga galerat veneciane që mbërrijnë në Londër në 1437-1438. TNA E 122/77/3.

⁴⁰*Views of hosts*, f. 112. John de Leso ad vendu le dit iour a dit Esmond querens, (po aty, f. 114). *membrane 1B*: ginger vert; (po aty, f. 115).

⁴¹*Views of hosts*, f. 113. George Malesaws ad vendu le mesme iour a John Glouceter peper

⁴²*Views of hosts*, f. 113. John de Drivasto ad vendu le dit iour a dit Esmond querens; (po aty, f. 114); querens; (po aty, f. 115)... triacle. Bradley, *vep. cit.*, f. 305, në notën

Kështu, Gjoni nga Drishti, del në galerën e Alowisus George, që mbërrin në Southampton nga Mesdheu në vitin 1481. Bashkë me të dalin edhe Johanne de Squytery,⁴³ dhe Johanne de Ludryn, që edhe këta shesin po ashtu sapun⁴⁴. Edhe kur e njëjta gale hyn në Southampton, më 26 shtator 1481, tashmë kur po ktheheshin nga Flandra shet 30 pashë cohë të linjta flamenge. Përveç Gjorit kryejnë shitje mallrash flamenge edhe tre drishtjanë të tjerë dhe një shkodran: Demit Drivastini, Nikollë Drivastini, Pero nga Drishti, Pali nga Shkodra⁴⁵ dhe Dimitri nga Liqeni (i Shkodrës)⁴⁶.

Mbas rënies së Shkodrës dhe Drishtit nën sundimin osman, shqiptarët vazhdojnë të jenë të pranishëm në rrugën detare të Flandrës, derisa kriza e kësaj tregtie merr përmasa të tilla, sa që edhe Venediku, shteti i fundit italian në këtë linjë tregtare më 1509 vendos pezullimin e saj për më se një dekadë, dhe në vitin 1532 mbylljen përfundimtare⁴⁷. Kështu vetëm në galerën e Bernard Bondymer⁴⁸ mbërritur në Londër më 14 qershor 1481 dhe që largohet nga porti i Londrës më 18 shtator 1481 dalin, Alesio Summa, Beasio de Lago, Francis de Meseo, George de Camsa, George de Scutery, John de Luderyn, John Camsa, John de Asdryna, John Masarachio, John de Squetery, Luke de Squetery, Nicholas Maserachio, Nicholas de Squetery, Nadale de Lago, Nicholas Somma, Novello de Lago, Paul Lago, Pero de Squetery, Primo de Squetery, Stephen de Lago, Travaso de Luderyn, Luke Kamsa, Andrea de Squetery, George de Lago. Mallrat që shesin këta shqiptarë, që të gjithë nga zona e Shkodrës, janë kryesisht qilima, vaj, qelqurina, sapun, mëndafsh, ruaza korali, hurma të thata, erëza, gota për pije, ngjyrosës pëlhurash, unaza me gurë.

biografike edhe pse në dokumente del krejt qartë si Giovanni da Drivasto, pa asnjë dyshim mendon se është nga Trieste. Si duket nuk e merr parasysh faktin se del gjithnjë në mesin e bashkëpatriotëve të tjerë nga zona e Shkodrës dhe Lezhës. Ky Gjon nga Drishti del edhe në galerat që mbërrijnë në Londër më 1445-1446 (TNA E122/203/3) dhe në vitin 1456-1457 (TNA E122/203/4).

⁴³ PBS, II, 1477-1481. Book G. Liber Alienigenus, 1480- 1481, fl. 18v-19.

⁴⁴ PBS, II, 1477-1481. Book G. Liber Alienigenus, 1480- 1481, fl. 20-20v.

⁴⁵ PBS, II, 1477-1481. Book G. Liber Alienigenus, 1480- 1481, fl. 24-24v.

⁴⁶ PBS, II, 1477-1481. Book G, Liber Alienigenus, 1480- 1481, fl. 18v2.

⁴⁷ R. Brown, *CSP, Venice*, I, f. lxx.

⁴⁸ Flota e vitit 1480 e përbërë nga tri galera hyri në Southampton më 12 shkurt 1481. Mbasi qëndruan aty për rreth tre muaj, galera e Bondymer-it u nis për në Londër, ndërsa dy të tjerat për Flandër. TNA E122/194/25, [m.1]; *The Overseas Trade of London. Exchequer Customs Accounts 1480-1*. Edited by H. S. Cobb. London: London Record Society, 1990, f. xliiii; PBS, II, 1477-1481, f. xxix.

Mallrat që blejnë janë pëlhura, lëkura të ngjyrosura, enë kallaji.⁴⁹

Siç shihet, prania e shqiptarëve në galerat veneciane të Flandrës mbas vitit 1479 bëhet akoma edhe më e rëndësishme. Kjo rritje e pranisë së shqiptarëve është me interes jo vetëm për faktin se dëshmon se një pjesë e mirë e atyre banorëve të pellgut të Shkodrës e Lezhës që emigruan për në Venedik mbas përfundimit të luftës veneto-osmane të viteve 1463-1479, gjetën një mundësi punësimi, por edhe për të vlerësuar tërthorazi peshën që këta shqiptarë të punësuar në galerat e Venedikut zunë në mesin e viktimave të një beteje detare ndërmjet piratëve dhe galerave të Flandrës të ndodhur më 1485, në brigjet portugeze⁵⁰.

Në afërsi të Lisbonës më 21 gusht 1485, galerat e Flandrës kur po lundronin drejt Flandrës, nën komandën e Bortolomeo Minio, u sulmuan nga korsarët Gjergj Bissipat dhe Kristofor Kolombi. Anijet pirate ishin gjashtë dhe mbanin flamur francez. Mbas një beteje që zgjati 20 orë, 130 anëtarë të ekuipazhit të anijeve venedikase u vranë dhe 300 u plagosën. Trupat e të vrarëve u hodhën në oqean⁵¹.

Sesa nga të vrarët dhe të plagosurit ishin shqiptarë nuk dihet, por duke u nisur nga fakti se çdo galerë venedikase e linjës së Flandrës në shek. XV, kishte një numër të konsiderueshëm shqiptarësh në ekuipazhin e saj, dhe siç e pamë pikërisht në këto vite numri i tyre u bë edhe më i madh, mund të kemi një ide të përafërt për fatin e atyre shqiptarëve që janë ndodhur në bordin e atyre galerave, që kurrë nuk mbërritën në destinacion. Organizimi i galeve të tjera të Flandrës u pezullua nga Senati për vite të tëra dhe dëmi i shkaktuar në këtë rast u vlerësua në plot 200 mijë dukate. Njëra nga galerat u dogj gjatë sulmit, ndërsa tri të tjerat, mbetën për njëfarë kohe të dëmtuara në Lisbonë, derisa Senati Venedikas vendosi që t'i faleshin mbretit portugez Zhoao II, në shenjë mirënjohje për ndihmën që u kishte dhënë detarëve të mbijetuar⁵².

⁴⁹ Cobb, *Exchequer Customs Accounts*, f. 159-162.

⁵⁰ Bilanci i kësaj beteje ishte rreth 130 detarë të vrarë dhe dyqindmijë dukate dëme. *CSP, Venice*, I, nr. 510.

⁵¹ Lajmi i kësaj tragjedie mbërriti në Venecia më 18 shtator 1485. Marin Sanuto, *MS. Lives of the Doges*. vol. ii, f. 254; *CSP, Venice*, I, nr. 499.

⁵² *CSP, Venice*, I, nr. 510.

Italo SARRO

PADRE SALVATORE DA OFFIDA E PADRE PAOLO DA MANTOVA¹

Le ville di Gruda e di Cucci erano popolate da cattolici che ricadevano politicamente sotto la giurisdizione del Despota di Serbia e spiritualmente sotto quella del vescovo Modunense, nel periodo che si sta esaminando era mons. Giovanni Battista Agatich di Fiume² (17 luglio 1617-1643)³. Costui, come tutti gli altri presuli albanesi, doveva

¹ Accogliendo l'invito del dott. M. Cungu, a cui auguro di conseguire ottimi risultati nel nuovo e prestigioso incarico, ripropongo questo saggio già pubblicato su *Hylli i Dritës*, 3-4 – 2015 sia perché richiede qualche modifica e correzione sia perché recentemente è stato tenuto presente da E. MALAJ, *Martirizimet e klerit katolik gjatë shekujve XVII-XVIII të pushtimit osman në Shkodër e rrethina*, *Hylli i Dritës*, 1 – 2020, 185. Inoltre, informo il lettore che ho trovato nell'Archivio di Propaganda Fide il documento sui frati nel mese di aprile 2014 nell'ambito delle mie ricerche sui francescani in Albania. Al momento della stesura del saggio (primavera-estate 2015), non ero a conoscenza che il documento era stato trascritto da J. ZAMPUTTI, A. RAMAJ, N. RRAHMANI, Z. AHMETI (a cura di) *Documenti per la storia dell'Albania (1623-1653) trascritti e tradotti da Injac Zamputti, sezione documenti trascritti*, Albanisches Institut-FAIK KONICA, San Gallo- Pristina 2015, 506-513, per cui non ho citato il meritorio lavoro di Zamputti.

² R. RITZLER - P. SEFRIN, *Hierarchia catholica, medii et recentioris Aevi, Monasterii 1923*, IV, (1592-1667), 245. «Episcopus segniensis solet administrare Modrussien sed de ecclesia aut civitate Modrussiensi nihil estat quod referatur, cum ipsa illa ob nimiam Turcarum vicinitate sit desolata». Traduzione: Il vescovo di Senj è solito amministrare Modrusio (Modruskoj) ma sulla chiesa o sulla città di Modrusio non vi è nulla da riferire essendo (perché) essa stessa per l'eccessiva vicinanza dei Turchi (è) rimasta senza abitanti. Modruse era una località sotto la giurisdizione del vescovo «Segniensis» da Senj, Zeugg in Croazia.

³ *Ibid.* L'anno della morte di mons. Agatich non è riportato, tenendo conto dei tempi

gestire un clero non sempre obbediente che operava presso comunità cattoliche tentate ma soprattutto indotte a cambiare la propria fede. La pressione esercitata dal clero islamico e dalle autorità era enorme. La gente fu in grado di resistere agli inviti dell'Hoggia, maspesso si trovò in gravissime difficoltà per la politica adottata dalle autorità, le quali ricorsero nell'ordine alle intimidazioni, allaviolenza e al sapiente uso della leva fiscale mediante la quale riuscirono a scardinare, ma non sempre, la resistenza cattolica.

Nell'Albania occupata, i cattolici vissero in condizioni inimmaginabili, ma furono in grado di superarle perché potevano contare sulla presenza del clero cattolico, che dipendeva direttamente dalla Congregazione di Propaganda Fide. Il problema della tenuta della fede cattolica si pose allorché non fu possibile sostituire immediatamente l'ecclesiastico che era venuto a mancare. In quel caso, la gente, avendo bisogno comunque del servizio spirituale, era costretta a rivolgersi ai sacerdoti islamici, i quali intervenivano a condizione che si convertisse. L'interruzione avveniva per cause naturali, ma spesse volte era provocata dai continui atti di violenza o dall'invio di militari turchi.

Il loro arrivo tra i monti dell'Albania settentrionale aveva provocato, per esempio, l'immediata partenza del vescovo che si era messo al sicuro. Mons. Agatich, forse per passate esperienze o per la conoscenza dei modi solitamente usati dalle autorità in analoghe circostanze, aveva preferito non rimanere in sede per non mettere inutilmente a repentaglio la propria vita o causare un danno alla Congregazione di Propaganda Fide per via della richiesta di pagamento di un pesante riscatto. Facendo perdere le sue tracce anche ai suoi fedeli e ai suoi sacerdoti, il presule aveva lasciato senza guida il suo gregge e soprattutto non aveva assicurato la presenza di un sacerdote ai *malissori*.

Il vuoto era stato immediatamente colmato dal Patriarca di Pech e dal vescovo di Cetina, diventati punto di riferimento per tutte le esigenze dei fedeli. Costoro, però, erano di rito greco e ciò aveva avuto come indesiderata conseguenza il passaggio di 300 delle 400 famiglie di Cucci allo «scisma». A Gruda, invece, il danno fu di gran lunga inferiore, perché il fenomeno interessò soltanto un numero limitato di famiglie (5 o 6) delle oltre 200 esistenti. L'abbandono della fede

connessi alla nomina e del fatto che il successore mons. Pietro Mariani prese possesso della sede il 18 aprile 1644, essadovette verificarsi almeno nel primo semestre del 1643.

cattolica da parte di tante persone di Cucci dimostrava ancora una volta che l'assenza anche temporanea di religiosi nella missione, costituiva un grave problema.

Vescovi, presidenti di missioni, sacerdoti e civili, nel passato, consapevoli di simili risultati, avevano inviato moltissime segnalazioni anche con toni concitati alla Congregazione di Propaganda Fide, che, naturalmente, pur non potendo fare il miracolo di procedere a una pronta sostituzione dei frati francescani, tuttavia non sottovalutò mai il problema che toccava profondamente le esigenze spirituali della popolazione che, come si apprende da una lettera non coeva, aveva tanta stima e considerazione per i missionari da affidare loro i figlioli perché li avviassero al sacerdozio in modo che in futuro nessuna località corresse il rischio di rimanere sguarnita dell'indispensabile presenza di un prete⁴.

Il pericolo di restare privi di servizi spirituali assicurati dai francescani, almeno tra le montagne albanesi, era stato scongiurato dal giugno del 1641, quando, per ordine della Congregazione di Propaganda Fide, era stata istituita la missione a Gruda, presso la quale, da allora, risiedettero stabilmente due frati per esercitare il loro ministero⁵. Padre Bernardino Romano, in un rapporto inviato l'anno successivo informò la Congregazione di Propaganda Fide che la missione assicurava il servizio spirituale a 826 famiglie sparse in ville non facilmente raggiungibili essendo situate tra «gli altissimi monti»⁶. Di queste 60 vivevano a

⁴ Archivo di Propaganda Fide (d'ora in avanti APF), *Fondo Albania*, vol. 11, c. 80r-81r. Lettera dell'abate Gennaro Clavaro, missionario apostolico. Drimades in Epiro, 10 marzo 1761. «Sempre andamo in giro predicando, insegnando (insegnando), ed istruendo, in pubblico, ed in privato Le vere massime Cattoliche, e buoni costumi, ai piccoli, ed ai grandi, senza badare a' pericoli. Li popoli stanno tanto ben contenti della nostra Condotta, che molto Ci stimano, e Ci rispettano, a segno tale che molti Ci fidano i loro figliuoli, che li portano presso di noi, da paese in paese, per renderli abili a Scendere al sacerdozio, e noi ne abbiamo tutto il piacere, senza badare all'incomodo, ed alla spesa, perché in moltissimi Paesi vi stanno de' gran Cristiani, ma senza sacerdoti; motivo per cui lasciano il Cristianesimo, e si fan Turchi; onde per liberarli da questo gran male, e da questa ruina, abbiám pensato portare sempre presso di noi giovani di questi paesi, affin di renderli abili al sacerdozio, e già ne abbiám ridotti molti, che stanno in procinto di ordinarsi. E' l'abilità de' sacerdoti di tutta l'Albania, non consiste in altro, che a saper leggere bene, ed a saper dire l'offitio, e la messa».

⁵ *Ibid.*, S.O.C.G., vol. 264, c. 49r.

⁶ *Ibid.*, «Sommario di una Relatione del Padre Bernardino Romano osservante Reformato Missionario in Albania circa lo stato della nuova missione di Gruda, e contorni li 25 Maggio 1642», c. 49r e v e c. 52r. In J. ZAMPUTTI, A. RAMAJ, N.

Scherielli, 120 a Hoti, 40 a Castrati, 206 a Gruda e addirittura 400 a Cucci «tutte parimenti cattoliche». L'impegno richiesto era faticoso e, soprattutto scarsamente remunerativo, perché si trattava di servire gente che viveva dedicandosi alla pastorizia, allevando animali da cortile e seminando i pochi terreni situati nei pianori.

Situata inizialmente in una capanna di paglia, nel mese di maggio del 1642, trovò una più idonea sistemazione in una casetta che gli abitanti di Gruda avevano costruito *ex novo* in muratura e generosamente messa a disposizione dei missionari, perché non affrontassero per la seconda volta l'esperienza del rigido inverno albanese. Nonostante il cambiamento, la sede della missione era veramente povera e adeguata alla estrema miseria di Gruda dal momento che i missionari si alimentarono con biade, con erbe senza olio e con pane di orzo e anche di serpentaria, detto così da una pianta erbacea con rizoma ritorto come un serpente.

Il Presidente della missione, data la situazione economica della villa di Gruda, insisteva nel dire che le inderogabili necessità dei frati, in quel momento di assestamento, erano di natura alimentare. Egli era dell'avviso che in missione non dovesse mancare mai il pane, l'olio e il vino⁷. Non chiedeva molto, perché, data l'esperienza maturata in terra d'Albania, era consapevole di un fatto elementare. I frati non avevano grandi pretese, per cui, una volta risolto il problema del sostentamento senza dover dipendere necessariamente da gente che per essere povera poteva essere di poco aiuto, non si sarebbero allontanati mai da quei cattolici, rimasti tali nonostante un'assenza a volte ventennale di sacerdoti⁸. La copertura della sede era stata non solo tempestiva perché nel recente passato, anche per l'azione di contrasto praticata dalle autorità civili e religiose, non sempre era stato possibile operare rapidamente le sostituzioni, ma anche opportuna, perché, senza "operai", la "vigna del

RRAHMANI, Z. AHMETI (a cura di) *Dokumente për historinë...*, 481-483 sono trascritte solo le cc. 49 r e v. Mancala parte finale della relazione, perché, come osserva Zamputti, la c. 50 riporta la lettera di fra Cherubino. La continuazione della lettera invece esiste e si trova nella c. 52r, che si trascrive:

«doppo la morte sua intiero, e senza lesione alcuna nel corpo, e tuttavia Si vede il suo sangue nel luogo, ove fù ucciso, che li Turchi non hanno mai potuto levarlo.

10. fàinstantia se gli mandino corone per quelli Cattolici

11. e che si fondi una nuova Residenza per li missionarij nelli Castrati.

12. e finalmente dà conto di alcune opinioni, riti, e costumi di quelli Scismatici per esser avvisato se dee tolerarle, ò reprovarle».

⁷ *Ibid.*, c. 49r.

⁸ *Ibid.*, c. 49v.

Signore”, cioè il numeroso popolo cattolico che viveva tra le montagne, avrebbe languito.

L'arrivo di missionari, pertanto, era stato molto apprezzato dalle comunità locali. Dopo un numero insopportabile di anni, gli abitanti di Scherielli poterono manifestare il loro orgoglio cattolico, i genitori riuscirono a battezzare i loro bambini e molte coppie per non essere accusate di vivere nel peccato regolarizzarono la loro posizione contraendo il matrimonio *in faciem ecclesiae*⁹. A Gruda e nel paese di Cucci, dove più forte era il pericolo, i missionari ingaggiarono una lotta serrata per il mantenimento della fede cattolica, di cui riproposero i principi in modo tale da far perdere validità alle offerte dell'Hoggia.

Costui, infatti, sfruttando l'assenza di religiosi cattolici e le paure dei fedeli, aveva cercato di convincere i cattolici che non era necessario salvarsi e che quindi aderissero all'Islamismo, unico e credibile interlocutore. Egli sperava di poter far breccia nell'animo dei fedeli sia perché il Cattolicesimo, pur essendo nel loro cuore, poteva rapidamente essere messo da parte ove la comunità non avesse potuto contare stabilmente su un continuo servizio spirituale sia perché la gente era così ignorante in materia di religione da confondere Cristo con Maometto o arrivare persino alla loro identificazione o addirittura ritenere che ci fossero tante religioni quante le lingue parlate¹⁰. Nonostante tale singolare modo di pensare, i *malissori* erano fortemente devoti alla persona del Papa sebbene gli ortodossi cercassero di metterlo in cattiva luce dicendo che li aveva abbandonati e altre «favole indecenti»¹¹.

Il Presidente, comunque, rassicurava la Congregazione che la situazione, ferma restando l'esigenza di avere sempre sacerdoti che risiedessero nelle località di destinazione, era sotto controllo e che l'incessante azione dei frati aveva dato risultati soddisfacenti. I missionari avevano battezzato centinaia di bambini e avevano aperto una scuola per istruire «quei figli nella lode, e timore d'Iddio». Essi, inoltre, con le loro prediche e con il loro esempio di vita, avevano rafforzato i cattolici nella fede riuscendo anche a dissuadere alcune persone che erano determinate a passare all'Islamismo o a far tornare indietro

⁹ *Ibid.*

¹⁰ *Ibid.*, «Sono questi Cattolici ignorantissimi»

¹¹ *Ibid.*, «ma ritengono tanto di devozione alla Santa Sede che per molto che siano stati sollecitati dalli Scismatici con dirgli, che erano abbandonati dal Papa e con raccontar lor dicerie, e favole indecenti della Santità di Nostro Signore sono sempre stati costanti ancorché senza sacerdoti cattolici per lo spatio di 20 e più anni».

parecchi che erano passati allo «scisma». ¹²Impegnandosi strenuamente, erano stati in grado di mantenere nel Cattolicesimo un intero villaggio, i cui abitanti avevano minacciato il passaggio in massa all'Islamismo se, entro un anno, non avessero un sacerdote cattolico. La sua presenza aveva scongiurato il pericolo, per cui, nell'ultima Pasqua, tutti avevano potuto fare la comunione ¹³.

Nel 1644, su indicazione della Sacra Congregazione di Propaganda Fide, l'Ordine dei Francescani affidò la responsabilità spirituale della missione di Gruda ai frati, Paolo da Mantova e Salvatore da Offida. Questi dovevano assicurare il servizio spirituale in quella località per evitare che restasse alla mercé degli Islamici e degli Ortodossi, che spiavano ogni occasione per soppiantare il Cattolicesimo. La Congregazione, almeno quella volta, poté agire con molta sollecitudine anche perché era ben consapevole del fatto che gli Albanesi aderivano alle altre religioni non per convinzione quanto per le necessità connesse al ricevimento delle necessarie e indilazionabili funzioni che solo un sacerdote poteva svolgere.

Dopo due anni di operoso funzionamento della missione, assicurato da altri frati di cui non si conoscono i nomi, si verificò, però, l'episodio che doveva turbare profondamente la vita della comunità cattolica. I due missionari, in base alla dichiarazione di «Andreas Marcus de Triepsci Villa de Cuccij», erano arrivati da poco ¹⁴. Essi, sospinti da un forte afflato missionario, ritennero che fosse loro preciso dovere recarsi a Clementi per la celebrazione solenne della festa di S. Nicola. Certamente, erano stati informati che in quella località, nonostante i tentativi effettuati da altri frati, i fedeli vivevano non in conformità delle

¹² *Ibid.*

¹³ *Ibid.*, c. 49r. «In Gruda, e Cucci, li missionarij, con prediche, et essortationi hanno confermatiquei Cattolici nella santa fede, e particolarmente alcuni, che si volevano far Turchi à persuasione dell'Hoggia, come già haveano fatto alcuni altri, stimando per l'ignoranza loro, non necessario per salvarsi; et hanno ritenuta una Terra intiera ne' Cucci, la quale havea determinato unitamente di passare al Mahometismo se in termine di un'anno non compariva sacerdote Cattolico in loro aiuto. Si sono confessati generalmente, giovani, e vecchi di 70 et 80 anni, e questa Pasqua si sono comunicati tutti».

¹⁴ *Ibid.*, cc. 66r – 71v. Da questo punto in avanti il racconto è giustificato dal documento allegato, che si trascrive rivisto e corretto. Per la trascrizione vedi anche J. ZAMPUTTI, A. RAMAJ, N. RRAHMANI, Z. AHMETI (a cura di) *Dokumente për historinë...*, cc. 67r-71r. 506-513; essa, però, è priva della carta 66r, della carta 71r di cui è trascritto il primo rigo e metà del secondo e della carta 71v.

prescrizioni canoniche che, soprattutto sul matrimonio, erano tassative e molto diverse da quelle previste dalla morale islamica.

Lapopolazione maschile, però, era fortementedetentata dalle possibilità offerte dall' Islamismo in tema di matrimonio. Molti uomini praticavano il concubinato; altri avevanopiù donne; altri ancora sposavano le cognate o la seconda o terza moglie del padre se rimaste vedove. L'abbandono dell'etica cattolica per quella islamica, inoltre, veniva in un certo senso favorito dalle norme consuetudinarie ancora vigenti che privilegiavano non la salvezza delle persone ma quella del patrimonio. Lo scandalo era evidente e plateale, perché vedeva tra i protagonisti lo stesso Ceffali del villaggio, cioè Prenk Nica che divideva le medesime donne con i due fratelli conviventi e un sacerdote di Pulati, don Giovanni Tanusi, il quale, dimentico delle norme canoniche, aveva giustificato il loro inusuale modo di vivere.

I due missionarisperavano che, per la festa di S. Nicola, l'ordine sarebbe stato ripristinato, ma indubbiamente non avevano una chiara percezione della situazione, perché per alcuni cattolici delle montagne avere certi comportamenti era un fatto del tuttonormale. I frati, è appena il caso di dirlo, non riuscirono a inserire quel particolare comportamento tra gli eventi umani e convennero sulla necessità di estirpare quella strana unione, novità assoluta anche per gli islamici notoriamente poligami o per il diritto consuetudinario che ammetteva il matrimonio con cognate e con matrigne se vedove. Essi avevano, quindi, motivo per pensare che il loro tentativo di far ritornare sulla retta via i fedeli che avevano sbagliato non sarebbe stata coronato dal successo eche, andando a cozzare contro la consuetudine, con molta probabilità, avrebbero fallito.

Tuttavia decisero di raggiungere ugualmente la località ritenendo che affrontare il problema davanti alla comunità ecclesiale rientrasse tra i compiti principali della loro missione. Lecca Ranchio di Gruda, un loro vicino, in verità, conoscendo bene le persone e le consuetudini, aveva sconsigliato il viaggio presagendo che, non essendo disposti a «farli la legge» che volevano, cioè avallare cioè la situazione esistente, sarebbero stati sicuramente ammazzati. Nonostante tale pesante, ma disinteressato avvertimento, i due «si avviorno verso li Clementi», dove furono accolti apparentemente con grande rispetto e ospitati nella sua casa da Prenk Nica.

Era abbastanza evidente che si tentasse di comperare il loro silenzio,

ma essi non potevano e non dovevano tacere, perché, in caso contrario, non sarebbero stati più credibili. La vicenda aveva assunto ai loro occhi le fattezze della sfida e della provocazione. Salvatore e Paolo accolsero l'offerta perché la legge dell'ospitalità, sia pure concessa da persone di dubbia moralità, doveva essere rispettata fino in fondo. Essi, però, erano decisi a non lasciarsi sfuggire la possibilità di mostrare appieno la loro incorruttibilità e la loro inflessibilità nel colpire il malcostume che si stava pericolosamente annidando nella società albanese. Certamente vi erano molti rischi in quel che facevano, ma decisero di correrli ugualmente.

I dashur Zoti Jup Kazazi -me qenë se do të rrini në Malsinat e Shkodrës, ju lutem të keni kujdes të hyni në korespondencë me krenat e fuqive nacionaliste që gjinden në Vlorë e Shijak (e Durrës). Këta janë burra që kanë dhënë prova të gjalla për ndjenjat e tyre nacionaliste dhe të cilët mund të paraqiten si grumbull përpara fuqive aleate, kur të zbarkojnë në Shqipëri. Ju urojmë punë të mbarë dhe të vlefshëme për Shqipërinë dhe sukses. Të fala Kryetari, Midhat Frashëri. (pra, ishte parashikuar me kohë qëndrimi i Jupit e përgatitja për zbarkim të aleatëve).

Fq.66- Në një letër që i shkruan Enver Bushati, me 17/10/1944. Ai e njofton se grupi anglez është kthyer me nëndetëse në Itali. Jupi ka shënuar me dorë të vet nisjen e Misionit Ushtarak Anglez që u largua nga Shqipëria dhe faktin e panjohur nga Enveri që Misionin Ushtarak Anglez e kishte përcjellë ai, gjë që nuk dihej më parë. (Ata i përcolli në Shëngjin, ku i mori nëndetësja, Jupi me vllazër).

Fq.127- me dt. 6/08/1946: *Informatë se Jup Kazazi asht ulë nga Dukagjini, asht nisë për Vorfë ku dyshohet se ka shkue tek Qerim Baculi, Mem Sadrija, Çek Selmani.*

Fq. 128- Informacion Sek. II-te: me dt.20/04/46 *Jup Kazazi tue ardhë prej Sumet ka shkue në shtëpinë e Ram Metës, dhe pas takimit është përcjellur për në Zhup ku dyshohet se ka shkue në shtëpinë e Sadik Zyberit deri në mbramjen e 22-shit (prill) e nuk dihet çfarë drejtimi ka marrë. Me20/04/46 në shtëpinë e Halil Hysejnit në Bardhej janë bërë lëvizje e dyshohet se asht bërë një mbledhje. Me 22/04 po ky person asht takue me Tahir Metin nga Mesi. Ky person ka pasë lidhje direkt me*

Jupin dhe dyshohet mos kanë dijeni për lëvizjet e Jupit.

Fq. 130- Shkruar me dorë e pa datë tre informacione: *Jup Kazazi simbas informatavet të sigurta prej tashti gjindet ne Sumë dhe rrin gjithashtu në Likaj. Njerëzit që mbajnë lidhje me Jupin janë: 1. Zyber Cafë, Kala 2. Dul Osja dhe i biri Muho Dyli nga Myselimi. Jupi gjindet vet i treti tashti janë: Nexhat Boriçi dhe një farë Abaz.*

- Raporti informativ i major Mihallaq Ziçishti, komandant i qarkut në M. P.Brëndshme, thotë: “*Kokat udhëheqëse të kriminelavet që u vranë ose u kapën ishin Jup Kazazi, Seit Kazazi, Pashuk Biba, Bajraktari i Shoshit, Murat Haxhija, Osman Haxhija (udhëheqësit e Postribës)*”

Nuk mund të mos shkruaj për Shaban Hysen Bibaj prej Boksit, një prej besnikëve të Jupit. Atë e patën torturuar për vdekje dhe pati bërë burg; e dinte ku ishte Jupi e nuk tregoi. Duhet të përmend edhe Abaz Et-hem Ibraj prej Linaj –Rrjoll, që e kanë pasë torturuar tmerrësisht e nuk tregoi. Gjithashtu kujtoj Çel Ahmet Isufaj prej Linaj, që ka pasë bërë burg dhe na vinte gjithmonë edhe me të shoqen.

Po të analizohen dokumentet e dy arkivave e të tjera, del se i vetmi person që ka lëvizë në të gjithë Veriun, është Jup Kazazi. Përveç Postribës e përreth Shkodrës, ka pasë lidhje e shkuar në Malësitë Madhe, Dukagjin, Pukë, Mirditë, Dibër, Nënshkodër e Lezhë. Ka pasë lidhje me Gjonmarkajt, Mirakajt e Dinët, si dhe dalin lidhje me Matin, me Durrësin e Shijakun, Skraparin e Vlorën. Pra, ishin lëvizje për të përgatitë kryengritjen e përpiqej t’i bashkonte të gjithë. Dalin bashkëveprimi e kontaktet me njerëz me influencë, si Sulçe Beg Bushati e në Lezhë, Xhemal Beg Mlika, miqtë familjes, Dedë Shabani, Kol Ashiku etj. Del se Jupi ka qëndruar kryesisht në Postribë, ku ka pasë miq bajraktarë e shumë njerëz të thjeshtë.

Fatkeqësi për liridashësit e fat për komunizmin ka qenë dështimi i parë për fillimin e kryengritjes, që ishte organizuar mjaft mirë. Ishte vendosë për të sulmuar Shkodrën me 21 janar 1946 në mbledhjen e 80 krerëve në Vukatanë nën kryesinë e Jupit, por sulmi i një kollone ushtarake në Beltojë para kohe prej Hasan Isufit, bëri të organizohen e të mblidheshin forca me mbrojtë Shkodrën. Gjithashtu filloi terrori, arrestime e pushkatime. Për këtë ka edhe dokumente.

Prof. Uran Butka, në librin “Kryengritjet e para kundër komuniste”, shkruan se në bazë dokumentesh për përgatitjen e kryengritjes që në janar. “Qyteti- shkruan ai- do të ngrihej nga brenda, por do të mësyhej menjëherë dhe nga jashtë prej kryengritësve të katundeve e krahinave

përreth: Postriba, Ana e Malit, Guri i Zi, Oblika, Beltoja, Rranzat, Rragami, Sheldija, Dukagjini etj. Për organizimin e saj me nismën e Jup Kazazit, u mblodhën në Vukatanë përfaqësuesit e këtyre katundeve e krahinave dhe vendosën që në datën 21 janar të sulmonin Shkodrën.” KolëAshiku, komandant i 9 katundeve deponon: “ *më erdhi një letër nga Jup Kazazi dhe Hasan Isufi. Ata më shkruanin se kishin krijuar lidhje me Mark Gjon Markun, i cili kishte komunikuar edhe me të tjerët për të përgatitur kryengritjen. Mati, Dibra, Lura e Luma ishin caktue me sulmue Tiranën, ndërsa prej urës së Mbretit e përpjetë do të mësyhej Shkodra. Hasani me shkruante se ai vetë do të mësynte nga ana e Bahçallekut, Halit Kazazi nga Tepja, Jupi me Pashukun nga Ura e Mesit, mua më caktuan si objektiv dhe prefekturën. Por do të ngrihej edhe qyteti...”*”.

Me shumë rëndësi e për t’u studiuar janë dokumentet e Arkivit Qëndror të Shtetit, sidomos raportet që sekretari i Komitetit Qarkut P.K.SH të Shkodrës, Spiro Pano, por edhe Bilal Parruca i dërgojnë Komitetit Qëndror, Koçi Xoxes etj. e anasjelltas. Përmes tyre njihemi me udhëzimet e veprimet për diskriminimin në opinion, të dënuarve (më vonë me vdekje); pjestarë të klerit, e të deputetëve Riza Dani, Kolë Prela etj.

1) Shkresa nr.503/1 - 11/9/1946, Komiteti Qarkor i PKSH për Shkodrën: Komitetit Qëndror të PKSh Tiranë.

Në vijim të shkresës s’onë Nr.503 dt.9.9.1946, shkruhet, ju japim këto njoftime të reja rreth goditjes s’ilegalëve afër kazermave t’ona. Si del sot dhe në bazë të informatave të fundit, numri i atyreve që kanë marrë pjesë në aksion nuk ka qenë 50 por gati 300 vetë nga katundet e komuneve Postribë e Gur’ i zi. Udhëheqësi i aksionit del Jup Kazazi dhe rreth tij një pjesë e mirë kulakësh, tipa kapadajsh, tregtarësh të tatuar, oficerash të Zogut etj. Këta nuk ishin të gjithë të armatosur, ditët e fundit informohemi se të tilla aksione do të bëhen gjoja në Lesh, Koplik e gjekët. Bazat t’ona janë të dobëta këtu, fshatarët e mesëm dhe pasanikë janë të lidhur me Jupin dhe këta kanë me vehte dhe fshatarë të varfër injorantë e të lëkundur. Ne tashti kemi marrë masat e para dhe goditjet tona vazhdojnë si në qytet si në fshat; njëkohësisht vazhdon demaskimi i kriminelit Jup Kazazi dhe dëmi që ju erdhi fshatarëve nga ky aventurjer. Është mirë që operacioni i rreptë kundra krerëve e bajraktarëve të Dukagjinit (e miqëve të tyre) të fillojë sa më parë e të paralizohet Shllaku i cili përbën një krah për Postribën. Njëkohësisht

të vazhdojnë masat në qytet e periferi duke patur kujdes që të goditen pronarët, tregtarët e tatuar, ish oficerat e Zogut dhe jo masa e varfër. P. Komitetin Qarkor të Partisë (Spiro Pano).

Ky dokument është shumë domethënës, sepse autoritetet komuniste pohojnë vetë dobësinë e tyre, që fshatarët i kanë kundra, të pasur e të varfër dhe pohojnë influencën e Jupit. Gjithashtu del se do të sulmonin edhe krahina të tjera.

2) Shkresa nr.10/12, Res. - 3/10/1946

Komiteti Qarkor i PKSH për Shkodrën: Komitetit Qëndror të P.K.Sh. Tiranë.

I. Reaksioni dhe ne. Nga proçesi që zhvillohet, sot del se reaksioni është përpjekur për një organizim më të mirë dhe për një veprim me të gjerë se ai i 9 shtatorit. Si duket, ilegalët, në kombinim me miqtë e tyre nëpër qendrat, mateshin të bënë aksione të kombinuara në Shkodër, Lesh, Koplík e Shën Pal pas 15 shtatorit duke vazhduar njëkohësisht veprimtarinë e tyre në Dukagjin. Mobilizimi shpejtoi veprimin e Postribës dhe masat e marruna nga ne, pas këtij veprimi, i çrregulluan planet e tyre.

Tashti del se reaksioni (koka e të cilit në qarkun tonë është kleri dhe prapa tij Int. Servisi) ka marrë lidhje me elementin Parì të së kaluarës, ky element parì mundi të gënjejë fshatarët e Postribës e të Gurit të Zi, e t'i hedhin kundra nesh. Përveç kësaj demagogjije, reaksioni ka përfutuar dhe nga influenza që ushtrojnë Kazazët me shokë në fshatrat e Shkodrës, po ashtu dhe nga mungesa e një pune tonë serioze në këto fshatra. .

Kleri punon në heshtje dhe në mënyrë shumë konspirative. Ne kemi filluar një demaskim sistematik kundra gjithë atyre klerikëve që duan ta bëjnë kishën vatër reaksioni (në bazë të udhëzimeve që patëm nga lartë) që hedhin parulla kundra nesh, dhe që mundohen t'a ftohin fshatarin t'onë nga pushteti. Bashkë me demaskimin kemi marrë edhe masa dhe mendojmë të godasim akoma ata priftërinj ose klerik që nuk heshtin. Organizata u udhëzua në lidhje me demaskimin e gjithë atyre klerikëve katolikë e muslimanë (mbasi na del se edhe disa hoxhallarë kanë punuar kundra nesh të nxitur nga Kazazi me shokë) që hedhin parulla, që flasin kundra pushtetit

Qyteti. Goditjet e Mbrojtjes këtu në qytet kanë dhënë gjer diku rezultate të mira (shumica e të arrestuarve implikohen) po akoma sot nuk kemi arritur të zbulojmë kokën drejtonjëse të këtij organizimi.

Proçeset vazhdojnë, merren masa të rrepta, po rezistenca që ndeshim është e madhe. Ka raste që proceset vazhdojnë 4-5 ditë rrjesht (ndoshta edhe më tepër) pa mbritur në një përfundim (d.m.th. torturat). Organizata është mobilizuar e tëra në mënyrë që të demaskojë përpjekjen e reaksionit, të demaskojë Riza Danin, Kol Prelën dhe shokët e tyre, të shtojë informacionin dhe të sqarojë opinionin e popullit për goditjet t'ona, në mënyrë që këto goditje të aprovohen nga masa. Goditëm rëndë në Postribë (me pushkatime e djegëje shtëpijash), por bashkë me axhitacionin është nevojë dhe për masa të repta (pushkatime në vend të elementit në se kemi informata se është armik i ynë e ka armë). /P. Komitetin Qarkor të Partisë (Spiro Pano)

Pra, më 3 tetor del se kanë filluar me udhëzim nga lart demaskimin e klerit e të deputetëve.

3) Shkresa nr.10/14 Res. - 2/11/1946

Komiteti Qarkor i PKSHP për Shkodrën: Komitetit Qendror të Partisë K. Shqiptare, Tiranë.

.... 1. Proçesi i ngjarjeve pas "Postribës". *Ndërsa përpara ngjarjes së Postribës vërehesh një aktivitet i gjerë i reaksionit (aktivitet ilegalësh në Pukë, Dukagjin, Malsi të Lezhës e Koplík-Këlmend, aktivitet klerikësh e bajraktarësh, aktivitet kapadainjësh dhe intelektualësh në qytet etj.) sot vrehet një mpirje e tij dhe një tërheqje. Armiqtë u goditën rëndë në Dukagjin. Në qendër, me vrasjen e Jupit, të Seitit (vllai i Jupit), me vrasjen e njërit dhe kapjen e tjetrit të vëllezërve Hardolli, me dorëzimin e disa të tjerëve (Shefqet Muka, Xhemal Naipit, Musa Gjylbegajt etj), me arrestimin e një pjesë të mirë të atyre që janë implikuar në këtë proçes (Dom Nikoll Deda - prifti i Jubanit, Myzafer Pipa, Paulin Palaj, PjetërPalaj, Guljelm Suma e të tjerë) vazhdon tashti një pastrim i mirë i gjithë atyre që kanë lëvizurdhe kanë punuar kundra, përpara ngjarjes së 9 shtatorit. Janë bërë në qark përmbi 270 arrestime, por këto arrestime janë me vend (vetëm fare pak mund të jenë pak fajtor) / P. Komitetin Qarkor të Partisë (Spiro Pano)*

4) Me mjaft rëndësi është dokumenti: datë 24/03/1946, që provon synimin e forcave nacionaliste për një kryengritje të përgjithshme. Në këtë dokument Spiro Pano i shkruan Koçi Xoxes: "Mark Gjon Markaj më pas dhjetë të arratisur ka hyrë në mëhallën Ndër Shetiroshit. Ka thënë që Rusia e pat e mbaroj, asht formue me ne Qeverija Shqiptare, me të cilën kemi lidhje; Ballistat e Zogistat po përgatiten për kryengritje, mbrenda dy ose tre muajve fillon lufta e përgjithëshme. Partija Komuniste nuk ka

ma forza me dërgue në Mirditë. Na jemi me Anglo Amerikanët...”.

Edhe kur po jepete shpirt diktatura me 1990, historiani Demir Dyrmishi në librin e Institutit Historisë- “Lufta për likuidimin e bandave kriminale dhe organizatave tradhëtare në Shqipëri (1944-1948)”, fq. 81 e 82, pohon se po planifikohej një kryengritje e përgjithshme. Ai thotë: “Në mbrëmjen e 8 shtatorit të vitit 1946 iu afruan Shkodrës 450 kriminelë luftime, klerikë, mbeturina të Ballit e Legalitetit, armiq të pushtetit popullor. Në mëngjesin e 9 shtatorit ato e sulmuan nga veri-lindja e jug-perëndimi. Brenda qytetit armiqtë e pushtetit filluan të qëllonjë me armëdhe më tej vijonte: *“Shpërthimi i goditjes kundër revolucionare para kohe bëri që kriminelët e luftës dhe armiqtë e pushtetit popullor në qarqet e rrethet e tjera të mos vepronin, e të mos koordinonin planet kriminale, me ata të Shkodrës. Shkodra nuk u mor, kështu që anglo-amerikanëve, ashtu si një vit më parë iu pre mundësia për të zbarkuar trupat e tyre. ...”*

Kjo kryengritje ishte në kordinim me pjesët e tjera të Shqipërisë. Plani ka qenë i studiuar nga specialistët ushtarake si, Zeneli (Kazazi), akademist e Haliti (Kazazi) oficer, e me ta Jupi e Saiti. Pas janarit 1946, plani qe modifikuar simbas kushteve të reja nga Jupi.

Me 9 shtator 1946, pa dalë drita, (pse po merrnin djemtë ushtarë), u dha kushtrimi e filloi kryengritja antikomuniste e Postribës dhe e katundeve për rreth. Një pjesë nën udhëheqjen e krye-bajraktarëve ishin edhe të pa armatosur; burra trima, të gatshëm me dhanë jetën për liri. Ata u futën deri në qytet e jo deri tek kazermat. Ndonëse nuk dinin datën, komunistët kishin marrë disa masa.

Kryengritja u shua me terror e pasoja të tmerrshme për luftarët e familjet e tyre. U vranë në luftime 12 vetë, u pushkatuan menjëherë 18 vetë e u dogjën 30 shtëpi. Vetëm per Postribën janë 64 të pushkatuar dhe u mbushën burgjet e shumta të Shkodrës. U burgosën menjëherë në Shkodër 26 vetë dhe nga katundet 69 persona. Në qarkun e Shkodrës u bënë mbi 270 arrestime. Ka shumë variante rreth shpërthimit të kryengritjes, thuhet që edhe sigurimi ka pasë dijeni, por kjo nuk është e vërtetë dhe dokumentohet.

E vërteta është se fillimi i kryengritjes ishte lënë me 16 shtator. Ishte planifikuar dhënia e alarmit përmes kordinimit të përgatitur e lidhjeve me krahinat tjera të Shqipërisë kryesisht të Veriut. Po të fillonte kryengritja e përgjithshme, populli do të shtonte rradhët, mbasi e provoi “lirinë” që fitoi.

E rëndësishme është që Jupi i pati lajmëruar se nuk duhet të fillonin sulmin, pse ishte lënë data 16 e nuk mbërrihej lidhja me krahinat tjera deri me datë 9 dhe vetëm një pjesë e zonës së Shkodrës nuk mund të përballonte një ushtri të përforcuar, që nën drejtimin e Beqir Ballukut, përdori kundër kryengritësve tërë arsenalin ushtarak që kishin në Tiranë, topa e tanke etj. Nga mungesa e koordinimit nuk u ngritën krahina që ishin planifikuar të mbështesnin kryengritësit shkodranë nga Kopluku, Shllaku, Dukagjini, Lezha e krahina të tjera.

Për fillimin e kryengritjes e vërteta është se Dulo Kali i mbushi mendjen bajraktarëve të sulmojnë dhe i bindi se mund ta merrnin Shkodrën. Bashkë me Dulin për fillimin, me sa di unë, ka qenë edhe Pjetër Shan Deda, por nuk jam krejt i sigurtë. Akti qe shumë i guximshëm e heroik, por i pastudiuar mirë. Ishte dëshira e madhe për të fituar lirinë e për të rrëzuar diktaturën ndaj të gjithë ata që morën pjesë në këtë kryengritje ishin të gatshëm të sakrifikoeshin.

Dulo Kali qe dënuar me pushkatim. Ndjej keqardhje për Pjetër Dedën me të shoqen Marije, për të cilët pothuajse nuk flitet. Ata të dy mbas kryengritjes i rrethuan, edhe ajo nuk pranoi të dorëzohej e luftuan të dy deri sa u vranë heroikisht. Të luftojnë e të vriten burrë e grua së bashku, është akt shumë i rrallë trimërie.

Mbas kryengritjes e torturave çnjerëzore ndaj të arrestuarve, arritën të zbulojnë ku ishte Jupi. E rrethuan në shtëpinë e dajës tij, Rifat Koplikut, më 17 shtator 1946. Arrestuan menjëherë Rifatin, djemtë e tij, Ahmetin, 16 vjeç, e Sadedinin, 14 vjeç, dhe të vllain, Shyqyriun. Ata i thirrnin të dorëzohej e kishin frikë të afroheshin. Më vonë ndihet zëri që ju thotë: “Jup Kazazi nuk ju dorëzohet i gjallë komunistave. Rroftë Shqipnija e lirë!”. U ndëgjua një krisëm arme, pra, sakrifikoi vehten.

Në të njëjtën mënyrë sakrifikoi vehten edhe vëllai i katërt, Saiti, i zbuluar më 6 tetor.

Duhet të sqaroj dhe rolin e rëndësishëm të Abdullah Kazazit. Ai është përpjekur të sigurojë lidhjen e komunikimin e krahinave, dhe të personave të përfshirë në kryengritje me Jup Kazazin. Abdullahit, Rifat Koplikut e Shyqyriut ishin caktuar të mobilizonin e të ngrinin shkodranët. Kanë qenë edhe të tjerë, edhe nga ana katolike me sa di së paku tre vetë, që do të ngrinin njerëzit, por nuk kujtoj emrat.

Dihet se Kryengritja e Postribës u bë preteksti për të akuzuar e eliminuar pjesën më të mirë të patriotëve, klerin, kryesisht atë katolik, e deputetët opozitarë, që kërkuan të ndryshojnë e përmirsojnë gjëndjen

në mënyrë demokratike. Viktima qenë edhe një pjesë e konsideruar e të dënuarve në burgje.

Një prej tyre Prof. Sami Repishti, si dëshmitar e viktimë i ngjarjeve pohon se nuk e ka ditë se do të bëhej kryengritje. Në “Almanak”, nr.1, viti 2011, i Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pasoja të Komunizmit, në kapitulli “Kryengritja e Postribës”, fq.43, thotë: *“Faji jo ekzistues për të pafajshmit u krijua me propagandë dhe tortura. Këtë detyrë monstruoze e mori mbi vehte sigurimi kriminel që vepron akoma sot. Vetëm gjatë muajit shtator 1946, u arrestuan më shumë se 1200 qytetarë, 99% e të cilëve ishin të pafajshëm. Të tjerët ishin kundërshtarë të njohur të regjimit. Numri i burgjeve në Shkodër e kaloi shifrën 20. Me torturat më çnjerëzore viktimat e arrestimeve u detyruan të deklarorin se kanë qenë pjesëmarrës, ose të paktën kanë patur dijeni për Lëvizjen e Postribës. Unë kam qenë një ri nga këto viktima. Kështu pushteti filloi të flasë për qytetarët shkodranë, tregtarë, pronarë tokash, itelektualë perëndimorë e, sidomos për klerin katolik, si organizatorë të Lëvizjes, dhe për kryengritësit si fshatarë të gënjyer”.*

Këtë ngjarje ai e ka trajtuar edhe në gazetën “Panorama”, më 9/09/2016.

Po në atë almanak, fq.48-49, Prof. Kolec Topalli shkruante: *“Megjithëse nuk pati asnjë aktivitet dhe asnjë lidhje me Lëvizjen e Postribës, Cin Serreqi u vra se i përkiste një familje me emër në Shkodër; u vra pa asnjë faj, u vra për kulturën perëndimore, për antikomunizmin dhe qëndresën e tij. Ai nuk pranoi asnjë nga akuzat e rreme që ngriti për të Sigurimi, sepse ai nuk qe as organizator, as pjesëmarrës i Lëvizjes së Postribës, e cila shërbeu vetëm si pretekst nga pushteti gjakatar për të zhdukur elitën shkodrane, intelektualët më të spikatur të qytetit verior. Dhe mënyrat më barbare me të cilat u torturuan dhe u vranë, janë dëshmi e pafajësisë së tyre”.*

Prof. Repishti ka shkruar se “Cin Serreqi i ka pasë pohue kur ishin në qeli së bashku, se po e torturojshin tmerrësisht për me pranue për mbledhjen gjoja të bërë në shtëpinë e tij për fillimin e kryengritjes e të jepte emra, ndërsa ajo mbledhje as nuk ishte ba”.

Të njëjtën gjë do të deklaronte e mbesa, Dorotea dhe i nipi, Guljelm Serreqi. Theksoj se Sigurimi ka sajuar një mbledhje të paqenë në shtëpinë e Cin Serreqit, me qëllim ngritjen e akuzës dhe dënimin me vdekje të Cinit, Riza Danit e të tjerëve që deshën të eliminojnë mes tyre DuloKalin. Përmendet edhe Rasim Gjyrezin, që në atë kohë ishte në

mal me çetën e tij, pra e pamundur të ishte në Shkodër.

Me rëndësi për t'u studiuar, thelluar e për t'u zbardhur janë akuzat për dënimin e grupit të deputetëve. Të gjithë ata, që u dënuan me vdekje u akuzuan: “për organizim kryengritje t'armatosur”. I akuzuar ka qenë edhe kumbara im, Shefqet Beja, pra miku më i respektuar i Jupit megjithëse me ide të ndryshme, që në gjyq ka thënë se ka ditë që kishte përgatitje për kryengritje, sikurse e ka ditë shteti shqiptar, por ai as kishte të bënte fare dhe se ka firmosë nga torturat e tmerrëshme fizike e psikologjike. Po kështue dhe Riza Dani, mik i familjes, si pak persona ju ka rezistuar torturave dhe nuk ka pranuar asgjë.

Në Arkivin e Shtetit ka dokumenta me shumë interes, si për demaskimin e klerit e të deputetit Kol Prela etj. Me datë 16 shkurt 1946, Spiro Pano i shkruan Koçi Xoxes dhe i kërkon udhëzime veprimi për Kol Prelën dhe don Luigj Picin. Ndërsa me 18 shkurt Koçi Xoxe shkruan: Konspirative.- Për don Luigj Picin të fillohet demaskimi direkt duke u mbështetur në deklaratën e lëshuar pro kriminelave të luftës dhe fashistave. *...(që akuzonin priftat dhe i kishte mbrojtë)*. Për Kol Prelën (*deputet*) përgatitni terrenin në mënyrë të atillë që t'i presim rrënjët nga populli. Koçi Xoxe.

Shtoj se don Luigj Picin e vrau Sigurimi pabesisht në Koplík në nëntor 1946, ndërsa Kol Prela qe dënuar me vdekje.

Në librin “Deputetët”, i Autoritetit të Dosjeve të ish Sigurimit, 2016, për deputetët del qartë që megjithëse nuk asnjë provë për implikimin e tyre me Kryengritjen, ata u dënuan me vdekjeme akuza falso. E njëjta gjë pranohet dhe në “Akte gjyqësore politike 1946” të Institutit të Studimeve të Krimeve të Komunizmit, 2018.

Për veprën e sakrificën e Jupit, forcat shqiptare që përgatiteshin në perëndim e dërgoheshin, në Shqipëri, diversantë siç quheshin aso kohe, janë përpjekë të merrnin nënën me ne, dy fëmijët. Ne vitin 1948-49 ka ardhë një ditë vonë në shtëpi Hazizi, djali i Taip Halit Rrustja, nga Bërdica, i pushkatuar si bashkëluftar i Jupit dhe i ka thënë Nënës se e kishin dërguar t'a merrnin me gjithë dy fëmijët, pasi çdo gjë ishte përgatitur më së miri dhe ishin të sigurtë për të kaluar kufirin. Të nesërmen, koha që ishte përcaktuar nga ana e tyre për të dhënë gjegje. Nëna i tha se nuk mund të rrezikonte sado pak fëmijët. Mbas gati dy muajsh Hazizin e zbuluan në Cukal. Ai djalosh luftoi e nuk u dorëzua.

Jup Kazazit, në vitin 2009, qyteti i Shkodrës i dha titullin “Qytetar Nderi”, ndërsa në vitin 2017 Presidenti i Republikës Bujar Nishani i dha

“Dekoratën e Artë të Shqiponjës”.

Kryengritja e Postribës konsiderohet si e para kryengritje në Europë kundër komunizmit. Ajo mbetet heroike e simbol i luftës kundër komunizmit jovetëm në Shqipëri, por edhe në botë. E tillë ishte edhe Kryengritja e Malësisë së Madhe me 1945.

Unë kam nga babai 7 tëvrrarë, 10 të burgosur, 1 internim e 2 internime mbas burgut, nga nëna kam 2 të vrrarë, 4 të burgosur e 1 internim mbas burgu. Prej të vrrarëve janë 7 të zhdukur që vazhdojmë t’i kërkojmë e duhet të impenjohet shteti që nuk do t’ ia dijë.

Mendoni e gjykoni çka kaloi një nënë, gjyshja Hamide, që në pak muaj i vranë 3 djem, vëllain, kunatin me djalë e burgosë dy djemët tjerë.

Eshtë detyrë e historianëve e sidomos brezit të ri të kërkojnë e dokumentojnë siç duhet historinë e vendit tonë të martirizuar.

Ndue **BACAJ**

NJË RIKUJTESË PËR 100 VJETORIN E “LUFTËS SË KOPLIKUT” (1920-2020)

Lufta e Koplikut “zyrtarisht” ka si datë fillimi, ditën e 27 korrikut të vitit 1920 dhe si datë përfundimi 14 shkurtin e vitit 1921. Kjo luftë do të kishte “bekimin” dhe ndihmën e Qeverisë Shqiptare të dalë nga Kongresi historik i Lushnjës, gjë që e bën këtë luftë mbrojtëse të parën të drejtuar nga një Qeveri Kombëtare, pas 441 viteve (nga viti 1479), luftë e qëndresës popullore. Lufta e Koplikut është vijimi luftime mbrojtëse të trojeve shqiptare nga lakmitë e fqinjëve shoven dhe intervenimeve ushtarake të ushtrive serbo-malazeze gjatë viteve 1919-1920

Në prag të luftës së Koplikut

Në Paris (1919) fillon Konferenca e “Paqes”. Në konferencë kishte shkuar dhe një delegacion shqiptar me në krye kryeministrin e Qeverisë së Durrësit Turhan Pashë Përmetin, i cili nën shkruan dy peticione që i dërgohen Presidentit të 28-të SH.B.A.-ve Voodroë Eilson, ku i kërkohet ndihmë për të kundërshtuar “mandatin” e italianëve për të mbajtur të pushtuar Vlorën.¹ Presidenti i Amerikës (Eilson) në fakt që me 4 korrik 1918 (nga jahti presidencial “Mayfloer”), thuhej se i kishte

¹ *Turhan Pash Përmeti, Shqipëria përball Konferencës së Paqes Paris, 1919, fq.111-114.; Revista “LEKA”, Të drejtat e Shqipërisë Etnike, vol. I. Shtypshkronja “Zoja e Paperlyeme”, Shkodër 1944, fq.196-197*

dhënë fjalën veprimtarit të njohur të “Vatrës” Fan Nolit, se një zë që kishte në Konferencën e Paqës dhe Amerika do ta përdorte edhe për të mirën e Shqipërisë². Më pas Turhan Pasha jep dorëheqjen dhe në vend të tij e mori kryesimin e delegacionit Imzot Luigj Bumçi me sekretar Atë Gjergj Fishtë. Vlen të kujtohet se serbo-malazezet (me ndihmën e dados tyre Ruisë dhe Francës të asaj kohe), në Konferencën e Paqës propoganduan “idenë” se popullsia katolike e Malësisë së Madhe, Shkodrës, Lezhës e Mirditës, ishte dakord t’i bashkëngjitet shtetit Malazet me popullsi ortodokse, pra kristiane. Me iniciativën e Imzot Luigj Bumçit, Atë Gjergj Fishtës dhe patriotit Luigj Gurakuqi, nga këto zona iu dërgua një protestë energjike Konferencës dhe Lidhjes së Kombeve, ku ndër të tjera shkruhej: *“Popullsia katolike shqiptare, ka interesin më të madhe të qëndroi e bashkuar në një Shqipëri të lirë, dhe për këtë e shtyjnë motive kombëtare dhe fetare. Po qe se do të kërkoni të na “bashkoni” me Malin e Zi, atëherë Konferenca do të bëjë një krim të rëndë ndaj gjuhës tonë, religjionit tonë. Katolikët e muslimanët janë vëllezer, dhe si të mirën ashtu dhe të keqen e ndajnë së bashku.”*³.

Në këto kohë mbrojtjes të të drejtave të shqiptareve i ishte shtuar edhe zëri i Benediktit të XV-të, me të cilin ishin takuar Imzot Bumçi dhe Mehdi Frashëri.⁴ Serbo-Malazezët, duke përfutur nga mjegullnajat e Konferencës, dhe heshtja e një pjese të Europës në fundin e dhjetorit 1919, vranë rreth 80 malsorë nga Hoti etj.⁵ Paria e Shkodrës më 11 mars (1920) do të merrte në dorë fatet e Shkodrës, që deri atëherë i “mbante” gjenerali francez Bardi de Fortu me ushtrinë ndërkombëtare që udhëhiqte. Kryetari Bashkisë Shkodër u emrua Musa Juka, ky veprimi shkodranëve, ka edhe miratimin e Qeverisë së Tiranës (dalë nga Kongresi i Lushnjës).⁶ Ushtria Serbo-Malazeze (nga mali I Taraboshit) do të sulmonte qytetin e Shkodrës, i cili kishte organizuar rezistencën ...

Lufta...

² Edwin Jacque, *Shqiptarët, Tiranë, [2004], fq.403-405, Tajar Zavalani, Histori e Shqipërisë, Tiranë, 1998, fq.257.*

³ *Gazeta, "55", 03.10.2009, protestën e nënshkruajnë : Imzot Jak Serreqi, Arkipeshkëvi Shkodrës; Imzot Gjergj Koleci, Ipeshkevi Sapës; Don Zef Gjinali, Administrator i Abacisë Shën Llezhdrit.*

⁴ *Sejfi Vllamasi. Ballafaqime politike 1897-1942, Tiranë 1995, fq.116.121.*

⁵ *Hamdi Bushati. Shkodra dhe Motet, Shkodër, 1998, vol.I, fq.471; trashigimi gojore.*

⁶ *Sejfi Vllamasi. Po aty, fq.144; Eqrem Vlora, Kujtime, Tiranë, 2001, fq.449.*

Më 27 korrik, rreth tre batalione të ushtrisë jugosllave të ndjekur edhe nga mercenarët shqiptarë iu drejtuan Kastratit. Pas luftimesh të ashpra në kufi, ata mundën ta pushtojnë Kastratin, të ndihmuar edhe nga formacionet serbe dhe të artilerisë të vendosur prej kohësh në Tarabosh. Këto luftime mbrenda tre katër orësh, kanë dhënë ndërkaq sinjalet e kushtrimit në Shkodër e rrethina. Qytetin e ka pushtuar gjallëria e zakonshme dhe qindra vullnetarë u janë drejtuar postave të xhandarmërisë, duke u armatosur. *"Vullnetarët shqiptarë nga Shkodra e rrethinat rendin drejt fushës së Shtojit të gatshëm për t'u nisur sa më shpejt në front"*.⁷ Për hirë të vërtetës duhet thënë se konflikti i armatosur në mes shovenëve fqinjë dhe mbrojtësve shqiptar kishte filluar (*jo në front të gjërë*), që një ditë më parë (më 26 korrik), konflikt që u karakterizua nga sulme e tërheqje të njëpasnjëshme nga të dyja palët,⁸ përtëri filluar lufta frontale më 27 korrik (1920). Ushtria serbo-malazeze ishte e pajisur me armë moderne të kohës, kryesisht franceze, si topa e mitroloza. Sulmi tjetër i ushtrisë Jugosllave shënon datën 29 korrik, kur goditen me artilerinë Qafë të Malthit, sulm që u përsërit më me forcë me 30 korrik edhe në Bratosh (Katund të Kastratit).⁹ Megjithë numrin më të vogël të xhandarmërisë dhe vullnetarëve që ndodheshin në Kastrat, ata bënë një qëndresë heroike për disa orë. Por duke dashur që të zgjidhin konfliktin në rrugë paqësore, sipas porosisë qeveritare, forcat mbrojtëse shqiptare pushuan luftimet dhe nisen një komision të përbërë nga tre shkodranë: Xhemal Bushati, Maliq Sokoli dhe Shuk Gurakuqi të cilët shkuan me urgjencë te komandanti i forcave jugosllave, duke e njoftuar për ndalimin e luftimeve nga ana shqiptare dhe zotimin për të dënuar ata që do të guxonin ta prishnin.¹⁰ Megjithë angazhimin e shqiptarëve për armëpushim, forcat serbo-malazeze vijuan luftën kundër forcave shqiptare, duke shtuar intensitetin e sulmit, nga ku arritën të pushtonin (*përsëri N.B.*) Kastratin¹¹, duke u riorganizuar për të mësy në drejtim të Shkodres.¹² Për këto sulme shoviniste të ushtrisë jugosllave, Princi regjent i mbretërisë Serbo-Kroate-Sllovene (*ku bënte pjesë Mali i*

⁷ <http://www.lajmi.shqip.com>, Eugen Shehu, Arkivi Qendrori Shtetit-Tiranë.Fondi Komiteti I Kosovës, dosja 14, dokumenti 707.

⁸ Mentor Quku. *Lufta e Koplikut 1920, kumtesa e referate, Shkodër, 2010.fq.40*

⁹ AQSH, F.nr. 252, viti 1920, dosja 115, njoftim i zyrës së krahinarit të Shkrelit në Katund të Kastratit, dt.30.7.1920.

¹⁰ AQSH,F.nr.646, dosja 22, viti 1920, letër për kryeministrin nga Shkodra.

¹¹ AQSH,F.nr.260,, dosja nr.18, viti 1920....

¹² Revista "Agimi", nr.5,s htator 1920 fq.76

Zi, tashma pa emër), do t'i konfirmonte atasheut ushtarak anglez në Beograd, se forcat e tyre ushtarake kishin pushtuar vijën e lartësive në veri të liqenit të Shkodrës rreth 15 km, në lindje të kufirit të 1913-ës¹³. Ky konfirmim tregonte qartë qëllimet pushtuese e aneksioniste të Jugosllavisë. Ky pushtim i trojeve shqiptare do të mobilizonte vullnetarisht, malësorë e shkodranë. Zyra e krahinarit të Shkrelit në kufi me Kastratin, do të kërkonte sa më shpejt fishekë e ushtarë.¹⁴ Vlenë të shënohet se me 29 korrik në Shkodër ishte organizuar një takim i madh i drejtuar nga Ahmet Zogu, me qëllim shmangien e rrezikut që i vinte krahinës e qytetit të Shkodrës nga avancimi i pushtimit të trojeve shqiptare të Malësisë nga ushtria shovene jugosllave. Mbledhja u bë nën “moton” e kushtrimit “Serbëtia bëhen në Koplík”. Revista “Agimi” do t’a pasqyrojë kushtrimin kështu: “*Serbët ia behën në Koplík*”, ishte fjala e mbrame, qi si një rrufe kumbuese në vesh të Shkodranit ditën e parë të gushtit. Lajmi shungulloi e mori dhenë e kushtrimi u dha and e kand ndër fusha e male. Burra të pjekun, djelmtë ri, musliman e të krishtenë, si të bijët e thjeshtë të një race, vllazën të një gjaku, të një fisi, të një votre e të një zjerri, shqypetarët kurdoherë, ma tepër se shyptarëë përpara të shejtit Atdhe, me vrap me guxim mbyllën dugajë e zyra, lane ç’do punë e sherbim e menjëherë rrokën armët, tue pasë zjermin në gji e uzdajën në zemër. Burra e djelmë, sot o kurr.. Shka asht mashkull nuk shifet ma nështëpi, po grumbullohej jashtë në potologun e trimnisë, në fushë të nderit.”¹⁵

I pranishëm në këtë organizim ka qenë përfaqësuesi Qeverisë Shqiptare, Ahmet Zogu, i cili kishte ardhur në Shkodër për të organizuar e drejtuar mbrojtjen, në emrin e Qeverisë me kryeministër Sulejman Delvinën. Me 30 korrik në qytet u dha kushtrimi. Vetë Sylço Begu doli lagje më lagje me rekrutu vullnetarë “Një pushkë për shtëpi”. U mbyll pazari. Si në qytet dhe në fshat filloi organizimi i formacioneve vullnetare, gatishmëria e popullit që e plotë dhe e menjëhershme. Agjencia serbe, bëri ç’bëri të përhapte panik e mosbesim në masën qytetare, por zërat e elementëve të gënijem u mbytën nga vendosmëria e përgjithshme. Me 1 gusht (1920), padrekte u nis formacioni i parë me 500 vullnetarë nga qyteti. Me ta u bashkuen edhe malësorët e Mbishkodrës si dhe

¹³ *Xhevat Repishti, Lufta për mbrojtjen e Shkodrës në vitet 1919-1920, Shkodër, 1998. (dokument i cituar), fq.204.*

¹⁴ *AQSH, F.nr. 252, viti 1920, dosja 115, letër e zyrës së krahinarisë së Shkrelit, dt.30.7.1920.*

¹⁵ *Revista “Agimi”, nr.5,1920, fq.75-76*

emigrantët podgoriçanë. Ushtria zuri vend perkatësisht në Vrakë. Edhe shtabi zuri vend në Vrakë. Përveç Sylço Begut e Rexhep Shalës në shtab ishin të pranishëm edhe Maliq Bushati, Muharrem Kazazi, Shuk Gurakuqi, Oso beg Kopliku, Can Mema. Kur shtabi u vendos, më vonë, në një han në Çesme të Koplikut që i pranishëm edhe majori i xhandarmërisë Malo beg Bushati (Melgusha). Shtabi do të ndihmohej vazhdimisht në punën e tij nga prania e Ahmet Zogut, Bajram Currit, Mustafa Krujës dhe korrierve¹⁶. Interesant më duket edhe përshkrimi i një autori tjetër shkodran, i cili jep shifra të vullnetarëve, si dhe shkruan edhe për një përpjekje me armë në Vrakë në mes forcave vullnetare shqiptare dhe pararojës së ushtrisë serbo-malazeze. Nga ky autor citoj si më poshtë: *“Sipas planit, fuqitë vullnetare të qytetit numronin rreth 800 veta, që marshuan nga fusha e Shtojit në drejtim të Vrakës. Kësaj force vullnetare do ti bashkoheshin edhe 700-800 malësorë, numri i të cilëve rritej gjithnjë. Komandant i pergjithshëm i ushtrisë vullnetare u zgjodh Sylçe beg Bushati. Në Vrakë u ndeshën me pararojën e ushtrisë armike, të cilët kishin arritur deri këtu “tue djegë e tue grabitë”. Kjo ndodhi me 01 gusht. Mbas përpjekjeve në Vrakë, armiku u tërhoq në Koplík. Vraca ka qenë pika më e perparuar në drejtim të Shkodrës, ku mund të arrinin forcat invaduese”*¹⁷. *Forcat vullnetare shqiptare, sipas disa kronikave të kohës (në fillim) përbëheshin nga rreth 2200 veta, të ndarë në tre kolona. Kolona e parë përbëhej nga forcat e ardhura nga Hoti, Gruda, Shkreli, Postriba e tjerë, me në krye Deli Metën, Luc Nishin e Vat Marshin e tjerë e cila kishte për detyrë të marshonte nga fshatrat Gruemirë-Grizhë e në vazhdim rrëzë maleve. Kolona e dytë, krahu i majtë ishte ajo që veprimet luftarake do t’i kryente nën rrugën kryesore Shkodër-Hani i Hotit, afër bregut të Liqenit të Shkodrës, e këto forca përbëheshin nga vullnetarë kosovarë e malësorë prej Kastratit (ata që kishin mundur të largoheshin para se të pushtohej Kastrati) shkoi buzë liqenit. Këto forca komandoheshin prej Hamit Gjylbegut e Hasan Ferrit. Fuqia kryesore me vullnetarë prej qytetit e një grupi xhandarësh, vazhdoi si kolona e qendrës duke ndjekur rrugën automobilistike Shkodër -Hani i Hotit*¹⁸. *Forcat e qendrës i drejtonte oficeri Taip Shkodra. Në krye të qendrës ishte batalioni shtitës nën komandën e Hasan Bushatit dhe një kompani xhandarësh nën*

¹⁶ Hamdi Bushati. *Po aty*, fq.472.

¹⁷ Xhevat Repishti. *Po aty*, fq.205-206.

¹⁸ Xhevat Repishti. *Po aty*, fq.206-208, dokument i cituar, Gjon Zeka, *po aty*, fq.29.

komandën e Ibrahim Mandiqit. Një detashment reserve mbahej pranë shtabit. Në krahun e djathtë luajtën rol të ndjeshëm vullnetarët nga Rrjollli e Gruemira me Bajram Hysenin dhe ata të Postribës me Adem Haxhinë¹⁹. Ndërkohë Kelmendi mbronte me perkushtim trojet e veta i primun nga piramida e gjallë e kufijëve, Prekë Cali me shokët e tij të atdhetarisë në Kelmend e tj. Ndërkaq kolonat e krahëve shkuan përpara, krahu i djathtë nga Ktoshi-Grizhë, po u afrohej kodrave të Koplikut, gjithnjë nga e djathta. Kaluan Shenat e Banushit e kapërcyen mbi Sukat e Koplikut, të cilat u çliruan nga hotjanët me në krye Deli Metën e Lucë Nishin (kjo ngjau në mesnatë). Këtu forcat vullnetare patën dëme nga mitrolozat e armikut, që qëndronin në pozitat mbizotruese të kodrave të Koplikut. Krahët po rrethonin ushtrinë invaduese, mirëpo “hezitimi” e ndali përkohësisht marshimin e mëtejshëm të tyre. Në këto kushte dy krahët u lidhën njëri me tjetrin. Kështu u siguria lidhja duke plotësuar boshllëkun, që krijoi ngurimi i qendrës²⁰. Manovrimi i shpejtë e i guximshëm (i hotjanëve e tjerë) i dha mundësi kolonës së mesme që të nesërmen me 2 gusht, të arrinte në fshatin Koplik i Sipërm. Qeveria shqiptare që ngulmonte për ta zgjidhur problemin në fushën diplomatike e ndërkohë, për tu përgatitur për sulmin vendimtar, me të cilin do të dëboheshin përfundimisht jugosllavët përtej kufirit²¹. Ahmet Zogu, më 3 gusht 1920, kryeson mbledhjen e ushtrive (kupto shtabit N.B.), mbas vedit kishte marrë Musa Jukën, (Kryetari Bashkisë Shkodër), Sylço Begun e Shuk Serreqin, dhe të tjerë pari Shkodre. Nisin m’u mbledhë ushtritë, mbas zanit të burijavet ushton toka për në kambë të tyre, një zhurmë e madhe mbretnon n’atë fushë derisa fëtyra e Ahmet Zogut, “armatosun” ma së mirit qetëson luftëtarët e merr e u flet²². Më 3 gusht, në mbrëmje jugosllavët bënë përpjekje për të sulmuar, po sulmi i tyre u thye, vullnetarët shqiptarë kaluen me kundërsulm Prroin e Thatë në anën e djathtë të tij duke i marrë dy mitroloza²³. Çetat vullnetare tashma i ishin afruar Shkrelit. Në tri ditë e para të luftimeve (1, 2 dhe 3 gusht), kishin rënë duke luftuar kundër ushtrisë serbo-malazeze 10 vullnetarë,

¹⁹ *Xhevat Repishti. Po aty, fq.473-474.*

²⁰ *Xhevat Repishti. Po aty, fq.209, shënime mbi Luftën e Koplikut, të mbledhura nga autori Xh.R. prej pjesëmarrësve në luftë, fleta 2-3 të dhëna nga Hamit Gjylbegu, mars 1970.*

²¹ *Xhevat Repishti. Po aty, fq.209-210.*

²² *Gjon Zeka. Nëpër lufta në liri. Kopliku në vitin 1920-1921, Tiranë 1932, fq.19*

²³ *AQSH f.n. 252, viti 1920, dosja nr.115, dok.nr.38, fq.34, tel. nga Shkodra, datë 04 gusht 1920.*

ndërsa raportohej se kishin mbetur të plagosur 21 të tjerë. Të rënë shqiptarë në luftë shënohet se kishin qenë nga qyteti i Shkodrës dhe malësorë: Mustafa Alivoda-mullis nga Shkodra, Ali Rexhep Spahija dyqanxhi nga qyteti, Can Osmani e Zeqir Beqja nga Ura e Shtrenjtë (Postribë), Oso Meta nga Rrjollli, Lukë Nika, Zef Prela, Kolë Nika, Prekë Dashi e Kolë Dushi nga Hoti²⁴. Vullnetarë shqiptarë humbjet më të mëdha i kishin pasur kur muarën kodrat e Koplikut. Jugosllavët në dhjetë ditëshin e parë të luftës, shënohet se kanë pasur 300 të vrarë e të plagosur²⁵. Në këtë kohë të rinjtë shkodranë (muslimanë e katolikë), kishin krijuar grupin e çiklistëve –korierëve, ku u dalluan Simon Rranxi, Muhamet Haxhia, Loro Nika, Qazim Mesi, Kolë Çuni e tjerë. Ndihmë të madhe dha mbrapavija. Musa Juka, si Kryetar Bashkie u dallua për organizimin e mirë e serioz të furnizimit të frontit me ushqime e ujë (me karroca). Doktor Sadetini themeloi shoqatën “Hylli i Kuq”, për të ndihmuar të plagosurit. Ahmet Zogu, së bashku me patriotin e njohur Bajram Currin, që ditët e para të muajit gusht do të vinte pranë shtabit të mbrojtjes të vendosur në Çesme të Koplikut, në shtëpi (diku shënohet han) të Zef Lucë Mullisit²⁶. Që me 01 gusht me porositë Ahmet Zogut, pranë Bashkisë Shkodër u krijua komisioni përkujdestar i Ushtrive Vullnetare²⁷. Komisioni Përkujdestar i ushtrive vullnetare pati pranë tij një grup me qytetarë shkodranë e nga fshatrat e Bregut të Bunës, të cilët, fshehurazi përmes ushtarëve jugosllavë kalonin kufirin në bregdetin jugosllave blinin fishekë austriakë. Në punën e tyre ndihmoheshin nga popullata shqiptare e Ulqinit, Tivarit, Krajës. Me tratat e ngarkuara me fishekë, përmes zonave të armikut ktheheshin në Shkodër.²⁸ Vlen të cilësohet se Lufta e Koplikut nuk ishte i vetmi front luftime, që drejtonte Qeveria Shqiptare e dalur nga Kongresi i Lushnjës. Ajo drejtonte tre fronte luftime thuajse në një kohë: Luftën e Vlorës kundër pushtuesve italianë, luftën e Koplikut dhe luftën e Dibrës, të cilat kishin një armik të përbashkët, serbo-kroato - sllovenët (Jugosllavinë).

²⁴ AQSH, F.n.260, viti 1920, dosja nr.18, dok. Nr.800100, datë 05.08.1920; Revista “Agimi”, nr.5, fq.80, viti 1920.

²⁵ Gazeta “Populli”, nr.73, datë 14 gusht 1920.

²⁶ Hamdi Bushati. Po aty, fq.472-473.

²⁷ AQSH, F.n.646, viti 1920, dosja nr.120, shkresë e Përlimitares (Bashkisë) Shkodrës, nr.7607 /1, dt.01.08.1920.

²⁸ Xhevat Repishti. Po aty, fq.224, shënime mbi luftën e Koplikut, të dhëna të mbledhur nga ne, fleta 20, kujtime të Ibrahim Krajës, pjesëmarrës në luftë.

Malësia Madhe fushë-beteja më e madhe e luftës së Koplikut

Gjatë 203 ditëve (27 korrik 1920-14 shkurt 1921), luftë e qëndresë në perballje me ushtrinë shovene serbo-malazeze çdo pëllëmbë e trojeve të Malësisë Madhe ka një histori në vehte gjaku, heroizmi e qëndresë, ku çdo fis, shtëpi, katund, fshat apo mal i trojeve tona ka kontributin e vetë të rëndësishëm në mbrojtjen e çlirimin trojeve të Malësisë e Shqipërisë nga pushtuesit serbo-malazez. *Historia e kësaj lufte na tregon organizimin perfekt të vullnetareve që u shumfishuan dhe u bënë ushtri e rregullt, duke zhvilluar mjaft beteja në çdo pëllëmbë të trojeve të Malësisë Madhe, disa nga të cilat janë: Betejat në Suka të Moksetit, në Rrasa të Fikut, të burgu i Kalajve – Vukpalaj, në Brigje-Hot, në Drume të Borës – Hot, te Vorri i Papes, në rranxë të Veleçikut, në majë të Napujes, në Sukë të Kolvatës, në majë të Krygjës, në Majë të Veliberdës – Katund të Kastratit, Rraxë Veshtit, në Aliaj të Kastratit, në “Kodrat” e Koplikut e rrethinat e tij, në Koplik të Sipërm, në Prrua të Thatë, në Qafë të Malthit. Aksionet luftarake në Buzë-Ujit (në fshatin Kamicë) ku u kapën mjete lundruese me furnizime të ndryshme për ushtrinë...etj. Ndër këto beteja të paharruara, mendova të kujtoi vetëm ato të zhvilluara në Suka të Moksetit dhe Qafë të Malthit, ku dhanë jetën dhjetëra dëshmorë me në kryetrimin e flaktë atdhetar, oficerin Lucë Nishi Dedvukaj, si dhe betejën në lagjen Llazan (Koplik më 20 shtator 1920), ku trimi Zef Prel Martini luftoi heroikisht (edhe pse i plagosur) përballë një ushtrie të tërë serbo-malazeze, duke e bërë shtëpinë e Lush Pep Smakajt ti ngjajnë Kullës famëmadhe të “Oso Barotit” në Vranin. Dëshmori Zef Prel Martini u “kap” tradhëtisht dhe u pushkatua nga ushtarët serbo-malazez (afërsisht ku ka sot memorialin), në vendin e quajtur Badra e Mehajve (Koplik.) Në luftën e Kopikut do të humbinin jetën 77 dëshmorë, (të evidentuar nga unë N.B.) nga të cilët 62 nga Malësia e Madhe me Rranxat e saja, 14 nga Shkodra e Postriba dhe 1 nga Dukagjini, si dhe u plagosën dhjetra malësorë, shkodranë e tjerë, gjaku i të cilëve nuk do të bëhet “ujë” kurrë, pasi është derdhur për mbrojtjen e lirinë e trojeve shqiptare.*

▪ Trashëgimi kulturore ▪

Vasil TOLE

MUZIKA POPULLORE QYTETARE POST-AHENG
*(gjysma e dytë e shekullit XIX deri më sot)**(Pjesë nga studimi Folklori Muzikor - monodia Shqiptare)*

Në fund të shek.XIX dhe në fillim të shek. XX, krahas lëvizjes përparimtare shqiptare për liri dhe zhvillim shoqëror, në fushën e muzikës u vu re tendenca për të evidentuar nga trashëgimia muzikore popullore të gjitha ato vlera që deri më atëherë, për arsye nga më të ndryshmet, ishin penguar, denaturuar ose nxjerrë nga qarkullimi artistik muzikor. Një ndër këto ishte edhe lëvizja për çlirimin e repertorit muzikor popullor qytetar prej të gjitha atyre ndikimeve muzikore, kryesisht të dhunshme të cilat gjendeshin në të. Është një fakt i pranuar se në muzikën popullore shqiptare, nga faza e përplasjes së saj me kulturat e tjera muzikore, veçanërisht ndërmjet shek. XVI-XIX, janë mbishtresuar dukshëm, rreth 100 turqizma¹. Ato përfshijnë emërtime shkallësh muzikore, pjesësh të ahengut qytetar si dhe emërtime të veglave muzikore, duke ngelur si dëshmi e qartë e përplasjes së dy kulturave.

Veçoria kryesore e ahengut lidhet me një vështrim po aq specifik të kromatikës që ai mbart. Kromatika e huazuar në disa prej grupimeve të ¹ “Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”. A.Kostallari, “Rreth depërtimit të turqizmave”, vëll III, fq.98, Tiranë, 1989. Shiko dhe A.Xhuvani, Vepra II, fq.368, Tiranë, 1990; “Historia e muzikës shqiptare”, 1, fq.10, Tiranë, 1984; Vasil S.Tole, “Enciklopedia e muzikës popullore”, Tiranë, 2001 etj.

ahengut është mjaft e pranishme. Në atë repertor këngësh, në të cilat ajo është e pranishme vihet re edhe një frymë tepër sentimentale e këngëve që, në ndonjë rast, kalon edhe në shpërthime erotike të ekzaltuara². Këtë e ka theksuar qysh herët edhe prof. Çabej kur thotë se *tingulli themelor i idhët e monoton i melodive të popujvet ballkanikë është i ndryshëm prej karakterit eksatik-sensual të melodive orientale, ay tingull lidhet më shumë me karakterin e vendit dhe të banorëve të këtij Gadishulli*³.

Muziktarët që u përfshinë në këtë lëvizje emancipuese u përkitnin si muziktarëve popullorë, ashtu dhe atyre profesionistë, të cilët sapo kishin hedhur hapat e parë në këtë fushë. Kështu, ndër pionierët e parë përmendim muziktarët popullorë shkodranë të cilësuar si “reformatorë të ahengut”: Kasem Xhuri, Mark Kranjani, Kolë Gurashi (1880-1971); në Elbasan Usta Isuf Myzuri; në Berat Riza Nebati; në Gjakovë Ymer Riza etj. Si kulminacion i kësaj lëvizjeje mund të konsiderohet ngritja në Shkodër, diku aty nga mesi i shek. XIX, i shoqërisë për pastrimin e ahengut nga orientalizmat. Vëmendja e këtyre muziktarëve reformatorë (krahas tjerres së repertorit të ahengut në pikëpamje të zhveshjes së tij nga fjalët e huaja dhe kromatizmit i sforcuar), u përqendrua kryesisht mbi dhe në evidentimin e atij repertori të muzikës popullore qytetare i cili, tradicionalisht, nuk ka qenë përcjellë me vegla muzikore, por vetëm është kënduar *a capela*.

Ky orientim për nga kjo pjesë e kulturës muzikore qytetare shqiptare ishte një kthim në origjinën e vjetër të këngës qytetare shqiptare, në atë muzikë e cila ndërtohej mbi diatonikën e pastër dhe jo mbi kromatikën, që është mbizotërues në ahengun qytetar me vegla. Në këtë pjesë të repertorit muzikor qytetar, mund të vësh re fare mirë edhe lidhjet e tij gjenetike me pjesën tjetër të folklorit muzikor fshatar, i cili natyrshëm e ka ushqyer qytetin shqiptar në të gjitha kohët me lëndë muzikore vendase. Ndër këto lidhje përmendim këndimin në grup të këngëve, aspektin e përbashkët diatonik të tyre si dhe shtrirjen intervalore brenda oktavës. Kjo për arsyen e thjeshtë, pasi ky repertor i hershëm i qyteteve tona ngeli jashtë ndikimit të mirëfilltë të muzikës së importuar. Kjo gjë ishte vënë re edhe vetë nga muziktarët e ahengut, të cilët në dasmat që merrnin pjesë, vërenin me vëmendje se pjesa më e madhe e qytetarëve shkodranë këndonin mjaft këngë dhe valle të tjera popullore pa shoqërim

² Zadeja Tonin, Daija Tonin, “250 këngë qytetare shkodrane”, Shkodër, 2000, fq. 10. Studim i cit.

³ “Për gjenezën e literaturës shqipe”, tek “Studime gjuhësore”, vëll. V, Prishtinë, 1975, fq. 129. Studim i cit.

orkestral. Kjo pjesë e rëndësishme e muzikën qytetare shkodrane⁴ është një repertor diatonik i tërë, i cili përfshin kryesisht këngët e ceremonialit të dasmës shkodrane, këngët e fëmijëve, këngët mitunore-ninullat, vallet e kënduara si dhe këngët e shtregullave. Pikërisht ky repertor ka luajtur një rol parësor, shumë të rëndësishëm, si për referimin paraprak të konceptit të origjinalitetit, po aq të muzikimit gradual të tij dhe shoqërimit me vegla, për t'u bërë më pas pjesë e reformuar e ahengut shkodran në shekullin e ri.

Me të drejtë është pohuar se në fillimet e zgjimit tonë kombëtar, Rilindjes sonë Kombëtare, kemi një evoluim të ndërgjegjshëm, si të përmbajtjes, ashtu dhe të formës në këngët e ahengut shkodran⁵ Shtjefën Jakova (1862-1928) synoi përafrimin tingullor të këngës shkodrane me atë të Tiranës; Zef Buba (1830-1890) ... *shtini në ahengun shkodran të gjitha ato këngë nga Shqipëria e Mesme, që përcillen me jaranina*⁶; *Kasem Xhuri u dha me shpirt me përmirësue ahengun shkodran tue i sjellë meloditë bizantine në trajtën e valleve shkodrane*⁷; *Mark Kranjani (1840-1902), mund të njehet si reformator i ahengut shkodran pse kangëve u hoqi të fshamen në formën e dervishëve dhe u dha një lëkundje të ambël melodive*⁸ *Shan Hila, si kryetar i shoqnisë për pastrimin e ahengut nga kangët e dylberave*⁹ etj.

Rol të veçantë në përhapjen e këngeve të reja të ahengut, këngë të cilat përfaqësonin çlirimin nga ngjyrimi oriental luajti edhe regjistrimi në disqe gramafoni i këngeve të ahengut. Me sa dimë deri më tani, në vitin 1903, muziktarët e ahengut shkodran Shtjefën Jakova, Xhoxhi i Preçit, Gjon Shahiri, Filip Koleka, kanë qenë ata të cilët regjistruan të parët këngët e ahengut në pllakat e gramafonit. Ishte vetë populli i cili i mirëpriti këto ndryshime në strukturën e këngëve, të cilat synonin një këngë edhe më popullore dhe më origjinale. Në këtë vazhdë do të përmendim edhe kontributin e shumë muziktarëve, të cilëve u njihet autorësia e shumë këngëve popullore të ahengut shkodran të kësaj

⁴ Shiko dhe Zadeja Tonin, Daija Tonin, "250 këngë qytetare shkodrane", Shkodër, 2000, fq. 5.

⁵ Zadeja Tonin, Daija Tonin, "250 këngë qytetare shkodrane", Shkodër, 2000, fq. 12. Studim i cit.

⁶ Gurashi Kolë, "Të dhana mbi disa kangëtarë popullore", almanaku "Shkodër, 1964, fq. 163. Studim i cit.

⁷ Almanaku "Shkodra"-1962, fq. 3. Studim i cit.

⁸ Almanaku "Shkodra"-1963, fq. 199. Studim i cit.

⁹ Gurashi Kolë, Sheldia Gjush, "Ahengu shkodran", tek almanaku "Shkodra", 1/1961, fq. 210.

periudhe:

Shkodra:

Hasan Preza:“*Dashtnuer t’u bana*”,“*Të gëzojm se erdh pranvera*”,“*Dalin vajzat prej mejtepit*”, “*Shkoj e vij flutrim si zog*”,“*As aman moj zojë mirane*”;

Alush Beqari:“*Moj e vogël si florin*”;

Ndrekë Vogli: “*Vaj si kenka ba dyrnjaja*”,“*Kënga e detit*”,“*Jargavan me bojë për mall*”, “*Hala emnin s’ta kam xanë*”, “*Edhe nji herë due me kja hallin*”;

Shtjefën Jakova:“*Ç’mu dhimte, bre çun, se je i pa nanë*”, “*Ç’po shkëlqen lulja në mur*”;

Paulin Pali:“*Çile atë zemër plot kujtime*”, “*F’tyra jote si sheboja*”, “*Dielli sa të ketë prendue*”, “*Ti je krejt si nji ganxhe*”, “*Sa e kandshme vjollcë ti je*”, “*N’nji kopsht t’bukur unë e mblodha*”, “*Kur të pashë moj lule*”, “*Drandofilles së bukur*”,“*Ja na erdhi sot pranvera*”, “*Shumëlulet na i qet pranvera*”, “*Freski pranvere*”;

Karlo Pali:“*K’ndon bylbyli poshtë te zalli*”,“*K’ndo bylbyl me t’madhin za*”, “*Shumë pranvera po kalojnë*”,“*Të kam dashtë edhe të due*”, “*Në kohë t’mramjes në pranverë*”;

Bejto Halili:“*Kenke nur i bukurisë*”;

Rud Gurashi:“*S’ka ma t’bukur se pranvera*”;

Zef Shestani:“*Besa-besë moj t’kam pasë thanë*”,“*Karajfil në kodër*”;

Hysen Dobraçi:“*Krisi topi*”;

Ramadan Sokoli: “*Në gjergjef vasha tue qëndisë*”,“*Turtulleshë*”, “*Zanushes*”;

Marku i Kranjanes: “*Sillet moti për së mbari*”;

Gjon Kraja: *Jare, iptida due me fillue*”;

Kolë Vjerdha: *Kur më shkon si zog n’hava*”;

Shefqet Kruja:“*Sa e bukur je natyrë*”, “*Nëpër fusha ndër kodrina*”, “*Dasho Shkreli*”;

Prengë Jakova:“*Margjelo*”,“*Synin si qershija*” etj.

Ky proces vazhdoi edhe pas viteve 50 të shek. XX me krijimet e kompozitorëve Çesk Zadeja, Pjetër Gaci, Simon Gjoni, Tish Daija, Zef Zorba etj.



Foto: “Orkestra popullore shkodrane në Radio-Tirana, viti 1942”

Si një etapë të natyrshme në këtë lëvizje e cila synonte ridimensionimin e ahengut qytetar, do të përmendim edhe të gjitha ato përpjekje të cilat synonin fiksimin në nota të tij. Në vitin 1940 Pjetër Dungu boton të “Lyra shqiptare” disa këngë të ahengut; Tonin Harapi ndërmori në vitet 1950 një nismë për transkriptimin në nota të ahengut, nismë e cila me sa dimë u realizua pjesërisht; në vitin 1955, pranë IKP nga muziktarët Eftim Dheri dhe Abdulla Grimci u synua regjistrimi i gjithë këngëve të ahengut, nismë e cila nuk arriti të finalizohet; prof. Ramadan Sokoli, në studimin e tij “Folklori muzikor-morfologjia” boton edhe shumë shembuj të transkriptuar të ahengut; në vitin 2000, kemi një botim me “250 këngë qytetare shkodrane”, të transkriptuara nga Tonin Zadeja dhe Tonin Daija. Në këtë vazhde do të renditim edhe përpjekjet e atyre autorëve që kanë shkruar¹⁰ lidhur me ahengun qytetar,

¹⁰ “T’faluna nderës”, tek “Taraboshi”, tetor 1913; “Kanuni i shoqërisë muzikore ROZAFAT”, Shkodër 1919; Ndojaj Injac Gj, “Ahengu shqiptar”, gaz. “Illyria”, 1935, 24 dhjetor; “Dasma shkodrane”, gaz. “Bashkimi”, 1949, 24 Shkurt; Hoxha, Sh. “Në festivalin folklorik të qarkut të Shkodrës”, gaz. “Zëri i Popullit”, 1955, 24 korrik; Beni, L. “Mbi festivalin e këngëve dhe valleve të zonave të rrethit të Shkodrës”, gaz. “Bashkimi”, 1956, 20 Qershor; Gurashi Kolë, Sheldia Gjush, “Ahengu shkodran”, almanaku “Shkodra”, nr. 1/1961; Sokoli Ramadan, “Folklori muzikor shqiptar-morfologjia”, Tiranë 1965; Mitko Thimi, “Vepra”, Tiranë, 1981; “Fjalor i

siç është Kolë Gurashi me dorëshkrimin e tij “Ahengu qytetar” apo dhe botimet e tij të ndryshme në shtypin periodik.

Berati:

Edhe në muzikën popullore të qytetit të Beratit të fillimit të shek. XX, gjejmë një rast shumë sinjifikativ të kalimit nga muzika e formacioneve muzikore të importuara, drejt atyre origjinale vendase. Në fillim të shek. XX, ashtu si në të gjitha qytetet kryesore të Toskërisë, filloi në Berat edhe formimi si një reaksion nga brenda i muzikës popullore, i formacionit origjinal të sazeve apo, siç njihet ndryshe, formacioni polifonik i sazeve.

Sazet e para në Berat i gjejmë qysh në fillim të shek. XX. Lindja e sazeve ishte si një rikthim në traditën iso-polifonike të të kënduarit të qytetit të Beratit përpara pushtimit turk. Një formacion i dëgjuar sazes ka ekzistuar në Berat në vitin 1915, i drejtuar nga violinisti i shquar Riza Nebati (të cilin populli në një këngë e ka vlerësuar si Paganinin e qytetit), një tjetër nga Isuf Meko Përmetari e më vonë vëllezërit Qamili, të ardhur po nga Përmeti. Po ashtu përmendim edhe sazet e Usta Halit Beratit me gërnëtë (rreth 1910-1920), ato të drejtuara nga Riza Jevi me qemane, e veçanërisht ndihmesën e sazeve të Sybi Sadushit me gërnëtë. Është fakt i pamohueshëm që një pjesë e rëndësishme e muziktarëve të shquar popullorë beratas u shpërngulën në qytetet e tjera të Shqipërisë për të interpretuar muzikën popullore. Kjo gjë solli një transferim dhe komunikim të vlerave të krijuara nga njeri qytet në tjetrin.

Me shembjen e Perandorisë Osmane, në Berat gradualisht u rrudh roli i tajfave të muziktarëve, ndërkohë që u popullarizua repertori i këngëve origjinale të sazeve popullore beratase. Duhet theksuar se sot, në muzikën popullore qytetare të Beratit do të konstatojmë si gjuhën muzikore-monodike, por dhe atë iso-polifonike, tipar i kahershëm i Beratit të vjetër, rrethinave të tij edhe i muzikës së qyteteve jugore në përgjithësi. Për shkak të pozicionit gjeografik, por dhe të lidhjeve gjuhës së sotme shqipe”, Tiranë, 1980; Prendushi Robert, “Palok Kurti dhe kënga qytetare”, “Jeta e Re”, 1988, 30 janar; Prendushi Robert, “Kënga shkodrane: tradita, zhvillimi i mëtejshëm”, gaz. “Drita”, 1988, 21 shkurt; Sokoli Ramadan, Miso Piro, “Veglat muzikore të popullit shqiptar”, Tiranë, 1991; Alibali Isa, “Në Shkodër të gjithë këndojnë”, Shkodër, 1997; Osmani Shefik, “Panteoni iranian dhe iranologët shqiptarë”, Tiranë, 1998; Lafe Emil, “Persizmat në kuadrin e orientalizmave të “Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe”, tek “Perla”, 1/1999; Zaja Sami C, “Hetë, njeri i urtë i shkodrës”, Shkodër, 2000; Daija Tonin, Zadeja Tonin, “250 këngë qytetare shkodrane”, Shkodër, 2000; Murtishi Kaim, “Ladorishti, histori dhe tradita”, Strugë, 2001 etj.

historike, tek gazet e reja të Beratit, u shkri natyrshëm repertori monodik i këngëve (që deri para lindjes së sazeve luhej nga tajfat e muziktarëve) me atë iso-polifonik të Beratit të vjetër. Kështu, përveç repertorit tradicional të qytetit, gazet zotëronin edhe numrat më të njohur të muzikës qytetare shqiptare, si të qytetit të Vlorës, Përmetit, Elbasanit, Shkodrës, Tiranës etj. Sazet e Beratit përbëheshin nga 1 gërnetë, 1 violinë, një ose dy llauta dhe 1 def.

Në rinovimin e repertorit muzikor popullor qytetar, një rol të rëndësishëm luajtën edhe krijimet e reja të muziktarëve popullorë të kësaj periudhe. Me emrin e muziktarit popullor Shyqyri Fuga (Berat 1883- Berat † 1962), njihen këngët “*Mora mandolinën*”, “*Në fushë të Uznovës*” etj.; me emrin e Sulejman Naibit në popull njihen këngët: “*Jelekun kadife veshur*”, “*Kështu e kështu më thanë*”, “*Aman, o im atë*”; me emrin e Qerim Fugës njihen këngët: “*Mblodhëm një tufë lule*”, “*Shaja me shami të kuqe*”, “*Ma gëzofsh shaminë jeshile*”, “*Ditën e xhuma po bëhesh xhuluzi*” etj.

Elbasani:

Krijimi i orkestrinës popullore qytetare në vitin 1905, nga usta Isuf Myzyrit u konsiderua si një reaksion popullor drejtuar kundër artit të mejhaneve dhe çingive. Me këtë grup, Isuf Myzyri këndonte në sheshet e qytetit të Elbasanit, në shëtitje popullore, ndër gëzimet familjare të njerëzve të thjeshtë¹¹. Në këtë mënyrë, ky hap i parë, por dhe krijimtaria e mëpastajme e usta Isufit, heq një paralele të qartë me shoqërinë shkodrane kundër orientalizmave të ahengut si dhe me formimin e sazeve të para në qytetin e Beratit. Kështu bëhet e qartë se ishte krijuar realisht një “front” i përbashkët kulturor për pastërtinë e muzikës popullore qytetare. Është një fakt i pranuar nga të gjithë se përpara se usta Isuf Myzyri të hynte në jetën muzikore popullore të qytetit të tij, sipas prof. Shuteriqit: në Elbasan dëgjoheshin sidomos ato që i quajnë “këngë të vjetra”, këngë qyteti, plot melizma, ku, përveç Elbasanit, i përdorin edhe pak fshatra veriore pranë, ku melizmat ua shtojnë, si në krahinën e Zaranikës¹². Siç dihet, si kënga më e vjetër popullore e qytetit të Elbasanit mbahet “Çohuni djema shaloni atin”, e cila datohet diku aty nga fillimi i shek. XVII. Në fund të shek XVII, fillimi i shek. XVIII, në këngën popullore të qytetit të Elbasanit ritet mjaft roli i bejtexhinjve, e

¹¹ Balliçi Alfons, Dedei Sulë, “Isuf Myzyri”, Onufri, 1996, fq. 14. Studim i cit.

¹² Shuteriqi Dhimitër, “Nga kënga e popullit”, Tiranë, 1991. Studim i cit.

konkretisht i Nezim Frakullës. Është Nezim Frakulla i cili ka shkruar poezinë e dy këngëve mjaft të njohura të Elbasanit, “*Mun ke çesmja në Bobolle*” dhe “*Çillni ju moj lule çilni*”.

Pikërisht në këtë klimë, usta Isufi konturoi krijimtarinë e tij të ardhshme. Për gati 50 vjet, në këngët dhe meloditë e tij të kësaj periudhe vëmë re ndërtimin e një repertori me këngë të reja popullore elbasanase ku spikatin mbështetja në traditën e çmuar të këngëve të vjetra elbasanase paraosmane, çlirimi nga kromatika e drejtpërdrejtë, bukuria e frazës muzikore diatonike, shprehje kjo e orientimit për nga vlerat e vërteta të kulturës muzikore të Elbasanit të hershëm etj. Krijimtaria e tij përfshin 89 krijime muzikore. Ndër to përmendim këngët: *Në zabel të gjeta*”, “*Iku nata, agun malet*”, *Dashunija si rrufe*”, “*Një lulishte me trandafila*”, “*Midis vetllash më ke një pikë*”, “*Ma mirë në pyll se në qytet*”, *Si bilbili në pranverë*”, “*Ç’u dëshirush për me të pa*”, “*Spaske pasë pikë mëshire*”) etj. Për vlerat e tyre, këto këngë janë përcjellë gojë më gojë në gjithë Shqipërinë, në Kosovë si dhe tek shqiptarët e Maqedonisë.

Eno KOÇO

GJON KOLË KUJXHIIJA DHE RËNDËSIA E VEPRËS “VALLE KOMBËTARE” NË MUZIKOLOGJINË SHQIPTARE¹

Sipas Ernest Koliqit e Tonin Harapit, Gjon Kolë Kujxhija u lind në Shkodër më 11 maj 1920. Një datë tjetër të lindjes se tij e jep Tonin Zadeja, i cili shënon atë të 19 shtatorit 1919.

Familja e Kolë Kujxhisë përbëhej nga pesë djem dhe dy vajza. Prirja muzikore Gjonit iu shfaq që në moshë të njomë. Sipas Tonin Zadesë, shtëpia e Kolës, të atit të Gjonit, ishte `skena e parë ku vëllezërit, motrat dhe bashkëmoshatarët e familjeve fqinje me ta, këndonin dhe recitonin` (T. Zadeja, `Në 60 vjetorin, 1993). Ndërsa Injac Kujxhija, vëllai i Gjonit, kujton përmes fjalës së tij me rastin e 55 vjetorit të vdekjes së Gjonit: “Ishte orkestrina familjare e formueme nga vllaznit: Ndoc, Gjon e Lin së bashku me kushrinin tonë, muzikantin popullor, Rud Gurashi, që formojshin orkestrinën mandolinatë. Ndër raste datëlindjesh e emnash, u mblidhin të gjithë në shtëpinë tonë, e aty me kangë të bukura familjare, e me pjesë nga melodramat e kompozitorit të talentuem Dom Mikel Koliqi e klasike, shpërthente entuzjazmi i të gjithvet. Mandej ky grup do të kthente në kor serenate, tue përcjellë nëpër shtëpija miqt e ftuem. Dhe kangët nga Schubert-i, si Serenata etj., e `Va pensiero` të Verdit, ushtojshin armonishëm nëpër rrugët e zbrazta të qytetit. Kje Gjoni që me anë të disqeve na njofti me muzikantat e mëdhaj botnor si: Bach, Handel, Mozart, Beethoven, Schubert, Verdi etj”.

Grupit familjar të Kujxhijave iu shtuan më vonë edhe djem dhe vajza të lagjes Gjuhadol, lagje kjo e mirënjohur e Shkodrës. Në këto argëtime ku fëmijët e të rriturit luanin në instrumente e këndonin në kore nën

¹ Titulli i vendosun nga redaksia.

meloditë e valleve të kënduara të martesese të shregullave, Gjoni mjaft natyrshëm vihej në rolin e organizuesit së 'shfaqjeve', të cilat shpërbleheshin me duartrokitjet e prindërve të fëmijëve pjesëmarrës. Gjoni këndonte shumë bukur si solist e ndër kore, si bas, luante në teatër dhe merrte pjesë në orkestrina me kitarë (Harapi, 'Jeta e Re', 1991).

Arsimimi

Pas shkollës fillore, Gjoni Kujxhija vazhdon mësimet pranë liceut "Illyricum" të Etenvet Franceskane. Që në klasat e para të këtij liceu ai tërheq vëmendjen e kompozitorit, organizatorit dhe drejtuesit të shquar të veprimtarive muzikore në qytetin e Shkodrës, Atë Martin Gjoka' (Tonin Zadeja, 'Ne 60 vjetorin, 1993). Pra, krahas mësimëve të përgjithshme në gjimnaz, Gjoni i kushtonte një kohë të mirë thellimit të njohurive të tij me mësimet bazë të muzikes, gjë që e bënte qoftë në menyrë autodidakte apo dhe si korist dhe instrumentist dhe, me pas, edhe si aktor ne Shoqërinë Antonjane' (Tonin Zadeja, 'Ne 60 vjetorin ...', 1993). 'Pas mbarimit të shkollës së mesme (1939) shkoi për studime në konservatorin 'Luixhi Kerubini' në Firence' (Harapi, 'Jeta e re', 1991).

Në trashëgiminë dhe vazhdimësinë e panderprerë të një kulture, si ajo e Shkodrës, nuk mund të flitet për koincidenca; i tillë është fakti që 'aty nën drejtimin dashamirës të muzicistit të shquem Atë Martin Gjoka, [Gjoni] përparoi shpejt e mirë si në përdorim të veglavet muzikore ashtu në teorinë të muzikologjis' - shkruante Ernest Koliqi në "Shejzat" më 1963. Atë Martin Gjoka, mund të thuhet me plot zë, është krijuesi i një gjuhe muzikore specifike shqiptare e cila rrezatoi tek mjaft kompozitorë shkodranë, që të gjithë e dimë që kanë qenë në pararoje të artit muzikor shqiptar. Ky ishte dhe fati i Gjunit. Sa më shumë kohë kalon, aq më tepër ndjehem i privilegjuar që kam mundur të shijoj i pari nëpërmjet drejtimit të orkestrës, ngrohtësinë, përzemërsinë e thjeshtësinë e simfonisë së Gjokës, 'Dy lule mbi vorr të Skanderbegut'. Ky ishte pra burimi, apo më mirë At Martini me orkestrën frymore të tij do të bëheshin frymëzimi nga ku Gjoni do të merrte eksperiencën e parë si muzikant dhe më pas rrugën drejt Firencës për të studiuar në konservatorin 'Cherubini' të atij qyteti të artit. Nuk mund të lihet pa përmendur që në Shkodër ishte dhe poeti dhe folkloristi i shquar, Atë Bernardin Palaj, i cili bashkautor me Atë Donat Kurtin, bëhen përpiluesit e veprës së mirënjohur "Visaret e Kombit", vëllimi II (Kangë kreshnikësh dhe Legjenda) dhe që Koliqi e

përshkruan Palajn si “frati gjenjal i depertuem në sekretet ma të thella të muzikës e të poezis” (Koliqi, ‘Shejzat’, 1963). Koliqi shton po aty se Atë Palaj “sigurisht e udhëzoi [Gjonin] kah vleftësimi i motiveve popullore dhe si zgjanoi horizontet artistike me at entuziazëm të ndritun qi edhe atë vetë e pushtonte si para zanit të dalun nga msheftësit e zemrës së popullit ashtu para kryeveprave te muzicistave të mëdhej botnore” (Koliqi, Shejzat’, 1963).

Studimet e Gjonit u prenë në mes nga një bombardim ajror që përfshiu edhe shtëpinë ku ai banonte e shkruante veprat e tij muzikore. Ishte kjo ngjarje që shënoi ditën fatale të 25 shtatorit 1943. Nëntë muaj më pas, Kole Ashta do të kujtonte: ‘Në një ças iu mbush mendja me shkue kah shtëpija për të krye një punim muzikuer. Shokët iu lutnë që të rrinte me ta. Nuk ndëgjoi. Por sa kishte çelë pentagramat ulurijti kushtrimi ajruer. Edhe këtu iu lutne njerzit e shtëpis. Nuk ndëgjoi të zbresi në strehim me ta’ (Ashta, Bashkimi i Kombit’, 1944). Ndërsa Koliqi 20 vjet më vonë do të kumtonte se ‘muzicisti shkodran Gjon K. Kujxhija qi në lule te rinis dhe në vlug të fuqive krijuese vdiq tue pasë moshën njize e trivjecare në bombardimin qi pësoi Firenze më 25 shtatuer 1943’ (Koliqi, Shejzat’, 1963).

U nderprenë vitet studenteske të Gjonit, u ndërpre muza e tij djaloshare, për t’u zevendësuar me veprën e tij të pashembullt, të papërsëritshme, unikale në historinë e muzikologjisë shqiptare.

Hulumtimi dhe vepra

Në 1943 Gjon Kujxhija botoi ne Firenze librin Valle Kombëtare (Dasëm Shkodrane), vepër kjo krejt e përveçme edhe për ditët e sotme të valleve të kënduara të dasmës shkodrane.² Mustafa Krantja në artikullin e tij ‘Valle Shkodrane’ të 26 korrikut 1944 e paraqet kështu librin e Kujxhisë: ‘Libri ndahet në tri pjesë: në fillim një parathanje shumë e mirë në të cilën auktori shoshitë probleme me randësi të madhe të muzikës s’onë. Pjesa e dytë përmban një spjegim të hollësishtëm të zakoneve të fejesës e martesës në gjindjen katolike të Shkodrës. Vallet qi titullojne librin janë rrjeshtue në pjesën e tretë të tij’ (Krantja, ‘Bashkimi i Kombit’, 1944). Pra, ashtu siç e ve në dukje edhe Krantja, Parathënia përmban shtjellimin teorik të lëndës, i cili përshkohet nga erudicioni i gjerë e guximi i shtrimit të tezave me synimin për të paraqitur një vepër thellësishtë kombëtare, si për të përforcuar gjenezën e shqiptarit të

² *Gjo Kolë Kujxhia, Valle Kombëtare, vepër e cituar, 1943.*

hershem, apo siç pohon Kolë Ashta se Gjoni`gjatë bisedës u mundonte me e lidhë mendimin me emnin (Ashta, ‘Bashkimi i Kombit’, 1944).

‘Dokët, Fejesa-Martesa’ është pjesa e dytë teorike e librit, ajo që pason Parathanje-n, ku jepen 115 shpjegime mbi këto rituale të hershme vendore. Pas këtyre dy pjesëve të shkruara teorike, vjen notëzimi i 52 valleve të kënduara bashkë me tekstin e tyre poetik që është i vendosur nën nota, ashtu siç është e rregullt të behet, por teksti jepet edhe në formën e një vjershe të shkruar më poshtë ku shihet qartë rima, rrokëzimi dhe natyra e vargut.

Në fund të faqes vihet dhe shënimi se ku dhe kur këndohet vallja. Ja disa shembuj: ‘Me ket valle fillon rituali i martesës. Këndohet kah djali t’ejten paradite’; ‘Kurdoherë për fejesë dhe martesë. Edhe në shregull’; ‘Me ket melodi edhe vjerrsha tjetër’; ‘Kah djali kurdoherë para marteset’. Të këtilla shënime jepen në fund të çdo valleje të kënduar.

Që prej viteve të Shkodrës për të vijuar me ato të Firences, Kujxhija ishte në procesin e krijimit e një vetedije personale, e cila bazohej e konsolidohej nga burime të ndryshme, të shkruara dhe gojore, duke i dhënë atij gjithnjë e më tepër siguri për t’i hedhur në letër në ato që ai besonte. Parësoria e kësaj vetedije ishte e të qenit autokton në ketë dhe, prejardhës i iliro-trakasve, ‘pjestarë të families së madhe indo-europjane [që] i përkasim prendimit, por tue mos lanë m’anësh pozitën geografike t’onën, dhe sidomos historinë’ (Kujxhija, Parathanje, VIII). Në një artikull tek ‘Bashkimi i Kombit’ më 12 shtator 1944, artikullshkruesi me pseudonimin ‘O’ do të nënvizonte se Kujxhija ‘asht i mendimit se, sikur gjuha, gjaku, doket janë rrejtje të pastërta ndër ato male qysh prej të parve ilir-trakes, edhe muzika asht mbajt e paprekun’. Një shpjegim më të detajshëm mbi këtë muzikë të ‘paprekun’ e jep edhe Robert Prennushi në shkrimin e tij ‘Një thesar i rrejtune i trashiguem i pastër për pesë shekuj, “Valle Kombëtare”, nga Gjon Kolë Kujxhija’. Pozitën gjeografike të Shqipërisë si ‘nji urë kalimi qi ka bashkue prendimin me lindjen’, Kujxhija e sheh të reflektuar edhe në muzikën kombëtare dhe, siç njihen më gjerësisht, në vallet e kënduara të dasmës shkodrane, ku mashkulloren me femroren, maxhoren me minoren, të gezueshmen me mistiken, i gjen si ‘shprehje kjo e vertetë e shpirtit të rracës s’one’ (Kujxhija, Parathanje, VIII). Ai nënvizon një fakt që shumë kush në praktikën e këtyre valleve të kënduara mund të ndjeje aromën e freskët e të këndshme të tyre, kënaqësinë që përftohet nga thjeshtësia e bukuria e tyre, por që jo shumë kujt i shkon në mendje të dallojë ‘se gadi të

gjitha këto melodi fillojnë në “magjore”, por të gjitha pa përjashtim do të mbarojnë në “minore”. Kjo asht një tjetër karakteristikë e këtyre valleve’ - do të shpjegohej Kujxhija në faqen VIII të Parathanje-s së tij. Këto lloj vrojtimesh muzikologjike të një djali në fillim të të njezetave të tij, bënin fjalë për një hulumtues të vemendshëm, njohës të repertorit të valleve të kënduara të dasmes së qytetit dhe bashkësisë së tij, për një të apasionuar thellësisht ndaj ‘jonsive/melodive’ me të cilat Gjoni ishte ushqyer.

Kujxhija që në faqen e parë të Parathanje-s së tij do të shpaloste njohuritë që ai kishte për muzikën në Shkodër, etapat që ajo kishte kaluar ndër shekuj. Ishin njohuri këto të marra nga shkodranë erudite, njëri nga të cilet ishte ‘folkloristi i njoftun dhe muzikanti i vlerët P. Bernardin Palaj’ - siç e konsideronte këtë personalitet shkodran Gjon Kujxhija. Edhe Ernest Koliqi ia njihte këtë ‘dobësi’ të Kujxhisë për Palajn kur në përvjetorin e njezetë të vdekjes do ta përkujtonte atë mes të tjerash me këto: “Flitë me bindim t’evارشem për At Bernardin Palaj, frati gjenjal i depertuem në sekretet ma të thella të muzikës e të poezis. Benardini sigurisht e udhëzoi kah vleftësimi i motiveve popullore dhe ia zgjanoi horizontet artistike me at entuziazëm të ndritun qi edhe atë vete e pushtonte si para zanit të dalun nga msheftësit e zemrës sëe popullit ashtu para kryeveprave të muzicistave të medhej botnore (Koliqi, Shejzat, 1963). I mbrujtur me këto njohuri, ja se si Kujxhija i kishte mishëruar etapat e muzikës në Shkoder: Në Shkodër, kemi dy soje muzike, ase ma mirë me thanë, dy perjudha të ndryeshme të krijimit dhe të zhvillimit të sajë.

I. Fillon prej kohve të lashta dhe arrinë deri të pushtimi i Shqipnisë prej Turkisë.

II. Përfshinë perjudhen e pushtimit deri në kohë të sotçme.

Së parës i përkasin ‘vallet; së dytës ‘kangët e hengut’...

Botimi i librit Valle Kombëtare ishte një ngjaje e shënuar për muzikologjinë shqiptare, ishte një afirmim i muzikës tradicionale qytetare shkodrane, e cila edhe pse njihej nga praktikantet e saj, nga bashkëqytetaret e saj, por vetëm në formë gojore, tani do të kishte një referencë të qartë që ashtu si lemet e tjera të folklorit e visareve të kombit, do të fiksohej në letër e kënduar në shqip, e shkruar shqip dhe e studjuar më së miri në shqip. Fatkeqësia e këtij libri unikal qëndron në atë që jo vetëm që u botua në pak kopje, pasi autori donte të vilte mendimin e gjërë intelektual e më pas ta ribotonte me ndonjë ndryshim

të nevojshëm, por ajo më e madhja që se vetëm një vit pas botimit të librit në Firence, në Shqipëri do të vendosej pushteti totalitar dhe Kujxhijat u konsideruan të padëshiruar për sistemin e ri, kështu edhe libri i Gjonit do t'i nënshtrohesh persekutimit për të mos u bërë kurrë objekt studimi, për të mbetur i panjohur.

Vallet e kënduara shkodrane

Kujxhija i transkriptoi me përgjegjshmëri të lartë meloditë e 52 valleve të kënduara nga vetë goja e 'atyne trembëdhjetë zojave kah ka ndigjue vallet, e prei atyne nandë zotnijve sigurisht do t'i ketë ndigjue ma se 1 herë' - shkuante Injac Zamputti nga Shkodra në tetor të vitit 1943. Pra, burimi i parë i këtyre valleve të kënduara të ritualit të martesës kanë qenë vetë praktikantët lokalë edhe pse duke qene trashëgimi gojore dhe jo e notëzuar nuk mund të thuhet se varianti i transkriptuar i Kujxhisë te ishte i vetmi që praktikohet asokohe në Shkodër. Injac Zamputti në tetor të vitit 1943, pra pa u bërë muaji nga humbja e Kujxhisë, do të konstatonte nga Shkodra me kompetencën gati të një muzikologu se 'kush i njeh vallet tona, natyrisht, aty-këtu ka për të gjetë në ketë libër ndoi ndryshim prej si i këndon aj vetë o gjindja e shtëpis së tij e si dalin ndër këto nota. Por aj ndryshim, shumë i paktë, rrjedh prejse personat që i këndojnë vallet nuk i këndojnë të gjithë njëri. A s'ju ka rano herë rasa me ndie valle ndër darsma e me vretë se dikush i këndon me ndryshim prej tjerësh, ndryshim që asht ma fort një varjacjon se sa një gabim? Janë sende që kurrsesi nuk mund t' unjisohen. Këndej mundet që ndokush, tue i marrë vallet me "notat" e librit, ka me u topitë kur të gjejë ndo ndryshim' (Zamputti, 'Leka', 1943). Si muzikë tradicionale lokale ky ritual i dasmës, fejesës a shregullave ishte produkt i një tradite të hershme muzikore e zhvilluar përmes procesit të transmetimit gojor dhe që me kalimin e kohës vazhdoi të përthithet nga tradita e gjallë dhe e pashkruar e komunitetit. Libri Valle Kombëtare është botim i cilësisë së lartë në përmbajtjen e të cilit gjenden meloditë e notëzuara me tekstet përkatëse bashkë me studimin dymbëdhjetë faqesh, Diftojsi-n prej dy faqesh, si dhe dy faqe të tjera me tekste këngësh. Faqet janë të formateve të traktateve të kohës (23x16 cm) dhe studimi muzikologjik peshon mirë në hapsirën tërë frymemarrje të këtyre faqeve. Madhësia e shkronjës dhe hapsira mes rreshtave i japin një dimension edhe më të këndshëm leximit dhe asimilimit të përmbajtjes së argumentimit teorik.

Që në nismën e Parathanje-s, Kujxhija shpjegon nocionin 'valle',

pra përse i quan këto valle dhe jo kangë të dasmes shkodrane, duke bërë dallimin midis togfjalëshit ‘te heqim valle’ dhe ‘me ia thanë valles’. ‘Të heqim valle’ - shënon Kujxhija - ‘ka kuptimin me dancue’, veprim që është i zhvilluar në jug të Shqipërisë, ‘Dardhë, Permet, e sidomos Labëri, ku, sikurse më ka ditue folkloristi i njoftun dhe muzikanti i vlerët P. Bernardin Palaj, kemi ende të rrujtun vallen ma të vjetrën, ma karakteristikën dhe origjinalen të quejtun “Vallja Pirrike”. Emni difton gjithçka: origjinën dhe vjetërsinë. Duket se kjo valle u hiqte n’oborret e mbretit epiriot për me kremtue mun fitoret e bame dhe me perkujtue herojt e ramë. Kjo valle kaq e randsishme, të cillën e kan marrë prej nesh Grekt, lypë një studim të veçantë (Kujxhija, Valle Kombetare, VI). Mustafa Krantja përveçse vlerësimit që i bën veprës së Kujxhise, duke qenë vetë muzikant e që studionte edhe ai aso kohe në Itali, synonte që mbrojtjen e veprës së Kujxhisë ta bante përmes rrahjeve të mendimeve duke gjykuar se Kujxhija ‘pohon se edhe sot në dialektin Lab flitet për këtë valle e së Greket e paskan marrë prej nesh atë lloj danci. Si kjo spjeron edhe rytmin PIRRIK grek që i pergjigjet rytmit dykohësh 2/8’ (Krantja, Tashkimi i Kombit’, 1944). Gjithnjë në vazhden e bashkëbisedimit me veprën e Kujxhisë, Krantja shton se ‘shum interesant asht përshkrimi i mënyrës së heqjes valle në Shkodër. Vallen shkodrane [Kujxhija] e paraqet në ketë rasë si lëvizje e kundralëvizje, dhe si frut i studimit të tij pohon se lëvizja qi ban kori nga e djathta donte me imitue lëvizjen e qielles, ajo kah e rrmakta ate të Hyjit’ (Krantja, ‘Bashkimi i Kombit’, 1944). Vlen të nënvizohet se në artikullin e tij Krantja nxjerr në pah atë që është më karakteristike e këtyre valleve të kunduara, dialogun midis burrave dhe grave të cilët qendrojnë përballë njëri-tjetrit dhe që lëvizin në drejtim përpara sa herë ia marrin këngës apo ia heqin valles, dhe bëjnë levizje mbrapa sa herë që i pergjigjet pala tjetër me lëvizje përpara. Natyrisht jo të gjitha vallet e kunduara i përmbahen këtij rituali të lëvizjes së ‘qielles’ dhe ‘Hyjit’. Kujxhija e ndjen të nevojshme të beje sqarimin e duhur të nocionit ‘valle’ duke evidentuar tog fjalëshin ‘me ia a thanë valles’: Posë valleve me danze, kemi dhe asosh qi nuk dancohen, e këto i gjejmë sidomos në Shqipni të veriut. Ktu kemi shprehjen “me ia thane”, e ka kuptimin me këndue; në ket rasë, kemi të bashkueme vetëm muzikë e poezi.

Megjithkëta, kemi edhe shumë valle qi dancohen, e ky libër përmban një sasi të madhe prej tyre (Kujxhija, Parathanje, VI). MC tej, ai bën lokalizimin e fenomenit në Shkodër, kush pjejon se kemi dy modele

dancash', në rreth me dy rrjeshta dhe nga ato që këndohen në këmbë pa lëvizur. Fakti që Kujxhija e lidh vallen e kënduar shkodrane me vallen e jugut shqiptar (Dardhe, Permet e Laberi) të bën të mendosh se vendosja e titullit të librit Valle Kombëtare dhe jo Valle Shkodrane apo Dasmën Shkodrane, lidhet me vizionin e tij prej "iliri" të ndezun' për të bërë një pergjithësim mbarëkombëtar të nocionit të 'valles', madje duke e shtrirë edhe më poshtë, në Epir, atje ku lëvrohej vallja e hershme pirrike.

Në vazhdim të diskutimit mbi përkufizimin e fjalës 'valle', mënyrës se si ajo këndohet dhe rolit që ka luajtur në traditën muzikore vendase, Kujxhija shpjegon:

Asht shun' e vshtirë me dhanë një përcaktim të njimendet dhe të përpikët, çka don me thanë fjala 'valle'. Ne qe se verbi 'me vallezue' rrjedhë nga emni 'valle', atëhere kemi të bashkueme: muzikën, poezinë dhe dancen; por ky verb përdoret fort

Lidhur me vallen pirrike apo ritmin pirrik të përmendur më sipër, do të qëndroj pak më poshtë. Ndërkaq, na duhet të vemë në dukje se vallet që këndohen në qytetin e Shkodrës me rastin e martesave e shtregullave, por dhe disa nga ato të katundit, janë struktura të thjeshta melodish, me fjali muzikore katër apo tetë masash, për të formuar kështu një periudhë homogjene e të plotë muzikore. Frazimet vokale (fjalitë muzikore) përputhen me vargjet e strofave edhe pse këto në një pjesë të mirë rastesh janë të çregullta. Meloditë e këtyre valleve kanë shtrirje të vogël vokale, siellen rreth pak notave të para të shkallës, pa e kaluar kurre të pestën [dominanten]; këta, provon se janë shumë arhaike, pse të gjitha muziket e popujve të vjeter, siellen rreth pak notave. Por edhe pse të shkurta e të thjeshta, janë shumë të bukura dhe shprehëse' (Kujxhija, Parathanje, VI).

Si për të përfocuar idenë e lashtësisë së këtyre valleve të kënduara, Kujxhija do të argumentonte se 'homogjeniteti i tyre asht i bindshëm, dulcet sikurse t'i kishte krijuar një personë e vetme, dhe se njena e tjetra janë të njajta. Kto gjana provojnë se i përkasin një epokës, dhe se janë shumë të vjetra pse sa ma primitive të jetë një muzike, aq ma pak [ka] ndryshime elementesh melodike' (Kujxhija, Parathanje, VII). Tonin Harapi, si hulumtues i vlerës që ishte, mbështet plotësisht Kujxinë lidhur me ambientin e traditës e hershme ku këndoheshin këto valle dhe shton se me kalimin e kohës ato kanë humbur radhën apo çastin e veçantë kur këndoheshin dhe janë mpleksur, në dasëm dhe me kengët e ahengut dhe disa valle kanë kaluar edhe në dasmat e katundeve të

afërta' (Harapi, Jeta e Re, 1991).

Vallja pirrike

Janë disa nga çështjet që në punimin e tij që Kujxhija i referohet muzikës së lashtë greke për të gjetur analogji mes saj dhe valleve të kënduara të dasmës shkodrane. Ndër këto po e nisim me termin 'valle' (që përdor Kujxhija, me konkretisht vallen pirrike, por edhe ritmin pirrik.³ Sipas disa autorëve mendohet se vallja shqiptaro-epirote, që konsiderohet të jetë një mbetje e hershme e valles pirrike, të ketë gene e lidhur me kamçën e ditëve të sotme. Ka disa teori lidhur me këtë valle; sipas njerës, ajo e ka origjinën nga Kreta dhe sipas një tjetre vallja pirrike ishte e ndryshme nga vallja luftarake (Straboni: lib. x. p. 701, ed. Ox). Por ka dhe një supozim të tretë sipas të cilit 'vallja pirrike ishte pjesë e detyrës e ushtarit legjionar romak' (Broughton 1855, 145). Ndërsa Hughes e ka shtruar kështu këtë çështje:λ

Shumë autorë e konsiderojnë pirrike-n si valle luftarake ndërsa të tjere e lidhin origjinën e saj me Pirron, djalin e Akilit, i cili, siç thuhet me së shumti, të ketë shkëlqyer në këtë valle. Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat, do mendoja se nuk është e pamundur të ketë pasur dy lloj vallesh pirrike, njëra me lëvizje të turpshme epshore, tjetra burrërore dhe me ushtrime luftarake: kjo e fundit ushtrohej kryesisht në Spartë ku fëmijët e mesonin atë që në moshën pesë vjeç; dhe kjo pirrik-ja e fundit nuk është e pamundur që të jetë një mbetje e hershme shqiptare. Vallja shqiptare apo ajo luftarake vazhdon të ekzekutohet me mjeshtri dhe njihet për reputacionin e saj te madh.⁴

Sathas një nga themeluesit e studimeve pas-bizantine, pohon se vallja pirrike në Greqi njihet me emrat:

□ A'ρβατιχοc, □ λεβένιx□ □ χοp□ □, dhe □ χαρτολαμα□. Dytë parat janë një përcaktim i qartë të origjinës pirrike epirote (Τομιδε□ është një fis që e ka marrë emnin nga lumi epirot □ύαμ□ apo Kalamas dhe që jeton përrreth lumi); fjala χαρτολαμά□ vjen nga e njëjta origjinë pasi χαρτοέιy në shqip do të thotë të kërcesh, të hidhesh. Shqiptarët e quajnë kërcimin βόλε [valle], që korespondon me fjalën e lashtë greke

³ Tipi bazë i këmbës metrike pirrike përbëhet nga dy rrokje të patheksuara të njëpasnjëshme: `vv'JJ

⁴ Rev. Thos. Smart Hughes, *Travels in Sicily, Greece and Albania/Udhëtimet ne Sicili, Greqi* Sathas, nje nga themeluesit e studimeve bizantine dhe pas-bizantine, pohon se valljapirrike ne Greqi njihet me emrat: dhe Shqipëri, vol.2, London, Printed for J. Maëmau, 1820, f. 31.

βαλλισμ [vallismos]. Nga fjala shqipe *χαρτοείυ* dhe *χατοείυ* vjen dhe emni neo-helenik i dhisë *χατοixa* (Sathas 1883, LXXVI)

Duke diskutuar më tej vallet e kleftëve (κλέφτικοχο) dhe atyre të çamëve (τσάμιχο), Sathas pohon se vallja pirrike ende nuk është harruar në Greqi Midis autorëve bizantinë, Agathias, historian i shekullit VI, vazhdonte t'i jepte kësaj valleje luftarake emrin e saj të lashtë ἡπυρρίχην. Gjatë rrjedhës së shekujve e deri në ditët tona, *pirriku* ka marrë emra të ndryshëm ndërkohë që ka vazhduar të ruajë emrat e valles shqiptare Thiamis (τσάμιχοχο) (Sathas, 1883, LXXXIX)

Holland, një tjetër vëzhgues i huaj, mbasi kishte këqyruar 'meloditë kombëtare të Shqipërisë' dhe instrumentet tradicionale që i shoqërojnë ato melodi, bëri komentet e tij mbi këtë temë kaq tërheqëse-vallen pirrike: 'Kjo valle kombëtare e shqiptarëve, albanitiko siç thuhet në përgjithësi, më shpesh ckzekutohet nga dy veta; nuk pretendoj të them se prej nga sa larg vjen, apo në se rrjedh nga pirriku i lashtë, por sugjerimi për një ngjashmëri të tillë nuk ka pse të mos përkojë duke vrojtuar ato gjarpërime të habitshme dhe të egra që formojnë karakterin e veçantë të këtij argëtimi' (Holland 1815, 80).

Lord Broughton i bën një përshkrim edhe më plotë të tipareve të kësaj valleje. Duke qenë i pranishëm mes fshatarëve dhe duke dëshnuar mbi këndimin dhe vallëzimin e tyre, ai kishte vënë re se fillimisht ata e nisnin kërcimin me një valle të ngadaltë; grupi qendronte i vendosur në një gjysmë rrethi me instrumentistat në qendër, që dhe këta me muzikën që luanin shoqëronin lëvizjet e valltarëve. Pastaj ishin vetë valltarët ata që ndërsa kërcenin, do të nisnin edhe të këndonin e të mbanin iso. Ky lloj ekzekutimi e befasoj Broughton-in duke e konsideruar të ishte mjaft i egër. Ja se si e përshkroi ai:

I takonte prijësit të vargut të drejtonte levizjet kryesore dhe tërë të tjerët e merrnin këtë vend me radhë. Ishte fillimisht ai që e niste këndimin lëvizjet njerën pas tjetrës këmbeve; më pas bën një hop të shpejtë përpara duke e terhequr të gjithë vargun në formë rrethi pas tij; më tej përdridhet e rrotullohet, bie me gju, kthehet edhe një herë mbrapsht që nga toka me një të klithur; të gjithë tjeret duke përsëritur burdonin [ison] e këngës ndjekin shëmbullin e prijësit Ka dicka të rrezikshme, ndonëse tërheqëse, në përpjekjen për të zbuluar pikat ngjashme mes zakoneve moderne, dhe atyre të lashta; ndoshta ndokush do perpiqej të aludonte se shqiptarët, pavarësisht nga e kanë mësuar këtë praktikë, ruajnë këtë argetim diçka shumë të ngjashme me valët

luftarake për të cilat ne gjejmë të dhëna tek autorët klasike.

Por ka nga ata, siç kanë bërë disa udhëtarë francezë, që nuk duan të flasin për vallen pirrike të shqiptarëve. Le t'i hedhim nje sy Ksenofonit mbi pershkrimin e valleve greke dhe barbare me të cilat ai argëtonte ambasadorë të huaj, dhe le te ngulemi tek vallja persiane si ajo qe mbart ngjashmërinë. me të përafërt me vallen moderne (Broughton 1855, 144-145).

Edhe studiuesi arberesh Francesco Falsone i cili shkruar një litër prej 342 faqesh mbi këngët kishtare të grekëve dhe shqiptarëve të Italisë, në afro njëqind faqet e para të tij studimi i kushtohet këtyre këngëve. Falsone shqyrton kulturën klasike të grekëve të lashtë dhe supozon se shumë tipare të përbashkëta të se njëjtës kulturë i përkasin edhe shqiptarëve/epirote. Ai përpiket të identifikojë këngët greke dhe shqiptare të Siçilisë me ato të grekëve të periudhës klasike para-kristiane. Falsone thekson se 'vijuesit e vërtetë të muzikës së lashtë greke janë sot shqiptarët siçilianë dhe jo grekët moderne' (Falsone 1936, 54-55).⁵

Gjithnjë lidhur me afersinë e presupozuar nga Kujxhija midis valleve shkodrane të dasmës dhe muzikës së lashtë greke, Krantja ve në dukje se Kujxhija 'melodit e valleve t'ona i paraqet si rriedhje e grupit të sistemeve të vjetra Greke, por tue mos pranue se linden kryekput prej tyne. Ai pranon se bajnë pjesë apo kanë influenc t'ayne sistemeve të vjetra Greke, siç kanë edhe meloditë e popujve të tjerë prendimore' (Krantja, Valle Shkodrane, 1944).

Shkrimet e mësipërme të autorëve të huaj e shqiptare mbi vallen pirrike janë ndoshta plotësimi i ideve qe donte të shtronte Kujxhija, apo më mire dëshira e një 'iliri të ndezut' – siç do to shprehej Kolë Ashta më 1943 - për t'i veshur vallet e dasmës shkodrane me petkun jo më të lokales por të kombetares, ashtu siç e kishte emërtuar ai vete titullin e librit - Valle Kombetare.

Orientimi harmonik i melodive të valleve

Kujxhija qe nga të parët muzikantë shqiptare që bënte dallimin se ç'është e jona në përdorimin e harmonisë, ç'është përtej nesh dhe ç'është e panevojshme të huazohet. Po citoj nje fragment të gjatë marrë nga Parathënia e tij:

Sot mjerisht, t'influencuem dita ditës prej muzikës së huej, e sidomos

⁵ *Francesco Falsone, I canti ecelesiastici Greco-Siculi, CEDAM, Casa Editrice Dott. Antonio Milani, Padova, 1936,54-55.*

prej asajë të fqijve t'onë Jugosllav, i interpretojnë dhe i ndijnë këto melodi në një mnydyrë tjetër. Te gjitha vallet qi janë në 'la minore', interpretohen porsì t'ishin në 'sol maggiore': e qe se si:...

Shqetësimi i Kujxhisë i cituar në paragrafin e mësipërm, ishte i justifikuar, sepse tek shumë kengë (jo vetëm të krahinës së tij, Shkodrës), veçanërisht ato të tonaliteve maxhore, intervali nëntonik (subtonik) llogaritet si tonike. Ky qëndrim ndaj nëntonikës modale u përcoll gradualisht si një funksion harmonik legjitim dhe u bë natyrë e dytë e këngës. Siç dihet tashmë, harmonia modale 'qytetare' e cila nxirrej nga linja lineare homofonike ekzistonte në brendësi të këngeve qytetare dhe kështu, sado e kufizuar dhe e parashikueshme, ajo kishte identitetin e saj. Harmonia e 'kultivuar' e krijuar nga kompozitorë-aranxhuesit profesionistë dhe gjysmë-profesioniste, edhe pse përdorej me synimin e mirë për të rritur cilësinë e këngës, shpeshshmangej nga origjina e saj. Prandaj edhe Kujxhija shqetësohej se 'në pikëpamje muzikore, sikurse e pamë dhe ma sipri, një interpretacion i gabuem melodik, e ban muzikën me humbë ftyrën e vet zanafillse, dhe nesër, kur muzikologët e huej të vehen me studjue muzikën t'onë dhe me caktue originën, do t'ishin qenë te drejtuem kah burime të tjera' (Kujxhija, Parathanje, IX).

Orientimi harmonik i kompozitorë-aranxhuesve përgjithësisht prirrej të udhëhiqej nga një sens krijues duke sugjeruar forma shprehëse që kishin të bënin me konceptet e tyre estetike të periudhës kur ata jetuan, pra mënyrës së konceptimit të gjuhës tonale dhe modale. Duhet thënë se gjatë viteve 1930-40 kishte shumë pak kompozitorë-aranxhues shqiptarë që iu përkushtuan harmonizimit dhe instrumentimit të këngëve tradicionale, njohuritë dhe përvoja e tyre mbi modalitetet e kësaj gjinie ishin mjaft modeste. Ata ishin edukuar me parimet e harmonisë perëndimore dhe kryesisht vetëm me gjuhën tonale, por duke e përvetësuar pak nga pak përvojën e muzikantëve tradicionale vendas, kompozitorë-aranxhuesit filluan të kuptojnë se faktorë të tillë si kërkimi për një harmoni shprehëse mund të bëhej i dobishëm në shërbim të prirjeve modale të këngeve. Vlen të theksohet se ndryshe nga elementet e tjerë të veshjes së një kënge, si melodia, ritmi dhe shprehja muziko-poetike, harmonia që përdorej në të nuk ishte pjesë integrale e figurshmërisë modale të këngës. Si mjet shprehës, funksioni i harmonisë përdorej më shumë për të kënaqur veshin sesa për të pasqyruar veçoritë tipike të modaliteve krahinore. Kjo është arsyeja që në fillim të viteve 1940 Kujxhija, mbledhësi i këngëve dhe muzikologu, preokupohej për

notën fundore të këngëve, *finalis*, dhe funksionin e saj harmonik:

Nota e mbrame `la', në vend qi m' u marrë porsì themelore e akordit tonal, e kshtu do t'ishim ne `la minore', interpretohet porsì e pestë e akordit të dominantes të 'sol magjore' d.m.th. 're, fa, la'; ato qi janë në 're minore', porsì t' ishin në 'do magjore', nota e fundit 're', porsì e pesta e dominantes d.m.th. 'sol, si, re'; e kshtu bajnë me të gjitha. T'interpretojsh në ket mndyrë këto valle, asht barabar sikuerse t'i Jugosllavizojsh, pse mbarimi këngëve në të pesten e dominantes, asht një karakteristikë e muzikës Jugosllave. Kshtu ndoshta' kishte me interpretue edhe ndonji qi bazohet në një kqyrje të thjeshtë teorike. Qe pra nevoja me studjue mirë shpirtin e muzikes s'onë; e sidomos atë të maleve dhe të fshateve, ku 'përlhura harmonike endun rreth çdo melodije, edhe pse në një mndyrë latente, ndiehet ma fort' (Kujxhija, Parathanje, VIII).

Në të njëjtën periudhë, një tjetër shkodran, Pjetër Dingu, i cili ishte po kaq i përfshirë në mbledhjen dhe përpilimin e këngëve tradicionale shqiptare në përgjithësi por edhe studimin valleve me këngët e dasmave e të shtregullave në veçanti, do të shprehej:

Kemi shumicën e kangëve e valleve të kendueme qe mbarojne me kadencën tonike minore. Kjo kadence ndigjohet që nga jugu deri në fund të veriut të Ballkanit. Kangët e shllregullave përfundojnë në kadencën e tonikës minore. Ne pergjithësi këto kangë janë shumë të gëzueshme dhe shumë melodioze. Po njisoj, edhe vallet ndër dasma e gëzime të tjera familjare gati në përgjithësi janë të gëzueshme, humoristike etj. Me kenë se kjo kadencë ndigjohet në mal e në fushe gjith kah në Ballkan, un e quej kadenca tonike minore ballkanike, ku kan jetue Pellazget-Illirët dhe sot pasardhësit e tyre Shqypetarët. Mbaj mend kur mësuesi im Martin Gjoka bisedonte me shokun e tij Bernardin Palaj për folklorin e lashtë, Bernardini thoshte se vallet me kangë të dasmave, shtregullave etj, janë vizari ma i çmushem, ma i vjetri në Ballkan. Ndër vendet e veriut të Ballkanit, vendasit u sllavizuen, ndrruen gjuhën, kangët dhe vallet me kohë u sllavizuen, [kështu] sllavët në kohët e mavonshme kangët me magjore e minore i ndryshuen dhe në vend me marue me minore marojne me dominanten e magjores, p.sh. në kjoft se kanga mbaron me tonikën minore la-, Jugosllavët e Ballkanit e mbarojnë me dominanten Re-Fa#-La.¹⁹⁶

⁶ Pjetër Dingu, 'Disa mendime personale të zhvillimit të kangës popullore shqiptare', 20 shtator 1984, f. 4-5. Ky artikull i pabotuar iu dha autorit të këtij punimi nga i biri i Dingu, Leopoldi.

Shëmbuj të përdorimit të të njëjtit mod si në këngët e dasmës shkodrane apo to shregullave, hasen edhe në tipa të tjerë këngësh në zona të tjera të Shqipërisë. Kam venë re të ekzistojnë ngjashineri të dukshme modale midis valleve të kënduara shkodrane (të dasmës e të shregullave) dhe këngëve të traditës gojore korçare, pikërisht në përdorimin e formulave kadencore nëntonike dhe atyre tonike.²⁰⁷ Kjo çështje është trajtuar nga Kujxhija dhe Dungu në hulumtimin e tyre rreth rolit të 'tonikës minore' në këngët tradicionale shqiptare. Gjithsesi, fokusi i këtij libri do të mbetet tek Kujxhija dhe vallet e kënduara të mbledhura prej tij, pra tek elementet muzikore që përbëjnë këtë repertor.

Në dy fjalë nga përgatitësi i librit të mësipërme përmenda Albert Papariston i cili e gjente shumë interesant faktin se si Kujxhija i kishte vendosur në intervalin e një kuarthe më sipër përgjigjen që gratë bënin pas këndimit të burrave, të cilët e kishin ekspozuar fillimisht melodinë një kuartë më poshtë. Lidhur me këtë marrëdhënie intervalore të kuartës midis grave e burrave që Kujxhija i notëzonte dhe emërtonte si soprano e tenore, Ramadan Sokoli kishte një gjykim të ndryshëm. Në librin e tij madhor Folklori Muzikor Shqiptar' (1965) Sokoli do të shkruante: 'Në vëllimin Valle Kombëtare që pat botue Gjon Kol Kujxhia në Firenze më 1943 vrehet se të gjitha kangët dialogjike të Shkodrës që këndohen dy palësh: burrat në njanën anë dhe gratë n'anën tjetër, tue përsëritë me radhë reshtat ose distiket, janë notizue me dy regjistra të ndryshëm, pra tema e grave gjithmonë një kuartë ma nalt se ajo e burrave. Ndonse kam kërkuë me kujdes me e ndie këtë kalim të temes në kuartën e sipërme nga goja e burrave në gojën e grave nuk kam mujtë me e verifikue asnjëherë ndër vallet zanore të Shkodrës. Madje kangëtarët dhe valltaret popullore të këtij qyteti as qe i pranojnë modulacione të tilla' (Sokoli 1965, 34). Mos ndoshta fakti që Sokoli nuk është ndeshur me këto valle të kënduara të Shkodrës ka të bejë me atë 'spjegim të hollësishëm të zakoneve të fejesës e martesës në gjindjen katolike të Shkodrës' qe Mustafa Krantja e parashtron në artikullin e tij 'Valle Shkodrane' të 26 korrikut 1944? Apo ndoshta ky ishte një projektim i Kujxhisë se si do të duhej të paraqitej vallja e kënduar në formë studimi e hedhur në notëzim? Është një tezë mjaft tërheqëse por që nuk jam në gjendje të provoj.

⁷ *Këngët që kadencojnë në 'tonikën minore' nuk përbëjnë përjashtim vetëm për shqipërinë; ato ndeshen edhe në zona të tjera të Ballkanit e më gjërë.*

Orientimi i organizimit metrik

Ashtu si në vallen e kënduar ‘Mori vashë e vogël, gati më shumë se në gjysmën e librit të Kujxhisë gjen njësi metrike asimetrike të cilat ai i ka transkriptuar me një zell e njohuri të lavdërueshme. Sot ne i përdorim këto faktura metrike me një tjetër konvencion, më të lehtësuara për nga thyesa e poshtme e fakturës, pra në vend të $7/16+5/16$ të Kujxhisë i kemi zevendësuar me $7/8+5/8$. Në gjykimin tim, Kujxhija me atë intuitën e tij djaloshare e mbështetur në njohuritë e marra nga mësuesit e vyer të tij në Shkodër, e konceptonte organizimin metrik me synim për nga analiza e valleve se sa për nga interpretimi i gjallë i tyre. Kësisoj, për sa i përket metrikës dhe ritmeve tona, Kujxhija do të konstatonte se:

Për çka i përket holiës ase rrythmit, dominon aj prendimuer. Pesdhetë për qind të këtyne valleve, kan rrythmin 2/4 e 4/4. Kemi mandej disa me rrythem të bashkuem 2/4+3/4 dhe 3/4+3/8 ase anasjelltas. Të tjerat e kjo asht një përqindje shum e madhe kan një rrythëm karakteristik 5/16+7/16 ase anasjelltas, i cilli besoj te jet original i yni. Kemi me pa se rrythmi 7/16 asht baza e kangve të ‘hengut’ (Parathanje, VII).

Që në fillim të Parathanje-s së tij, Kujxhija diskuton për tipin bazë të këmbës metrike pirrike që përbëhet nga dy rrokje të patheksuara të njëpasnjëshme. Ai ve në dukje këtu se ‘posë ‘valles Pirrike’, ndër Grek gjejmë edhe ‘rrythmin Pirrik’. Ky, në pikëpamje metrike asht njinji me ‘dy rrokje to shkurtra’, ♪♪ dhe i pergjegjë rrythmit dy kohësh ‘2/8’. Duket se ky rrythëm ka marrë emnin prej dancet, dhe asht koha karakteristike e sajë. Edhe kjo paraqitet si një gja shumë e randsieshme’. Mustafa Krantja në analizën e tij të kujdesshme e profesionale parashtron se ‘në pikpamje ritmike vallet e Kujxhis kanë afinitet me ato prendimoret. Siç thotë dhe ai [Kujxhija] vetem 50% t’atyne valleve kanë ritmin 2/4 dhe 4/4. Të tjerat shkojnë me ritëm të bashkuem 2/4+4/4 dhe 3/4+3/8. Në vend qi siç e thashë ma përpara dhe siç e shënon dhe ai vetë, përqindja ma e madhe ka një ritëm karakteristik 5/16+7/16 të cilin e beson si origjinal t’onin’ (Krantja, Valle Shkodrane, 1944). Pra, çështjen e këmbës metrike pirrike në aplikimin e valleve të kënduara të dasmës shkodrane me sa duket Krantja e le të hapur për një diskutim të mëtejshëm.

Gjithnjë në kuadër të analizës metrike të këtyre valleve, Krantja evidenton se ‘tue insistue në origjinalitetin e këtyne valleve auktori [Kujxhija] paraqet ritmin 7/16+5/16 si ritëm origjinal i valleve t’ona popullore. Ai ban vetë një analizë shumë të hollë të këtyne valleve e për

më gjetë origjinën të këtyne shërbehet shumë nga krahasime ndërmjet koreve të valleve t'ona dhe t'atye të Grekve të vjetër. Kujxhija konstaton një ndryshim ritmi në vallet e tija' (Krantja, Valle Shkodrane, 1944).

Vallet në shtregull

Në një fjalor shqip botuar në vitet 1930, togfjalëshi aheng kombëtar jepet si me poshte:

ahengu ase melodija qi e trajtonte, ishte Turko-Bizantine, ase ma mire: 'Aheng Orjental i perziem'. Vetëm vallet e darsmës qi këndoheshin prejë grave të gjytetit, të shtregullave në priell e në maje, ashtu kangët kreshnike të malsienave⁸ e të katundeve fushore, ishin brumit si në përmbajtje ashtu në melodie, të cilat Shkodra, tue mos i qenë aq të kandëshme për vesh, i cilsoj kurdoherë si të dorës së dytë e të tretë.⁹

Me të drejtë mund habitemi përse thesaret e vërteta autentike, si këngët e dasmës shkodrane apo ato të shtregullave, 'cilësoheshin' nga autorët e këtij përpilimi 'si të dorës së dytë e të tretë'? Nuk do të mendoja që cilësimi i shprehur në fjalor të ketë qenë plotësisht ai i duhuri. Gjykoj që kur filloi të praktikohej *makami* në Shqipëri, intonacionet otomane kishin hyrë në modë jo vetëm për prijën e tyre të re, por edhe për pasurinë e tyre të shprehjes, çka e bënte të pamundur t'i rezistojë asaj magjie aq të fuqishme orientale; këto intonacione të përafërta me ekzotizmin që përdorej edhe në Europën përendimore (ai spanjoll apo ai i jenicerëve tek Rondo alla Turca e Mozart-it) janë ende në mode edhe sot pas rreth treqind vjet të ekzistencës së tyre në Ballkanin Jug-Perëndimor e sidomos në Shqipëri e në Shkodër.

Eshtë kjo arsyeja që Kujxhija me nuhatjen e tij të hollë e vizionin e tij larg pames kishte ndërmend të bënte një studim gjithëpërfshires të muzikës sonë kombëtare. Me pasë pa të mundshme të fokusojë kryesisht tek ajo e veriut: 'Per arsye vishtirsish se kohës nuk që në gjëndje të kalojë ndër krahina të ndryshme dhe kështu e ndroi piknisjen e botimeve të veta e ia filloi me folklorin muzikuer të Shkodrës'-

⁸ *Meloditë që do të jenë muzikalisht dhe kronologjikisht më të vjetëra, rojnë në këngët e Malësorëve të Shqipërisë Veriore. Kjo këngë solo e fortë është shprehja e që moçme e malësorit të lirë, gjurma tingëllore e fundit të shtresës primare të kulturës shqiptare. Simboli muzikal i shtëpisë së vetmuar, i ekzistencës së izoluar dhe i karakterit individualist të njeriut të malit na paraqitet qartas në këto melodi'. (Çabej, Studime gjuhësore, Prishtinë, Rilindja, yell. 5, 1975, f. 129).*

⁹ *Shogninat e vjetra muzikore', 193?, AQSH, F 831, d. 5, f. 63.*

shkruante më 12 shtator 1944 tek 'Bashkimi i Kombit' një nga vlerësuesit e parë të punës së Kujxhisë por që preferonte të mbetej anonim duke u identifikuar vetëm me inicialen 'O'. Koha sa jetoi i lejoj Kujxhisë të botonte vetëm studimin mbi vallet e martesës e të shtregullave, si dhe të linte si dorëshkrim notëzimin e këngëve të ahengut shkodran. Vallet e kënduara 'kurdohere' para marteset, edhe në shtregull', përfshihen në gjysmën e parë të shëmbujve notëzues të librit të Kujxhisë Valle Kombëtare; janë 25 syresh (nga 52 vallet e dasmës shkodrane).

Meloditë e shregullave, si traditë rituale, këndoheshin në një muaj të caktuar të pranverës dhe me kohë u bënë edhe pjesë e ritualit të fejesës e martesës. Shtregulla është një litar i hedhur në degën e permës së manit për të përdorur si përkundes (kolovajze); ulur mbi një jastek në lakun e poshtëm të litarit, këngëtari duke u përkundur poshtë e përpjetë ia niste këngës, ndërsa poshtë në tokë, përballë shtregullës, qëndronin të tjerët të cilët përsërisnin melodinë e atij që përkundej në shregull. Kjo mënyrë simbolike të kënduari, apo valleje të kënduar, është e një traditë dhe natyrë krejtësisht lokale, shkodrane. Kujxhija në Parathanje shënon:

Në Shkodër, vallet këndohen ndër- tri çfaqje ase raste:

- a) artese.
- b) Festa e pranëverës (shregullat).
- c) Sheti (pick-nick).

Vallet që përmban ky libër i përkasin së pares, megjithkëta, kemi me pa se edhe valle tjera, sidomos ato të shregllave, kanë depertue shumë, dhe këndohen s' bashku në rastin e martesës; posë ktyne, edhe ndo' i valle katundit (Kujxhija, Valle Kombetare, VI). Për më shumë mbi këngët e shregullave, shih më sipër edhe përshkrimin e Pjetër Dungut, i cili i shquan ato për nga pikëpamja harmonike të 'përfundojnë në kadencën e tonikes minore' dhe për nga karakteri të jenë shumë të gëzueshme dhe shumë melodioze'. E veçanta e këtyre valleve të kënduara (të martesës e shregullave) në librin e Kujxhisë, është se ato ishin të natyrës korale (përfshire edhe personin që përkundej në shregull) dhe se këndoheshin ë unison si të tilla. Pra, pavarësisht nga simbolika e përkundjes në shtregull, në formën e tyre si gjini muzikore ishin burrat (meshkujt) që ekspozonin melodinë me fjalët dhe pastaj gratë (femrat) që i pergjigjeshin atyre me të njëjtën melodi e fjalë por në një tonalitet tjetër, një kuartë më lart. Ishin pra melodi pa shoqërim instrumental, ashtu si këngët tradicionale shumë zerëshe të jugut, por që nga pikepamja tonale/modale ishin diatonike dhe jo-diatonike, ndryshe

nga këngët shumë zerëshe të jugut shqiptar që janë të mbështetura mbi mode pentatonike.

Doket: Fejesa-Martesa

Në vijim të Parathanje-s së librit Valle Kombëtare të Kujxhisë vjen nën kapitulli 'Doket:Fejesa - Martesa', ku autori shpjegon mbi ritualin e këtyre ngjarjeve të veçanta në jetën e njeriut. Ritualin e mbledhur e i shkruar, në gjykimin tim jo prej eksperti, duket i plotë e me detaje nga më të perveçmet, ritual që praktikohet kryesisht në gjindjen katolike të Shkodrës. Bëhet fjalë për një trashëgimi të hershme të këtij rituali që me kalimin e kohëve, nga më të hershmet deri në shekullin XX, të jetë pasuruar e të jetë konsakruar në formën e një visari kombëtar. Madje Kujxhija i referohet një kolegu të tij, i cili thoshte se 'çdo plak qi vdes, merr me vedi në vorr një vizar kombëtar'. Nuk di nëse ky ritual të jetë praktikuar si mbarë shkodran, por nga ato 115 shënime mbi rrjedhën e tij, prej fillimit e deri në fund, dëshmohet që pjesë e ceremonialit të fejesë - martesës ishte dhe lajmi publik qi famulltari epte në kishë' (nyji 20) apo që 'Kunora Civile nuk kishte, prandej ajo fetare vlete edhe për shtet' (nyji 21). Të tjera momente të 'Dokeve' si 'nusen e lyeshin me ujë të bekuem' (nyji 51), 'nusja shkote në kishë me kal' (nyji 52), 'kur vite nusja, vite dhe famulltari' (nyji 59) e të tjera shpjegime të tilla, bëjnë fjalë për martesën e gjindjes katolike.

Lidhur me 'Doket: Fejesa-Martesa', shkruesi anonim, 'O', vinte në dukje lidhur projektin që kishte Kujxhija në lëvrimin e një teme muzikologjike të etnisë shqiptare: 'Kishte në mende me mbledhë folklorin muzikuer të veriut të Shqipnis tue fillue prej maleve e fshateve e tue zbritë ndër qytete. Asht i mendimit se, sikur gjuha, gjaku, doket janë rrujtë të pastërta ndër ato male qysh prej të parve ilir-trakes, edhe muzika asht mbajt e paprekun. Por të muzika e qytetit buron prej muzikës së maleve, por e zhvillueme baras me jetën shoqnore qytetare' ('Bashkimi i Kombit', 12 shtator 1944).

Vijon në numrin pasardhës

▪ Trashëgimi kulturore ▪

Arben PRENDI

**SHKODRA PËRMES VËSHTRIMEVE ETNOGRAFIKE E
KULTURORE TË STUDIUESIT GJUSH SHELDIJA**

Prej veprës së arsimtarit, historianit dhe etnografit të mirënjohun shkodran, Gjush Sheldia (1902-1976) po paraqesim edhe një tjetër vepër me shpresën se kështu vepra e tij e shpërndame nëpër periodikë të kohës apo e mbetun në dorëshkrim po plotësohet pak nga pak. Ai pati një krijimtari të gjanë në shumë fusha të kulturës kombëtare, artikuj, studime, por edhe krijimtari letrare e cila fatkeqësisht ende nuk asht botue në formën e veprës përfundimtare. Shumë prej punimeve të tij u botuen në revista zamëdha të traditës sonë kulturore si: “Hylli i Dritës”, “Leka”, “Kumbona e së dielles”, “Shkodra”, “Shkëndija” e Tiranës por edhe në gazetata “Balli i Rinisë” në Tiranë, “Afrimi” në Vlonë, “Gazeta shqiptare” në Bari e në gazeta të tjera të Shkodrës.

Siç e portretizon studiuesi Koleç Çefa në artikullin “Gjush Sheldia veteran i arsimit kombëtar”, ai ka një veprimtari të dendun e të larmishme në: -krijimtari artistike origjinale, poezi, prozë e dramatikë; - artikuj me karakter arsimor, gjuhësor, etnografik, historik e arkeologjik; - në mbledhjen e materialeve të larmishme me vlerë kulturore, biografive e kujtimeve të personaliteve historike etj. Në shumë prej punimeve të veta Gjush Sheldia ka përdorë edhe pseudonime, si: *Gjet Kola*, *Nji mik*, *Sheboja*, *Magister*, *Nji bashkëpunëtor i ri*, *Korrespondenti*, Dikush, 67, 647 etj.

Libri “Historiku i karnivaleve të Shkodrës dhe shkrime të tjera” (2020) që po i paraqesim lexuesit përbahet prej disa artikujsh e punimesh, kopje të të cilave ruhen në dorëshkrim prej familjes së tij, në arkivin e Muzeut Historik në Shkodër apo në arkivin e shtetit shqiptar. Shumë prej punimeve të Gjush Sheldisë janë shfrytëzue nga studiues të ndryshëm, ndonjëherë, tash edhe në të kaluemen, edhe pa u përmendë burimi i mirëfilltë. Fatkeqësisht vepra e shumanëshme e këtij studiuesi mbetet ende e shpërndame nëpër periodikë, dorëshkrime e arkiva pa kujdesin e vëmendjen e duhur prej institucioneve private apo shtetnore që kanë përgjegjësi e detyrë nxjerrjen në dritë të dokumenteve të harrueme të kulturës tonë kombëtare.

Botimi i kësaj vepre shumëvëllimëshe dhe shumëdimensionale, e cila ende nuk e ka pa dritën e botimit, do të përbante një shërbim të vlefshëm jo vetëm për autorin në fjalë por edhe për studiuesit e dashamirësit e kulturës shqiptare. Sigurisht në gjendjen në të cilën ndodhet ajo ka nevojë të gjurmohet dhe të sistemohet prej studiuesve të fushës dhe të mos i lihet vetëm spontanitetit dhe dëshirës e vullnetit të mirë të familjarëve të autorit, të cilët e kanë të pamundur ta kryejnë këtë mision edhe për pamundësi financiare.

Megjithatë përballë indiferencës së institucioneve vjen me kontributin e familjes së autorit edhe ky libër i ri. Në këtë libër gjinden këto punime: “Historiku i karnivaleve të Shkodrës” (1960); “Shiroka. Gjuetija e peshkut në liqenin e Shkodrës dhe në lumenjtë Bunë e Drin”; “Shkolla e parë në Shirokë” (1874); “Darsma në Dukagjin”; “Shpijat tipike të Shkodrës”; “Udhëheqësi nëpër qytet”.

Në punimin “Historiku i karnivaleve të Shkodrës” (1960), gjejmë atmosferën e hareshme të karnevaleve të Shkodrës, humorin karakteristik e të pavdekshëm të njerëzve të këtij qyteti si një mënyrë me iu kundërvue vështirësive dhe travajeve të shumta të jetës. Përveç të dhanave me interes historik për ekzistencën e traditës folklorike të karnevalit, në këtë punim përshkruhen skena të gjalla plot ngjyra të atmosferës së jetës së lirë qytetare e cila edhe pse nën pushtim e gjen shtegun drejt lirisë dhe shfaqjes së vetëdijes opozitare ndaj regjimeve të kohës, nga pushtimi turk deri në kohën e regjimit komunist. Për autorin, *në vjetin 1880, Jak Fishta, i cili kishte qenë shegert i Sh. Ingrisit del se e kishte përvetësue mirë zejen, kishte çelë dugajë në vedi, mbasi ishte edhe në bandë, sëbashkut me gjithë shegertat u veshën “surretën” dhe dolën në kortë me vegla muzikore, nëpër qytet, gja krejt e re për Shkodër;*

ky qe ma i pari manifestim karnivalesk i organizuem; ky festim mbeti për shumë e shumë vjet traditë e shtëpisë së Fishtorëve e cila ende sot përmendet për këtë punë, ndërsavllaznit Zef e Gjon Mala të Martën e Karnivaleve, të vitit 1878, qenë të parët që u veshën “surretën” dhe dolën botnisht: Zefi u vesh si hoxhë dhe Gjoni si prift. Kjo bani bujë të madhe. Studiuesit gjejnë në këtë punim të dhana me interes për ekzekutimin e karnevalit në Shkodër, ritualin, aktorët, kostumografinë, bejtet që recitoheshin me këtë rast, rruga që përshkohej, apo ngjarjet e paparashikueme që ndodhnin me autoritetet apo me individë të caktuar; pastaj përshkruhen edhe shoqnitë e grupet kulturore të kohës, të cilat jepnin kontribute për mbarëvajtjen e karnevalit etj. Ndërkaq lexuesit mund të bien në gjurmë të familjarëve të tyne që morën pjesë si aktorë apo organizatorë të tij. Përmes një narracioni të ngjeshun autori na sjell në këtë punim skena të jetës familjare e qytetare të Shkodrës nga vitet 1880 e deri në vitet 1960.

Një punim tjetër shumë interesant i këtij libri asht: “Shiroka. Gjuetija e peshkut në liqenin e Shkodrës dhe në lumenjtë Bunë e Drin”. Një punim model për kah gjithanshmënia e përshkrimit etnografik e ma gjanë, i një vendbanimi të vjetër, siç përshkruhet këtu Shiroka me pasunitë e veta natyrore e historike, materiale e shpirtnore. Autori na shpalosë me zhdërvjelltësi e bukuri poetike por edhe me konkretësi relievin gjeografik të Shirokës, liqenin, malin, atë pak tokë të punueshme, këndin e ndriçimit nga rrezet diellore, por edhe njeriun, botën e jetën morale-zakonore të shirokasit. Autori na mahnitë me dijenitë e tij deri në detaje, për liqenin dhe botën e gjallë që gëlon brenda tij, kryesisht për peshqit, llojet e tyne, mënyrat e vendet e peshkimit etj. tue na ngjallë imazhet e një bote kryesisht të humbun apo të rrezikueme prej zhvillimit të pakkontrolluem në kohën tonë. Ky punim, sikurse shumë të tjera të autorit tonë, kishte me hapë para syve vizitorit të Shirokës një botë fantastike në të cilën njeriu dhe natyra japin e marrin tue rrujtë kufijtë e tyne në shekuj. Prandaj ky punim ka përveç të tjerash edhe vlerën e një guide etnografike e kulturore për Shirokën, Liqenin e Shkodrës dhe lumenjtë Buna e Drin. Autori na del përveç si njohës i thellë i objektit të studimit edhe një mjeshtër i përshkrimit të natyrës, mjedisit dhe marrëdhënieve të njeriut me to, tue i dhanë punimit një përjetim të përdezun emocional, a thue se edhe na si lexues gjindemi gjithkund mbas autorit, hap mbas hapi.

Në artikullin “Shkolla e parë në Shirokë” (1874), autori sjell të dhana

me interes për këtë shkollë. Ai asht i mendimit se “Shkolla e Shirokës është hapun së parit me 1874. Kjo datë gjindet e protokolueme ndër akte zyrtare të Famullis katolike të Shirokës. Prej date së themelimit deri në vjetë 1880 mbahet prej klerit katolik shekullarë shqyptarë. Prifti që e themeloi shkollën kje Dom Zef Ashta”. Me këtë rast jepet edhe një listë e arsimtarëve që dhanë mësim në këtë shkollë nga viti 1874 deri në vitin 1944.

“Darsma në Dukagjin”na jep një përshkrim të organizimit të ceremonialit të dasmës në Dukagjin, tue fillue me shkuesinë, veshjet, marrjen e nuses, këngët e vallet që ekzekutoheshin me këtë rast, zakonet që shoqnojnë gjithë ceremonialin, deri edhe ushqimet që shërbeheshin në sofrën e dasmës etj.

Në ndonjë rast autori sjell dëshmi që hedhin poshtë pretendimin e ndonjë studiuesi se *“ka ndollë që me u shtye vuemja e kunorës deri me lindjen e fëmijës së pare”*. *Nuk due të vë në dyshim auktoritetin e auktorit – dhe ka gjasë e të ketë pasë raste sporadike- por për sa kam mujtë me hetue vetë për këtë mjaftojnë dëshmitë e plakut shalnjane Marash Kola nga Pjesholli i Gimajt-Dukagjin, i cili tesh vonë ka dekë në moshën 110 vjeç dhe sipas rregjistrit të pagëzuemve të katundit (?) Shalë delte ashtu me moshë-; ky më pat thane se aj nuk mbante mend të ketë ndollë gjatë jetës së tij një gja e tillë. Ka pasë raste kur kisha famullitare ishte larg, me e shtye ndonjë ditë vuemjen e kunorës.*

Pjesë të çmueshme të historisë, urbanistikës dhe kulturës së qytetit të Shkodrës gjejmë edhe në punimet: “Shpijat tipike të Shkodrës” dhe “Udhëheqësi nëpër qytet”. Këto punime nxjerrin në pah faktin se autori i tyne e pati në qendër të vëmendjes këtë qytet nga të gjitha pikëpamjet. Këtu lexuesi i apasionuem mbas kujtimeve që Shkodrës së dikurshme mund të zhbirojnë betejën e këtij qyteti me kohën, harresën por edhe me regjimin komunist, i cili bani çmos me e shformësue qytetin edhe nga pikëpamja arkitektonike dhe urbane, tue ndërpre përdhunisht traditën dhe zhvillimin e tij të natyrshëm simbas parimit të njoftun politik: “mbi gërmadhat e vjetra të ndërtohet e reja”. Në “Shpijat tipike të Shkodrës” gjejmë përshkrime interesante dhe të detajueme të arkitekturës së jashtme e të brendshme të shtëpive karakteristike të Shkodrës e të familjeve të shqueme të saj, si: Sahati i Hinglizit, shtëpia e Luigj Gurakuqit, e Gjokë Muzhanit, Musa Dulit, Kolë Llopit-Melgushit, Shuk Serreqit, Zef Gjonej, Myfti Plakut, Kolë Serreqit, Shan Dedës, Ndreka Shirokës, Loro Shirokës, Gjovalin Sumës, Pjerin Simonit, Mark

Kakarriqit, Kolë Sumës, M. Gjylit, Qazim Ramadanit, Hasan Zenelit, Visho Barbullushit, Mushanoviqvet, e Rrojejvet, e Kazazvet, Tonin Jubanit, Zef Sumës, Kolë Sumës, Qazim Ramadanit, Mehmet Gjylit e të sa e sa qytetarëve të Shkodrës. Studiuesi na ka regjistruar këto banesa në prag të rrënimt të tyre ose në prag të ndryshimeve që imponojnë me dhunë ndryshimet sociale e politike, të cilat sollën ndikime negative edhe në urbanistikën dhe arkitekturën e qytetit të Shkodrës.

Qyteti i Shkodrës, tradita, kultura, arkitektura dhe njeriu gjinden në qendër të punimit tjetër “Udhëheqësi nëpër qytet” në të cilin autori i prin lexuesit apo udhëtarit tue i tregue në detaje visaret ma të çmueshme të qytetit qysh prej monumenteve të lashta historike si kështjella e Rozafatit me legjendën e saj tronditëse, Kisha e Zojës, Pazari i Vjetër e deri te rrugët e rrugicat me kalldram që në dimën përmytëshin nga ujnât e Kirit. *Dikuer*, thotë autori, *nepër këto rrugë, syni të ndeshte në nuse të reja si zana, veshë me kostumet karakteristike të Shkodrës, kahë shtat-hjedhta e bel-holla i bajshin me rrahë zembrën me hov, djelmënis trime dhe sokoleshë të Shkodrës plakë por përherë e ré.* Me të drejtë studiuesi Besi Bekteshi në artikullin “Guida e parë për Shkodrën nga Gjush Sheldia”, shprehet për këtë punim se Sheldia në fillim të viteve '50 ka sjellë për Shkodrën “guidën” e parë të plotësuar dhe të mirëqartësuar nga pikëpamja historike. Një përshkrim se çfarë kishte pasuri Shkodra, ku ishin dhe kush ishin njerëzit apo lagjet e saj mungonte.

Ajo çka dallohet menjherë në këtë libër të studiuesit Gjush Sheldija asht se në qendër të këtyne punimeve gjindet Shkodra me qytetin e rrethinat e saj, njeriu, tradita, kultura, arti, arkitektura, monumentet, natyra e gjithçka tjetër që lidhet me të. Prandaj libri na zbulon detaje të rëndësishme, të njohuna e të panjohuna nga jeta e kalueme e këtij qyteti, jetë e cila tashmë gjindet vetëm nëpër kujtime të qytetarëve të Shkodrës apo ndër fletët e librave të historisë. Prandaj nuk asht e tepërt të thuhet se kjo vepër përban një përmendore ma shumë në nder të qytetit të Shkodrës dhe të qytetarëve të saj, përmendore që mundet me orientue në rrjedhë të kohës si vizitorin e lexuesin fillestar ashtu edhe brezat që do të vijnë.

▪ Kritikë letrare ▪

Arjeta FERLUSHKAJ

MESJETA IME: ROMAN-À-CLEF

I.CONFINIO

Mesjeta ime është kategorizuar si vepër e përbërë nga dymbëdhjetë ese, nga ku e para (“*Ulalume*”) dhe e fundit (“*Via*”) shërbejnë përkatësisht si prolog dhe epilog.

Nga mënyra si është shkruar vepra, është e vështirë të përcaktohet prerë zhanri pasi nuk është zgjedhur të punohet me kufinj të prerë. Me të vërtetë që “*fusnotat dhe shpjegimet janë ato që i japin veprës identitetin e saj prej eseje*”,¹ por fusnota kemi edhe tek romani *Ulurima e ujkut*:

“Kur mbërrij në kodër, zbres nga vetura dhe e shoh qytetin që ka rënë në gjumë të thellë. Ngre kokën lart dhe lëshoj një ulurimë² të gjatë sa këtu e në hënë.

2. Për shkak të motivimit më të madh onomatopeik dhe emocional, në këtë roman është përdorur trajta ulurimë, në vend të trajtës standarde (ulërimë).”¹

Tek lexon “*Ulalume*”, por edhe “*Allegoria*” dhe “*Via*”, do të ishte e padrejtë ndaj tekstit sikur ta shihnim këtë vepër vetëm si një libër me dymbëdhjetë ese. Edhe vetë autori, në një intervistë për median në

¹ Sherif Luzha gjatë fjalës së mbajtur në promovimin e librit *Mesjeta imenë* Prishtinë, më 28 shkurt 2019. Link: <https://www.youtube.com/watch?v=33HStZnkO2M>

Kosovë ka deklaruar: “*Është dhënë zhanri esesë për të mos e sfiduar dhe munduar lexuesin. Për mua, do të isha më dakord të quhej ‘roman dokumentar’ sepse është shkruar mbi ato parime. (...) Ato (esetë-shën. im-A.F.) janë kallëzime, janë më afër romanit se esesë.*”²

Në thuajse të gjitha pjesët të marra më vete ka rrëfim. Tek disa ka edhe dialog:

“*Unë nuk lexoj, sepse nuk dua të ndikohem. (...) Unë e pyeta shkrimtaren: Pasi ti nuk lexon, pse mendon që dikush duhet t’i lexojë ato që shkruan ti? Tha: Nuk e di, qishtu jam unë, origjinale.*”

(f. 89)

Gjithashtu, edhe sa i takon pozicionit të instancës rrëfyese në vepër do të thoja se kufijtë paraqiten të ndjeshëm, pavarësisht se në vepër lexojmë: “rrëfej brengat e zemrës, mendjes dhe shpirtit” ku përjetues thuhet qartë se është Ag Apolloni. Mirëpo autori thotë edhe këtë: “*unë flas për jetën time sipas mënyrës sime*”, ndërsa po ai, në një intervistë pohon se: “*Autori nuk funksionon dot pa maskë, i duhet një maskë, i duhet krijimi i një personazhi, qoftë edhe i një simboli për ta thënë një të vërtetë që pa atë maskë nuk mund ta thotë. P.sh., unë them shumë të vërteta në librat e mi që realisht në biseda të drejtpërdrejta, nuk do të guxoja t’i thoja.*”³

Kufiri ndarës *roman-ese* dhe *autor-narrator* është jashtëzakonisht i ndjeshëm. Të turbullt janë edhe kufinj të tjerë brenda kësaj vepre. I kujdesshëm në detaje dhe me sy të mprehtë, Apolloni ka punuar mbi veprën si të ishte ndonjë pikturë. Sikur po përdor *sfumato*⁴-n, teknikën e preferuar të Da Vinçit, ai ka zgjedhur të mos *shënojë* kufij të qartë as në zhanër e as në zërin rrëfyës, por jo vetëm aty. “*Ag Apolloni, siç mëton letërsinë, ashtu edhe e krijon. Letërsia e tij të nxjerr në dyshim çdo gjë. Aty asgjë nuk është e sigurt.*”⁵ Siç do ta shohim në vazhdim, pikërisht *pamja turbulluese* e krijuar jo rastësisht, e bën kaq të veçantë dhe intriguese veprën “*Mesjeta e re*”.

² Ag Apolloni i ftuar në emisionin “Bon Bon” ne RTV 21, më 01.03.2019 në Kosovë. Link: https://www.youtube.com/watch?time_continue=5&v=EV7tXTCkwqQ&feature=emb_title

³ Ag Apolloni i ftuar në emisionin “Express” në Koha Vizion më 27.02.2019 në Kosovë. Link: <https://www.youtube.com/ewatch?v=8qMbtvirAyQ>

⁴ Është një nga 4 teknikat që praktikonte Leonardo Da Vinci në pikturë: *sfumato, cangiante, chiaroscuro* dhe *unione*.

⁵ Besnik Jaha: “*Mesjeta ime e Ag Apollonit dhe Mesjeta jonë*”, në: www.kultplus.com, datë: 20 shkurt 2020.

II. ROMANI NË PESË KODE

Retorikaklasike njeh pesë kode: *Inventio (Eurexis)*, *Dispositio (Taxis)*, *Elocutio (Lexis)*, *Memoria (Mnemoa)*, *Pronuntiatio (Hypocrisis)*. Këto kode, dy prej të cilëve⁶ nuk lidhen direkt me fiksionin, i kemi marrë dhe i kemi përshtatur sipas qëllimit tonë për t'iu përgjigjur pesë pyetjeve që kemi shtruar:

E para i referohet *gjetjes* dhe ne pyesim: cila ishte ideja që ngjizi veprën dhe çfarë mendon autori se do të jetë interesante të rrëfejë për lexuesin?

E dyta i referohet *strukturës* dhe ne pyesim: si vendos autori se çfarë duhet lënë të thuhet në fillim e çfarë duhet të vijë më pas?

E treta i referohet *stilit* dhe ne pyesim: si ka menduar autori të ndikojë tek emocionet/mendimet e lexuesit të tij?

E katërta i referohet *kujtesës* dhe ne pyesim: si e ka ndihmuar dija autorin për ta shkruar veprën?

E pesta i referohet *prezantimit* dhe ne pyesim: si zgjodhi autori ta prezantojë veprën para publikut?

I shohim me radhë:

1. *Inventio*

Më përpara, rrëfimet autobiografike nuk konsideroheshin aq interesante, ndryshe nga sot që kërkohet të dihet gjithnjë e më shumë mbi jetën e një shkrimtari. Prandaj edhe Ag Apolloni zgjedh këtë gjetje:

“Me impulsin e një epifanie delfike, të shfaqur në moshën e mesme biblike, si një fragment nga realiteti platonik, mbi rrënojat e tempullit në kërthizë të botës, rrëfej brengat e zemrës, mendjes dhe shpirtit, i vetëdijshëm se opinioni im mbi botën (...) është gjithashtu rrëfim i karakterit.”⁷

Ka shkrimtarë që e përdorin jetën e tyre për të ndërtuar rrëfimin autobiografik, por në rastin e Apollonit është e kundërta: ai e përdor autobiografinë për të rrëfyer mesazhe të tjera sepse, *“kënaqësia nuk qëndron te gjetja, por te kërkimi.”*⁸ Apolloni vendos të rrëfejë për veten, por gjithashtu vë alarmin për *vonesat* politike e socio-kulturore që nuk

⁶ *Memoria* dhe *Pronuntiatio*.

⁷ Ag Apolloni, *Mesjeta ime*, “Bard Books”, Prishtinë, 2019, fq. 11.

⁸ Ag Apolloni, *“Autobiografia amorfe”*, në: Revista “Symbol”, nr.13, Tiranë-Prishtinë-Shkup, 2018, fq.50.

zgjidhin ngërçe në Kosovë. Përzgjedhja e “mesit të jetës” për të bërë këtë rrëfim duket se ka rrënjë te “*Komedia hyjnore*” e Dante Alighieri-t, pasi edhe ai deklaroi se në mesin e jetës e ka shkruar veprën, edhe pse mesit të jetës së tij nuk qëllon të ishte tridhejetë e pesa.

Duke lexuar romanin “*Ulurima e ujku*” (botuar në 2013), mund të themi se ishte i pritshëm një “shpërthim” i tillë i autorit. Ja disa shenja paralajmëruese që gjejmë aty⁹:

- “*Poeti i parë plebej, pa strehë e pa pretendime poetike, shkruante autobiografinë vulgare të tij*” (f.20)
- “*Inkuizicioni, obskurantizmi, mesjeta moderne. (...) Dijen në turrë të druve*”. (f.181)
- “*Nuk ekzistojnë djajtë, nuk ekzistojnë engjëjt. Ata janë krijuar në Mesjetë dhe ju deri tani është dashur të iluminoheni.*” (f.242)
- “*Tani po jetojmë si në Mesjetë: ose të vrasin, ose të çmendin, ose të shpallin të çmendur.*” (f.251)

Nga historia e vet personale, autori nuk zgjedh të rrëfejë ngjarje të jetës së tij që i duken të rëndësishme për t’u ditur nga lexuesi, ai gjurmon e zgjedh të rrëfejë ngjarje që *i duhen* për temat që ai ka përzgjedhur të trajtojë në vepër.

Ndërkohë që deklaroi se “*krejt librin e shkrova për ta njohur vetveten*”¹⁰, nga kuptimet e shumta që mbart pohimi, një ndër to mund të jetë edhe kërkesa e tij për ta njohur: “*Po unë që s’kam qenë kurrë pjesë e kopesë, si t’ia bëj me bariun? Ndoshta bariu duhet të mësohet ta respektojë, nëse jo ta dojë, ujku.*” (fq. 66)

Autori deklaroi: “*Në Delfi, te tempulli i zotit të dritës, ndjeva praninë e dikujt tjetër në mua. Frymëzimi (...) më bën të kuptoj se unë kur shkruaj jam në duar të zotit.*” Sipas Umberto Eco, nuk duhet t’i besojmë autorit kur thotë se *ka punuar në dalldinë e frymëzimit*.¹¹ Dhe në fakt, siç do të shohim, vepra “*Mesjeta ime*” ka një rrëfim të llogaritur në detaje dhe tejet të përpunuar.

2. *Dispositio*

Ulalume, Obscura, Vulgus, Doctrina, Pelegrin, Allegoria, Persona, Schisma, Templarius, Inquisitio, Memento dhe *Via* janë 12 esetë/kapitujt e veprës “*Mesjeta ime*”.

Rrëfimi në këtë vepër nuk ka një rend kronologjik, ndryshe nga çfarë

⁹ Citimet janë marrë nga ribotimi i vitit 2019.

¹⁰ Ag Apolloni, *Mesjeta ime*, “Bard Books”, Prishtinë, 2019, fq. 11.

¹¹ Umberto Eco, *Emri i trëndafilut*, “Elena Gjika”, Tiranë, 1996, fq. 452.

mund të pritej kur lexon nëntitullin “*Confessiones*”. Ne jemi munduar të veçojmë disa nga episodet kryesore të veprës duke bërë dallimin mes rrëfimit dhe fabulës dhe i kemi paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Rrëfimi:	Fabula:
I.Konstatimi i moshës 35-vjeçare	I.Origjina e fisit
II.Lindja në vitin 1982	II.Lindja në vitin 1982
III.Origjina e fisit	III.Shkolla fillore-gjimnazi
IV.Shkolla fillore-gjimnazi-fakulteti-doktorimi	IV.Vdekja e gjyshit
V.Udhëtimet në Austri-Itali-Greqi	V.Lavdrim Muhaxheri (kur ishte shok i vëllait)
VI.Botimet e veprave	VI.Vdekja e babait
VII. Historia e Lavdrim Muhaxherit	VII.(Fakulteti)-Doktorimi/Botimet
VIII.Vdekja e gjyshit, gjyshes, babait	VIII.Udhëtimet në Austri e Itali
IX.Nga vizita në Firenze	IX.Nga vizita në Firenze
X.Mbyllja e rrëfimit	X.Udhëtimi në Greqi

Rrëfimi fillon e mbaron me Apollonin që është në *gjysmën e jetës biblike*: tek “*Ulalume*” tregon se në këtë moshë (kur vizitoi Greqinë në 2017) i erdhi frymëzimi për të shkruar veprën dhe në fund, tek “*Via*” ku shënohet mbyllja e rrëfimit: “*Athinë-Prishtinë, 2017-2018*”.

Nëse provon të ndjekësh datat sheh se kemi të bëjmë me një *rrëfim kaotik*, p.sh. vdekja e babait dhe e gjyshit përmendet disa herë brenda veprës (frekuenca narrative):

Rasti I nga “*Ulalume*”: “*Gjyshi im ka vdekur rreth të pesëdhjetave, nga sëmundja e zemrës (...) i dyti (babai) me vdekje natyrale (sëmundje zemre).*”

Rasti II nga “*Vulgus*”: “*Ai që po largohej nuk isha unë, por gjyshi, i cili pak muaj më vonë ndërroi jetë, duke më lënë për një kohë të gjatë në një pikëllim të pangushëllueshëm.*”

Rasti III nga “*Doctrina*”: “*Babai pësoi infarkt (...) nga ai infarkt i vitit 2005 e deri më 28 janar 2007 (...) më shumë ndenji në spital sesa në shtëpi.*”

Rasti IV nga “*Schisma*”: “*Dy humbje të mëdha të gjysmëjetës sime janë edhe: vdekja e gjyshit (1997) dhe vdekja e babait (2007).*”

Rasti V nga "Memento": "Kur erdha, gjyshi kishte shkuar. I kishte mbyllur sytë. (...) Lum ky çfarë deke!, thoshin zërat e njerëzve."

Rasti VI po nga "Memento": "Ai, pas pak, e goditi gjoksin me grusht dhe tha: s'jam mirë.(...) Babai dha shpirt duke më shikuar mua."

Sa i takon renditjes së dhjetë kapitujve, mund të themi se edhe ato i përshtaten nivelit të ideve. Në katër kapitujt e parë, informacioni rreth autorit është më i ngjeshur e më i plotë sepse po tregohet rreth rrugës se si është formuar karakteri i protagonistit që do të tregojë diçka.

Pas "*Allegoria*", nis të kalohet si në një "rrëfim të vetës së tretë", në kuptimin që në tekst marrin më shumë hapësirë qëndrimet e veta apo refleksionet mbi fenomene të ndryshme që e çojnë në *dëshpërim* autorin. Ndërsa, "*Ulaluma*", "*Allegoria*" dhe "*Via*" kanë pozicione të atilla në renditje për hir të një funksioni tjetër, që do të trajtohet në pjesën e tretë të kësaj sprove.

Mesjeta ime ka një rrëfim me *arkitekturë ideore* precize. Kjo strategji e ndjekur për renditjen e dymbëdhjetë eseve i përgjigjet në mënyrë të përsosur qëllimit autorial për ndërtimin e një vepre të hapur. Autori përdor këtë strukturë narrative sepse "*ky organizim shtrihet thjesht në nivelin e ideve, jo në atë të ngjarjeve.*" (Todorov, 2000:62)

3. *Elocutio*

Elocutio, siç e kemi përmendur, lidhet me stilin e një vepre letrare. Te *Mesjeta ime* mund të bëhet një punim shkencor më vete vetëm nëse do të ndaleshim te stili, pasi teksti është punuar me një kujdes të posaçëm deri në imtësi. Por, në kuadër të kësaj sprove, ne do të cekim shkurtimisht vetëm disa përzgjedhje autoriale që i përgjigjen pyetjes sonë.

Pyetjes se si ka menduar autori të ndikojë tek emocionet e lexuesit do t'i jepnim këtë përgjigje: përmes *lojës*. Ndërsa, që të ndikojë te mendimet e tyre, ka zgjedhur *kulturën*. Pra kemi një double-coding (kodifimi i dyfishtë): loja dhe serioziteti. Për të funksionuar ky parim, i duhet një lexues ndryshe.

Disa here, autori i drejtohet direkt lexuesit, por ne veçojmë një rast kur thotë: "*Po të drejtohem me ti, ty që Baudelaire të quante lexues hipokrit, Genette të thërriste narrater, kurse Eco të konsideronte lexues model.*"¹² Me këtë "thirrje", autori, jo vetëm na konfirmon se jemi në

¹² Ag Apolloni, *Mesjeta ime*, "Bard Books", Prishtinë, 2019, fq. 23.

fiksion¹³ por sikur na *kërkon të bashkëpunojmë me të dhe t'i rrimë gati lojës së tij.* (Eco, 1996:465)

Lojën e nis që në titull sepse titulli duhet “*që t'i ngatërrojë idetë, jo që t'i verë në rregull si ushtarë.*” (Eco, 1996:450) Dykuptimësia (a më shumë) dhe kontrasti shtrihet në të gjithë veprën.

Loja vazhdon me *ngatërrimin* e qëllimshëm të *perspektivës rrëfyese* për të hutuar paksa lexuesin, por edhe për ta argëtuar:

Rrëfim në vetën e parë: “*E, nëse për ta befasuar gjenetikën, jetoj më shumë se të fortët e familjes, atëherë s'më mbetet tjetër të them, pos të kërkoj falje (...): më falni që s'kam vdekë*”.¹⁴

Rrëfim në vetën e tretë: “*Fëmija, sapo doli, ia nisi vajit, thuajse kishte lexuar Shakespeare-n: qajmë sepse e kuptojmë që kemi ardhur në një skenë përplot me budallenj. Tash që kishte dalë, kthim mbrapa s'kishte.*”¹⁵

Në dy situatat e cituara, bëhen të turbullta edhe marrëdhëniet mes fakticitetit dhe fiksionalitetit (ku nis njëri e ku mbaron tjetri?), që e ngacmojnë lexuesin dhe e bëjnë të shkojë me një kuriozitet të shtuar drejt fundit të librit.

Në funksion të parimit të kodifikimit të dyfishtë është edhe pranëvënia e kodeve të larta me ato popullore përmes kontrasteve. Simbolikisht, këtë e shohim edhe te leksiku, që nis nga ai vulgar a komik, tek ai sublim:

<p>“<i>..në Gjurgjurdell njerëzit ishin trefish vulgar (...)</i> Nuk ishte çudi të dëgjoje fjalë të tilla edhe kur i shihje duke biseduar nënë e bir (A s'ta mbajti bitha o bir me ia thanë nja di llafe, a?)” (f. 27)</p>	<p>“<i>Ne jemi persona, por nuk jemi njerëz. Dhe çka është njeriu? Një shpirt i maskuar me formën e një trupi. Por, kjo maskë ka edhe kuptimin e burgut. Unë jam burgu që ec. Brenda meje është shpirti që mund të fluturojë, pas daljes nga burgu.</i>” (f. 82)</p>
--	--

Apo edhe ndërputja e sentencave në latinisht, si diskurs elitar në mesjetë: *Sine nomine / Post tenebras spero lucem/ Nomen est omen/*

¹³ Sepse, sipas Genette, narrateri ndodhet vetëm brenda rrëfimit fiksional. Ai dallon nga lexuesi. Narrateri është lexuesi fiksional që bashkëpunon në rrëfim.

¹⁴ Ag Apolloni, *Mesjeta ime*, “Bard Books”, Prishtinë, 2019, fq. 9.

¹⁵ Ag Apolloni, *Mesjeta ime*, “Bard Books”, Prishtinë, 2019, fq. 13.

Hora fugit/ Ubi dubium, ibi libertas / Quo vadis?, etj.

Ndarjen kod i lartë/popullor, autori e shënon edhe kur përmend klasën politike dhe atë intelektuale, duke ironizuar hierarkinë: “Nganjëherë kam qejf t’i takoj liderët tanë e t’ua them në fytyrë ato që mendoj, por ata janë larg në hierarkinë politike sa unë asnjëherë s’mund t’i arrij për t’i takuar dhe janë aq poshtë për nga edukimi sa s’më lë kurrizi të përkulem për të diskutuar.” (f. 92)

Për ta pasuruar rrëfimin, autori ndërfton në tekst disa tipe diskursesh: atë shkencor, kur shpjegon të dhënat historike apo etimologjike etj.; të përrallës (“Na ishte njëherë viti i largët 1982”); të ditarit (“Një ditë qershori të vitit 2013”; “Sot u zgjova, si çdo ditë..”); të legjendës (“Maksutin e konsideronin të çartur, të trentë, gati se përbindësh. Thoshin se i rrihte meshkujt dhe femrat”); të politikës (“Xhelatët kanë ndryshuar, populli ka mbetur prapë viktimë. Nga një vend që kërkonte me guxim të njihej si republikë, vendi ynë është kthyer në labirint të frikës”); diskursin ideologjik (“Ne jetojmë në epokën e virtualitetit, kur më e rëndësishme është të jesh i famshëm, sesa i vlefshëm. Më e rëndësishme është të dukesh i dijshtëm, sesa të jesh i tillë”), etj.

Gjithashtu, shohim të inkorporuar në vepër edhe forma të tjera letrare, si poezia (kur citon vargje por edhe poezi të plota) apo elemente të dramës si dialogun, monologun por edhe didaskalizma:

<p>Gjyshja: Çka t'i kanë ba librës n'Shkup?</p> <p>Unë: ma kanë përkthly'.</p> <p>(...)</p> <p>Gjyshja: E ti qysh e lexon?</p> <p>Unë: Unë e lexoj shqip.</p> <p>Gjyshja: E pse ta kanë marrë librën?</p> <p>Unë: Se kanë qejf me lexu'edhe ata naj sen t'mirë.</p> <p>Gjyshja: Eh, fare dalshin!" (f.112)</p>	<p>"Ja do t'ia ndërrojmë emrin, ja çojeni fëmijën ku të doni! Pauzë. Heshtje e gjatë. Buzë të kyçura. Kollitje të shtirura. Litari fillon të shtendoset kur nisin të hidhen propozime për zëvendësimin e emrit." (f.15)</p>	<p>"Të jem, apo të mos jem? Të jem siç jam, apo të bëhem ndryshe? Të jetoj, apo të vdes? Të jem në luftë me të tjerët dhe në paqe me vetveten? Të jem në paqe me të tjerët dhe në luftë me vetveten? Të jem në luftë me vetveten dhe me të tjerët? Të jem në paqe me vetveten dhe të tjerët? I kam provuar të gjitha, por ende nuk e di cila ka qenë e duhura."(f.90)</p>
--	---	---

Gërshetimi i komikes me tragjiken duket një *mjet* i preferuar i Apollonit tek ndërton arkitekturën e veprës. Përmes kontrastit, ai e ka sjellë estetikisht bukur gjendjen personale dhe social-politike të Kosovës: nga bashkëjetesa me njerëzit *e vulgut* deri te humbjet e njerëzve dhe humbja e njerëzores; nga dehja në dhe për dije, te mospranimi i dijes; nga udhëtimet e tij nëpër botë (veço udhëtimet 'jo fizike') te *kthimet* në Kosovë etj.

Situatat komike e ironike (edhe autoironia), që vijnë aq natyrshëm bashkë me detajet biografike, i japin rrëfimit një ritëm të këndshëm dhe lexuesit një kënaqësi të veçantë:

- "Po t'u thuash që Shakespeare ka lindur në Stratford (mbi Avon), ndalen në dy shkronjat e para të vendlindjes së tij dhe e lidhin Stratfordin me Stagovë. Unë mendoj se aty mund të mbyllej edhe Çështja homerike: një njeri pa sy që krijoi vepra më të mëdha se të atyre më dy sy, çfarë mund të ishte nëse jo stagovali?" (f. 24)
- "Disa fshatarë nga Stagova janë regjistruar në divizionin nazist SS Skanderbeg vetëm se u pëlqenin rrobat Hugo Boss, që i vishte

ushtria e Hitlerit. (...) Pavarësisht se disa iu bashkuan Hitlerit, stagovalitë kurrë s'i dorëzuan hebrenjtë. Me Hitlerin i lidhte moda, me hebrenjtë i lidhte mendja." (f. 25)

- *"Nëse flet pak e pi shumë, ti je stagovali; nëse i do femrat dhe librat, ti je stagovali; (...) nëse i do shetitjet dhe sherret, ti je stagovali; nëse je i huptë dhe mban kryet lart, ti je stagovali; nëse me krye mendon e godet, ti je stagovali; nëse me një vesh nuk ndien dhe me tjetrin s'do me ndi', atëherë ti je stagovali."* (f. 25-26)
- *"I lindur mes këtyre dy fshatrave, unë mund të kem marrë diçka nga të dy anët: nga të çarturit dhe nga çërkuzat; nga heshtakët dhe nga llafazanët; nga punëtorët dhe nga dembelët; nga tragjikët dhe nga komikët, me shpresë se s'do të jem shartim tragjikomik."* (f. 26)

Ndërsa, përmes ndodhive tragjike, si çlirim edhe i vetvetes, autori reflekton mbi rëndësinë që i duhet kushtuar kohës dhe asaj çfarë na rrethon: *"E di që jam përkohësisht në këtë botë, e di që një ditë do të largohem, e di që kjo botë është burg prej të cilit askush s'del i gjallë. (...) Ne të gjithë jemi vrasës. Vrasim kohën, vrasim mendjen, vrasim tjetrin, vrasim veten, pastaj na varrosin."*¹⁶

Prania e filozofisë fataliste (por që sfidohet) është e shfaqur te prezenca e fjalës "dëshpërim" në fund të çdo kapitulli, përveçse në:

"Ulalume", "Persona" dhe "Via":

"Sa dëshpërohem kur kujtoj.." (nga "Obscura");

"..nisa ta thur dëshpërimin tim" (nga "Vulgus");

"..ngjitem shkallëve të dëshpërimit.." (nga "Doctrina");

"..pelegrini është një i dëshpëruar që shëtit.." (nga "Pelegrin");

"Ëndrrat janë...shteg për t'i ikur dëshpërimit tonë."

(nga "Allegoria");

"..na ka mbetur vetëm hiri i dëshpërimit" (nga "Schisma");

"..dëshpërimi çel zogj në zemrën time" (nga "Templarius");

"Si mund të mos jesh i dëshpëruar..." (nga "Inquisitio");

"vonesa nuk e vret dëshpërimin" (nga "Memento").

Merr një rëndësi të posaçme në vepër edhe vënia përballë e lokales me universalen: *genius loci* që duhet mbajtur gjallë është *shpirti i vendit* që shkon te të gjithë; nga njohja e vetvetes shkohet drejt njohjes së botës. Nga lokalja synohet të shkohet tek universalja. Ky synim është

¹⁶ Ag Apolloni, *Mesjeta ime*, "Bard Books", Prishtinë, 2019, fq. 113.

i shpërndarë nëpër të gjithë veprën në forma të ndryshme duke përdorur antiteza, metafora, metonimi, ironi, parodi etj.

Duhet përmendur se, një ndër arsytet pse vepra ka ngjallur interes të gjerë dhe reagime të ndryshme është për faktin se aty artikuloohen qartë e prerë gjendja politike e vendit dhe problemet shoqërore që vijnë si rrjedhojë e saj. Duke ua zbuluar lexuesve të vërtetat hapur, që nuk e ka bërë *kështu* askush më parë dhe, duke ironizuar paradokset e aktualitetit që e jetojnë të gjithë bashkë, Apolloni merr pas vetes të ngjashmit e tij duke iu treguar rrugën e përmirësimit: “*Kërkimi është njohje, kurse njohja është pushtet dhe shpëtim, por jo pushtim.*” (f. 57) Për ata që nuk duan të dëgjojnë se “*maska e artistit ua heq maskën të tjerëve*” (drita), ai i lë të jetojnë në “*epokën e bythës*” ku “*truri duhet të zbythet*” (errësira/ mesjeta).

Ajo që pastron e pasuron mendjen është kultura. Prania e një enciklopedie kulturore në roman, e inkorporuar aq bukur në rrëfim, është një vlerë e padiskutueshme që ka vepra *Mesjeta ime*. Ja pse autori “*nuk lexon vepra “originale” të shkrimtarëve që për vete nuk lexojnë dhe ka frikë nga njerëzit që lexojnë vetëm një libër.*”

4. *Memoria*

Në këtë vepër, kujtesa nuk lidhet drejtpërdrejt me të kujtuarit e episodeve të ndryshme nga jeta e Ag Apollonit. Ndoshta kështu duket se synon të na tregojë autori, i cili e përforcon këtë synim duke vënë nëntitullin “*Confessiones*”. Por, në fakt kujtesa lidhet më së shumti me njohjen, erudicionin, ku për këtë të fundit do të flasim sërish në pjesën e fundit të kësaj sprove.

Ndërtimi i tekstit në terësi, apo siç shprehet autori *thurja*, do të thonim se realizohet në një mënyrë mjeshtërore duke gërshëtuar përvojën personale me kujtesën kulturore.

Enciklopedia autoriale zgjedh të shfaqet në dy forma: edhe *brenda* rrëfimit, nëse mund ta quajmë kështu por edhe *jashtë* rrëfimit, tek fusnotat. Tek këto të fundit gjejmë emra autorësh e tituj veprash, emra këngëtarësh e tituj këngësh, përkthime vargjesh apo fjalish, shënime sqaruese por edhe ironizuese, përmenden emra realë bashkëkohësish të autorit, tregohen anekdota etj. Në të gjithë librin numërohen 70 fusnota, nga ku “*Vulgus*” mban numrin më të lartë të tyre ndërsa “*Allegoria*” dhe “*Templarius*”, duke mos pasur (kupto: dashur) çfarë të sqarohet, kanë zero footnotes. Kurse, brenda rrëfimit janë të përmendur mbi njëqind

emra autorësh/veprash që nuk i përkasin vetëm letërsisë artistike. Në rrëfim gjejmë edhe tituj filmash; këngëtarë e tekste këngësh; mbi njëzet emra bashkëkohësish të tij etj.

Citimet/emrat e përfshirë në tekst kanë arsye të ndryshme përdorimi: disa për të dhënë një gjurmë, disa për të shënuar një kuptim, disa për të shtuar (jo hequr) një mister, disa për të përforcuar një mendim, disa për t'i nderuar, disa për t'i sulmuar, disa i përdor si bashkëlojtarë e disa si spektatorë, disa si aleatë e disa si kundërshtarë, disa i përdor për t'u argëtuar e disa për të shpërthyer dëshpërimin etj. E të gjitha këto truke e mësimë të marra së bashku, kërkon t'i përcjellë tek lexuesi, me shpresën që ta edukojë (në kuptimin më të gjerë të fjalës) pa harruar edhe ta argëtojë.

5. *Pronuntiatio*

Zakonisht, kur flasim për një vepër letrare, ne me të drejtë i kushtojmë rëndësi primare brendisë dhe nuk na intereson shumë se si do të vijë deri te ne përmbajtja (edhe pse ende ka lexues që librat e tyre i përzgjedhin vetëm duke parë kopertinën). Kohët kanë ndryshuar dhe tashmë në industrinë e biznesit të librit, paraqitja fizike e grafike (veçanërisht kopertina) merr rëndësinë e saj, ashtu siç edhe marketingu.

Mbasi ke përfunduar së lexuari një vepër si “*Mesjeta ime*”, libër me 120 faqe, ku ke parë se autori ka treguar *maninë* prej perfeksionisti që të ishte gjithçka e mirëllogaritur (deri edhe në numerologji) në përcjelljen e mesazhit (mesazheve), ke kuriozitet të shohësh se çfarë pune është bërë me një detaj të fundit: kopertinën.¹⁷ Në rastin e Apollonit ne shohim se ai ka zgjedhur ngjyrat e konceptit e dualizmit *Yin and yang*, ku forca të kundërta plotësojnë njëra-tjetrën¹⁸; ku bashkëjeton errësira dhe drita, e mira dhe e keqja, diversiteti i mendimit etj. Mburoja (kupto edhe maska) e Athinës, perëndia olimpike e mençurisë (dhe mjeshtre e thurjes) si përkrenare është përzgjedhur të vihet në kopertinë gjithashtu. Kontrasti dhe double-coding-u e kanë dominuar veprën dhe domosdoshmërisht, autori, punën me *gjetjet* duhej ta çonte deri në fund. E nuk zhgënjeu.

Për të përcjellë librin te lexuesi, autori nuk ka zgjedhur rrugën e *heshtjes*¹⁹. Një ndër arsyet, përveç të tjerash, është edhe provokimi që

¹⁷ Këto elemente, Genette i quan paratekste. Natyrisht, kopertina shihet para se të fillojë leximi i veprës, por ‘studiohet’ edhe një herë pas leximit, e sidomos për një vepër si *Mesjeta ime*, ku titulli, fillimisht, çonte në shtigje të tjera.

¹⁸ Në shkrimet e Apollonit preferohet dikotomia Dionis-Apollon.

¹⁹ Disa shkrimtarë nuk i parapëlqejnë promovimet dhe kanë deklaruar hapur se i

ngjall si vepër duke qenë se artikulon reflektime kundrejt politikës dhe dukurive sociale që e shqetësojnë autorin. Apolloni ka ndjekur rrugën e dialogimit, (i vetëdijshëm për veprën e hapur) me lexuesin në forma të ndryshme: përmes përrimit (një në Kaçanik e një në Prishtinë), dhënies së intervistave në televizione dhe përmes komenteve për reagimet që vepra shkaktoi.


III. ROMAN-À-CLEF

*Roman-à-clef*²⁰ është një term francez i krijuar nga Madeleine de Scudéry në shek. XVII, i cili i referohet një “romani-çelës”, brenda të cilit rrëfohen ngjarje të vërteta të “mbuluara” me një fasadë fikcioni. Emrat që përfshihen në rrëfim janë të vërtetë dhe “çelësi” është pikërisht lidhja mes fakticitetit dhe fikcionit. Ky çelës metaforik mund të jetë i qartë ose i fshehur nëpër epigrafe apo teknika të tjera narrative. (Merriam – Eëbster Dictionary)

Te *Mesjeta ime* ndodh diçka tjetër: është rrëfimi autobiografik që ‘mbulon’ pjesën fikzionale. Në nivelin e parë të rrëfimit pamë se si autori Ag Apolloni ka shkruar një libër me ese autobiografike. Ndërsa, në nivelin e dytë, kemi një narrator autodiegjetik (sepse është protagonist i *ngjarjeve*) i cili rrëfen për një udhëtim trashendental në 35 vitet e jetës ku gjatë *rrugës*, ai “transformohet” në disa personazhe, derisa në fund njeh vetveten.

Pyesim: Si e ka ndërtuar Apolloni këtë botë fikzionale? Ku qëndron ky *çelës* i roman-à-clef?

Ne mendojmë se *çelësi* qëndron në këtë trini: prologu “*Ulalume*”, mesi i veprës “*Allegoria*” dhe epilogu “*Via*”. Pikërisht prej këtu zbulohet një botë tjetër rrëfimi ku ka *fshehtësi*, *ankth krijues* dhe *profeci*.²¹



urrejnë intervistat.

²⁰ Për më shumë, shih: Brian McHale, *Postmodernist fiction*, “Routledge”, New York, 1994.

²¹ Shih: Hysni Hoxha (ed.), *Çështje të romanit*, “Rilindja”, Prishtinë, 1980, fq. 315.

Te *Mesjeta ime*, në pamje të parë, duket se është krejt i identifikueshëm autori si i vetmi narrator autodiegetik i rrëfimit të tij. Ka raste kur e vë në dukje direkt: “*Meqënëse është natyra egocentrike e esesë që ta shfaqë herë pas here, nëse jo përherë, autorin e saj, më duhet ta pranoj se...*”²² Por, ai nuk donte vetëm kaq; nuk ishte në kërkim të një autobiografie për të treguar kush është Ag Apolloni por, siç e kemi cekur, po kërkonte të shfrytëzonte autobiografinë për një *modus operandi* tjetër.

Për të realizuar këtë i duheshin “disa personazhe” që të fshihej pas tyre dhe kështu do të ishte “i çliruar nga dyshimet, por jo prej jehonash ndërtekstuale.” (Eco, 1996:454) Ndaj dhe bën një gjetje shumë elegante: autori i *Mesjeta ime* projektohet nëpër “personazhet” e tij përmes fjalës.²³ “*Ai vendos që të bëjë të thotë “unë” atë personazh që nuk është më krejt i përputhshëm me veten e tij, por as nuk është plotësisht një person tjetër.*” (Genette:1976:297) Ndaj edhe thotë: “*Unë nëpërmjet personazheve të mia, u shumëfishova për ta ndier vetveten.*”²⁴ Këtu lexojmë, veç të tjerash, edhe marrëdhënien e vështirë që ka me veten. Prandaj edhe projektimi në instanca si autor-narrator-personazh rezulton zgjidhja më e mirë për të *përballuar gërricjen* e brendshme.

Nëse Dante e përjetoi *kthesën* në Rrugën e Damaskut, ai e përjetoi në Delfi; ai lindi kur ishin bërë 150 vite nga vdekja e Goethe-s; ai kishte lindur në një ditë me *diellku nomen est omen*; ai nuk kishte dalë nga koka e Zeusit, si Athena; kishte një baba me sindromën e Uliksit dhe nënën me sindromën e Penelopës; ai ishte një nga ‘tartarugat’ e profesorit të pikurës: Da Vinci; nëse për Hesse-n dhe Kazantzakis-in jeta ishte rrugë, për të rruga t’i mëson të gjitha; edhe ai udhëton me kalë si Don Kishoti; ai mbante zjarrin në dorë si Prometeu; e sheh në ëndërr George Bernard Shaw duke dhënë mësim në fakultetin e tij; është rritur me Kapuçkuqin, që ngjan si aktor i shfaqjeve të Shakespeare-it; ashtu si Pessoa, u shumëfishua nëpërmjet personazheve për ta ndier vetveten. Ky projektim i autorit²⁵ nëpër ‘personazhet’ e tjerë, i shfrytëzuar si mjet (“*këto janë gjëra të zakonshme në studion e një shkrimtari*”²⁶) është paraqitur prej nesh në grafikun e mëposhtëm:

²² Ag Apolloni, *Mesjeta ime*, “Bard Books”, Prishtinë, 2019, fq. 57.

²³ Të gjitha nënvizimet e fjalëve në vijim janë për këtë qëllim.

²⁴ Ag Apolloni, *Mesjeta ime*, “Bard Books”, Prishtinë, 2019, fq. 76.

²⁵ “*Ai është i ndarë në shumë mendje, në shumë personalitete, përndryshe, si do të mund të krijonte?*”, në: *Mesjeta ime*, fq. 86.

²⁶ Ag Apolloni, *Mesjeta ime*, “Bard Books”, Prishtinë, 2019, fq. 79.



Përmendim që ky grafik nuk është shterues dhe mund të ngushtohet/zgjerohet edhe më shumë. Përmes këtyre “personazheve” në *aksion*, autori e thur tekstin e tij, tekst i cili ka shtresa dhe kuptime të shumtë.

“*Mesjeta ime*” ka si nëntitull përcaktimin “*Confessiones*”, por, siç autori na shpjegon: “*Unë nuk rrëfej mëkatet, por ankthet*” sepse ai nuk është admirues i *lojës* së teatrit kristian si Agustini e Tolstoj por, “*admirues i teatrit athinas dhe eleuzinian*”. Loja që preferon protagonistin lidhet me misterin, jo me rrëfimet. Më tej, autori vazhdon të shpjegojë titullin e librit, sipas të cilit ka dy kuptime: shpreh një dëshmi dhe një dëshirë. Dëshmia përfaqësohet nga të dhënat autobiografike, dëshira përfaqësohet nga *profecia* që ulurima parnasiane (apo e origjinës) do të flasë; edhe pse në mes të pyllit, do të gjejë “shtëpinë e qënies” dhe rrugëtimi drejt dritës do të vazhdojë pikërisht për të ndërtuar tempullin që të mbajë veç emrin e vet, *Apolloni*.

Nëse për Dante-n “mesi i jetës së tij ishte 28” dhe jo 35, kur “iu shfaq vizioni dhe nisi ta shkruajë Komedinë hyjnore”, tek numri 35 si moshë e mesit të jetës lexojmë ankthin e vonesës (si krijues) të autorit.

Tek ëndrra me George Bernard Shaë dhe tek zgjedhja e tij që kësaj radhe të mos tallej me fjalë por me paraqitje ne shohim aty një udhëzim se si duhet lexuar fiksionalja: përmes lojës. Forma është loja, serioz është mesazhi.

Në këtë linjë është edhe rrëfimi për poezinë “dadaiste” që i tregonte gjyshja: fillimin që e kishte mashtues (si titulli “*Mesjeta*” apo

‘*confessiones*’ të mëkateve), kapuçkuqi zhduket (lojcaku që fshihet), pastaj nis Tomi e Xheri (loja autor-lexues). *Paralajmërimi* që jep në këtë rast *protagonisti* ynë është se nëse do të luash, loja nis pas disa leximesh, jo vetëm me një lexim. (“*Kur e dëgjoja të përsëritur*”).

“*Ju të gjithë thoni ‘pse?’ , kurse unë them ‘Pse jo?’*”²⁷- është llogaria që ai i jep lexuesit që e ka kuptuar lojën.

Sa i takon epilogut “*Via*”, vetë autori është shprehur se: “...është *krejt filozofik dhe simbolik, është më i shkurtri, por është më i rëndi, më i vështiri për t’u kuptuar*”²⁸ Duke qenë tekst i hapur, çdo lexues gjen një alternativë ndryshe interpretimi. Për disa, “*Via*” mund të merret edhe si shenjë dorëzimi. Mirëpo, ne mendojmë se duke përdorur auto-ironinë: “*më duket se bashkë me gjysmën e jetës, më ka ikur edhe gjysma e trurit*”, protagonistin e ka mundur errësirën: “*Nisem drejt dritës.*” Ashtu edhe autori, shkrimtari dhe intelektual Apolloni arrin të sfidojë *errësirën mesjetare* të Kosovës duke u *iluminuar* përmes asaj që më së shumti do: letërsisë/artit.

Në funksion të roman-à-clef është edhe përdorimi që i bëhet erudicionit, për hir të receptimit. Titulli i veprës *Mesjeta ime* i bëri lexuesit të mendonin se kishin vetëm dy opsione: se do të lexonin ndonjë histori personale (ndoshta të errët) ose do të lexonin “disa” histori mbi mesjetën dhe çfarë e shoqëroi atë. Të dy këto opsione dolën të pavlefshëm. Të njëjtën gjë mund të themi edhe sa i takon erudicionit: nuk kemi të bëjmë vetëm me shfaqje të parapëlqimeve autoriale, apo me një *paradë* njohurish por, me një strategji rrëfimi. “*Tash duhet të dish të lexosh, përveç librit, edhe filmin, muzikën, pikturën, arkitekturën dhe krejt kulturën, krejt jetën. Ne udhëtojmë nëpër pyje semiotike. Po s’ditëm t’i lexojmë shenjat, jemi të humbur.*”²⁹

Nëse i ndjekim me kujdes nga fillimi deri në fund, citimet *brenda* rrëfimit dhe *jashtë* tij (fusnotat) lidhen më së shumti me: letërsinë/filozofinë, me teatrin/filmin, me muzikën, me përkthimet dhe me përmendjen e paraardhësve dhe bashkëkohësve të autorit. Ne e kemi paraqitur me një skemë se si e shohim në një përdorim të mundshëm të kësaj strategjie të shpërfaqjes së erudicionit në tekst:

²⁷ Ag Apolloni, *Mesjeta ime*, “Bard Books”, Prishtinë, 2019, fq. 72.

²⁸ Ag Apolloni i ftuar në emisionin “Express” në Koha Vizion më 27.02.2019 në Kosovë. Link: <https://www.youtube.com/watch?v=8qMbtvirAyQ>

²⁹ Ag Apolloni, *Mesjeta ime*, “Bard Books”, Prishtinë, 2019, fq. 58.



Letërsia si frymëzim e kuptim i jetës; piktura është arti, e bukura; muzika që dikton ritmin e fazave të ndryshme të jetës; teatri/filmi si dëshira e nevoja të mos harrojmë lojën e aventurën; përkthimet si nevojë të përjetshme për dialogim, qoftë edhe si “*traduttore traditore*” dhe të gjitha këto e bëjnë rrugëtimin e jetës më domethënës, qoftë si përjetim e qoftë si histori për t’ia rrëfyer të tjerëve: “*Dua të lë diçka këtu që t’i mbulojë shpenzimet e mia për qëndrimin tim si mysafir në tokë.*”³⁰

Duke ia rrëfyer të tjerëve, Ag Apolloni, i cili është edhe pedagog përveçse shkrimtar, kërkon të japë mësimin e jetës: se gjetja e vetvetes është liria; te liria duhet kërkuar e bukura; se jo çdo fazë e jetës ka të njëjtin ritëm, por gjithmonë duhet ta ndjekësh; se duhet të njohim, pranojmë e të mësojmë ta luajmë lojën e të argëtohem (edhe kur na e luajnë lojën); se vetëm me dije dhe kulturë mësojmë si të bashkëjetojmë me të ndryshmin tonë.

* * *

Në trajtë përfundimi mund të themi se *Mesjeta ime* është një vepër ku luhet kukafshehthi mes autorit dhe lexuesit. Një arkitekturë e tillë e veprës ku artikulimi i pjesëve bëhet përmes kamuflazhit dhe loja bëhet me fjalët në vetvete, flet për vlerë estetike dhe kënaqësi leximi njëkohësisht. Gërshetimi i dy niveleve të rrëfimit që na vjen si *dëshmi* e *dëshirë*, është realizuar me një gjuhë të pasur figurative dhe përmes njohjes së thellë të teorisë.

³⁰ Ag Apolloni, *Mesjeta ime*, “Bard Books”, Prishtinë, 2019, fq. 113.

Natyrisht, ky është një lexim jo shterues dhe më shumë nxitës, që duhet plotësuar edhe më tej. *Mesjeta ime* është nga ato vepra që sapa e mbyll, mbetet e hapur për shumë interpretime dhe përballon çdo teori të kritikës letrare: që nga ato strukturaliste e deri tek ato të receptimit. Këto janë tipare të një letërsie cilësore.

Trinia *Ulalume-Allegoria-Via* e klasifikon veprën si roman-à-clef, sepse aty na tregohet se në fund të fundit, pavarësisht të gjitha të vërtetave që rrëfohen brenda, ky është një libër kushtuar frymëzimit, krijimit dhe subjektit krijues, pra vetëm letërsisë. Autobiografia si rrëfim dhe erudicioni si mjet ishin thjesht mburoja, maska që humbte gjurmët e fiksionit; ishin thjesht *skena* ku u zhvillua shfaqja, *loja*. Kjo është mënyra odisejake për të lënë *shpellën*. Fiksioni i duhej veprës, sepse “*në jetë lejohet pak gjë, në roman gjithçka.*” (Dibra, 2004:3)

Nëse sprova jonë konsiderohet *fajto*, ne e lemë Todorov-in të përgjigjet: “*Nëse autori mund të mos e kuptonte aq mirë atë që ishte duke shkruar, këtë e dinte tregimi.*” (Todorov, 2000:73)

Literatura:

1. APOLLONI, Ag: “*Autobiografia amorfe*”, në: Revista “*Symbol*”, nr.13, Tiranë-Prishtinë-Shkup, 2018.
 2. APOLLONI, Ag: *Zomb*, “BardBooks”, Prishtinë, 2019.
 3. APOLLONI, Ag: *Ulurima e ujkut*, “BardBooks”, Prishtinë, 2019.
 4. BOOTH, Wayne C.: *The Rhetoric of Fiction*, “The University of Chicago Press”, Chicago, 1982.
 5. DIBRA, Ridvan: *Kumte dashurie*, “Dudaj”, Tiranë, 2004.
 6. ECO, Umberto: *Lector in fabula*, “Bompiani”, Milano, 2010.
 7. ECO, Umberto: *Emri i trëndafil*, “Elena Gjika”, Tiranë, 1996.
 8. GENETTE, Gérard: *Figures of literary discourse*, “Columbia University Press”, New York, 1982.
 9. GENETTE, Gérard: *Figure III. Discorso del racconto*, “Einaudi”, Torino, 1976.
 10. HOXHA, Hysni (ed.): *Çështje të romanit*, “Rilindja”, Prishtinë, 1980.
- JAHA, Besnik: “*‘Mesjeta ime’ e Ag Apollonit dhe Mesjeta jonë*”, në: www.kultplus.com
- McHALE, BRIAN: *Postmodernist fiction*, “Routledge”, New York, 1994.
- TODOROV, Tzvetan: *Poetika e prozës*, “Panteon”, Tiranë, 2000.

(Footnotes)

- 1 Ag Apolloni, *Ulurima e ujkut*, “Bard Books”, Prishtinë, 2019, fq. 9.

▪ Kritikë teatri ▪

Gëzim PUKA

DRAMA E JETËS SË LEKË TASIT DHE “ARKA E NOES”

Ndodh në Shkodër, në një mbrëmje gushti, të meditosh rreth një sprove teatrore në oborin e një shtëpie të vjetër ku mbijeton një shoqatë me emrin “Arka”, e cila promovon më së miri kulturën e patjetërsueshme të këtij qyteti.

Kësaj here është Lekë Tasi, një artist shqiptar 90 vjeçar, që ka bujtur me monodramën e jetës së tij skenarisht e përcjellë nga Stefan Çapaliku dhe Ledjan Gjeçi. Ajo që binte në sy, ishte edhe instalacioni dhe skenografia interesante e artistit pamor Ergys Velaj.

Shikuesit ishin aty për të ëndërruar ndalesën e kohës, që ngjet vetëm në Shkodrën shtëpi lindjeje e teatrit shqiptar, pikërisht në bahçe dhe oborre të tilla, ku luhej me shtregulla dhe ku elementet e para të ekzibicionizmave teatrale do të bëheshin fillesa e teatrit tonë.

Nën tingujt e një instrumentaleje që nxit të njëjtën gjatësi vale për galopin e zemrave të shikuesve, përqark oborrit, nis një rrëfim zanafillor, siç është ai i Arkës së Noes nga Testamenti i Vjetër.

“Përmbytja është një ngjarje e vërtetë. Perëndia e solli Përmbytjen për shkak të degradimit moral që kishte marrë dhenë disa breza mbasi Adami dhe Eva ishin dëbuar nga parajsja. I zemëruar Zoti thirri Noenë, të vetmin që kishte mbetur besnik dhe i virtytshëm. Ai i komunikoi Noes vendimin e tij që do të shkatërronte të ligjtë, sepse për shkak të njeriut

ishte prishur edhe Toka. Por Zoti kishte vendosur ta ruante Noen me gjithë familjen, si dhe gjithë gjallesat. Ndaj e urdhëroi të ndërtonte një varkë të madhe ku të futeshin të gjithë, Noeja me gruan, tre djemtë me nuset, dhe nga një çift të secilës specie, për të vijuar ekzistencën.

Noeja u bind. Ndërtoi varkën simbas përmasave që i dha Zoti, dhe kur erdhi momenti, hyri brenda me gjithë farën vijuese nga e cila kemi rrjedhur edhe ne”.

Me një lëvizje qarkore narratori-aktor, Ledjan Gjeçi, rrëfen parabolën biblike përreth një varke dekor brenda së cilës gjenden disa të rinj figurantë me jelekë shpëtimi dhe maska, duke pritur ardhjen e një kapiteni rrëfimtar me një ligjërim ngjethës, për të zënë vend në bashin e saj. Aty vendoset paradoksalisht Noe-ja ynë, Lekë Tasi, një artist pamor, muzikant, shkrimtar, njeri i kulturës dhe i filozofisë, që gjithë jetën udhëtoi me mend dhe asnjëherë me trup. I lindur më 1929, punoi për 15 vjet si violonçelist në orkestrën shtetërore të Operës, më vonë u internua për 15 vjet të tjerë në një fshat të humbur dhe mbas rënies së komunizmit iu përkushtuar vetëm artit. Nga zëri i tij i qetë dhe nga nyjëtimi i një toskërishteje të kulluar, befasohemi se si ky “botëkrijues”, ka ruajtur dhe poetizuar vuajtjen. Arti dhe vuajtja janë tema e kësaj performance teatrore. Makabritetet e diktaturës rrëfohen përmes një lirizmi stilistik dhe duket se arrijnë mrekullisht tek marrësit më të mirë të mundshëm të mesazhit katharsisndjellës. Pikërisht ky është qëllimi i kapitenit plak në “Arkën e Noes 2”. Kështu rrëfimi i madh biblik për qark rrëfimit të vogël njerëzor ironikisht prodhon një frikë dhe mëshirë po aq ironike ndër ne, spektatorët zullumqarë të epokës pandemike.

Ja si përshkruhet nisja drejt internimit:

“Data 15 erdhi me shi. Nisja u bë nën mbikëqyrjen e Këshillit të Lagjes dhe të oficerëve të rajonit. Nga ora tetë mbaruam me bartjen e plaçkave. Makina u mbush. Siguruam mamanë midis shoferit dhe shefit të rajonit që do na përcillte deri në destinacion dhe vetë hipëm në karroceri: Unë, im vëlla Ylli dhe e shoqja. Aty u ul dhe polici i armatosur që na ruante.

Kështu me shiun përjashta dhe me gjithë katandinë tonë brenda në atë kub lëvizës, u nisëm ngadalë drejt jetës së re. Hymë në Grabjan në orën kur dilnin fëmijët nga shkolla”.

Kësaj here teatri i Çapalikut na propozon njeriun, krijesën më të dashur të artit të skenës. Madhërohet vuajtja dhe adhurohet krijimi. Ajo që bën përshtypje veç muzikës janë edhe pikturat e autorit të projektuara

në sfond. Ndjeshmëria për muzikën, puna fizike, burgimi i motrës, demaskimi në lokalitet, brohoritjet, përpunimi dhe presioni psikologjik. E gjithë kjo brendi e njëmendtë vjen përmes një ligjërimi të paqtë për atë diktaturë, që është e dënuar estetikisht më ironinë kallëzimore.

Sprova teatrore e Çapalikut rimbështet idenë se njeriu mund të kryejë dy lloj ikjesh apo eksodesh. Një arrati me trup dhe një arrati me mend. Ngandonjëherë ato gjenden edhe të kombinuara, por shpesh janë të ndara. Vihet re një raport i zhdrejtë në to. Sa më i izoluar fizikisht që të jetë njeriu, aq më i madh shansi, që të emigrojë me mend. Ky mbase është kushti i parë i eksodit me mend. Kushti i dytë për ekzod ka lidhje me dijen. Sa më i ditur të jetë personi i izoluar, aq më e largët arratia e tij.

Në vendin tonë që ka jetuar gjysmë shekulli izolim, ka shumë njerëz të arratisur me mend, njerëz që shoqëria i thërret “ëndrrimtarë” apo edhe “të humbur”. Ka madje prej tyre që nuk ikën dot me trup as mbas viteve '90. Disa ishin të varfër, disa të pamundur fizikisht, disa të tjerë i kishte zaptuar nga një farë dembelie.

Në lidhjen e dy teksteve na mbin një tjetër shenjë kuptimore, ajo e përballjes me realitetin, madje fërkimi mes historisë zanafillore dhe aktualitetit politik. Patjetër që këtu ndikon edhe stili, pikat e referimit, përvoja e grumbulluar gjatë dhjetëvjeçarëve të punës në teatër. Është një estetikë e përpunuar. “E hershmja” origjina dhe “e tashmja” ose aktualiteti, që të dyja pas një katastrofe, janë në të njëjtën kohë një rënie e sistemit shenjor, me të cilin është ndërtuar bota. Strategjia autoriale dhe shenja skenike e varkës së ndalur në tokë na rikthen në mendje përmes kësaj yjesie objektivitet, gjestesh, lidhjesh kuptimore e më për më tepër referencash, tek një përvijim i qëndrueshëm, drejt një përmase ëndrrimtare.

Kjo ishte gjendja tragjike që prodhoi performanca teatrore e Lekë Tasit në këtë natë gushti, e cila qëllimshëm refuzon lidhjen e drejtpërdrejtë me gjendjen tonë politike dhe shoqërore. Për ta fuqizuar këtë mendim m'u ndërmend një citim i një kritiku italian, i cili ndër të tjera shprehet: *“Tragjedia nuk krijon një model estetik, në të cilin qyteti (polisi) njeh vetveten dhe ilustron dhe mendimet apo ankthet e një epoke. Nuk është fjala as për një pasqyrim, as për një pamje të botës, por për një pyetje të qenësishme rreth mundësisë për të vepruar. Tragjedia nuk është pra dëshmi, por epifani, nuk është reflektim i njëmendësisë, por kontestim i thellë i saj, përmes krijimit të ndërjegjes tragjike, e cila lind nga*

konflikti.”

Kështu edhe kësaj radhe në teatrin e Çapalikut kufiri midis etikës dhe estetikës mbeti i pakapërcyeshëm.

Këto janë dy rrëfime që na u shpallën në atë shfaqje, fakte që edhe i dinim, qoftë pjesëmarrësit, qoftë populli i gjerë. Dhe Lekë Tasin si simbol profetik, me 90 e kusur vite mbi shpinë, ishte aty i durueshëm me mesazhin e përplotësuar të një ligjërimi tjetër të madh, atij Kuranor, që na thotë se përfundimi i lavdishëm është për të devotshmit...

▪ Letërsi ▪

Ag APOLLONI

SANDALET E SENEKËS

I.

*Seneka në sallë sheh sandalet e s'flet.
Pinjojtë e kalit në senat bajnë tërmet.*

*Pushteti asht si zjarri, ti kot përpiqesh,
i rri larg - ftohesh, i rri afër - digjesh.*

*Bota për secilin asht një simulacrum,
ku burrat zgjohen me neco, ergo sum.*

*Neroni ngrihet mbi zhurmë e përplasje:
-I dashun profesor, ju propozoj vetëvrasje.*

*Seneka i Spanjës ngre kokën, ngre trupin
dhe niset drejt banjës për me la turpin.*

II.

*Toga e gjykatësve
shikon shpinën e stoikut
si del prej salle dhe zbret shkallëve,
me urtinë e të lashtëve, me trimninë e të rrallëve.*

*Shqiponja në bez
kobshëm krahët i lëviz;
flamuri i ndërgjegjes zbret në gjysmështizë.*

*Shohin seneksët Senekën
si largohet, i vetëm, pa rojë, pa drojë,
se asht i dënuem të jetë i lirë deri te vaska.
Ndërkohë që mes kolonave të pallatit bie heshtja,
ai asht i lumtun që ma në fund i pa miqtë pa maska.*

*Roma perandorake,
Roma madhështore,
Roma që e kopjoi Athinën në gjithçka:
në zakone, fe, tempuj, pallate, dije dhe kurajë,
prej sot do ta ketë edhe Sokratin e saj.*

*Sheh stoiku
tek plandosen zogjtë e shkretë si bagla përtokë.
S'ishin vetëm sytë, po edhe mushknitë,
që e banë me i ra murit me kokë.
Këtu sundohet
me muskuj,
me grushta,
me nofulla,
me dhambë.
Populli përkulet e shtrihet
(askush nuk e pret rrufenë në kambë).*

*Stoiku
ndalet në platformë
mes kolonave të pallatit
dhe e sheh prej nalt perandorinë e fatit;
i urti gjithmonë asht gati çdo të keqe me e pritë,
se shkallët nëpër të cilat ngjitet
janë edhe për me zbritë.
Por, zbritjen e tij si t'ia shpjegojë miletit,
tash që andrra theu qafën në murin e realitetit?*

*Sheh centurionët,
si një digë e hekurt,
që e ndalojnë turmën;
mandej me dorën strehë mbi vetull,
sheh sheshin dhe krejt çka mund të rrokë.
Sa shpejt shkoi kjo jetë, mendon
dhe i duket vetja pluhun në erë, baltë në tokë.*

*Thyhet muri i centurionëve,
vërshojnë shkallëve përtpjetë
kamera, mikrofonta dhe diktafona,
mbushet platforma plot me gazetarë:
- Zoti Seneka! Zoti Seneka, çka mund të na thoni
tash që ju shpallën tradhtar?*

*Stoiku ua kthen qetë: Po, pajtohem me vendimin,
unë jam tradhtar; unë tradhtova nënshtrimin,
korrupsionin, të keqen, ligësinë...
Si tradhtar i tillë po e la perandorinë.*

-Tradhtar! Tradhtar!,- turma shan e pështyn.

*Sa shumë urrejtje ka turma ndaj trunit,
urrejtje që urtakut i dhemb deri në asht,
por, fundja,
vetë Roma asht dashni e kthyeme mbrapsht.*

*Poshtë Seneka!
Poshtë Pizoni!
Rroftë Neroni!*

*Çirren e përjargen servilët plim,
aspak s'ua vret sytë shkrumbi
tash që s'ka ma tym.*

*Toka romake pjerdh e gromësin shpesh,
rezultati po shihet në senat dhe në shesh.*

Zbret shkallëve Seneka,
 një gazetar për rrobe i kapet:
 - Ju njiheni si njeriu që ka ba reforma,
 gjyqësoret e fiskalet;
 si njeriu që i dha Neronit këshilla
 për jetën dhe për shtetin...

-... i dhashë këshilla prej filozofi dhe prej juristi,
 po sundimtari ma i keq qenka
 ai me ambicie artisti.
 Ai e djeg shtetin, veç t'i vijë frymëzimi,
 se njilloj për të janë krimi dhe krijimi.

- Zoti Seneka, Roma pas djegies
 u shoqërue me shumë skandale...

Seneka hesht dhe ecë në togë e sandale.

- Na flisni për akuzat,
 për skandalet,- thonë gazetarët.
 - Si do të ndalen ekzili, nepotizmi, korrupsioni?
 - Si mund të ketë paqe me gjithë këta të papunë?

Senekë stoiku ngre supet e thotë:
 - Derisa e duroni tiranin, ju jeni ma stoikë se unë.

Ata e pyesin për senatin,
 për politikën perandorake,
 për ujqit e natës dhe delet e ditës.
 Ai hesht dhe ecë, e ç'mund të thotë sot
 kur pinjolli i kalit e gjykoi kalorësin e dritës?
 E pyesin për perandorin,
 nuk i ndahen pa e marrë të vërtetën.
 Ai ua hedh plot mëshirë shikimin:
 - Ru'juni prej sundimtarit
 që s'mund ta sundojë vetveten!

- Si mund ta vrasim tiranin?- bërtet nji i marrë.

*Filozofi shikon mbi kokat e plebejve:
- Nëse s'ka servila, s'ka as sundimtar.*

*Hesht dhe merr përdore hijen e vet,
këtu ku pushteti asht pa dije,
këtu ku dija nuk ka pushtet.
Pse duhet të flasë kur secili e di
që bastardja e bishës i ha bijtë e vet?*

*Sheh anash stoiku nëpër trotuare:
në njanën anë, buzë e bythë të fryme;
në tjetrën anë, mjekra dhe havale.*

*Arka e shtetit
nuk zen ma sesterca, nuk zen ma ar,
e kalldrëmet e sheshit
nuk zanë ma lebrozë, nuk zanë ma lypsarë.*

- Ku po shkoni?, - e pyesin.
- Po arratiseni?
- Po ktheheni në vendlindje?
- Nana asht vendlindje, - u thotë –
tjetër vendlindje s'ka.
- Atëherë vendlindjen e vet
perandori e paska vra'!

*Ky vend nuk ka shpirt;
këtij vendi i ka vdekë ora;
këtu ka vetëm mij, hijena dhe orla.
Këtu qelbet gjithçka: senati, gjykata, vulgu...
Këtu tash punë mund të kryejë vetëm plugu.*

*Këtu krejt janë mashtrues;
krejt janë përgjues;
krejt punojnë tinëz.
Kujtojnë se kështu përparon Roma.
Po, vërtet kështu përparon drejt greminës.*

*Stoiku ndal hapin,
shtat e shpirt i shtangen
kur sheh pasojat e paranojës së horrit;
kërma e kufoma kudo,
turp e tmerr para Tempullit të Poluksit e Kastorit.
Nga tavernat dalin pijanecët,
e stërpikin me temjan,
nga pusetat dalin pastruesit dhe e quejnë fliqan.
E ai s'i flet askujt, pos vetit
dhe ndien mall për levën e Arkimedit.*

*Ecë sheshit stoiku, turma i vihet mbas,
po ai e shpërfill. Nuk ka kujt t'i flasë,
prandaj u shmanget fjalëve.
Përgjigjen ma së miri e jep ecja e sandaleve.*

*Nga shtëpia publike ku kryhen punë private
del prostituta e ballsamosun si kufomë,
plot parfum e pudër.
Skuqet,
se stoiku e di
që ajo pati humbë garën me Mesalinën,
kur dikur u shtynë se kush ishte ma kudër.*

*- Ngrihe kokën, zonjë,
na këto pare dhe shko e bli tjera tesha!
Tjerët munden me thanë çka të duen,
por unë e di se ti je ma e ndershme
se perandoresha.*

*Befas i zanë udhën
marangozë, këpuctarë, berberë...
- Magister, na zhgënjeve shumë këtë herë.*

*- Atëherë n'eroni Neronin,
se ai s'ju zhgënjen asnjherë!
Ai vret nanë, vret vëlla e vret grue;
ai nuk kursen askend, as ju, as mue.
Tek ai shpresa dhe realiteti gjithmonë janë një;
ai ju tredh, ju çnderon e ju thërret si spektatorë n'orgji.
Me gojën e turmës nis e flet droja:
- Tash që u hap diga, si mund të ndalet ploja?*

*Seneka u thotë se perandori
tash asht dyfish i marrë:
i dehun prej pushtetit,
i trembun prej grushtshtetit.
Para se t'i dalë pija tiranit, regjimit po i del boja.
Ju, edhe po të doni,
s'mund ta shpëtoni nga paranoja!
Le t'i këndojë edhe ndonji ditë diellit
si gjel mbi pleh,
le t'i lehtë edhe ndonji natë si qen zhugan hanës,
nji ditë, kur të jetë esëll,
do ta shohë se nuk mund ta hedhë
krejt popullin prej shkambit të Tarpejanës.*

*Hesht vulgu, ecë i urti,
sheh rrugët plot kreatura interesante,
që u nisën për njerëz e dolën insekte gjigante;
sheh fushat djerrë,
shportat me krena që kullojnë gjak,
kryqat me gjymtyrë të gozhdueme,
hujtë me viktime që bërtasin në flakë.*

*Nji plak me sy të bardhë,
e kap për mange, e prek në trup, fytyrë e flokë
dhe i thotë se një fe e re po pret ta veshë këtë togë.
Dymbëdhjetë dishepuj të dëshpëruem dalin
dhe ia zanë udhën, qajnë, ia puthin duert,
dhe mundohen ta bindin mendimtarin.*

*I thonë se ia kanë gjetë një strehë të fshehtë
atij që ia di thelbin fshehtësisë,
i luten që në rrugën e tij të drejtë
të marrë një kthesë,
se, për ta, fundi i tij asht ma tragjik
se fundi i perandorisë.*

*I sheh Seneka si të ishin bijtë e vet
dhe u flet me ton madhështor si një shpirt i qetë:
- E di se fara e mendjes sime
po mbin në zemrat tueja,
por unë e kreu misionin në tokë,
tash po më thërret qielli.
Shpëtojeni veten, o të dashunit e mi,
dhe mohomëni tri herë para se të këndojë gjeli!*

*Nji farkëtar
le kudhrën, merr sakicën
dhe i del stoikut para:
- O mësues dështak,
premtove drague e na dhe salamandër;
e bane fëmijën perandor,
por s' e bane dot Aleksandër.*

*- Historia, - thotë i urti,-
nuk u përsëritka pse dashkemi na;
atje nalt ndryshe paska qenë e shkrueme!
Aristoteli ishte me fat,
kurse mue më qëlloi ena e shpueme.*

*Sot,
mbasdite prilli,
ecë stoiku me sandale,
shkrumb kudo që shkel,
nga Campania deri në Forum.*

*Perandori mbas zjarrit këndon e krihet,
nga grilat përdhese duken robtë
e shfytyruem në bodrum.
Në sytë e tyne stoiku sheh vujejtje, sheh frikë.
Veshët i mbushen plot britma e kamxhikë.*

*Nji cinik me qen e sheh stoikun:
- Për ku po shkon ashtu?
Si mund t'ia kthesh shpinën ven 'it?*

*Stoiku ia hedh ashtin në fyt:
- Nuk jam mësue me kalue jetën
mbas bishtit të qenit.*

*Turma, që uron e pështyn, ndalet:
dikush asht i lodhun nga puna,
dikush asht i këputun nga dhuna,
po nesër asht pushim e mund të rrinë të qetë,
falë zotit, java romake e ka edhe një ditë të tetë.*

*Stoiku me sandale
mbërrin në shtëpi,
kthehet edhe njëherë,
te pragu, te dera,
i thotë lamtumirë turmës,
i thotë lamtumirë botës
dhe sheh qiellin që nxihet mbi fytyrat e verdha.*

*Ngadalë për herë të mbrame
buzëqesh dhe ngre dorën.
E një plebe bluen një pyetje retorike:
çka të duhet mendja, kur s'e ke kunorën?!*

*Komploti dështoi,
retë ia zunë pamjen diellit.
Mes reve të randa rrufeja tha
se diçka po ndodh atje në Mbretninë e Qiellit.*

III.

*Sandalet e sjellin Senekën në shtëpi.
Paulina e re dhe e bukur e fut mbrenda,
mbyll derën, kafshon buzën dhe ia ngul sytë në sy.*

*Ajo me panik e shikon burrin,
ai me qetësi e sheh gruen.*

*Me zjarrin e buzëve
që s'ia fik uji i krojeve të ballit,
ajo i lutet burrit të ikin, por stoiku nuk tundet:
- Njeriu jeton sa duhet, o shpirt, e jo sa mundet.*

*Fati
kur i sheh
nuk ia fal vetes,
qan pse ka marrë në thue
pikërisht në pragun e kësaj shtëpie,
ku urtia dhe bukuria janë burrë e grue.*

*- E dashun Paulinë,- ia nis Seneka,-
vdekja asht pensioni që ma dha Neroni.
Uji asht jetë, thoshte i urti Tales,
prandaj unë po hyj të pagëzohem në vaskë
dhe të nisem drejt fushave të Elizesë.
Lamtumirë, vogëlushja ime!
Nëse një ditë fëmijët të pyesin
se si mund të gjendet lumtunia,
thueju mos t'i mbathin sandalet e mia!*

*Kështu flet stoiku, mandej del nga dhoma,
zhvishet, futet në vaskë,
e në parvaz gugat paloma.
Me teh të mprehtë i prek venat,
venat i prek me teh të mprehtë.
Nji ah i nxjerrin buzët
e veshët ia shpon vaji i grues së shkretë.*

*Sheh stoiku pëllumbin e i kujtohet Kordova
dhe sytë e njomun i fshin shpejt me shuplakë:
për një pjesë të jetës pse u dashka të qaj,
kur krejt jeta asht për me u zhgrehë në vaj?
Pse të ankohe
kur po i jap fund vujtjes e përprjekjes;
kur prejse kam le, kam udhëtue drejt vdekjes?*

*Sheh Seneka për dritare:
përpara ka paraajsën, mbrapa historinë
dhe e di se disave u prin fati, disa fatit i prijnë.*

*Pëllumbi avullohet, stoikut i shuhen sytë
(vijmë në jetë për nandë muej, ikim për një ditë).*

*Gjaku
rrjedh jashtë venave,
në vaskë, në pllaka e s'ndalet.
Si dy binjake bonjake te dera presin sandalet.*

Stefan ÇAPALIKU

XHAKETË TEKE

(Fragment romani në dorëshkrim. Shkodër, dhjetor 2019)

1.

Sa herë që kam premierë blej dicka të re. Më ka pëlqye kjo gja që kur ma tha një aktor i mocëm. Punonim bashkë atë kohë, kur tamam në ditën e fundit të provave erdhi e m'u ul në tavolinë me një pulovër të re, vishnje.

E bleva për premierë, tha. Pjesën më të madhe të garderobës sime e kam të lidhun me premierat e teatrit dhe të filmave. Më përshtypi kjo gja dhe vendosa ta baja edhe zakon timin. Dhe e bana.

Mbas dy ditësh kam premierë.

Ka plot një muaj e gjysëm që kam ikë nga shpia ime në Tiranë dhe kam ardhë në qytetin e lindjes, në Shkodër, te shtëpia e t'im eti. Rrimë bashkë me të këto ditë edhe pse takohemi veçse pak në drekë dhe nganjëherë edhe në darkë, kur e gjej zgjuet.

Ime shoqe rri vetëm në shtëpinë e Tiranës dhe vjen veç për fundjava.

Provat si pa u marrë vesh kanë shkue nga fundi dhe dalëngadalë po afrohet premiera.

E tash që po vjen premiera mendoj se e vetmja gja që më mungon kësaj radhe kishte me qenë një xhaketë. Jo kostum. Sapo i bleva një palë pantallona bukur të mira e të shtrenjta në Itali. Pantallona stofi, blu i thellë. Me këto pantallona shkon një xhaketë gri, por edhe oker, ba me qenë shumë guximtar.

Mirëpo tash që e ndjej se jam shëndoshë edhe ma, nuk jam hiç i

sigurtë për numrin. Ndoshta 58 ba me qenë prerje klasike. Kam vu bark. Nuk mund ta shoh veten me bark. Kur zgjohem në mjes më duket sikur nuk kam edhe aq, por andej nga dreka dhe sidomos në darkë, barku rritet.

Vetëm në mjes para orës dhjetë dhe mbas dreke midis orës një dhe pesë kam kohë për të kërkue për xhaketë.

Pjesa që po vë në skenë thirret “Tre vetë në një varkë pa llogaritë Nik Prel Mujën”, ndërkohë në teatër shfaqet për fëmijë edhe përralla “Tre derrkucët”, një tekst amerikan, i shkruem së pari prej Joseph Jacobs e ma vonë i ripunuem prej kushedi se kuj tjetër. Koincidencë e çuditshme kjo me titujt. Unë titullin tim e kam sajue i frymëzue nga romani i famshëm i Jerome K. Jerome “Tre vetë në një varkë pa llogaritë qenin”. Po thonë se ky tashma quhet gjest postmodern.

- Mirdita! A mbani xhaketa teke?

- Xhaketa teke? Pooo patjetër që mbajmë - dhe unë hy në dyqan. Një grua rreth të gjashtëdhjetave, ndoshta ma e re. E shkurtë me flokë të lyeme. Të zi pis. Buzë të lyeme gjithashtu me të kuqe të ndezët. Natyrisht e shëndoshë. E veshun lirë. Mbasi që hyn në mes të një turre me rroba duket sheshit se po ban sikur. Ajo më hedhë një sy dhe më thotë se për masën time nuk ka xhaketë. Por ama, vazhdon ajo, paska një pallto trecerekëshe, që po e pe pa kujdes ngjan edhe me xhaketë. Varet.

- A di gja a ka xhaketa teke diku këtu rrotull?

- Vështirë se gjen në masën tande.

O Zot më duket vetja si bol.. Marr frymë thellë. Thithi barkun dhe dal. Ajri në rrugë ka diçka prej uji. Lagështinë e madhe...

2.

Qytetit i dallohen shtresëzimet e veta si të ishin arna mbi arna. Por arnat e reja, këto të vendosura mbas ranies së komunizmit, janë të një tjetër lloji. Janë arna teritali, diçka sintetike, me shkëlqim, kanë shijen e ilaçeve. Janë kryesisht shtesa të ndërtimeve anash strukturave të vjetra prej betoni të komunizmit. Shikohet qartë se tranzicionit postkomunist i ka mungue spaga dhe dy njerëz që t’ia tërheqin ekstremet. Asgja nuk asht ndërtue drejtë dhe në solidaritet me njena-tjetrën. Ndjehet shfrimi i nevojave për protagonizëm. Vihen re lehtësisht shpërthimet e vullneteve të ndrydhuna, vullneteve të shtypuna.

- A mbani xhaketa teke?

- Po more zotni. Urdhnoni.

Kjo asht një grue e kolme. Edhe ajo e veshun keq, lirë. Nuk më shikon në sy. Asht ma e re se e para. Shumë ma e re ndoshta, por shendeti nuk lejon që të vihet re diferenca.

- Kena këto dy lloje këtu - dhe rrëshqet dorën mbi tre - katër xhaketa me shkëlqim. Janë për dasma ma shumë, buzëqesh ajo me sytë përdhe.

- Keni të drejtë - i them unë - Për dasma... - dhe dal.

Shikoj telefonin. Dikush ka komentue te facebook-u im. Ka komentue poshtë posterit të shfaqjes. Shkruan thjesht “Suksese”. Suksese për emisionin, m’u kujtue parrulla e njerëzve të tranzicionit, që marrin pjesë me telefonata nëpër emisionet e shumta televizive.

Shikoj orën. Koha për prova. Me xhaketën mund të merrem edhe këtë mbasdreke. Nisem nga teatri.

Shkoi si shumë gjatë ky projekt. Patëm tre ndërpremje. Dy për fajin tim e një për fajin e trupës. Megjithëatë, nganjëherë më duket se ndërpremtet banë mirë. Kohë për refleksion. Secili prej nesh ka nevojë të distancohet nga rutina e provave.

Dhe jam para derës së teatrit. Një qen i madh rri te dera. Anash tij dhe tre katër të tjerë. Nuk e di pse ka përfundue kështu ky qytet. Ka dy-tre vjet që asht i mbushun me qej. Shumica prej tyre sillen rrugëve kryesore, por ka plot nga ata që zanë hymjet e institucioneve, veçanarisht atyne kulturore, si biblioteka dhe teatri. Mesa duket sepse në hyrjet e tyre ka ma pak lëvizje. Kam dëgjue se qarkullon një thashethem sikur i sjellin tinzash prej qyteteve të tjerë. Ngarkojnë ndonjë kamion dhe vijnë natën në Shkodër dhe i lëshojnë nëpër periferi. Ata pastaj mblidhen vetë në qendër. Nuk e di. Di vetëm se kam mbetë kund dy-tre metër nga dera e teatrit dhe s’ma mban me hy. *In from the margins*, më kujtohet rastësisht ky slogan i Këshillit të Evropës.

-Selami!

Dhe Selamiu del. Selamiu asht inspektori i skenës. Diku afër të gjashtëdhjetave. I shëndoshë. Ai ka gjithë jetën në teatër dhe asht i martuem me një kangëtare të muzikës popullore.

-Hajde profesor! Mos e ke merak. Nuk të han. Jam unë këtu.

Dhe unë afrohem gjithë drojë. Selamiu më tregon se qeni thirret Isak dhe se ky e ushqen përditë...

3.

Historia e dramës ze rranjë nga ky burrë i shkurtë që po vjen me

biçikletë. Ai quhet Leopold dhe ka një lule në dorë. Një lule të bardhë me bisht të gjatë. Këtë njeri e njoh prej vitesh. E di se ka qenë në burg diku nga fundi i viteve '50 të shekullit që na la dhe, di gjithashtu se shkon cdo ditë me vue lule te një monument i Nanës sonë Terezë, që asht vendosë prej disa vitesh në qytet.

I baj me dorë Leopoldit dhe i them me të shpejtë se po takohemi këtu afër, mbasi që ai të çojë lulen në vend. Këtu majtas ka sërish një tufë qejsh. Kujdes. Mbramë më thanë se një qen kishte kafshue në fëtyrë një mikeshën time doktoreshë, e cila qe përkulë për me i dashtë. Edhe doktoreshën e njoh prej vitesh. Asht e motra e një ish studentes sime, që jeton në Suedi.

Llogaris kohën se sa i duhet Leopoldit për me u kthye dhe hy shpejt e shpejt te një dyqan i vogël që gjendet në krah.

- A keni xhaketa teke?
- Xhaketa teke jo, por kena kostume...
- Ah jo. Kostumet nuk më duhen.
- Por urdhnoni brenda se edhe mund t'i ndajmë...

Ndërkohë shoh Leopoldin që po kthehet dhe refuzoi të hy brenda. Vë re me të shpejtë se shitëses i mbetet hatri. Ajo sapo tregoi gadishmërinë t'a çojë dam një kostum, kurse unë...

- Erdha! Po kthehem menjëherë - i them Leopoldit dhe hy.

Leopoldi u ba shkas i gjithë kësaj historie. Në të vertetë zanafilla duhet kërkue te kurioziteti im për një lugë të vogël druni të ekspozueme te muri i dhomës së pritjes së familjes "Shkreli". S'kisha parë kurrë më parë një lugë druni të ekspozueme në mur. Asht luga e burgut, më pat heqë kureshtjen Leopoldi.

Ajo shitësja e kishte zbritë varësen ku gjendej kostumi, që sipas saj duhej të dekonstruktohej për mua. Ajo e mbante xhaketën prej supesh. M'u desh ta provoja si me pahir. Nuk më pëlqente aspak dhe për fat nuk më ra. Kjo ma lehtësoi refuzimin.

Leopoldi qe vëllai i vogël i familjes Shkreli së përbame nga Lini, i madhi, Zefi dhe Ndoka. Lini gjatë viteve të Luftës së Dytë, pati shkue të studionte në Romë për mjeksi dhe mbeti aty. Ai edhe u martue me një romanjole dhe duke qenë se me të nuk patën fëmijë, u pasunue mjaft, pak prej zanatit e punës së tij dhe pak prej origjinës borgjeze të së shoqes. Madje kur vdiq Lini pati lanë në trashëgimi edhe një numër pikturash të një Lini tjetër, një piktori shqiptar, që e pati mik e që jetonte jo larg tij.

Në të vertetë tash që kujtohem mirë paten qenë pikturat e Lin Delisë argumenti kryesor, që më patën shtye të vizitohj shpinë e Leopoldit.

Ai po afrohet. Prapë qej nëpër rrugë. Janë të gjithë të zgjidhun dhe pa zot. Asht rrezik i madh të ecësh më biçikletë bri tyne. Të lëshohen me tufa...

4.

Vë re se në teatër të gjithë punojnë vetëm atëhere kur shkoj unë. Edhe pse provat janë të fiksuara në orën dhjetë të paradites ata gjithmonë e nisin me vonesë. Ka një kordinim të përsosur. Frymë grupi. Vetëm pesë minuta përpara njerëzit e teknikës kanë nisë punën për të realizue atë, që duhej të ishte tashma gati. Dhe këtu duhet të shtoj se ka edhe disa prej tyne që thonë gjithmonë “s’ka”. Për ndriçuesin përshembull asht e pamundun që të gjenden projektorët e duhun në vendet e duhuna... Mungojnë prizat hera herës, zgjatuesit, stativët, apo projektorët me fuqinë e duhun. Vetëm Shpendi dëshmohet të jetë i vetmi person i gatshëm.

Shpendi asht roja i mbasdrekës dhe i natës.

Shpendi thotë për veten se asht një “kurvë e vogël”.

Shpendi thotë se “prej servilizmit nuk ka vdekë njeri”.

Shpendi mban mustakë dhe nuk lejon njeri që t’i shajë mustakun.

Shpendi ka një portret kinematografik, sy të mëdhenj dhe shumë ekspresiv.

Shpendi duhet të ketë pak klasë shkollë, por nuk ia hedhë kush ndër hesape.

Shpendi ngutet. Aq shumë ngutet, sa nuk arrin kurrë ta artikulojë fjalën deri në fund.

Shpendi asht aktor periferik në dramet e mia për të katërten herë.

Shpendi vdes për me luejtë në teatër.

Shpendi kënaqet, jo edhe aq shumë se po luen, sesa se po i ban sherbezllëk kolegëve.

Shpendi llastohet kur unë nisi punë në teatër.

Dhe ndërkaq harroj që kam ftue në prova Ergysin. Ai më prët atje brenda në sallë, në një cep. Aktorët e kanë shumë bezdi kur dikush i hyn në prova, por unë jam regjisori dhe ata nuk mund t’i refuzojnë njerëzit që ftoj unë... S’kanë ç’më bajnë. Nuk e di pse i kanë aq bezdi. Nga njëherë aktorët më ngajjnë me kuzhinierët që nuk duen që dikush t’i shohë sesi e përgatisin pjatën. Duhet të kenë të drejtë.

Por Ergysi ka ardhë më shumë për të folë me mu për një projekt të vetin. Ai asht një artist i ri pamor dhe sapo ka përfundue një video me dy pleq të azilit të qytetit që masturbojnë të ulur në dy stola parku. Ergysi ka arritë që t'i fusë ato në të njajtin ritëm. Nuk e di si ia ka dalë. Kur pashë kopjen bruto, një *raff cut* të parë të videos, ai më tha se do donte t'i montonte në fund një kolonë zanore, me gjasë një fragment të finales së simfonisë së nantë të Bethovenit. Unë nuk jam dakort me këtë ide. Nuk ka pse të ndërhyjë muzika te ejakulimi i tyne në sinkron. Në fund të fundit ai asht një ejakulim pleqsh.

Unë vetëm e salutoj me dorë. Nuk dua që t'i jap Ergysit aq shumë randësi në sy të aktorëve. Madje due ta nënvleftësoj në mënyrë që aktorët të lehtësohen nga ndjesia e të patunit të një spektatori të randësishëm në prova.

Zot çfarë zanati të jeshë aktor. Kam zbulue nga eksperiencia se marrëdhانيت e aktorit me regjisorin janë si ata të ushtarit me rreshterin. Pra njëra palë përpiqet t'ia hedhë e pala tjetër t'i vendosë në rresht.

5.

Provat kësaj here shkuen ma mirë. Përsëritja vjen dhe krijon një rutinë të lumtun, për ata që i ndjekin provat nga jashtë dhe një lëvizje idiotike dhe tmerrësisht të mërzitshme, për ata që veprojnë nga brenda.

Por nga ana tjetër provat veprojnë si një rrokolle që flak jashtë elementet e tepërta. Kështu përshebull, kur tre djemtë duan të ndahen me nanën, i madhi i jep asaj një letër dhe i thotë:

-“Nanë nësë e sheh vajzën e Sofisë, të lutem jepja këtë letër prej meje!” - dhe i lë një dorë një pusullë.

Në këtë moment djali i vogël, Marku, ai që do të ikë për arësye shkolle dhe studimi, djaloshi i përdëlluem në libra, i thotë të dytit, Lukës, gjithnjë duke iu referue letrës së Gjonit:

-Do të jetë e mbushun me gabime...

Në mendjen time kjo asht një batutë perfekte dhe që ka brenda një humor të zi sterrë, mirëpo provat e nxjerrin jashtë. E flakin. Situata dramatike nuk e duron. Batuta, edhe pse kështu brilante, shkatërron diçka tjetër. I bie në qafë suspansës dhe kësisoj rrethana dramatike ka rrezik të dështojë. Kështu, biem të gjithë dakort dhe e heqim pa mëshirë. Fundja autori jam unë vetë e s'kam nevojë t'i kërkoj njeriu leje...

Gjithsesi. Kur bien, rrëzohen a zhgulen hallka të tilla nga ligjërimi dramatik krijohet njëfarë ngërçi. Asht e mira të bahet pak pushim.

Shkojmë të pijmë një kafe të shpejtë te klubi ngjitë, që thirret “Te teatri”.

Në shtëpinë e Shkrelëve, mbas ikjes së Linit në Itali, kishin mbetë tre djem, e bashkë me nanën baheshin katër frymë. I ati kishte vdekë relativisht i ri. Mue më mahniste gjithnjë e ma tepër ideja që ato kishin pasë sesi me ikë e me ia mbathë prej këtij vendi. Më dukej gjenial plani i arratisjes. Ata kishin ndërtime tre module, në pamje të parë të ngjashme me tre koshere bletësh...

Në klub, sa hyn majtas asht tavolina e Enverit, një aktori thuajse të pashkolluem, por të dalë në pension si aktor profesionist. Ai e zë atë vend nga ora 9 deri në 1 të drekës. Edhe kur dikush ulet në atë tavolinë heret në mjes, ende pa ardhë Enveri, çohet prej andej sapo e sheh në klub. Enveri nuk flet me pothuajse ma shumë se gjysmën e njerezve të klubit. Tavolinë tjetër të personalizuese nuk ka në atë klub. Enveri di mirë tre notat që i duhen një aktori: me përceptue, me vlerësue e me reague.

Nuk asht çudi që ai ka me vdekë ndonjë ditë prej asaj rakisë të keqe që pin. Asht një lloj alkooli i tmerrshëm, i egër, i ashpër, i fortë, shpërthyes dhe me një shije në fund, si me qenë barut.

Por edhe pjesën kur vëllai i vogël shkon të përshëndetet me derrkucin, Pirollën, që mbajnë në shtëpi e hoqëm. Edhe ajo batutë më dhimbsej në shpirt, por edhe atë e shkulëm pa mëshirë. Ishte momenti kur po ndahej me nanën Luka, vëllai i mesëm. Në atë çast Marku, i vogli, rishfaqet në skenë dhe Gjoni, i madhi, e pyet:

- Ku ishe?
- Shkova me u falë me shndet me Pirollën.
- Çfarë i the?
- I thashë me na e ba hallall - përgjigjet Marku.

Pranëvënia e fjalës turko-islamike “hallall” me fjalën “derrkuc” më shijonte shumë, por ja që duhej zhdukë prej tekstit të shfaqjes.

Nuk rri...

6.

- Deshta një xhaketë teke gri. Pak a shumë për këtë kohë. As të hollë e as të trashë shumë... ose edhe ndonjë ngjyrë tjetër interesante...po nuk patët gri... nuk e di...

Një burrë më shikon nga kambët deri në maje të kresë. Shihet prej së largu se e njeh mirë zanatin që ban.

- Më prit - thotë - Kam diçka për ty - dhe zhduket mbas një kthine të

dyqanit, ku duket se fillojnë një palë shkallë që të çojnë sipër.

Unë rri e shoh përreth dyqanin. Ai vonohet pak. Ndërkohë në facebook-un tim kanë ardhë disa komente që kanë lidhje me imazhin e sotëm që kam nxjerrë në lidhje me shfaqjen. Njena pyet “Do jetë edhe në periudhën e festave?”. Një tjetër më shkruen “Suksese me shfaqjen e rradhes!”. S’e kuptoj. Sidomos këtë të dytën. E ka fjalën për këtë që ka premierën pasnesër a por për shfaqjen që do baj në të ardhmen? Pra shihet qartë se nuk e ka ndërmend me ardhë.

Sonte kam ftue në prova Leopoldin, personin prej nga zë fill historia, pra. E kam njëfarë merak. Nuk e di sesi ka me i tingëllue gjithë cfarë kemi ndërtue deri më tash.

Leopoldi asht një përsôn simpatik, brrun, i shkurtë me një profil të zgjatun dhe me një gjoks e nofull të poshtme paksa të dalë. Në profil më duket ma shumë si një kangtar operash prej Italisë së Jugut.

-Më vjen keq, por këto që më paskan mbetë këtu sipër janë masa ma të mëdha. Numër 60. Më vjen me të vertetë keq.

Megjithëse unë e kam parapergatitë Leopoldin se zanafilla nuk asht e njejtë me rezultatin, prapëseprapë e kam njëfarë droje.

-Unë thjesht jam frymëzue nga ajo histori e mandej mënyra sesi e kam zhvillue asht e imja... A më kupton?

Leopoldi asht ulë diku në plate, tre-katër rreshta nga buza e avanskenës. Unë rri e sillem mbrapa tij. Prova ka nisë. Asht momenti kur djali i madh, Gjoni, i ban me dije dy të tjerëve planin e daljes nga shpija: “Unë dal i pari. Nëse prite Zot dicka më ndodhë, për një çerek ore ju keni mjaft kohë për ta marrë vesh se çka më ndodhi ose mue me del koha për me u kthye mbrapsht. Fiks mbas një cerek ore nisesht ti Lukë. Kosheren në shpinë dhe strajcën me bukë e ujë që të ka ba gati nana. Një çerek ore mbasi që të dalë Luka, pra fiks në tre e gjysëm nisesht ti Mark. Kosheren në shpinë dhe strajcën me bukë e ujë që të ka ba nana”.

Dal dhe e vërej Leopoldin skic nga profili. E shoh se asht i zhytyn në skenë, por nuk dalloj ndonjë shenjë tjetër. Leopoldi asht një aktor i përsosun. I lexohet një monolog i brendshëm i pasun, por jo tamam se çka. Megjithëatë deri këtu jam në rregull me Leopoldin dhe historinë. Fill mbrapa ia nis një dozë e mirë fiksioni. Kam fantazue përshembull se Nana, duke qenë thellësisht e friksueme se mund t’ia vrasin djemtë në kufi, ka dashtë t’ua dështojë planin duke ia prishë herë mbas here kosheret. Këtë Leopoldi nuk e di. Mbas pak minutash ajo ia thotë

djemve: “Kam qenë unë ajo që cohesha natën e ju prishsha kosheret. Kam qenë unë. Ka qenë faji im, ma i madhi faji im.”. Kisha dëshirë kështu të ndërtoja një lidhje me mitin e Rozafës: tre djem që punojnë ditën dhe u prishet natën.

Shikoj Leopoldin. Më duket se një hapësirë milimetrike hapet në profilin e tij. Duket sikur dicka lëviz. A në cep të synit, a në cep të buzëve, nuk e di mirë.

Durim TAÇI

“NJË PRANI NË IKJE” (fragment nga romani)

Një kalimtareje

*“Rruga shurdhuese përreth meje ulërin.
Shtatlarte, në zi, me dhimbje të madherishme,
Një grua ecën aty përbri, ngre dorën e fisme
Dantellën prek, palë e fustanit fëshfërin;
“Këmbët prej statuje e shtatin lastar, drejt.
Kaloi kur po pija, tendosur , ekstravagant,
Qielli gri në atë sy lajmëroi një uragan
Ëmbëlsinë që magjeps e harenë që vret.
Vetëtimë... pastaj natë! Bukuri qe te ikën
Vështrimi i saj më ringjalli fill si burrë,
Vallë, do t’ua shoh më këtyre syve dritën?
Gjetiu, mbase, larg! shumë vonë! o kurrë!
Nuk di nga shkoi e për mua nuk do e dinte,
Veç, do e doja gjithmonë, këtë e kuptoi në ikje!*

Sharl Bodler

23 mars 2020

E shkruara jote, zakonisht, është një orvatje gjurmimi e hurnbjes tënde të fundit, por këtë radhë, siç do të merret vesh, shumë shpejt, është edhe një humbje kohe. Nuk e ke idenë e peshës që kanë këto sekonda, të cilat i kalon duke parë xhamin e dritares dhe kërkon, me nge, të fshish aty një njollë. Afrohesh dhe e kupton se bëhet fjale për syrin tënd që sheh refleksin e vet, i lodhur me dritën verbuese jashtë. E kjo të tremb.”

Por, ajo që bën me pas, është goditja e fundi t që ti i jep fatit tënd. Në vend që të marrësh rrugën turravrap jashtë, shkon e ulesh tek shkrimorja jote, se kërkon lehtësim e do ta harrosh edhe atë njollë në xham. Ti duhet thjesht të dalësh, tani. Dhe nuk të ndihmon as zëri i ulët i televizorit, që ta mpreh më shumë dëgjimin e të mban lidhur, për nja dy minu ta të tjera e, ti ndjek me shqetësim transmetimin e pandërprerë të një rrjeti kombëtar, RaiNeës24. Kthen kokën, titujt me germa të mëdha vijnë duke lënë të njëjtin tekst e duke përditësuar vetëm shifra, natë e ditë:

*”23 marzo 2020, Italia, i morti sono 601, in diminuzione rispetto a ieri 651 e altro ieri 793. Lombardia: Treno in calo. Luce in fondo al tunnel. A Bergamo scende il numero dei ricoveri, positivi con Covid 19: 6471, +255 in 1 giorno”.

E fik, por tanimë është tepër vonë. Burri me një çantë në dare sapo ka kaluar semaforin dhe është vëtëm pak metra nga shtëpia jote. Kthehesh dhe i hedh një vështrim të fundit shtratit tënd martesor, duket i parregulluar, por ana majtas ku fle gruaja jote dyzetetë vjeç ka mbetur e paprekur.

... kthen pak kokën majtas dhe e vë re, aty poshtë, imcake, e pa interesar, një kokë ovale që vjen e zgjatet, në zbritje, duar të mbështetura mbi një banak të gjerë e të bardhë, një figurë që ngadalë bëhet e njohur për ty dhe ti haitesh për herë të dytë, kësaj radhe i shtyrë nga diçka që nuk e njihje brenda teje, një mall, si ai që të godet në zemër fill pas një shikimi në ikje,...

Me pas, bën një xhiro nëpër dhoma, si fillim shko në sallë, ku, deri pak ditë më parë, rrinte babai yt tetëdhjetedy vjeç. Nuk është. As telefoni. Ka mundësi të jetë kujtuar ta marrë me vete, në momentin që do e transportonin me barelë. I ka mbetur aty ushqyesi i baterisë. Kot. E heq dhe flak tutje mbi divan. Kalon pastaj në dhomën e vajzës tënde. Zakonisht, një rrëmujë e vërtetë: libra tek rrobat, këpucë mbi poltron,

sende, karfica, vathë, një tablet i ri i papërdorur mbi tryezën e studimit. Tani të tremb rregulli i ftohtë që mbretëron aty, gjithçka në vendin e vet. Ajo nuk është.

Je gati të nisesh. Boshi i shtëpisë të vjen me një shurdhëri të zgjatur, një cingërimë në vesh që nuk të pushon, e megjithatë ti e dëgjon mirë zilen që bie.

Shkon te përgjigjesh, nuk të flet askush. E lë hapur dhe përgjon, vijnë zhurma sirenash të ambulancave edhe aty, po ti po kërkon të dëgjosh kush është. Nuk ke guxim të pyesësh i pari. Dëgjohet dera e hyrjes kryesore poshtë që përplasat në mbyllje. Do ta ketë hapur dikush para teje, pasi kur ti flet, nuk merr me asnjë përgjigje. Ka shtypur butonin tënd pa dashje. Nuk ka kush vjen tek ti. Ul receptorin.

I afroresh derës së re të blinduar, vënë pas dy vjedhjeve të njëpasnjëshme të shtëpisë, por e di që të mungon syri magjik. Afron veshin dhe dëgjon zhurmën e ashensorit. Do shkoje tek kati lart, thua, por shpejt dëgjohet dera metalike e katit tënd që hapet.

Sapo ke humbur edhe mundësinë e fundit, se mund të dilje ngjitej ashensori e të merrje poshtë shkallë me nge. Mund të jetë djali i zonjës së derës përbri. Është e moshuar e ai ka dy ditë që nuk vjen ta kontrollojë nëse është ende gjallë, kjo, se në këtë pallat kanë vdekur deri tani dy pleq me koronavirus.

“Pastaj e lëshon veten, pret të dëgjosh zilen tënde, e po ndjen hapa që afrohen drejt derës dhe dikë që dihat aty.

Kush mund të vijë të kontrollojë ty? I ke ca shenja të lehta, por askush nuk është në dijeni të këtij fakti. Pastaj, nuk ke ndokënd në këtë moment që do të interesohej për ty.

Ja, filloj prap! Ai ankthi djalit të vdekur që kthehet në shtëpi, të kap sa here që bie zilja.

Edhe ideja për të mos e vënë syrin magjik nis nga ky ankth. Kur afrosh të vije syrin tek dera e mëparshme, të dukej sikur shikoje supin e djalit tend që e ke humbur vite më pare. Ishte një ëndërr që të robëroi dy ditë pas humbjes së tij, e cila do të shndërrohej pastaj në këtë ankth që përsëritet. Ti vazhdon kthimin e tij. E hap derën para kohe, se nuk duron dot më.

Një fytyrë e njohur, po, po, e njeh, po çdo këtu ky? Nuk ka moshën e djalit tend, edhe pot ë ishte gjallë, i ka kaluar me kohë të tridhjetat. Të përshendet me një ‘T ‘jeta profesor!’, vë re habinë tënde e të thotë se ka ardhur me vrap, në këmbë, nga burgu në rrugën Gleno i Bergamos. E

njuh. Është burri i kushërirës së gruas tënde.

Arratisur nga burgu! Fillon ta bësh një lidhje.

I ul sytë tek çanta e tij. Kishe dëgjuar për revoltat e të burgosurve në gjithë Italine, po burgun e Bergamos nuk ta kishte zënë veshi, mbase thjesht nuk ishte përmendur nëpër kronikat televizive! Dije që kishte pasur dhjetë të vdekur midis të burgosurve në përplasjet me policinë në burgjet e tjera. Si e merr guximin ky të arratiset e të vijë drejt e në shtëpinë tënde!

Por ai është i lumtur dhe e ka shumë të vështirë ta fshehë këtë fakt. Duke parë ngurrirnin tënd, rrëmon në çantë e nxjerr që aty një letër e ta zgjat. Ti nis e lexon tekstin në italisht duke e menduar në shqip: Urdhëresë! Ç ‘punë kam unë me këtë urdhëresë. Vijon leximin duke i hedhur sytë ku është nënvizuar thelbi i përmbajtjes së kësaj shkrese: urdhërohet zëvendësimi i masës së sigurisë me burg në arrest shtëpie, lëshuar nga Gjykata e Bergamos.

Mos! E kupton se ku është fjala. Një kërkesë për arrest shtëpie e prezantuar nga i burgosuri gjashtë muaj më parë, firmosur nga gruaja jote, pastaj edhe nga ti vetë. Duket që është marrë në dorë këto ditë, mbase nisur nga situata e pandemisë së koronavirusit.

Ky djalë është treguar më i shpejte! Ti ishe veshur, po zbisje, do shkoje drejt e tek stacioni i autobusëve, ta bëje një tentativë për të lënë pas krahëve këtë makth, kur ja tek vjen miku, si miku, pa asnjë paralajërim. Nuk është e mundur, e mendon pas pak më me qetësi, mbase kanë provuar të telefonojnë gruan tënde...

Po, duket i kënaqur që ka mbërritur deri aty para derës tënde. Dhe vihet re që ka menduar çdo çast lirinë e vet. Se ti kujton një djalë në kufijtë e obezitetit një vit më parë, me bark e një rreth të trashë dhjami rrotull ijëve, sikur të mbante gjithnjë veshur një kamerdare, kurse tani ke parasysh një lloj personal trainer-i, i freskët, i porsadalë nga palestra, i cili, në fakt, po merr ende frymë me zor se rrugën nga burgu deri tek ty, tre kilometra, ka mundësi ta ketë bërë me vrap.

Deri diku, ka qënë në dijeni të gjendjes, ka parë pastaj edhe rrugët e shkreta si ka lënë burgun, por mbase e gjitha kjo, nuk i është dukur aq e rëndë sa për t’i fshirë nga kujtesa atë përvojën e freskët të qelisë, sikurse, nga ana tjetër, shpresa e tij për një pikë kthese në jetë, zë fill nga një situatë si kjo. Ai nuk mund e nuk ka përse të bëjë asgjë për ta ndryshuar.

“Nuk m’kanë leju me u kthy tek familja ime.

Më kanë urdhëru me ardhë drejt e këtu, pa taku askënd rruges”, ndërhyt ai teksa të shikon që ja ke ngulur sytë letrës.

Po, ti e di që vetëm pak rreshta pallatesh nga këtu, jeton gruaja me tre fëmijë dhe vjehrrën. Çfarë po na thënka! Nuk shkon dot t’i takojë. Po dihet, është në arrest shtëpie, nuk mund të dale!

Po përse të mos e bënte në shtëpinë e tij!

I hedh edhe një sy më të vëmendshëm urdhëresës, të kuptosh se çfarë thotë më poshtë:

Kjo urdhëresë i ndalon gjithashtu pararendesit që të ketë kontakte, përmes çdo mjeti, me persona që nuk janë familjarë të këtushëm...

E more vesh, familjari i vetëm në këtë banesë je ti. Do mbetesh mbyllur me të kushedi për sa kohë, mbase me muaj të tërë. Familjarët e tij të vërtetë nuk lejohen të vijnë e ta takojnë. Të hipën keq inati e nuk arrin ta kontrollosh dot veten.

“Shiko këtu mor ... se nuk po me kujtohet emri ...”

“Artur!”

“Me dëgjo pak, mor Artur. Unë pranoj gjithçka, për atë Zot! Ja, e dëshmojnë edhe këto letra që i kam firmosur. Po mos të shkojë mendja që i kam këmbet e lidhura. Se nuk kam nga t’ia mbaj. Këtë ta dish, njëherë. Nëse kam firmos, e kam bërë për gruan time. E more vesh?”, ndalon ti për një pauzë të shkurtër.

...afrohesh e shikon sytë e saj që të vrojtojnë sikur po vërenin një objekt të mrekullishëm, bebëzat lëvizin, si gjatë aktit të leximit e timbetesh i ngrirë...

“Se jam dakord, deri tek letrat, në rregull.

Edhe për shtëpinë, në djall të shkojë, nuk po e vras mendjen! Por mos mendo se do të rri këtu me ty e të bëhem gardiani yt! Jo! Këtë nuk e pranoj! Mjaf t! Unë po iki! Ja ku i ke çelësat.

Shtëpia është e jotja. Bëj çfarë të duash!”

Ti bën ecejake në korridor, me duart kryqezuar, kurse Arturin duket që e ka zënë frika, edhe pse nuk guxon të hapë gojën.

“E more vesh?”, përsërit tani me një ton tjetër, thujse dorëzimi.”

“Po. Po nuk kemi çfarë bajmë. Kështu asht kjo punë, nuk varet ma nga ne. Ju, zoti Donat, tani jeni i detyru të qëndroni me mu, n’shpi, sepse baheni garant i pranisë sime këtu, përndryshe ...”

“Përndryshe çfarë?”, i hedh sytë nga çanta që ka lënë pranë këmbeve. Ky mendoka se do behem une i burgosuri i këtij.

“Jo, jo në atë kuptim ...”, do te thotë që nuk po të kërcënon.

“Mor Zot! Po e kupton ti se në çfarë gjëndje jam unë? Shiko, nuk bëhet kjo punë! Do të marr në telefon karabinierët e do të kërkoj sistemim tjetër për ty!”

Nxjerr celularin. Sytë e djalit tani të terrorizuar e nëse është vërtet agresiv, tani mund edhe të vërsulet.

“Po nuk ka sistemim tjetër për mu”, të thotë me një ton lutës. “Të gjithë miqtë e mi janë tërheq. Po më kthyet mbrapsht edhe ju, më pret edhe njëherë qelia!”.

Je gati t’i thuash: ‘Ik, ku ta marrë mendja!’, po pastaj i hedh një vështrim nga këmbët tek koka dh e fut celularin në xhep.

E mbështet kokën në pëllëmbën e dorës së djathtë, duke e mbajtur bërrylin me dorën tjetër, vënë para gjoksit në një kënd të drejtë të, që është pozicioni yt sa herë që je në vështirësi.

Në një situatë normale, mendon, kjo çështje do ishte zgjidhur pa pikë problem! Dhe fillon të fantazosh, duke kaluar në skajin tjetër. Mendon një hipotezë, ku ai do të qëndronte patjetër këtu me ty, se është urdhër gjyqi e nuk mund të zhbëhet lehtë, madje ti shkon më larg, hamendëson sikur mund lejohej edhe prania e familjes së tij. Ai me gruan dhe të voglin në karrocë tek dhoma juaj e gjumit, ti do të zhvendoseshe tek dhoma e vajzës, nëse nuk do çmendeshe, të dilje e të merrje arratinë, kurse dy fëmijët më të rritur në sallë.

Mbetje të shtohet edhe një krevat portative për vjehrrën. Dhe e ke krevatin për të, lart në depo. Prandaj e mban, gati, e përdor sa herë që të vinë miq. E shoqëron këtë mendim me një të qeshur të hidhur.

Kjo do të ndodhte në një situatë pa virusin vërdallë, por sidomos pa ato kufizimet e dekretit të fundit nxjerrë nga Qeveria, i cili ndalon zhvendosjet e njerëzve nga një komune në tjetër, që të ulen sa më shumë rastet e prekjeve të reja nga virusi. Se po të ishte një situatë tjetër, ti nuk do të ishe fare i zoti ti ndaloje. Në një farë mënyre, kështu, je i mbrojtur. Jo se, nëse dikush nga të tijtë del mendsh, për shembull, e shoqja e, vendos ta takojë burrin me çdo kusht dhe e pastaj e kapin, ajo rrezikon gjobë të majme dhe burg. Zgjidhja më e mirë për ty do të ishte që atë ta çonin menjëherë ne Shqipëri, se edhe dokumentet i ka të skaduar. Se sa për burg, ka shumë mundësi ta sillnin e ta plasnin këtu tek shtëpia jote! Se do e pyesnin, kë ke këtu në Itali, kam kushërirën do thoshte. Punë dreqi!

Nuk vendos ti për shtëpinë tënde.

E të vjen në mend një ide e një seminari filozofik, të cilin vitin e

kaluar e ke mbajrur në Nembro, pranë Bergamos, një qytezë e cila këto ditë është bërë një varr i hapur. Ke folur Mbi mikpritjen* bazuar tek koncepti që ka për të Jaques Derrida, i cili na e thotë qartë: asnjëherë nuk jemi ne pronarët e vendit që për mikpritje. E përdorë në kuptimin gjuhësor, në thelb na thotë se që prej lindjes së ligjëritimit ne nuk mund të jemi pronarë të një realiteti të tillë si gjuha, që e ndajmë bashkë e prandja pastaj vjen e quhet njerëzor, shoqëror, simbolik.

E tillë është edhe shtëpia, një vend marrëdhëniesh njerëzore, ku askush nuk mund të jetë plotësisht zotërues.

E fton brenda. Gjatë e ke lënë në derë.

Nuk ka shtrëngim duarsh, takoheni me atë mënyrën e re, prekni bërrylat. Por ti ke mbetur ende i ngurt aty në derë.

Ai e merr këtë si një hezitim tjetër, edhe pse ti në fakt je thjesht i përhumur, po rrekesh të pajtohesh me fatin tend. Ndalet në korridor, vendos për tokë edhe një herë çantën dhe nxjerr që aty një letër të dytë. Ta zgjat. Ti i hedh një sy:

Relacion shëndetësor. Nuk ka trashëguar sëmundje të mëparshme, ka bërë testin Mantoux dhe rezulton: negativ, sierologia negative...

Nuk lexon më, po e bëje thjesht për merci, vetëm për të fituar pak kohë, nuk je mirë. I dorëzon dhomën e vajzës. Dhe menjëherë u telefonon karabinierëve, u komunikon se i burgosuri erdhi dhe se është në ruajtje me arrest shtëpie në banesën tënde. U jep numrin e celularit, - i vetëdijshëm që nga ky çast telefoni yt do te vihet në përgjim, - adresën e plotë dhe u komunikon ernrin që është shkruar në kutinë tënde postare.

Nga ky moment, nuk duhet as të shkojë nëpër mend të lëvizesh nga banesa jote. Mundësia për mbërritur tek shtëpia e dyte në liqen, për ta kaluar atje karantinën, nuk ekziston më as teorikisht. I ke ca shenja fillestare, temperaturë 37°C, pak kollë, një dhimbje muskujsh dhe kockash. Je i vetëdijshëm që nëse guxon e del me temperaturë, të çojnë drejt e në burg, mbase edhe tek qelia e liruar e të burgosurit që sapo ka zënë vend në dhomën e bijës tënde.

Zbraz edhe njëherë valixhen që kishe bërë gati. Hajt, të paktën shtëpia nuk është më krejt bosh. Nuk e kishe menduar kurre se do te viheshe ndonje ditë në rolin e gardianit, kurse të burgosurit, po, kjo mbase edhe mund të ndodhte. Në dhomën ngjitur, sapo është shtrirë një njeri nën mbrojtjen tënde të plotë.

Rikthehesh edhe një herë tek tryeza jote e punës e nis të shkruash.

2.

24 mars 2020

Rezervat e ushqimeve në shtëpi janë pakësuar shumë, se nuk është blerë asgjë prej ditësh. Ti vetë po bëheshe gati të ndryshoje vendin e karantinës. Tani nuk del dot, se e ndjen që ke ndonjë vijë temperaturë më shumë. Nuk ngrihet më lartë, rri ashtu, me sa duket, që prej dy ditësh, por ti nuk e di as se sa grade temperature konsiderohet e lartë, në rast se do të ndalte ndonjë patrullë. Duhet të jetë pertej 37,5, në mos gabohesh, por nuk je i sigurt. Po sikur, sapo të dalësh, të ndodhe që ajo të ngrihet befash? Nuk ke përse të rrezikosh, hë për hë. Mos luaj vendit.

Arturi i ka bërë shtëpisë një pastrim të përgjithshëm, por ka dhënë prova edhe që është i zoti të gatuajë. Ky është një lehtësim i madh. Do të ishte tradhti edhe ndaj gruas, së cilës nuk është se i rri gati në punët e shtëpisë, nëse ti këto ditë do çohesh e do t'i bëje vetë të gjitha: pazarin, gatimin, hedhjen e mbeturinave, pas trimin, larjen e rrobave, hekurosjen. Hekurosjen jo, kjo nuk hyn me ne punë përderisa nuk dilet jashtë.

Ka bërë makarona për dy vetë. Pikërisht, në raftin e ushqimeve ka vetëm makarona dhe një sasi të madhe salcë kalabreze 'nduja', tejet e shijshme, por edhe shumë pikante. Nuk keni tjetër. Ju mugon buka, djathi, gjithçka.

Si ka ardhur puna mendon ta zgjidhësh duke u telefonuar karabinierëve, ti infomosh me kohë që je i sëmurë, madje edhe më keq, mbase i prekur, se kështu do të ndihmojnë në një farë mënyre. Të shkon mendja edhe tek djaloshi në arrest shtëpie, mbase mund të dale ai të blejë ushqime në vendin tënd. Dhe këtë ja thua atij, nuk të rrihet. Djaloshi shqetësohet, të lutet të mos e bësh këtë telefonatë. Shton, që të bindë, se në shtëpi ka edhe miell, ka vaj, ka hudhra, shkurt mund të rezitoni edhe ca e ti, ndërkohë, bëhesh më mirë.

"Po ka edhe zgjidhje të tjera, mor zoli Donat, pa thirr karabinierët, mund të kërkojmë thjesht ndihmë. Mund të na i sjellin ushqimet në shtëpi.

Ja si kjo zonja përbri nesh. A e keni pa si ja sjellin? Vetëm karabinierët jo, të lutem!"

"Ti nuk arrin ta kuptosh dot frikën e tij ndaj karabinierëve, nuk hyn dot në psikologjinë e dikujt që mbase e kakaluar jetën duke u fshehur 'të zinjve', siç u thonë këta. Nisesh nga përvoja jote. Vijon me celularin në dorë.

“Te lutem, fute në xhep atë celular!” Tani Arturi e ka ngritur zërin kërcënueshëm dhe, e vë re shpejt, e ndryshon tonin. “Unë di ta baj edhe bukën vetë. Ujin e kemi. Nga çezma. Kemi edhe kripë! Nuk na mungon kurrëgjja!”

“Bukë e kripë e zemër!”, shton ti me ironi, duke kujtuar formulën e mikëpritjes shqiptare.

Djali edhe mund të ketë të drejtë në thelb, ti e di, që mund ta shtyni edhe për ca kohë, por ai sheh veprimet që ti bën me celular, kjo i thotë që nuk ke ndërmend të tërhiqesh. E ku e di ai se çfarë thirrje ken ë mend të bësh. Ç’tu desh që fole, të duhet të japësh llogari tani për veprim që bën. E ndjen se mund edhe të vërsulet, por ti e bën telefonatën.

E vë në vesh smartfonin dhe e ndjek me durim teksa bije zilja. Djaloshi zbehet fare. Paska shume frikë.

“Për çfarë je akuzuar?” e pyet me celularin në vesh. “E ke marrë dënimin përfundimtar?”. E ul mbi tryezën e bukës atë drejç telefoni, se numri nuk përgjigjet, pastaj, në të kundërt, ai do mbetej aty i mekur, pa hapur gojë.

“Jo, hala jo, jam në pritje. Kam shkelur Nenin 73 të Kodit Penal, jam akuzuar për trafik dhe mbajtje të paligjshme të substancave narkotike ose psikotrope”.

“Ke shpërnda drogë, pikë muhabeti! Pa shiko çfarë fjalori! Duket sikur studion për drejtësi. Ta dish, duhet ta konsiderosh veten me shumë fat që të kanë lënë në arrest shtëpie! Dija për nder koronavirusit!”

Do ta shpjegoje rastin e vet, por është i terrorizuar teksa shikon që ti kërkon sërish një numër në display. Bën një hap prapa, se tani vërtet diçka mund t’i shkrepë në kokë, ka një shikim që vjen e bëhet më i frikshëm. Ku e di ti si e ka punën. Mbase është mësuar edhe vetë të konsumojë lëndë narkotike dhe ke dëgjuar se ajo hyn edhe nëpër burgje. Këtu tek ti nuk do ta ketë e i bie, të jetë në një burg më të fortë.”

“Nuk e kam ditë deri në çastin e ftindit që do dilja në arrest shtëpie”. Djaloshi e ka hedhur një hap përpara. Flet i qetë, por të duket se ka ndërmend diçka tjetër me veprime. “Më dhanë letrat t’i firmos e më thanë të vij drejt e këtu, të mos i flas kujt e të mos e kthej kokën fare rrugës, të mos kërkoj të hyj në kontakt me askënd që nuk është banor i kësaj shtëpie ...”, përsëriti me ritëm një informacion që ti e dije. Ti e shtyn edhe njëherë telefonin tutje, pastaj kujtohesh se nuk duhet ta ketë ai pranë, kushedi ç’i shkrep, ta merr, i telefonon dikujt nga miqtë që ka jashtë e të arratiset fare. E merr edhe njëherë celularin në dorë.

Ai t'i ndjek të gjitha veprimet me sy. Kujtohet pastaj për diçka që ka dashur ta thotë me kohë e i ka ikur nga mendja . “Harrova me ju pyet, zoti Donat, ku i keni robt e shpis’, Adea, Elira, baba?”

Ti nuk do e nuk mund t'i përgjigjesh kësaj pyetjeje.

“Po, dihej se këtu do të vije, ku mund të shkoje tjetër?”

“Jo, fakt unë kam ba shumë kërkesa të tjera për arrest shtëpie, edhe në adresa të shokëve e miqve.”

Bën dy hapa të tjera dhe mat largësinë me sy, nëse duhet që të afroresh edhe më shumë. Tani. Të sulet për të kapur telefonin, por ti shmangesh në kohën e duhur. Të hipën gjaku në kokë!”

“Rri i qetë mor burrë, po marr doktorin në telefon! A po merremi vesh? Ta marrë dreqi këtë punë! Do të marr leje tani për çdo telefonatë!”

Mbetesh për një kohë të gjatë i zbehtë në fytyrë dhe shfrytëzon kohën e ziles që bie për t'u qetësar, por edhe për të reflektuar. Nuk të hyn në punë ta nxehësh djalosin. Se ti harron që ke të bësh me një te burgour, në fund të fundit. Duhet të kesh shumë kujdes që të mos e provokosh.

“Ku e lamë muhabetin? Ah, po ke të drejtë, mund të rezistojmë ende. Mbarojmë këto ushqime që kemi.”

“Tani është tërhequr. Po duket që do të flasë, mbase edhe të kërkojë falje, por sa rreket të thote diçka, ti e bën të heshtë me një gjest me dorë, ‘lëre atë muhabet’. Po behesh arrogant.

Mjeku yt i familjes vazhdon të mos përgjigjet dhe kjo po ndodh prej ditësh. Ke një parandjenjë të keqe, sepse midis viktimave në qytetin tënd janë edhe nja dhjetë mjekë deri tani. Për të mos përmendur mbi njëqind mjekë të sëmurë në të gjithë provincën.

E lë djalin në kuzhinë dhe shkon në dhomën tënde, i afroresh dritares nga ku shikohet kisha e Shën Zefit. Të vjen aty brenda zhurma e kamionëve. Kisha është shndërruar në një depozi të për arkivolet që vijnë nga Lugina Seriana. Në orët e para të mëngjesit është bërë transferimi i dyzetepesë kufomave. Zakonisht, siç ka ndodhur edhe në kishat e tjera, ku lënë të vdekurit, në fillim bëhet bekimi dhe shenjtërimi i arkivoleve dhe më pas ata ngarkohen nëper kamionët e ushtrisë për t'i dërguar në krematoriumet e krahinës Romanja: kanë dërguar njëzetë arkivole në Ferrara dhe njëzetepesë në Koparo, por ndërkaq vazhdojnë të vijnë arkivole të tjerë.

E le dritaren dhe zhvendosesh në shkrimoren tënde. Të duhet, për t'u qetësuar, të vihesh e të shkruash menjëherë diçka.

* * *

Zgjohesh kur motorët e avionit ndryshojnë zhurmën e sakonshme në një si fishkëllimë që paralajmëron uljen. Ti e di që në aeroport të pret gruaja. Pas pak minutash do të zbresësh.

... nuk je Orfeu, e di, por sërish nuk rrezikon, nuk do ti rrish para, nuk të duhet një kthim koke pas. Rrini bashkë në një linjë, kapur për beli, mahnitur nga kjo habi që nuk habit, e cila po ju ngre lart drejt qiellit...

Tani shikon liqenin Izeo, që e njeh mire, shtypja atmosferike të shkakton dhimbje tek veshët si gjithmonë, pa ndonjë qëllim, tani është përqendruar tek shpinorja e një ulëseje tre rreshta përpara, nga ku derdhet si ujëvarë floknoja e dendur e një gruaje, e pranuar befas nga dielli që hyn nga dritrja pas një kthese të fluturimit. E pikërisht dielli, që siç duket e bezdis, e bën të kthehet djathtas. Ti e shikon në prozfil. Është një e moshuar mbi të shtatëdhjetat.

Si fillim vetëm kaq, por shpejt diçka e njohur, ngacmuese, të fut ngadalë në një alarm.

Ka filluar zbritja dhe ti përhumbesh në një kujtim të ditëve të fundit, të cilit nuk do t'i japësh gjithsesi një formë reale, të momentit, edhe pse e përjeton gjithmonë në të tashmen, aq me pak ta bartësh me vete..”

Nuk je i sigurt ku e ke parë për herë të pare floknajë, kështu nga prapa. Duket, të jetë po ajo që të shfaqet gjatë takimeve për paragjitjen e librit tënd të fundit në Shqipëri. Ndodh kur do mbyllet gjithçka, ti fillon të lexosh në publik fragmente nga teksti dhe e ndjen që është aty, si qenie e një pranie që ikën, e një rendje drejt gjurmës e ti je gjithnjë pak me vonesë, kap mbresën e asaj që ndodh, kur kjo fshihet, thahet, tretet, humbet, por të bën ta ndjekësh. Si vetë leximi. Nga vetja jote ngjallen copëza jete e kujtimeve e ndërthuren fill me atë që të jep teksti.

Të çojnë pastaj në drejtime të papërcaktuara, jashtë kohës. Prej këtyre ndjesive e impulsive plot imazh vjen e merr formë diçka krejt e qartë. Ti shikon shpinën e një gruaje që ikën, flokët e saj që tunden lehtë e hidhen lart, a thua se do ta marrin me vete trupi n e saj të brishtë e do ta shpihen diku larg sapo ajo të kalojë pragun. Dëgjon zhurmen e derës që përplasat. Kjo të ndodh.

Po ti nuk e njeh ende kush është, se nuk përmbillet njohja me një imazh që e ke parë në ikje. Aty rëndom fillon malli. Të kujton diçka, por ti i shikon vetëm shpinën e, në çastin kur hap derën, edhe paksa profilin. Fill më pas, i hedh një sy vendit bosh ku ajo sapo ishte ulur. Çohet

gjithmonë kur je nën kthetrat e çastit sublime të leximit.

E ke gjithmonë atë impulsin që të shtyn të çohesh, ta ndjekësh, të vraposh pas saj, të kuptosh kush është dhe për çfarë motivi të thërret në këtë ikje, por nuk e bën dot, je i përfshirë në diçka tjetër. Është vonë kur gjendesh jashtë dere ajo nuk është. Vjen në vete, se dëgjon xhirimin e gomave të një taksie që ikën. Nuk je i sigurt se ka të bëjë me të.

Vetëm se, ky ritual përsëritet. Kthehesh teklexuesit, lëshon autografe për ata që sapo kanë hyrë në një marrëveshje besimi me librin tend dhe të mbetet të mendosh për takimin tjetër. Do kthehet, je i sigurt, vetëm se duhet të jesh më i vëmendshëm në fillim.

Do të jetë qyteti radhës, e ke të shkruar në program, me njerëz të tjerë në sale, megjithatë t'i këqyri mire ata që ke përballë, sidomos gjatë kohës që nuk të takon të flasësh. E bën dhe nuk ia vë dot gishtin asnjëherë. Vjen akti përmyllës i leximit dhe të ndodhë përsëri. Mbaron me një derë që përplasat.

“Andrea!”, e pyet botuesin tënd që është ulur bri teje. “A vë re ti dikë që çohet dhe ikën bash në çastin kur unë jam duke lexuar?”

“Je i lodhur, Donat. Hajt’ se është takimi i fundit”. Të bie shpatullave. “Jo, jo mor burrë, nuk e kam vënë re. Ah, po edhe mund të ndodhë mor. Po njeriu ka njëmijë arsye të çohet e të ikë ku t’i teket, edhe gjatë leximit. Apo jo?”

“Po tani a u çu njeri e iku, tani mor, kur po lexoja?”

“Tani jo, jo, jo, nuk doli askush. Unë të paktën nuk kam vënë re”.

“Dy orë më vonë, je në një studio televizive në Korçë, qytet në jug të Shqipërisë. Të ndodh sërish, edhe këtu kur po lexon një pjesë nga teksti yt. Kësaj radhe në studio jeni dy, ti dhe bashkëbiseduesja, e cila ka mbaruar me pyetjet e po ndjek leximin tënd. Ti dëgjon një dridhje të zgjatur të celularit që e ke lënë rmbi tavolinë jashtë fokusit të kamerave. Reagon edhe intervistuesja, që ndjek vështrimin tënd për një çast, duket që ka një ndërdyshje e ti ngul sytë.

Ti lëviz nga vendi e zgjatesh. Tani të bëhet se vëren fytyren e saj në ekran. Po si? Kush e hapi videothirrjen? Aja është! Tani një zonjë e shkuar në moshe, të cilën nuk e ke parë që prej njëzetë vjetësh. Ajo është! Po çfarë do nga ty, xhanëm? Dhe tani? Ti zgjat dorën e çohesh vrik të kapësh telefonin që po dridhet e po zhvendoset ne zgrip të tavolinës, në rënie, do thyhet. Intervistuesja është me e shpejtë. Ta kap dorën tënde në ajër, fort, me pezëm.

“Stop!” dëgjohet fill një zë nervoz nga brenda studios, mbase

regjisori i prograrnit. Ti nuk e sheh.

“Kush ishte, Gerta? Ju e njihni?” , pyet intervistuesen dhe fërkon dorën. Ta ka shtrënguar fort. Dhëmb.

“Ju nuk ndjeheni mirë, zoti Donat. Nuk ishte askush”.

E megjithatë ti kërcen kah tavolina e merr celularin në dorë dhe kërkon të identifikosh videothirrijen e fundit Nuk ka asnjë gjurmë. Është thjesht nje mesazh nga Andrea që thotë se po pret tek një restorant tek Pazari.

“Je mirë tani? Rifillojmë? Çfarë ndodhi?” , interesohet intervistuesja.

“Nuk mora vesh asgjë. Vetëm se, sapo gjeta titullin e librit të rrardhes, po ta them ty për here të pare e mbaje mend nuk do e ndryshoj; “Një prani në ikje”.

* * *

Të ndërpritet zëri djalit që të fton të hash në kuzhinë.

“Është gjithçka gati! Kam përgatitur makaronat. Kemi boll! Bukën po e gatuj nesër, ma mirë”.

“Ha se je i ri, ti. Mua nuk më hahet tani, vij më vonë” i përgjigjesh.

* * *

Nuk je i sigurt se floknaja përpara është e saj, e njeriut që të sjell këtë angështi e të bën të përjetosh atë ndjesinë e provuar gjatë paraqitjes së librit tënd. Po diçka do të ndodhte, dihej. Të gjitha personazhet e librit tend të fundit janë njerës që i njeh dhe u druheshe reagimeve të tyre, gjatë takimeve, kudo. Është e habitshme se si “reagon” një grua e cila nuk është pjesë e librit tënd. Mbase këtu duhet gjetur edhe arsyeja. Por sigurisht, kjo është një histori krejt tjetër.

Ndjen frenimi e avionit fill pasi ka prekur tokën dhe e vuan vetë, sikur po të ndodh ty.

Mbeteni për pak çaste me rripat e sigurimit ende të lidhur, por fillojnë e dëgjohen shpejt zhurmat e të paduruarve që i zgjidhin para kohe, pastaj sinjalet e celularëve, edhe i yti.

“Donat, zemër, a u ulët? Çfarë të bëj, të nisem unë?”, të shkruan gruaja.

“Sapo u ulëm! Llogarit një çerek ore, që të jem jashtë. Te kam xhan!”, i përgjigjesh. Dhe e di që të pyet për të mos paguar orën e parkimit në

aeroport. Shtëpia juaj është fare pranë pistës. Sa herëe që del për vrap, në parkun ngjitur, të takon ti kesh avionet mbi kokë në zbritje, çdo trekatër minuta, e të duket vetja në fund të detit me peshkaenë e balena sipër.

Ngre kokën. Ajo nuk është. Filloi prapë kjo punë? Jo, mjaft!, i thua vetes dhe zgjatesh të kapësh valixhen tënde. Ecën duke shtyrë ndonjë udhëtar, por megjithatë bllokoresh gjatë në korridor. Shkallët i zbret shpejt, po sa para bën, ajo ndërkaq ka mundur të hyjë në autobusin që i mbyll dyert para syve të tu. Do presësh tjetrin. Shikon floknajën e saj të kuqerremtë, në fund, pas xhamit. A thua të jetë thjesht një halucionacion? Po përse ky persekutim, ti nuk i ke bërë asgjë të keqe kësaj gruaje. Të paktën e gjykon ti.

Por, edhe nëse është vërtet ajo grua, do të jenë të paktën mundësitë për ta takuar. Është gjithmonë një hap përpara. Mund ta shikosh me shpinë, gjatë kontrollit të pasaportave, po prapë do të ikë, je i sigurt. Nuk është ajo që të ndjek, me sa duket. E ke vetë në dorë. Ngadalëso pak. Mbërrin autobusi i dytë dhe t'i hipën, në fund. Në rradhën e kontrollit nuk është. Ke një moment çlirimi. Është hera e pare, sot, që i hedh sytë qëllimisht për ta pare dhe nuk e sheh.

Pak para kontrollit, të afrohet një burrë me veshje mbrojtëse nga koka tek këmbët. Janë shumë si ai, vënë si një digë, para njerëzve, me termometra elektronik në dorë. Kur ja, të del para një djalë që e paska me ngut. Nuk paska fat se e ka të lartë, e ndalojnë bashkë me një grup të vogël njerëzish si ai. Ajo grua nuk është midis tyre, ka kaluar. Të takon ty tani. Aparati është në distancë, po ti ndjen një si kruarje në ballë sikur ta ka ngjeshur mire në lekurë. Je në rregull. Kalon pastaj edhe kontrollin e pasaportave.

Hapet para teje dera automatike, nga ku arrin të shohësh menjëherë gruan tënde që të përshëndet me dorë, midis pak njerëzve që ruajnë distancë midis tyre. Jo, nuk janë pak, por janë vënë në një si radhë që gjarpëron përgjatë gjithë sallonit të pritjes së udhëtarëve. Përshejton hapin. Të ka marrë malli. Gruan nuk e sheh që prej dhjetë ditësh e të duket një jetë. Nxiton ta takosh, i çliruar, më në fund, edhe nga ky makth i fundit.

“Adea!” e thërret me zë të lartë, se e shikon që ajo është drejtuar për nga dalja, të ka pare dhe ikën. Ndalo pak, çështë ky nxitim! Më prit!”

Nis një vrap të shkurtër që ta kapësh dhe ta përqafosh.

...buzët ngjiten e fill rrëshqasin lirshëm tek njeri-tjetri, gjuhët takohen

si dy udhetarë në rrugë e shkojnë për të kërkuar nektar gjithmonë e më thellë, secili për hesap të vet, duart rrëshqasin nëpër shpinat, derisa ndalen pas një shiu të lehtë duartrokitjesh. Shkëputeni ngadalë dhe takoni gotat me të gjithë...

Ajo kthehet, por sa shikon që afroresh të ndal me nje gjest me dorën e djathtë.

“Rri larg, mor hut!”, ti e shikon që nuk ka ligësi, i qeshin sytë.”

“Ende nuk e ke marrë vesh ti. Nuk ka më përqaftime, puthje, nuk e ditke? Mbahet distancë!”, qesh.

“Ah,po, virusi! Në Shqipëri sikur nuk ndjehej fare, mbase është herët”.

* * *

“Tani çohesh nga shkrimorja dhe shkon në kuzhinë. Vihesh para pjatës me makarona, mbuluar me një pjatë tjetër nga Arturi. E heq dhe të përplasen avujt fytyrës, bashkë me aromën e specit djegës të pranishëm në salcen “nduja”.

Ha me shumë shije.

Rudof **MARKU**

(Poezi nga libri “Rrathë të mbrendashkruar”)

MALET

Mbramë vonë, tepër vonë,
Atëherë kur nuk prisja as edhe një trokitje të vetme,
Në oborr dëgjova një rrapëllimë shurdhuese,

Pa arrogancë, por edhe pa ndonjë mirësjellje,
Hynë drejt e në shtëpi.

Malet. Shkundën në pragun e shtëpisë dëborën,
Ashtu siç shkundim pallton kur vijnë nga jashtë,
Në një ditë stuhie.

Të heshtura e tëmençura. Pa shkëmbyer as edhe një fjalë,
Më dhanë të kuptoja së kishin bërë rrugë të gjatë,
Ca përrej kërcenin nga prehri i tyre,
Kapriçiozë dhe njëherësh të ndrojtur,
Ashtu siç janë nipërit në praninë e gjyshërve,
Dy-tre ujq i ulëritën llambës së dhomës
-konfuzion i natyrshëm me hanën,
Një ortek m’u afrua për ta përdorë si nënkresë,
Ndërsa kaprojt’ filluan të ndjekin në TV
Lajmet ma të fundit me të vrarët dhe bursën.

Në mëngjes herë, si të thuash, me gjelat e parë,
Ikën. Pa thënë lamtumirë, madje pa kthyer kokën pas.

Kur fëmijët erdhën nga shkolla,
I pashë nga dritarja tek luanin për herë të parë me gurë,
Tek përpiqeshin të bënin ca mure të shtrembra që
Gjithsesi nuk rrëzoheshin.

LOZNMIM ME HISTORINË

1

Fëmijët luanin në kodrat përreth,
 Në rrënojat ilirike, në gërmadhat greke dhe romake,
 Poshtë mureve të kalasë mesjetare me gurë ciklopikë,
 Tek gjenin monedha të Filipit të Dytë, atit të
 Aleksandrit të Madh
 (Me monedhat e Pirros së Epirit blinim akullore
 Te shitësi i vetëm ambulant i qytetit
 - monedha me të njëjtën vlerë si mijëra vjet më parë.)
 Dhe më vonë lakrimore, heshta të ushtrisë së Pompeut,
 Eshtra të ushtarëve të rënë kushedi në emër të çfarë
 gënjeshtresh,
 Larg nënave me shami të zeza (nënat tona vazhdojnë ende
 të mbajnë shami të zeza),
 Ku ta dinim ne, fëmijë, që loznim nga mëngjesi në muzg
 Me shtizat dhe shpatat dhe heshtat tërë ndryshk,
 Ku ta dinim se të rriturit na shihnin me trishtim

Vetëm e vetëm se loznim me historinë?

2

Nga ditët e largëta ruaj një lakrimore romake
 Nga ato që të vjetrit dikur i mbushnin me lot për të
 vdekurit,
 Të gjetur në një varr të hapur që nuk kish nevojë ta gjenin
 Arkeologët,
 Shkoj në bregun e detit
 Dhe e hedh në thellësitë e ujërave. Lotët janë të helmëta si
 ujërat.
 Dhe deti është i kripur po ashtu. Kush mund ta dallojë
 detin nga lotët ?
 E di se një lakrimore kurrë nuk duhet të qëndrojë e zbrazët,
 Ashtu si sytë njerëzorë që janë të shëmtuar pa lotët.
 Ku ta dija se atë lakrimore, pa e ditur as vetë,
 Që fëmijë e kisha ruajtur në qoshen më sekrete
 Për gjërat më të çmuara që do kem në jetë?

Tetor 2019

NJË ITAKË TJETËR

Në ditën e nesërme pas mbërritjes në Itakë
Pasi bëri dashuri me Penelopën
Pasi lau rrobat tërë pluhur dhe qepi sandalet e grisura
Pasi foli gjatë me Telemakun
Për t'u bindur se ai tash nuk qe më fëmijë
Pasi varrosi kufomat e mëtuesve
Dhe fshehu lotët tinëzarë që kundër vullnetit të vet e tradhëtuan
Pasi përkëdheli qenin besnik i cili gjithsesi nuk e pati njohur përnjëherë
Pasi i vendosi në shtëpi të gjitha sipas shijes së vet
Pasi vari në mur harkun, shpatën dhe shtizën
Dhe oxhaku filloi të nxjerrë po ate tym si para 20 vjetësh,

Mori sëpatën, atë më të mprehtë nga të gjitha,
Preu pemën më të madhe dhe filloi të gdhendë me force,
Me këmbëngulje dhe më me force
(Sepse e di se nuk ka kohepse e di se nuk ka kohë për të humbur),
Zuri të bëjë një anije tjetër
Më të pa thyeshme ndaj zemërimit të Poseidonit
Më rezistent ndaj furive të polifemit
Më të shurdhët ndaj joshjeve të sirenave
Një anije tjetër ku mund të udhëtonte më gjatë
Shumë e shumë më gjatë se njëzet vjet,
Shumë e shumë më gjatë se gjithë jeta e vet,
Fillikat i vetëm, pa asnjë nga shokët e vjetër

Në kërkimin e një Itake tjetër.

Trieste, 2008

(Pjesë nga libri “Retë që shkasin atje tej, retë e mrekullueshme. Antologji e poezisë botërore”, përkthime, Rudolf Marku)

RUDYARD KIPLING (1865 - 1936)

Çmimi Nobël për vitin 1907. Tregimtar, romancjer dhe poet anglez. Autori i librit të famshëm për fëmijë “Libri i xhunglës, - përkthyer herët në gjuhën shqipe – mbetet njëri ndër shkrimtarët më popullor të gjuhës angleze. Që 42 vjeç kur ju dha Çmimi Nobël, i pari shkrimtar angles që ju akordua ky Çmim dhe me i riu ndër shkrimtarët që morën Nobel. Poeti dhe dramaturgu gjerman Breht ka shkruar një variant të vetin poetik mbështetur në këtë poezi të Kiplingut që botojmë poshtë.

Rruga mes pyllit

E mbyllën rrugë përmes pyllit
Shtatëdhjetë vite më parë.
Moti dhe shirat kanë bërë,
Që tani askush të mos kujtohet,
Se dikur na qe një rrugë mes pyllit
Përpara se pemë të tjera të kenë mbi.
Rruga ka mbetë poshtë korijesh dhe shqopishtash
Dhe luleve delicate të amonit;
Veç rojtari i pyllit e di
Se atje ku pëllumbi-gugatës pushon,
Dhe vjedullat rrokullisen aq lehtësi
Ka qenë njëherë një rrugë mes pyllit.

E prapë nëse futesh në pyll,
Kur ajri freskohet mbi pellgjet me trofta që kcejnë në ajri,
Dhe Vidra i fishkëllen të dashurit të vet
(Nuk kanë frikë nga Asnjëri
Sepse Njerëzit janë aq të rrallë këtu),
Në një mbrëmje vonë,
Do dëgjosh një kale që ec me të njëjtin trokëllimë,
Dhe fëshfërimën e një fustani në vesën e njomë
Një kale që çan me trok perms
Vetminë e mjegulltë përreth;
Sikur ata të dy ta njihnin aq mirë
Rrugën e vjetër që kalonte njëherë në pyll.

Por tash nuk ka rrugë që kalon në pyll.

MIKHAIL LERMONTOV
(1814 – 1841)

Është thënë shpesh herë se Poetët janë profetë. Dhe sidomos në Rusi, njerëzit janë aq të bindur për forcën profetike të poezisë, san ë momentet më të vështira të historisë, rusët u janë drejtuar poetëve, po ashtu si grekët e lashtë u drejtoheshin Orakullit të Delfit. Dhe mendoj se asnjë poezi tjetër në botë nuk mund ta ilustrojë forcën profetike të poezisë sa kjo poezi e shkurtë e Lermontovit, e cila në mënyrë të pashmangshme më ka sjellë ndër mend një tjetër poezi, atë me titull “Dredha e Djallit”, e poetit tonë kombëtar, Gjergj Fishta. Profeci, që po botojmë më poshtë, mendoj se është e panjohur për lexuesit tonë, i cili është tepër i njohur me Pushkinin dhe Lermontovin, falë përkthimeve të bëra me mjeshtëri vite e vite më parë, nga ca përkthyes – njohës të shkëlqyer të gjuhës dhe letersisë ruse... Lexuesi i mençur dhe i pa skleritizuar nuk do ketë asnjë

vështirësi për deshifrimin e kësaj Profecie, që duket që ka ardhue pasi Lermontovi të ketë përjetuar prekjën e një shkëndie hyjnore në çastin kur e ka shkruar profecinë e vet. Dhe ta mendosh se Lermontovi ka qenë veç 16 vjeçar kur e shkroi këtë poezi.

Profeci

Do vijë një kohë, nje ditë zi dhe tmerr,
 Kur nga koka e mbretit kurora do bjerë;
 Kur Froni i Carit do fundoset në baltë,
 Dhe njerëzit do ngopen me vdekje dhe gjak;
 S`do ketë drejtësi për nënën dhe foshnjën e vet,
 Ligje për viktimat më nuk do të ketë;
 Kolera kutërbuese, e kalbur, do grijë dhe korrë;
 Dora e saj e uritur njerëzit në grykë do i shtrëngojë
 Guximshëm do ece rrugës nga kasollja në kasollë,
 Fytyra e saj para njerëzve do valëzojë;
 Një det i përskuqur do shpras gjakun me dallgë të stërmëdha,
 Deri sa një njeri- përbindësh papritur do shfaqë, frikë dhe hata!
 Do e njihni këtë njeri, do e ndjeni përnjëherë,
 Se ka ardhë me një thikë të çeliktë, veç për të mbjellë tmerr.
 O Ditë e Zezë! Thirrja juaj, rënkimet, lutjet, dëshpërimi
 Veç sa do e bëjnë të qesh këtë njeri me lot gëzimi;
 Dhe çdo gjë nën vështrimin e tij plot zyrtësi:
 Balli, manteli i tij- do e mbulojnë vendin me tmerr dhe lemeri

▪ Aforizma ▪

Dhimitër DHORA

15 AFORIZMA NGA KOHA E PANDEMISË NGA COVID-19

*ARN replikative dominonte në mjediset ujore të Tokës së para 4 miliardë vitesh, por replikimi i lidhur me vetëriprodhimin ndodhi vetëm tek qelizat e organizmave të gjalla. Viruset kanë ARN, por janë të pajetë, nuk vetëriprodhohen, sepse nuk kanë ribozome. Viruset marrin formë jetë pas hyrjes në qelizat e organizmave të gjalla, të cilat i imponon për të kryer këto funksione.

*Në Rruzullin Tokësor specia Homo sapiens ka numrin më të madh të individëve, krahasuar me çdo specie të gjitarëve të mëdhenj.

*Shtimi eksponencial i popullsisë njerëzore, i bërë në kurriz të biodiversitetit dhe frenimi i evolucionit të njeriut, të dyja përkundër ligjeve universale, kanë mundësuar krijimin e larmisë së viruseve shkaktarë të epidemive dhe pandemive.

*Në luftën më të ashpër për ekzistencë njeriu është përballur brenda species, si dhe me agjentët e epidemive dhe pandemive. Në të dy rastet pasojat shfarosëse nuk do të kishin ndodhur, nëse njeriu do të zgjidhte rrugën e bashkëjetesës.

*Shumë kafshë kanë sisteme imune mjaft interesante dhe agresive, që mund të studiohen dhe të ndihmojnë për zgjidhjen e problemeve të mbarë njerëzimit.

*Potenciali i lartë i genomës, i formuar që në lashtësi është arsyeja që

shqiptarët janë popull mjaft vital dhe me potencial të lartë imunologjik të fituar në rrugë natyrore.

*Stresi i madh dhe stërmundimi fizik shtojnë vështirësitë e përballjes ndaj COVID-19.

Pas shtimit suksesiv brenda trupit të njerëzve në krejt zinxhirët e përhapjes, COVID 19 do të humb gradualisht potencialin e tij gjenetik dhe kjo do të shënojë rëniën e sëmundshmërisë tek njerëzit.

*Për të shpëtuar nga COVID-19 duhet të bëhet vaksinimi, distancimi social dhe fizik, si dhe mjekimi efikas i të sëmurëve, siç bëhet edhe për sëmundjet e tjera infektive.

*Për të shëruar sëmundjen nga COVID-19, duhen njohur më thellë implikimet biokimike, mikrobiologjike dhe fiziopatologjike të mushkërive, zorrëve, zemrës etj.

*Shpëtuan jetën nga COVID-19, por të izoluar në shtëpi u krijuan edhe mjaft shkrime, muzikë, piktura, studime. Përhapja globale e COVID-19 u bë në rrugën më të shkurtër, nga lindja drejt perëndimit, përkundër kahjes së rrotullimit të Globit Tokësor, sidomos në brezin mesatar të Hemisferës Veriore, pikërisht ku popullsia dhe lëvizjet e saj janë nga më të mëdha

*Dy paradokset disfavorizuese në historinë e pandemisë së COVID-19 ishin mosnjohja në shekullin e XXI e virusit shkaktar, si dhe se shtetet më të përparuara kapitaliste të botës patën sëmundshmërinë dhe vdekshmërinë më të lartë.

*Fatkeqësitë natyrore janë thirrje për ndryshimin e madh drejt rendit shoqëror ekologjik. Nëse nuk ndodh, njerëzimi mund të përballet me humbje të paparashikueshme, të papërballueshme, të pariparueshme.

*Duhet vepruar ndryshe nga çka bërë njeriu në historinë e tij. Interesat mjedisore dhe shkencore duhet të kenë përparsi dhe rol institucional absolut, në të gjitha aspektet dhe nivelet e vendimmarrjes dhe zhvillimit.

▪ **Bibliofili** ▪

Valbona **BERDICA**

“ELCIJA I ZEMRES T’JEZU KRISCTIT”.

(Refleksion për revistën e parë në Shkodër)

Revista “ELCIJA I ZEMRES T’JEZU KRISCTIT”, si revista e parë në qytetin tonë, besojmë se ngjall edhe për lexuesin e sotëm kureshtje dhe kënaqësi, ndërsa për studiuesit që vështrojnë me interes zhvillimet e publicistikës shqiptare ajo mund të vijojë të jetë objekt studimi, si edhe shumë periodikë të tjerë që dolën në Shkodër në kapërcyll të ndërrimit të shekujve XIX-XX. Shtypi është i lidhur me kujtesën e një kombi, e tillë ishte edhe “ELCIJA I ZEMRES T’JEZU KRISCTIT”, e cila u shfaq në kontekstin shqiptar të kohës me motivim të fortë jo vetëm fetar, por edhe kulturor. Shfletimi i kësaj reviste na nxit për të kuptuar atë ndihmesë që dhanë paraardhësit tanë në dobi të përparimit. Thuhet që “shkrimi shpreh kush jemi ne si njerëz”; “Shkrimi e bën mendimin dhe mësimin tonë të dukshëm dhe të përhershëm”, këto citime m’u ndërmendën, ndërsa po njihesha me materialin e kësaj reviste, e cila nuk ishte vetëm zëdhënëse e një misioni fetar, por më së shumti u bë edhe zëdhënëse e mendimit përparimtar të kohës. “ELCIJA I ZEMRES T’JEZU KRISCTIT” ka meritën që nuk qasi pranë saj vetëm besimtarët e një besimi të caktuar, por ajo afroi pranë saj edhe besimtarët e çështjes kombëtare dhe adhuruesit e gjuhës shqipe. Revista bashkë me lajmin e lumë, po bëhej përhapëse edhe fjalës së shkruar në gjuhën shqipe (me alfabetin e autorëve të vjetër të veriut, alfabetin latin), në një kohë

kur gjuha dhe shkollat nuk lejoheshin për shqiptarët në përgjithësi. Drejtuesit e revistës ndër vite treguan interesin dhe profesionalizmin e tyre në përmirësimin e kësaj reviste si nga materiali i përzgjedhur, ashtu edhe për nga numri i faqeve që vinte e rritej. Jetëgjatësia e këtij periodiku ishte plot 54 vjet, duke filluar me botimin e parë në vitin 1891, deri në botimin e fundit të vitit 1944. Në faqet e revistës gjendet informacion për festat fetare, uratat, këshillat, që duhet të shoqërojnë marrëdhëniet shoqërore të kohës. Citojmë: “mos me sha, mos mu marrë me pun’ t e t’jerëve, me dashtë prindrit, mos me pi, me respektu gruan si nanë dhe si bashkëshorte, si duhet të edukohen fëmijët dhe si duhet të orientohen njerzit nga puna pasi papunsia është burim i së keqes në familje dhe shoqëri”. “ELCIJA I ZEMRES T’JEZU KRISCTIT” sjell me besnikëri kronika për ngjarjet e kohës si nga vendi, ashtu dhe nga bota. Në fletët e saj ka letërsi, përkthime nga romane të ndryshme, gramatikë shqip, fjalor italisht – shqip, shqip – gjermanisht, mësimet të frëngjishtes, meteorologji, astronomi, kopshtari, reklama, si dhe një material të vyer me foto, që lidhen më tekstet përkatëse. Kronikat letrare na japin informacion edhe për botimet e ndryshme të autorëve më në zë të kohës, si: Ndre Mjeda, Lazer Mjeda, Mati Logoreci, Dom Lazer Shantoja etj. Një meritë të veçantë kanë drejtuesit e revistës për përpjekjet e tyre për ta pasuruar, zhvilluar dhe unifikuar gjuhën, e për këtë flet më së miri letra e falënderimit e dërguar nga klubi “Bashkimi” më 6 nëntor 1908 në emër të Jezuitëve të Shkodrës, duke i falënderuar për përqafimin e menjëhershëm që këta të fundit i bënë alfabetit të miratuar nga Kongresi i Manastirit, si dhe artikulli që gazeta “Lirija”, e cila dilte një herë në javë në Selanik, në numrin e saj të 35 të vitit 1909, i bën jehonë “Elci-së” për përdorimin e këtij alfabeti, duke u shprehur “Këndimin e kësaj së përkoshme ja u këshillojmë gjithë memëdhetarëve, edhe mâ teper Toskëvet qi duanë të fëmijesohen me dialektin gegerisht”. Revista ka vlera të mëdha gjuhësore, të cilat mund të shqyrtohen dhe të interpretohen nga gjuhëtarët tanë. Që nga viti 1908 e deri në vitin 1913 revistës iu shtua edhe një pjesë tjetër, që i dedikohet artit e literaturës. Në vitin 1914 revista ndryshon emrin duke hequr fjalën turke “Elçija” e duke vendosur fjalën shqipe “LAJMTARI”, ndërsa pjesa e dytë del më vete duke u botuar si revista “PËRPARIMI, e cila vijoi të botohet deri në vitin 1916. 2 Përmes kësaj pasqyre të shkurtër besojmë se do i përforcojmë idenë lexuesit të bibliotekës sonë, por edhe më gjerë, se padyshim, “Elçija...”, si pjesë e shtypit të shkruar të

Veriut është një gur i rëndësishëm themeltar, që meriton të interpretohet dhe studiohet në ditët e sotme si vlerë e madhe për kulturën shqiptare. Në mbyllje kam shkëputur një fragment nga përgjigjja që redaksia e revistës në shtator të vitit 1910 i kthen një lexuesi shkodran, i cili ishte shprehur: “E’ shka na duhen nee gramatikat? Na giûhen t’onë e diim mire mieft edhe pa ta...!” Përgjigjja : “Gramatika, kuer âsht e plotshme, nuk t’mson vetun t’perulmen e êmnave , t’verbave e kso tierash; por pershkon fûnd e mâje natyren e një giûhes, e tu’ i shberthye ând e dând vetiit e saja t’nep rregulla t’perrgjithshme e jo veç dialektore, t’iqet para ndryshimet e dialektave e tu’ i shoshun t’ nep se si me shkrue e me folë bukurisht jo vetun mbas t’lypunave por me rrella qi kan temelin shi n’palc t’giûhes e t’dialektave, e kshtu jau zblon Toskëve bukurii e gegenishties, e Gegëve hieshiit e toskenishties; e mbas ktyne diffîmeve tek e mramia shkrimtarët filloine shkruein mâa me lirii e me bukurii, e n’nji mendyrë qi u pelqehet Toskëve e Gegëve per një herit e qi i bashkon t’dy dialektat me doii t’madhe t’letratyres kombetare”. Revista ka vlera të mëdha gjuhësore, të cilat mund të shqyrtohen dhe të interpretohen nga gjuhëtarët tanë. Që nga viti 1908 e deri në vitin 1913 revistës iu shtua edhe një pjesë tjetër, që i dedikohet artit e literaturës. Në vitin 1914 revista ndryshon emrin duke hequr fjalën turke “Elçija” e duke vendosur fjalën shqipe “LAJMTARI”, ndërsa pjesa e dytë del më vete duke u botuar si revista “PËRPARIMI”, e cila vijoi të botohet deri në vitin 1916.

Përmes kësaj pasqyre të shkurtër besojmë se do i përforcojmë idenë lexuesit të bibliotekës sonë, por edhe më gjerë, se padyshim, “Elçija...”, si pjesë e shtypit të shkruar të Veriut është një gur i rëndësishëm themeltar, që meriton të interpretohet dhe studiohet në ditët e sotme si vlerë e madhe për kulturën shqiptare. Në mbyllje kam shkëputur një fragment nga përgjigjja që redaksia e revistës në shtator të vitit 1910 i kthen një lexuesi shkodran, i cili ishte shprehur:

“E’ shkana duhen ne e gramatikat? Na giûhen t’onë e diim mir e miefte dhe pa ta...!” Përgjigjja: “Gramatika, kuer âsht e plotshme, nuk t’mson vetun t’perulmen e êmnave, t’verbave e kso tierash; por pershkon fund e mâje natyren e një giûhes, e tu’ i shberthye ând e dând vetiit e sajat’nep rregullat’perrgjithshme e jo veç dialektore, t’I qet para ndryshimet e dialektavee tu’i shoshun t’nep se si me shkrue e me folë bukurisht jo vetun mbas t’lypunave por me rrella qi kan temelin shin’palc t’giûhes e t’dialektave, e kshtu ja u zblon Toskëve

bukuriit e gegenishties, e Gegëve hieshiit e toskenishties; e mbas ktyne diftîmeve tek e mramia shkrintarët filloin e shkruen maa me lirii e me bukurii, en'nji mendyrë qi u pelqehet Toskëve e Gegëve pernjiherit e qi i bashkont'dy dialektat me dobie t'madhe t'letratyres kombetare”.


-A nuk punojin' t'rrjedhant'gjith ktyne...vjetve per msime permirsimt'popullit t'onë?-A nuk popullarizoj, ne mosë ndopak, shume shum sênde dijet sidomos ne t'Dyten Pjesë qi I kje shtue e njitëtesh 8vjet per perparimt'komit...?-A nuk vjefti Elçija edhë per zhvillim e hjeshtim' gjuhës s'onë tuj msue popullin me kndue e me perdorue saa e saa fjalë t'reja e t'nevojshme?-A nuk kje endë lama letrar ishte e nja disaa shkrintarve qi e ka nnderue e sbukurue tuj botuen'të vjersha e artikuj e edhë shkrime t'gjata e t'çmueshme?-E praa a nuk kje, sidomos neper Gegnii, gzimi I saa e saa shpijave me kallzimet'kândshme et shpeshata qi kaa muejt me qitunn'kto... vjett'jetuemitt'?

Drejtimit i Elçijas



Elçija i ZëmërsT'Jezu Krisçtit ka meritën se është Revista e Parë që përfaqëson shtypin e shkruar në qytetin e Shkodrës. Revistë e përkohshme mujore fetare e klerit katolik. Botohet nga kolegji i Jezuitëve me testurt'Parit Fees, drejtues ishte P.Jak Junku (Jungg) nga viti 1891 deri në vitin 1894. Numri i parëfillon në muajin mars deri në tetor të vitit1891. Ai u botua në gjuhën shqipe duke përdorur alfabetin latin dhe atë të autorëve të vjetër të veriut (vlen të theksohet përdorimi i disa shenjave

piktografike për tinguj të veçantë të gjuhës shqipe, p.sh., shkronja“th”shprehet në dy mënyra të ndryshme).



Urat per t' u zzan gizz ditt e mojit.

Megjithëse një revistë me karakter fetar, solli në gjuhën shqipe informacion mbi besimin, uratët dhe disa rregulla mbi sjelljen p.sh “ Per me cinnrue nner vepra t’mira”; data 21 e muajit maj, sipas “Merame t’posacme per gith ditt e mojit” [një kalendar që tregonte sherbesat e kishës sipas datave perkatëse të muajit].

Merame t' posacme per gizz dit e mojit.

1	P.	S.	sc'	Filipi e so' Jakobi Ap.	Per missione t' Scipinius
2	S.	S.	sc'	Atanasio .	- Per Ipesekvi.
†	3	D.	T'	getunit e scëites Krug.	- Per sabrin ner travai.
4	H.	S.	sc'	Monik.	- Per nana t' ksetëna.
5	H.	S.	sc'	Pio V. Pap.	- Per Scëitin at Pap.
6	M.	S.	sc'	Gnon Damasceno.	- Per Skiee.
7	E.	T'	Scelbumit.	- Per discirin e Parriët.	
8	P.	T'	dukunit i So' MhiAit.	- Per cinnresen nner tunnime	
9	S.	S.	sc'	Greghuur Nazianzeni	- Per do t' rii ci muna t' a marrin mrapa Eänin e Tenzot.
†	10	D.	S.	sc'	Isidoro - Per fukaraa.
11	H.	S.	sc'	Lek Pap	- Per daulet t' Scëtes Kise.
12	M.	S.	sc'	Pancrazio	- Per t' kxamit e t' paafeve.
13	M.	S.	sc'	Benedet Pap.	- Per Mesctaar e giakonii.
14	E.	S.	sc'	Pascko Pap.	- Per t' smiut.
15	P.	S.	sc'	Paal i Kruçit	- Per t' travajuum.
16	S.	S.	sc'	Ubald Ip.	- Per t' siełunit e gni dialit kah Eoti.
†	17	D.	RSCAIT	- Per zuntit e Scpirtit Scëit.	
†	18	H.	S.	sc'	Pasqual Bailon - Per reghułtaar.
19	M.	S.	sc'	Pieter Celestini	- Per t' siełunit e mkatnorve.
20	M.	S.	sc'	Bernardin prei Siens	- Per scenede t' gnënit.
21	E.	S.	sc'	Len	- Per me cinnrue nner vepra t' mira.
22	P.	S.	sc'	Eusebio	- Per ksetenim t' nahis s' on.
23	S.	S.	sc'	Desiderio	- Per t' rii e t' reja.
†	24	D.	E	Scëitnuscemia Trinii	- Per m' e disemue trimnisc feen e Jezu Krisetit.
25	H.	S.	sc'	Greghuur Pap.	- Per priän ci ta rrisin vla- din n' hür t' Tenzot.
26	M.	S.	sc'	Filip Neri	- Per t' hapunit i divozionit Eëmers
27	M.	J.	Krisçtit.		
		S.	sc'	Gnon I Pap.	- Per sepirtna t' Burgatorit.
28	E.	Korpi i Krisotit	- Per discirin m' u kunghue scpesc.		
29	P.	S.	sc'	Bonifacio	- Per nevoi t' scëites Kiisc.
30	S.	S.	sc'	Ferdinando	- Per t' hapunit e Scioenüs t' Eë- mers J. Krisçtit.
†	31	D.	S.	sc'	Petronil - Per diltin e scpirtit.


Me testiir t' Parit Fees.

Në vitin 1892 revista nxjerr numrin e saj të parë në Kallnor [Janar]


1892, duke shtuar: Vieta e II. Numri I, si edhe i kushtohet vëmendje tjetër paraqitjes vizuale të fletës së parë të çdo muaji pasi tashmë është me ngjyrë, pink. Këtë herë vihet re një shënjë tjetër konvencionale me funksionin e “th-se”

URAT PER TU 𐌆𐌆AN GI𐌆𐌆 DITT E MOJIT

që mund të jenë objekt i një studimi më të hollësishëm në një punim tjetër. Në botimin e vitit 1901 për të ndihmuar besimtarët revista vendos në faqen e fundit të saj fazat e formimit të hënës me pamjet përkatëse, të cilat janë një element ndihmës jo vetëm në aspektin fetar por edhe në atë “informative”e kulturor.[Në k’ të rast Astrologji]



Viti 1893, novela: “*Harapt e Afrikës N’robni*”. -Jepet informacion për keqtrajtimin që ju bëhet afrikanëve nëpërmjet tregtisë së sklllevërve. “Goja e insantit spunon me diftu kiametin ci jan tui hek edhe n’dit t’sodit harapt e Afriks ci zëhen n’robni. Gjinden nji qind mi vet rob qi shiten per gjith viet n’Afrike... Ata ci dun me i pas n’ dor k’ to harap t’shkret shum her bain luft t’mdha e t’pergjakuna”.



Viti 1894, “*Kunnra adetit me fol palavii*”. Jepen disa këshilla si mu sjellë në shoqëri, konkretisht mos me fol fjalë të këqija


“*Usullet e Scocniis*” [Sjellja e Shoqërisë]

1. Mos me shku me shok t’kqi

2. Mos me fol fjal t’kqija

3. Mu kujdes mos me fol as tiert fjalt’kqija

Me lut zotin per ata qi flasin fial t’kqija, qi t’kthehen



Viti 1897, “*Zoja e Shkodrës*”. Me 26 prill 1897, kremtohet 430 - vjetori i largimit të afreskut së figurës së “*Zojës së Shkodrës*”. “*Zoja e Shkodrës*” ndryshe e quajtur edhe “*Zoja e Këshillit të Mirë*”, është një afresk që u mor nga Kisha rrëzë kalasë së Shkodrës në vitin 1467, dhe shtegtoi në Genazzano të Italisë së bashku me besimtarët që emigruan për të mos iu nënshtruar pushtimit turk.

Kjo figurë u bë e njohur në të gjithë botën katolike dhe jo vetëm, kur u shpall si mrekullibërëse nga Papa Pali i II (1464 – 1471).



SHKODËR E SHKODËRË.

Me 26 t'Pribit n'Skodër e gjeckun n'Scespni lutel simiet t'paren her me seshret festa e Eois t' Skodërs, e sod e urapa kiò fest kaa per t'u mait gja-mon n'Scespni. Na bëhet prun e me ceof kan per t'u kanne kto pak lahëre si po leishin per Fughurën e mrekuzeseme t'5ojes s'on.


Museen n'ket muui 430 viet esse se Fughuria e Lois t'Skodërs n'laghua prui nese e voit n'Genazzin. Genazzini, venn i bukur e i berecetesem mient, dset gni secher i voshet t'Itales, ngjrelun kaluor t'gni kodret, gni dit erugh lergh prui komet nasin t'posacem kaa pse i pari kie muor t'gjea vennet e dargnaas er ghoditi e sengharoi gni kise Eois Beukuenie nen omen t'Nans t'Ksciat t'mir. Kiò pun n' baa (210n t'disemit) gna 500 o 600 viet mas t'leemit t'

Viti 1899, Nekrologji, “Past Drit”, kushtuar P. Jak Junku (Trento, 1837 – Shkodër, 1899), Drejtuesit të parë të Elcija-s

PAST DRI

[The text in this block is extremely faint and largely illegible due to the quality of the scan. It appears to be the beginning of a memorial or obituary text.]

Viti 1899, tregimi “Mrekullia e Sc’Francesk Asizit ci sbuti gni uik”. - Zbutja e Ujkut si simbolikë e fjalës së dhënë. “Ujku tui ra nguj, e tui luit bishtin e veshet si muite, diftote se besen donte me e mait per te sakte”



Në botimin e vitit 1901 për të ndihmuar besimtarët, revista vendos fazat e formimit të hënës me pamjet përkatëse, të cilat janë një element ndihmës jo vetëm në aspektin fetar, por edhe në atë informativ e kulturor, në këtë rast Astrologji.



Nga viti 1902, revista boton një vjershë satirike ‘Uiku’[Ujku], gjë që tregon se tashmë ndoshta ishte konsoliduar misioni i saj, jo vetëm fetar por edhe kulturor, ‘argëtues’ përçues i mesazheve nëpërmjet simbolikave të tilla, tek besimtarët dhe tek të gjithë qytetarët që e lexonin atë. Drejtues ishte P. Frano Gjenoviçi, i cili e mbajti këtë drejtim së bashku me Pater Xanonin deri në Korrik 1905, të cilët filluan të kujdesen që shkrimet e botuara të pastroheshin nga turqizmat. -Poezia ‘Uiku’, në mënyrë simbolike nëpërmjet veprimeve të ujkut tregohet për lakminë dhe gënjeshtëri. *‘Uiku met.-Cillon per dit, Ci dinaku kah kerkon, Me rreit tiert, ai vet sharron, Uiku lkuren s’e nrron dot’.*



Artikulli është përkthyer nga Kalendari Italian i kohës “La Buona Strenna Sal. 1905”

1 “Strenna” në fjalorin Italian ka dy kuptime: 1. Dhuratë që është marrë ose dhuruar për Krishtlindje.

2. Botim antologjik i prozës apo i antologjive, të dala me rastin e vitit të ri.

Strenna editoriale ¹lindi në fundin e shekullit XVIII dhe fillim shekullin XIX në Angli, ku viti i ri urohej me

dy forma të veçanta botimesh: 1. Kalendarët hënorë, ose vjetare me informacion të gjerë për masat popullore, që përmbajnë parashikime meteorologjike, tregime të shkurtra, këshilla për ekonominë shtëpiake, fjalë të urta të destinuara për t’u ardhë në ndihmë fermerëve, artizanëve dhe tregtarëve të vegjël.

2. Fletë të veçanta të botuara për shtresën e lartë të shoqërisë së asaj kohe, ishin me informacione speciale mbi dhuratat, një dedikim dashurie etj “Srenna” e parë në Itali për vitin e ri apo për ditët onomastike u botua në Milano, vitet 1831- 1847. Në vazhden e kësaj tradite siç duket u botuan kalendarët edhe në 2 shtëpinë botuese Zoja e Papërlyeme, ekzemplari i parë i të cilit u konfirmua që në vitin 1889: “Miku Bestaar” me autor Ndre Mjeda SJ (1866 -1937) ku pjesa e parëkalendarike (faqet 1-16) u shtyp në shtypshkronjën misionare papnore “Shën Jozefi” në Milano, kurse kopertina dhe faqet me përmbajtje të përgjithshme astronomike, lirike dhe të tjera (faqet 14- 47) qe shtypur tek Jezuitët në Shkodër.

“Termeku i Shkodrës”. Në këtë artikull jepet informacion për tërmetin e vitit 1905 që preku qytetin e Shkodrës. Lëkundjet e tërmetit filluan në orën 6.5 të mëngjesit dhe zgjatën rreth 12 minuta, epiqendra e tij ishte në Bahçallek, Ana e Malit, Bushat, Trush e zonat përreth. Ujërat e lumit Kir, Buna dhe Drini u frynë dhe dolën jashtë shtratit të tyre duke përmbytur fushat. Gjatë gjithë ditës pati rreth 40 lëkundje, ku më të fortat ishin në orën 10.30 dhe 11.15 të mëngjesit. Në qytet numri i

¹ It.wikipedia.org.

të vdekurve ishte: 10 qytetarë të krishterë, 80 Myslimanë; në Bahçallek 40 të vdekur e 250 nën rrënoja, e në total në qytet dhe zonat përreth, numri i të vdekurve shkon deri në 300 persona e po aq edhe numri i atyre që janë nën rrënoja. Për rreth 1 muaj e gjysmë u ndjenë lëkundje të herëpashershme tërmeti me magnituta të ndryshme. Ky tërmet ishte një ndër tërmetet më të fuqishme që kanë rënë në qytetin e Shkodrës dhe në Shqipëri.



Në vitin 1906 vijon të botohet në në Scyp t’Zois Zānun pa mkat t’rrie[dh]scem. Në botimin e vitit 1906, në fund të tij, bie në sy vendosja e një”Réelame”[Reklamë] me emrin “Hafis Hasan Kaduku mjek zāmse”[Mjek dhëmbësh]. Hasan Kaduku ishte dentisti i parë shkodran i diplomuar dhe i specializuar jashtë vendit, që në periudhën e sundimit turk. Vlen të përmendet inisiativa e tij përparimtare për për të hedhur bazat e shërbimit stomatologjik modern të Shkodrës, në një kohë kur dhëmbët nuk kuroheshin por hiqeshin me praktika primitive në këtë mënyrë duket se revista përmbush edhe një mision, atë të “reklames”.



Në vitin 1907, Nr 2, botimi realizohet në Shtypshkroje t'Zois Papërlyeme- Shkodër, drejtues P. Shtjefën Zadrima.

Në vitin 1908, jepet një adrese e saktë e vendosjes së shtypshkronjes, Adresse: Imprimerie de l'Immaculée Conception-Scutari(Albanie).

Në fillim të muajit korrik, tek Pjesa I, lajmërohet për daljen e Fjalorit Shqip – Italisht, përgatitur nga Shoqëria “Bashkimi”. Në lajmërim thuhet: ky fjalor është me 538 faqe, dhe është shumë i vlershëm, pasi përmbledh shumë fjalë që skanë qenë të përfshira në fjalorë të tjerë. Është një ndihmë e madhe për ato që duan të dinë si i thonë “sendeve” në shqip, të cilat deri atëherë i dinin vetëm në gjuhë të huaj. Shoqëria “Bashkimi” e themeluar nga Abati i Mirditës, Imzot Preng Doci, në vitin 1899 në Shkodër, me qëllime kulturore - letrare. “Fialuer i rii i shqypes


përbaam prei Shoqniiet t' bashkimit", fjalor dygjuhësh shqip-italisht, u botua në vitin 1908. Ky fjalor me rreth 14.000 fjalë, konsiderohet si një ndër më të mirët në leksikografinë shqiptare.



Në këtë numër fillon të botohet si shtesë dhe një pjesë e dytë "Elcija II", ku vihet re tashmë pa asnjë mëdyshje misioni kulturor, letrar dhe informativ në shërbim të besimtarëve dhe të gjithë atyre që e lexonin këtë revistë. Në faqen 15, "Do Madhni n'mretni t' natyres e t' arteve" jepet informacion mbi "Libertoria a biblioteka mâ e madhe ci ka nner t'tana mretnii âsct kombetaria e Parisit" apo informacioni mbi Kisca e SC' Pietrit N' Rom, ku me anë të një fotografie tregohet kisha dhe sheshi përreth saj, si edhe të dhënat rreth ndërtimit, përmasave dhe numrit të besimtarëve që mundet të zërë. Informacione për t'u përmendur në këtë botim janë gjithashtu edhe të dhënat

për Makusci (Sbruthio Camelus) [Struci], për "Cka ipset per t'bimun t'gruhnit" [Grunit], "Voji i Drannofillevë" [Përdorej si aromatizues, ilaç, etj] apo "T'msuemit o T'sbutunit e Filave" [Zbutja e Elefantëve në shërbim të njeriut].

Në botimin e vitit 1909 interesant është njoftimi i përgatitjes për botim të "Kalendarit", "i viefshem sidomos per tregtarë e shtepiakë, per vietë 1910", duke dhënë sqarimet përkatëse të përdorimit të tij. Ky kalendar në fletët e çdo muaji kishte të dhënë edhe emrin e secilit Shejt që shënjote ditën përkatëse, si dhe fletë bosh ku mund të mbaheshin shënime.



Që nga viti 1909 dhe në vazhdim kjo gazetë fillon të përdorë alfabetin e vendosur nga Kongresi i Manastirit, tashmë revista nuk shkruan më “Elcia” por “Elçija”, pra shihet qartë përdorimi i shkronjës dalluese “ç” përdorimi i së cilës u miratua në këtë Kongres [në Kongres u mor vendimi që shqipja të shkruhej me germa latine, dhe të plotësohej me 9 shkronja të njëpasnjëshme, diagrame; DH, GJ, LL, NJ, RR, SH, TH, XH, ZH, dhe dy diakritike; ç, ë]. Kongresi i quajtur ndryshe edhe Kongresi i Alfabetit, u mbajt në qytetin e Manastirit në shtëpinë e Fehim Zavalanit (F.Zavalani ishte 4 “Kryesonjësi” i Shoqërisë “Bashkimi” të Manastirit), gazetar dhe aktivist i Rilindjes Kombëtare, ndërmjet datave 14-22 nëntor 1908, me iniciativën e shoqërisë “Bashkimi” dhe kishte si qëllim standardizimin e alfabetit të gjuhës shqipe, duke u nisur nga mendimi mbizotërues i kohës, që përdorimi i shkronjave jolatine nuk ishte në të mirë të një gjuhe unike kombëtare.

Abeçëja e ree vîemun me t' vietren		
ç = c	bi qala	A m'a çova librin?
q = e	.	Pse lehi qani?
dh = z	.	Na ket dhuntii!
ë = e pasëne	.	Kena kenë.
g = gh	.	Mos gaboni.
gj = g	.	A Changri gjarpi?
ll = l	.	Sillni prei mejet.
mb = mm	.	Eni mbas mejet.
nd = nn	.	Sakramendet na janë?
uj = gn	.	U njall s' dekanit.
sh = sc	.	Mos shko më andei.
th = rz	.	Mirë jee tui thanë.
y = n	.	A t' dhom kryet!
x = z	.	Duhet me xanë më tepër.
xh = g	.	Turku falet n' xhamii.
z = c	.	Me zëmer t' mire.
zh = sc	.	Sdeshni ato zhele c' shkreta.
c = z	.	A ka cofë gomari? Po ka cofë.

Që nga viti 1909 dhe në vazhdim kjo gazetë fillon të përdorë alfabetin e vendosur nga Kongresi i Manastirit, tashmë revista nuk shkruan më “Elcia” por “Elçija”, pra shihet qartë përdorimi i shkronjës dalluese “ç” përdorimi i së cilës u miratua në këtë Kongres [në Kongres u mor vendimi që shqipja të shkruhej me germa latine, dhe të plotësohej me 9 shkronja të njëpasnjëshme, diagrame; DH, GJ, LL, NJ, RR, SH, TH, XH, ZH, dhe dy diakritike; ç, ë]. Kongresi i quajtur ndryshe edhe Kongresi i Alfabetit, u mbajt në qytetin e Manastirit në shtëpinë e Fehim Zavalanit (F.Zavalani ishte 4 “Kryesonjësi” i Shoqërisë

“Bashkimi” të Manastirit), gazetar dhe aktivist i Rilindjes Kombëtare, ndërmjet datave 14-22 nëntor 1908, me iniciativën e shoqërisë “Bashkimi” dhe kishte si qëllim standardizimin e alfabetit të gjuhës shqipe, duke u nisur nga mendimi mbizotërues i kohës, që përdorimi i shkronjave jolatine nuk ishte në të mirë të një gjuhe unike kombëtare.

Revista në botimin e saj vendos edhe një njoftim “Abeçëja e ree vîemun me t' vietren”, duke dhënë me shembuj përkatës mënyrën e zëvendësimit të shkronjave

Me datën 6 nëntor 1908, Klubi “Bashkimi” i dërgon një letër zyrtare Jezuitëve të Shkodrës, duke i shprehur keqardhjen për mosdërgimin e përfaqësuesve të këtyre të fundit në Kongres për çështjen e abecesë, por njëkohësisht i falënderon, pasi, si shtypshkroja ashtu “Elcija” i Jezuitvet qënë má e para shtypshkrojë e má e para revistë qi shtine në punë alfabetin e soçëm ”

-Kopshitari, “ Vreshtari”



Nga gjysma e vitit 1909 deri në gjysmën e vitit 1911 drejtues i revistës është përsëri P.Frano Gjenoviçi.

Viti 1910, pjesa II, “Udhat e hekurit” është një tregim interesant që tregon për zhvillimin rrjetit hekurudhor në botë: Robert Stephensoni ndërtoi n’vjetë 1829 një makinë, e cilla n’nji bashkërditë t’madhe kié ndeerue me çmim, e punonte kreit si lypei [si duhej]. Kione [Treni] është makina vëndloise, e cilla edhe sot vrruull mbi dyqa t’udhës s’hekurit. Dyqa u thonë

atyne dy hekurave si shtrur për tok’ e gjithmonë kraha kraha, mbi t; cillët vrrulloin rrotat e koçivë, italisht: binarii. Kryet e gjåas e t’åna hekurullave t’botës mbledhun bashkë, njehei 182 miliarda e 275 mii frank. Tesh qi kaq është hapë neper botë udha e hekurit, sikuer edhe n’do vise t’turkiis, na mban uzdaja, se s’kaa për t’ngiatë shum e kena për t’a paa edhe na tui e nisë prej Shkodret me voit m’u perpiekë me udhët e Shkupit e t’ Sh Njinit Atbotë kaa për t’u çilë e me lulzue tregtija.

e sajë, kuer e bâni rrugen prei Liverpoolit e deri n' Manchester. Tridhet e dy kilometra i soste per sahat, e vien si me thanë, nji sahat rrugë prei Shkodret n' Sh' Njin me e kapë vizen ndreit.

Por tui kënë vëndloisa permirsue fort n' ditë t' soqme, âstlû mundet per pak sahat me voit pa dredh' e zhdredhë prei Shkodret n' Prëzrënd.



Me makina eletrike u bâne n' vietë 1902 dyqind e dhetë kilometra m' nji sahat, por makina kso fejet janë mâa fort per shkollë se per dobii punet.

Prei nji librit t' Oktavit Codogno ëmnue *Udhtimi i rri per postat e t' tănë botës* i shtypun n' Venedik n' vietë 1676, daan se asò kohet tui e mârrë me karrocë rrugen mâ t' miren, kû gjâa mos t' a pritte udhtimin, e tui shkapercye malin e Çenisit, nieri i nisun prei Romet ja mrrite n' Parigj gadi m' 240 sahat, d. m. th udhtonte pa u ndalë kund dhetë dit rresht e tui ndrue kualt 117

Vijon në numrat e ardhshëm

Gjovalin ÇUNI

PAK RRESHTA PËR ISH-KOLEGUN DHE PËRKTHYESIN FERIT HAFIZI

Thjesht, është mirë kur vlerat dhe kontributet nuk humbasin, ndonëse ata tashmë janë të ngurtësuar në shtypshkrime, libra, si dëshmi e asaj pune të bërë ndër vjete. Në ditët tona kur krahas telasheve të tjera, (situatave të pakjarta thuejse në çdo lami të jetës, pandemisë etj.) puna me librin vijon. Bibliotekat dhe libraritë vijojnë me kenë aty, e ndonëse përkohësisht jo “hir plote” heshtazi dëshmojnë, kurbën që pëson e ka pësuar libri ndër vjete. Në pritje të më së mirës, ja vlen me u kujtu personat që i shërbýen, por edhe që i dhanë jetë librit në forma të ndryshme, si: autorë përkthyes, redaktorë, korrektorë gjuhësorë, radhitës, dizenjues, botues, shtypshkrues e deri tek lexuesit. Ndoshta duken shumë, por realisht një produkt, një titull libri, kapërthen në vetvendi aftësitë krijuese dhe për një kohë relativisht të gjatë një “mori” njerëzish që merren me atë. Vetëm ai që shkruen dhe e prodhon librin e provon kënaqësinë e papërshekrueme të një botimi të ri, sejcili tuj ju kënaqë punës që ka bërë. E “malli i shtampës”, siç e cilësonte Ernest Koliqi, bërë prap të veten, pra pak kohë len për përgatitjen e tjetrit.

Libri dhe punëtorët e tij, ishin shtýsa që më bane të shkruaj pak rreshta për kolegun dhe ish- drejtuesin e bibliotekës “Marin Barleti”, përkthyesin Ferit Hafizi. Vite më parë në fletët e shtypit periodik është zhvilluar një debat, mbi domosdoshmërinë e krijimit të një shtëpie botuese. Tek e rikujtoj këtë fakt u përpjeka me rikujtue elementët e trajtesës në qytetin tonë, që për hir të së vërtetës, kanë lanë gjurmë të pashlyeshme në këtë fushë. Mjafton me përmendë përkthyesit e famshëm të kryeveprave të letërsisë botënore, por edhe ata të përkthimit të dokumentave të shqipës. Me listu emna, me siguri ke me harrue

ndonji. Gjithsesi jeta ban të vetën, brezat largohen por trashëgimia e gjurma mbetet.

Puna përkthyesë e Feritit mban interesin për t'i sjellë lexuesit shqiptar, kandvështrimin e hedhun në letër të studiuesve të ndryshëm, kryesisht të huej të botës shqiptare, si dhe literaturën fetare.

Deri para viteve '90 të shekullit të kaluem në Shqipëri pati përkthime librash për Shqipërinë e shqiptarët, por ata ishin përgjithësisht të rralla dhe mjaft të cingueme edhe kur lejohej me u botue. Shembulli më i mirë është botimi i cinguem në një vëllimi me titull: "Brenga e Ballkanit" e Edit Durhamit.

Vite ma vonë, apo siç është bërë zakon me thanë "vitet e demokracisë", doli e domosdoshme njohja e plotë e veprave të autorëve të ndryshëm, por njëkohësisht edhe sjellja në shqip e tyre, të cilat në skutat ku ishin vendosë, ishin të destinueme për me u zhdukë, mbasi gjatë komunizmit lejoheshin konsultimet vetëm për një publik të zgjedhun.

Me nuhatjen e një bibliotekari të mirë, që njeh interesat e lexuesve, por edhe ato të kohës, Feriti i dha lexuesit materialin e domosdoshëm për trajtesat historiko-shkencore tuj ndihmue debatet shkencore pro dhe kundra, për mjaft probleme të së djeshmes dhe të sotmes, të lidhuna sidomos me historinë e qytetit tonë, dhe me lashtësinë e popullit bazue në doke, besime, bestytни, simbole e zakone, pa lanë mbas doret edhe përkthimet fetare, aq të domosdoshme për periudhën post-komuniste.

Ndodh shpesh herë, që përkthyesit me pasë gjatë punës tyre edhe këshillat e autorëve të përkthyer. Këtë luks Feriti nuk e pati, por gjithsesi puna e tij në fushën e përkthimeve u plotësue nga mendimet e personaliteteve të fushave të ndryshme (kujtoj të ndjerin Jusuf Shpuza), përmes trajtimeve në parathënien apo pasthënien e librave.

Nëse dalim edhe një herë tek shtëpia e përkthimit, ashtu siç bien dakord shumë vetë ajo do të motivonte më tej punën e përkthyesve, do të shënonte risi të reja në këtë fushë, por në rastin tonë kur këto mundësi janë të paarritura, kur përkthyesit nuk e kanë përkthimin thjesht për "hobi" por edhe si mjet jetese, puna e tyre, botimet, duhet me kenë e ndihmueme financiarisht për t'u botue. Por gjithsesi ndihmue apo pa ndihmue përkthyesit, kjo kategori intelektualësh duhet me gjetë një "strehë", që do t'i motivonte më mirë në përhapjen dhe promovimin e vlerave shpirtnore, letrare, dhe shkencore.

Kontributi i Feritit në fushën e përkthimit lidhet me botimin e 4 librave me karakter historik dhe fetarë. Nga Edit Durhamit, ka përkthyer

nga anglishtja “Lufta për Shkodrën” (Turq, sllavë e shqiptarë) (2005); “Për fiset, ligjet e zakonet e Ballkanasve” (2009); nga Hortense von Zambaur: “Rrethimi i Shkodrës”(10-tetor 1912 deri më 22 prill 1913): ditar, si dhe librin “Muhamedi (a.s) i dërguari i fundit“ i autorit Majid Ali Kan (redaktor Arben Halluni) (2008), fitues i çmimit ndërkombëtar: ”Vepra studimore për Siren”.

Të tjerë përkthyes, fatmirësisht edhe të rinj, sjell në vëmendje këtu Meritan Spahinë me përkthimin e arsytuem veprës “Komedia Hyjnore. Ferri Kantikut I” të Dantes në vitin 2019, Ledia Dushin, Vinçenc Markun, Amila Gjyrezi etj. që mes vështirësive vijojejnë me lëvrue përkthimin.

Por çka don me thanë me përkthye? Gjegja e parë dhe ngushëlluese do të ishte: *“të thuash të njëten gjë në një gjuhë tjetër. (Umberto Eco “Përvoja përkthimi “Tiranë, 2006. f. 9.). Një tjetër e përcakton përkthimin edhe si “ligjëratë e zhdrejtë e maskuar si ligjëratë e drejtë”.*

Por, cilido kjoftë arsytimi për me arritë përkthimin duhet shumë punë, mund e eksperiencë. Umberto Eco, fatin e përkthimit nuk e lën vetëm në dorë të njohjes së gjuhëve, pra asaj që përkthen e amëtares; jo vetëm tek talenti i përkthyesit, por ai përcakton deri në një farë mase edhe detyrën e tij. Përkthyesit arsyeton ai i duhet: *..”që jo vetëm të ketë shqyrtuar shumë shembuj përkthimi,por edhe të ketë kontrolluar përkthimet e të tjerëve duke i qëndruar besnik vetvetes në përpjekjet për të shndërruar një tekst në gjuhë të huaj, në një tekst që duhet të kuptohet dhe të lexohet nga të gjithë lexuesit”.* (U. Eco, po aty, f. 13). N’se mbesin prap te Eco-ja për me kuptue vështirësitë e përkthimit, fjala “bachelor” mund të përcaktohet në kontekstin njerëzor me fjalën shqipe *beqar*, në një kohë që në botën akademike barazohet me përfundimin e studimeve në një nivel shkencor.

Siç e cilësuem përkthimi është formë interpretimi i një shkrimi origjinal që është i ndërthurun me ndjeshmëninë dhe kulturën jo vetëm të përkthyesit, por edhe të lexuesit. Feriti e ka pasë parasysh këtë *“postulat”*. Shumë herë ka negociue me *fantazmën e autorëve të zhdrukun, por edhe me praninë e pushtetshme të tyne në tekste librash, me vetvedin në përpjekje për gjetjen e fjalës apo shprehjes së saktë, me lexuesin imagjinar, për të cilin është duke përkthyer.* (U. Eco, po aty).

Feriti Hafizi, ndonëse tashma është pensionuem, edhe në ditët e sotme si një ndër përkthyesit e rrallë që i ka mbetun qytetit, që siç thohet në Shkodër, *“numërohen me gishta”* vijon me punue tuj mbetë njashtu

si ka kenë, një intelektual që punon në heshtje.

Ishte pikërisht kjo arsyeja që më shtyni ta kem mik të bibliotekës së qytetit të Shkodrës “Marin Barleti“ gjatë kohës që drejtova, po ua sugjeroj edhe ju lexues të dashtun që ta keni “mik’ në bibliotekat tuaja.

▪ Filateli ▪

Lorenc KAÇULINI

ARKEOLOGJIA NË PULLAT SHQIPTARE

Para pak kohësh është botuar libri më i ri i autorit Hysen Dizdari, titulluar “Arkeologjia në pullat shqiptare”. Botimi i librit i paraqitur edhe në Shkodër, përkonte me rastin e 106 vjetorit të pullës-vulë të parë shqiptare emërtuar më 15 maj 1913, nga qeveria e Vlorës. Libri, i pari që pasqyron ndër vite, arkeologjinë shqiptare në filateli, është ndarë në tri periudha kohore.

Emisioni i parë

Emisioni i parë që përket vitit 1922, me emërtesën, “Qytete dhe ndërtime” përbëhet nga dy seri me nga 7 pulla, me dhëmbëzim dhe pa dhëmbëzim. Nga ky emision 5 pulla paraqesin kalatë emblematike shqiptare, si: Fortesa e Rozafës (Shkodër), Durrësit, Beratit, Gjirokastrës e Kaninës (Vlorë). Dy pullat tjera të serisë paraqesin Urën e Vezirit (Kukës), mbi Drinin e Bashkuar, e cilësuar si një ndër urat më të mëdha të ndërtuara në Ballkan gjatë Perandorisë Osmane, ndërkohë që pulla e dytë shfaq pamjet e një rruge nga Korça, i njohur si një nga qytetet më të lashta të Evropës Jug-lindore i themeluar në shekullin V-VI,

Në vitin 1930, Posta Shqiptare emëton serinë me 11 pulla, “Emision i zakonshëm”, që i kushtohet ndërtimeve shqiptare. Tre pulla i referohen qytetit të Butrintit që ndodhet në gadishullin e Ksamilit. Këtu gjenden

rrënojat e qytetit antik, njëri nga qytete më të lulëzuara të pellgut të Mesdheut, me moshë mbi 2000-vjeçare, i shpallur Sit i Trashigimisë Botërore të UNESCO-s. Dy pulla paraqesin Urën e Zogut (Milot) mbi lumin Mat, ndërtuar në vitin 1927, me nismën e vetë mbretit Zog, ndërsa katër të tjera të kësaj serie paraqesin portretin e Ahmet Zogut. Dy pullat e tjera që e mbyllin këtë seri në vlerat 3 dhe 5 Fr. Paraqesin Ruinat e Kështjellit të Zogut në Mat. Serija e mësipërme, pa vlerën e fundit 5 Fr, doli me mbishtypje 1924, më 24 Dhjetor 1934. Ndërsa më 12 Prill 1939, serija e plotë me 11 pullat doli me mbishtypjen “Mbledhja Kushtetuese”, 12–IV–1939. Një seri tjetër e viteve 1939/40 edhe kjo, emërtuar, “Emisioni i zakonshëm” doli me 14 pulla, ku me katër vlerat e fundit 5 Fr., paraqiten Ura e Mesit (Shkodër), Kështjella e Krujës, Baptisteri i Butrintit, (një ndër momentet më të rëndësishme të periudhës paleo-kristiane) dhe Teatri i Butrintit, që është një nga ndërtimet antike të ruajtura mirë, një konstruksion romak i fillimit të shekullit II.

Periudha e dytë

Periudha e dytë kohore 1945-1990, nisë më 25 Janar 1959, një emision me tre pulla “Java e kulturës” këto pulla paraqitet Dea Butrintit, skulpturë antike prej mermeri, që u gjet në Butrint në vitin 1928 nga arkeologu italian Luigi Ugolini. Emisioni i dytë doli më 20 Korrik 1965, me titull “Zbulime arkeologjike”. Emisioni përbëhet nga 5 pulla, ku paraqiten enë dhe armë ilire, mozaikë dhe skulptura mermeri të shek. II.

Posta shqiptare më 16 nëntor 1965, emëton emisionin “Mjete lundrimi”, me seri prej 6 pullash. Në to paraqiten anije ilire dhe anije të ndryshme të përdorura në portet shqiptare në shekujt e XVIII -XIX dhe XX.

Emisioni i katërt del më 25 Dhjetor 1969 i titulluar, “Mozaikët”. Emisioni përbëhet nga 5 pulla me mozaikë të ndryshëm që datojnë nga shek. II deri shek. VI të zbuluara në Apoloni dhe në Lin të Pogradecit, gjatë gërmimeve të viteve 1959-1960. Emisioni i pestë, “Mozaikët” doli më 10 Korrik 1970, një seri me 6 pulla me mozaikë të zbulura në Lin të Pogradecit; të shek. V-VI, periudhë e sundimit të Justinianit dhe pasardhësve të tij.

Vazhdojnë emetimet e serive të pullave me mozaikë, si ajo më 10 Dhjetor 1972, me 7 pulla ku paraqiten zbulimet e bëra në Butrint dhe Apolloni që i përkasin shekujve II-III dhe shekullit të V. Paraqiten

pjesë mozaiku me figura gjeometrike me skena nga mitologjia detare si peshk apo përkrenare luftëtari grek Emisioni i shtatë 20 shkurt 1974, seri me 6 pulla me mozaikë të zbuluara në Lin të Pogradecit, Butrint dhe Apolloni, datojnë të shekujve V-VI

Emisionet tjera

Emisioni në vazhdim është ai i 25 Dhjetorit 1976, “Zbulime arkeologjike” Serija përbëhet nga 8 pulla. Këtu pasqyrohen zbulimet e reja arkeologjike në Shqipëri, në Apolloni, Butrint, Durrës, Korçë, Mat, dhe në qytetin antik të Antigonës (Gjirokastrës). Në këto pulla paraqiten portrete, statuja, përkrenare ilire etj. të shek. II-III para Krishtit.

Në emisioni i nëntë në dhjetor 1976 “Kështjellat tona” emetohet një seri me 7 pulla ku paraqiten Kështjellat e Bashtovës ndërtuar në shek. XV, Gjirokastrës shek. XIII-XIX, e Ali Pashë Tepelenës shek. XIII-XIV, Petrelës shek. VI. Beratit, dhe qytetit, si vendbanim protourban i përmendur që në shekujt IV para Krishtit; Kalaja e Durrësit e ndërtuar nga venecianet në shek. XV. Pulla e fundit është Kalaja e Krujës, një nga më të njohura në Shqipëri. Në shekujt XIII-XIV Kruja u bë Kryefortesa e qëndresës heroike të popullit shqiptar kundër osmanëve.

Më 28 Dhjetor 1983 emëtohet emisioni “Qytete të vjetra” që përmban 3 pulla Teatri i Butrintit, Fontana e Apollonisë dhe Galeria e Amfiteatrit, Durrës. Emisioni i njëmbëdhjetë, i botuar më 25 Shkurt 1984, emërtohet “Zbulime arkeologjike” me 6 pulla ku pasqyrohen portrete, skulptura, enë balte, figure bronzi etj. Emisioni pasardhës me të njëjtën emërtesë “Zbulime arkeologjike” del më 25 shkurt 1985 me 4 pulla, ku paraqiten gjurmë të lashtësisë në Iliri si enë, statuja bronzi, kokë. Emisioni i 13-të përsëri me të njëjtin titull I përbërë nga 4 pulla me koka, statujë bronxi, objekte mermeri publikohet më 20 shkurt 1987 Në këtë emision kemi edhe zarfin e ditës së parë FDC Vazhdojnë zbulimet arkeologjike në emisionin e 14- të, që është edhe i fundit i periudhës së dytë, i publikuar me 10 Mars 1989, me 3 pulla ku paraqiten varre e objekte, paftë bronzi dhe vathë ari të zbuluara në Selicë të Poshtme të rethit Pogradecit gjatë gërmimeve arkeologjike në vitet 1969-1972. Kemi edhe FDC.

Periudha e tretë

Periudha e tretë 1991-2018 Pas vitit 1990 ritmeve i kërkimeve arkeologjike pëson rënie. Gjetjet arkeologjike janë të pakta gjë që pasqyrohet edhe në seritë e pullave që vijnë t’i referohen gjetjeve të

hershme apo objekteve arkivore dhe ikonave të depozituara prej kohësh në muzeume

Emisioni i parë që doli më 30 Janar 1991, “800 vjetori i shtetit të Arbërit” përbëhet me 2 pulla dhe 1 FDC në të cilat paraqitet shqiponja, simboli i forcës dhe i fuqisë i shtetit të Arbërit. Emisioni i dytë i 5 Nëntor 1996, “Kodikët” përbëhet nga 3 pulla dhe një FDC paraqet kapakët e Kodikut të Beratit Kodikët janë libra të shkruar në pergamenë me përmbajtje fetare, por edhe laike. Emisioni i tretë “Epitafi i Gllavenicës” i 15 Nëntorit 1998 ka 2 pulla, 1 bllok, 1 FDC. Në epitaph dallohet Krishti i vdekur i shtrirë në çarçaf. Ky epitaf ruhet në Muzeun Historik Tiranë. Vazhdon emisioni tjetër po me 3 pulla, 1 FDC emëtuar me 15 Tetor 1988, “Kodikët” që paraqet Kodikun e pestë të Vlorës i shek. XI. Emisioni i gjashtë “Monedha Ilire”, 1 Qershor 1999” ka 3 pulla, 1 bllok, 1 FDC Emisioni i shtatë emëtuar më 30 Tetor 1999 “Ikonat e Onufrit” ka 2 pulla, blloku, FDC dhe dy kartë. Në këtë emision paraqiten ikonat e Onufrit, piktor mesjetar shqiptar. Emisioni i tetë, 19 Nëntor 2007, “Monumente Kulture” ka 2 pulla, 1 bllok, 1 FDC. Janë shpellat e Lepenicës dhe Trenit në rrethin e Vlorës dhe Devollit. Emisioni më pas është ai i 16 Nëntorit 2007, “Zbulime arkeologjike në qytetin e Durrësit-Gea”. Seria ka 2 pulla, 1 bllok dhe 2 FDC. Skulptura e Geas, statuja pa kokë e Perëndeshës së Tokës dhe Begatisë Gea, u zbulua në Durrës, nga gërmimet aty. Emisioni i dhjetë 5 dhjetor 2008, “Zbulime arkeologjike” seri me 3 pulla, 1 FDC paraqet Sinagogën e Sarandës, të shek. IV që i përket besimit hebraik dhe Orika, një qytet antik, rrënjët e të cilit gjenden në Orikum, Vlorë Pulla e tretë është Antigonea, qytet antik, (Gjirokastrë). Emisioni njëmbëdhjetë, 16 dhjetor 2009, “Zbulime të reja arkeologjike” seri me 2 pulla, 1 FDC paraqet Kalanë e Tiranës shek. XVIII, Tuma e Kamenicës dhe një enë treshe e përbërë nga 3 kupa të vogla. Emisioni i dymbëdhjetë 2 Mars 2011, “Arkeologjia nënujore e Shqiperisë” është me 2 pulla, 1 FDC. Emisioni trembëdhjetë 14 Tetor 2011, “Mozaikë të periudhës Paleokristiane në Shqipëri” ka 3 pulla, 1 FDC Këtu paraqiten mozaikët nga shek. II deri shek. VI. Emisioni i katërbëdhjetë, 29 Tetor 2012, “Arti Shkëmbor në Shqipëri” me 3 pulla, 1 FDC janë pikturat e Rubikut, Bovillës dhe shpellës Lepenicë. Emisioni mëpasshëm “Zbulime të reja arkeologjike”, më 6 dhjetor 2013, përmban katër pulla, FDC ku paraqiten zbulime në Apolloni, Lezhë shek. II-III e. re. Emisioni i gjashtëmbëdhjetë 5 dhjetor 2014, “Arkeologjia shqiptare” – Artimesa dhe Dyrraclionit seri me 4 pulla, 1

FDC paraqet shtatore, portrete, statuja, buste. Emisioni i 17-të “Objekte muzeore –ikonostase në muratura”, përbëhet nga 6 pulla, FDC, ku pasqyrohet Kisha në Himarë, Dhërmi, Vuno, Mene. Emisioni i fundit i 18 Nëntorit 2015, “Arkeologjia shqiptare zbulimet e fundit” 4 pulla, FDC ku paraqiten doreza, shtatore mermeri, figura prej bronzi.

“Arkeologjia në pullat shqiptare”, është libri i katërt i publikuar nga Hysen Dizdari. Përmbajtja paraqitja grafike, dhe ilustrimet me ngjyra të librave të autorit Dizdari janë jo vetëm një paraqitje e çmuar kronologjike e trajtesave përmes pullave dhe mjeteve të tjera bashkëkohore në fushën e filatelistë, por një ndihmesë shumë e çmuar e historisë së filatelistë shqiptare

▪ **Kronikë kulturore** ▪

MYSAFIRËT E FESTIVALIT LETRAR TË SHKODRËS

Biblioteka Publike “Marin Barleti” organizoi me datat 24, 25, 31 tetor dhe 1 nëntor 2020, “Biseda letrare” me shkrimtarë shumë të njohur shqiptarë në kuadrin e aktivitetit “Festivali letrar” që tashmë ka krijuar traditën e tij pozitive. Këto veprimtari ishin konceptuar në formën e një bashkëbisedimi për veprat e autorëve, por edhe për çështje të letërsisë në përgjithësi.

Takimi së shtunës, datë 24.10.2020 kishte të ftuar shkrimtarin dhe studiuesin nga Prishtina, Ag Apolloni, i cili paraqiti krijimtarinë e tij shumëdimensionale si: poet, prozator, dramaturg dhe studiues i letërsisë. Ndër të tjera Ag Apolloni vlerësoi rëndësinë që ka promovimi i letërsisë shqipe, qoftë edhe përmes këtij aktiviteti interesant në Shkodër.

Në bisedën e së dielës, datë 25.10.2020 protagonist ishte shkrimtari i mirënjohur Stefan Çapaliku, i cili erdhi në këtë Festival me një prurje të re studimore, pikërisht me librin “Imago ed verbum”. Biseda më tutje u përqëndrua edhe në rëndësinë që ka takimi i letërsisë bashkëkohore me lexuesin e ri. Gjatë dialogut u qartësua se letërsia bashkëkohore ka përballë sfida të mëdha dhe duhet të synojë ruajtjen e vlerave të mirëqena estetike. Të dyja bisedat u moderuan nga pedagogu i Letërsisë, Gëzim Puka.

Fundjava tjetër kishte të ftuar shkrimtarin dy gjuhësh (shqip dhe italisht), Durim Taçi. Autori promovoi librin e tij më të fundit “Prani në ikje”. Ky roman me një qasje të mirëfilltë filozofike, ngjarjet e të cilit përfshijnë një tematikë shumë aktuale nga qyteti Bergamo ku jeton autori, u komentua dhe u ndërmejtësua për të pranishmit nga pedagogia e letërsisë Ermira Alija. Durim Taçi e vlerësoi shumë rolin e lexuesit, të cilin për vetë teknikën e veçantë të përdorimit të vetës së dytë, e kishte konceptuar të brendashkruar në vepër.

Takimi përmbyllës u zhvillua me praninë e shkrimtarit të njohur Rudolf Marku i cili jeton në Londër prej vitesh. Takimi u moderua nga Gjovalin Çuni, ish- drejtuesi i bibliotekës “Marin Barleti”. Me këtë rast autori prezantoi librin e tij më të ri “Rrathë të brendashkruar” si dhe aspekte të ndryshme të krijimtarisë së tij. Ai foli gjithashtu për vlerat dhe rolin e poezisë si art në kohë të ndryshme të qytetimit.

Drejtori i Bibliotekës “Marin Barleti”, Maxhid Cungu, bëri një tjetër vlerësim të këtyre veprimtarive duke u ndalur tek kontributi i autorëve të mësipërm dhe vlera e tyre për lexuesin. Ai theksoi se veprimtari të tilla, edhe pse në kushte e jashtëzakonshme, përcjellin kënaqësi estetike, por edhe mesazhe optimizmi për publikun e gjerë.

Në të gjitha takimet e zhvilluara pati diskutime nga profesorë, studiues dhe dashamirës të letërsisë, të cilët me pyetjet dhe ndërhyrjet e tyre ia rritën cilësinë veprimtarive. Festivali letrar i Shkodrës dëshmoi edhe këtë here se vlera e librit është e pazëvendësueshme.



